

TË DREJTAT E GRUAS, ASPEKTE LIGJORE DHE RESPEKTIMI PRAKTIK. RASTI I SHQIPËRISË.

Brikena (Buda) Dhuli

Dorëzuar
Universitetit Europian të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Shkenca Juridike, me profil “E drejtë publike”, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof.Asoc.Dr. Jorgo Dhrami

Numri i fjalëve: 65.826

Tiranë, QERSHOR 2016

DEKLARATA E AUTORËSISË

Deklaroj nën përgjegjësinë time personale se ky disertacion është shkruar prej meje dhe nuk është prezantuar asnjëherë përpara një komisioni apo institucioni tjetër për vlerësim. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe referuara në brendi të tij.

Brikena (Buda) Dhuli

Abstrakt

Të drejtat e gruas dhe çështjet e barazisë gjinore kanë tërhequr vëmendjen dhe janë bërë objekt trajtimi në studime, analiza dhe punime të ndryshme pikërisht pasi mbetet prioritet për t'u realizuar praktikisht. Me ndryshimin e rolit dhe pozitës së gruas në shoqëri, ajo që diskutohet sot është garantimi i barazisë reale mes burrit dhe gruas dhe përfshirja e saj gjithnjë e më e madhe në jetën publike, sociale e politike të vendit. Roli i gruas në politikë dhe vendimarrje është një nga çështjet më të diskutueshme të kohës tonë, gjë që duhet parë e vlerësuar në një kontekst të gjerë ekonomik, politik, social e kulturor.

Në këtë punim analizohet garantimi i të drejtave të grave, roli që luan pjesëmarrja e grave në shoqëri, politikë dhe në vendimarrje si një element thelbësor për një qeverisje të mirë dhe një demokraci funksionale. Gjithashtu pjesëmarrja e grave në vendimarrje është një kusht i rëndësishëm për arritjen e barazisë gjinore në shoqëri. Përvoja tregon se pjesëmarrja e grave në politikëbërje kontribuon në një vëmendje më të madhe ndaj çështjeve që shqetësojnë grupet më të brishta në shoqëri.

Gjithashtu në temë analizohen shkaqet e pabarazisë gjinore në shoqëri dhe si ato të mund t'i adresojmë si probleme për të garantuar barazi gjinore reale ndërmjet burrit dhe gruas në të gjitha fushat dhe në të gjitha nivelet.

Fjalë kyçe: *të drejtat e gruas, të drejtat themelore, barazia gjinore, integrimi gjinor, diskriminim, barazia para ligjit etj.*

Abstract

Women's rights and Gender equality has attracted attention and is the subject of treatment in various studies, analysis and various works to address this issue, which always remains a priority to be realized in practice. By changing the role and position of women in society, what is being discussed today is to guarantee real equality between men and women and the higher inclusion of women in public, social and political life of the country. The role of women in politics and decision-making is one of the most controversial issues of our time, that must be assessed in a broader economic, political, social and cultural context.

This thesis examines the rights of women and their practical implementation, the role played by women's participation in society, in politics and in decision-making as an essential element for good governance and a functioning democracy. Also the participation of women in decision making is an important condition for the achievement of gender equality in society. Experience shows that women's participation in policy-making contributes to a greater attention to the issues that concern most vulnerable groups in society.

Also this thesis focus on the causes of gender inequality in society and how they can be addressed as problems to be solved, to guarantee real equality between men and women in all fields and at all levels.

Keywords: *women's rights, fundamental human rights, gender equality, gender integration, discrimination, equality before the law ect.*

DEDIKIMI

Këtë punim ia dedikoj familjes time që më ka mbështetur gjithmonë dhe i falënderoj për atë që kam arritur deri më sot.

FALENDERIME

Studimet doktorale në UET shënojnë një çast vendimtar për formimin dhe avancimin tim akademik.

Falenderime të singerta shkojnë për udhëheqësin shkencor, për pedagogët me të cilët kam patur kënaqësinë të njohem dhe punoj gjatë studimeve doktorale, vecanërisht pedagogëve të Departamentit të së Drejtës Publike, prej të cilëve kam mësuar shumë si dhe stafit administrativ të UET për mbështetjen e tyre, për të përfunduar me sukses këtë punim.

Familjes sime e cila ka qenë dhe mbetet frymëzim e mbështetje për mua.

Miqve dhe kolegëve të mi, për të gjithë mbështetjen dhe mirëkuptimin e vazhdueshëm dhe të pakursyer.

Me mirënjohje

Brikena

TABELA E PËRMBAJTJES:

TË DREJTAT E GRUAS: ASPEKTE LIGJORE DHE RESPEKTIMI PRAKTIK. RASTI I SHQIPËRISË.

Deklarata e Autorësisë	1
Abstrakt.....	2
Abstract.....	3
Dedikimi	4
Falenderime.....	5
Tabela e Përmbajtjes	6
Lista e Shkurtimeve	10

KAPITULLI I:- HYRJE

1.1.Hyrje.....	12
1.2. Objekti i studimit.....	18
1.3. Qëllimi dhe rëndësia e punimit	20
1.4. Metodologjia dhe metodat e kërkimit.	22
1.5. Hipoteza dhe Pyetjet kërkimore.....	23
1.6. Kufizimet e punimit.....	24
1.7 Përmbledhja dhe struktura e studimit.....	25

KAPITULLI II: STANDARTET NDËRKOMBËTARE PËR TË DREJTAT E GRAVE SI PJESE E TË DREJTAVE THEMELORE TË NJERIUT

2.1.Hyrje.....	28
2.2.Standartet ndërkombëtare lidhur me të drejtat e grave. Aktet e OKB që promovojnë barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin.....	29
2.2.1. Karta e Kombeve të Bashkuara.....	31
2.2.2. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut.....	34
2.2.3. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike	36
2.2.4. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale e Kulturore	37
2.2.5. Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave	39

2.3. Standartet europiane në lidhje me të drejtat e gruas dhe barazinë gjinore.....	42
2.3.1. Këshilli i Europës.....	43
2.3.1.1. Karta sociale evropiane.....	44
2.3.1.2. Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut.....	45
2.3.1.3. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe roli i saj në respektimin e garantimin e të drejtave të grave si pjesë e të drejtave të njeriut.....	47
a) <i>Parimet e përgjithshme të zbatimit të Nenit 14 KEDNJ: natyra e tij plotësuese</i>	50
b) <i>Parimi i autonomisë.....</i>	51
c) <i>Dallimet nga diskriminimi.....</i>	53
2.3.1. 4. Aktivitete të KE-së për promovimin e barazisë gjinore.....	56
2.3.2. Bashkimi European, të drejtat e gruas dhe barazia gjinore.....	57
2.3.2.1. <i>Traktatet Themeluese dhe ato rishikuese të BE-së.....</i>	59
2.3.2.2. <i>Traktati i Lisbonës.....</i>	62
2.3.2.3. <i>Karta e të drejtave dhe lirive themelore të BE-së.....</i>	64
2.3.2.4. <i>Aktet dytësore. Direktivat.....</i>	67
2.3.2.5. <i>Diskriminimi i drejtpërdrejtë.....</i>	68
2.3.2.6. <i>Diskriminimi jo i drejtpërdrejtë.....</i>	70
2.3.2.7. <i>Ngacmimi.....</i>	72
2.3.2.8. <i>Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane e Drejtësisë në lidhje me barazinë dhe mosdiskriminimin.....</i>	76
2.3.3. OSBE-ja dhe aspektet gjinore.....	85
2.3.4. Të drejtat e grave, mbrojtja dhe garantimi i tyre në legjislacionin e brendshëm. Një vështrim i shkurtër.....	86

KAPITULLI III: BARAZIA GJINORE DHE INTEGRIMI GJINOR. KORNIZAT KONCEPTUALE JURDIKE DHE INSTITUCIONALE

3.1. Barazia gjinore dhe korniza konceptuale e saj.....	88
3.2. Rëndësia e integritimit gjinor.....	93
3.3. Barazia gjinore si një gur themeli në procesin e zhvillimit të vendit.....	96

3.4. Barazia gjinore si një domosdoshmëri për integrimin gjinor.....	99
3.5. Barazia gjinore si një domosdoshmëri për integrimin e Shqipërisë në BE.....	102
3.6. Mekanizmat institucionalë shtetërorë që sigurojnë zbatimin e ligjeve, parimin e mos-diskriminimit dhe barazisë midis burrave dhe grave.....	104

KAPITULLI IV: TË DREJTAT E GRAVE, MBROJTJA E GARANTIMI I TYRE NË LEGJISLACIONIN E BRENDSHËM DHE JURISPRUDENCË

4.1. Mbrojtja dhe respektimi i të drejtave të grave si pjesë e të drejtave themelore në Kushtetutën e RSH.....	108
4.2. Respektimi i të drejtave të grave në aktet ligjore. Kodet e Republikës së Shqipërisë.....	110
4.3. Respektimi i të drejtave të grave në aktet e tjera ligjore.	116
4.4. Disa strategji kombëtare të rëndësishme në funksion të mbrojtjes dhe fuqizimit të rolit së gruas në shoqëri.	121
4.5. Analizë e lirive dhe të drejtave vetjake të gruas si pjesë e të drejtave themelore të individit	
4.5.1. E drejta e pronës private.....	123
4.5.2. Mbrojtja e të dhënave personale.....	124
4.5.3. E drejta e informimit.....	125
4.6. Analizë të drejtave dhe e lirive politike. E drejta aktive dhe pasive e votimit dhe e drejta e organizimit kolektivisht.....	126
4.7. Liritë dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore.....	126
4.7.1. E drejta për punë dhe punësim.....	126
4.7.2. E drejta për kujdes shëndetësor dhe mbrojtja e shëndetit të gruas.....	128
4.8. E drejta për martesë dhe e drejta familjare	129
4.9. Mbrojtja e gruas ndaj dhunës në familje.....	132
4.10. Çështje të (mos)diskriminimit dhe barazisë gjinore në praktikën tonë gjyqësore dhe jurisprudencën kushtetuese.....	133

KAPITULLI V Analizë krahasimore e situatës aktuale të barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit në Shqipëri me disa vende europiane.

5.1. Hyrje.....	139
5.2. Arritjet kryesore në legjislacion.....	141
5.3. Praktikrat kundër diskriminimit në Shqipëri.....	144
5.4. Situata aktuale e (pa) barazisë gjinore në Shqipëri.....	147
5.4.1 Kuotat gjinore.....	149
5.4.2 Barazia gjinore dhe mosdiskriminimi në punësim.....	153
5.4.3. Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimi në çështjet martesore dhe familjare. Caktimi i vendbanimit të bashkëshorteve	155
5.4. 3.1 Barazia dhe mosdiskriminimi në marrëdhëniet pasurore midis bashkëshortëve.....	156
5.4.3.2. Çështjet e barazisë dhe mosdiskriminimi në trashëgimi.....	161
5.4.4. Analizë e standardeve lidhur me mosdiskriminimin në çështjet e kujdesit shëndetësor.....	163
5.5. Standarte të disa legjislacioneve europiane në lidhje me barazinë ligjore.....	163

KAPITULLI VII: KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

7.1. Konkluzione.....	171
7.2. Rekomandime.....	178
BIBLIOGRAFIA.....	183

LISTA E SHKURTIMEVE

AP- Avokati i Popullit

BE – Bashkimi European

BGJ - Barazia Gjinore

CEDAW - Konventa për Eliminimin e të Gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Gruas

DPSHBF - Drejtoria e Politikave për Shanse të Barabarta dhe Familjen

DUDNJ - Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut

DHF - Dhuna në Familje

ECRI - Komiteti për Eleminimin e Diskriminimit Racial

GJED - Gjykata Evropiane e Drejtësisë

GJEDNJ- Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore

GJK- Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë

GJL - Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë

INSTAT - Instituti i Statistikave

KE - Këshilli i Europës

KEDNJ- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore

KEE - Komuniteti Ekonomik Evropian

KEFDG - Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave

KF - Kodi i Familjes

KKBGJ - Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore

KP- Kodi Penal

KPA- Kodi i Procedurës Administrative

KPP- Kodi Procedurës Penale

KPu - Kodi i Punës

KZ- Kodi Zgjedhor

LBGJ - Ligji i Barazisë Gjinore

MB - Ministria e Brendshme

MD - Ministria e Drejtësisë

MPCSSHB - Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

NVGJ - Nëpunësit Vendorë Gjinorë

ODIHR- Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut

OJF - Organizata Jofitimprurëse

OKB – Organizata e Kombeve të Bashkuara

ONP – Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO)

OSBE –Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

PE – Parlamenti European

RKSGBGJ Raporti Kombëtar i Statusit të Gruas dhe Barazisë Gjinore

RSH- Republika e Shqipërisë

STRATEGJIA - Strategjia Kombëtare Për Barazinë gjinore, Reduktimin e Dhunës me Bazë Gjinore e Dhunës në Familje 2011-2015

UNICEF - Organizata e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve

UNIFEM - Fondi i Kombeve të Bashkuara për Gruan

VKM -Vendim i Këshillit të Ministrave

Kapitulli I

1.1 HYRJE

Barazia Gjinore është gur themeli në procesin e zhvillimit të vendit. Çështjet e barazisë gjinore janë në qendër të politikave sociale të vendeve të BE-së, si dhe një nga kërkesat për vendet që kanë hyrë në procesin e integritit europian. Integrimi gjinor, d.m.th., procesi që siguron që perspektiva gjinore dhe qëllimi për barazi gjinore të jenë në qendër të të gjitha aktiviteteve – zhvillim politikash, kërkime, advokim/dialog, legjislacion, shpërndarje e burimeve si dhe planifikim, zbatim dhe monitorim i programeve dhe projekteve, si një strategji për të promovuar dhe arritur barazinë gjinore, duhet të jetë pjesë e të gjitha politikave sociale, ekonomike dhe politike në Shqipëri. Nga studime të shumta rezulton se edhe pse gratë nuk janë të barabarta në vendimmarrje dhe në politikëbërje. Gratë, po ashtu, në të gjithë botën, janë pak të përfaqësuara në këto dy sektorë të rëndësishëm të jetës, mbajnë pak vende në parlament dhe pak poste udhëheqëse në partitë politike, në krahasim me burrat. Ndërkohë që ato janë të pranishme, në përqindje të lartë, në fushat e legjislacionit (notere, avokate, juriste, prokurore), në mjekësi, arsim, në sistemin bankar etj. Por pavarësisht nga kjo prani e ndjeshme dhe e dukshme, ato janë pak të përfaqësuara në role drejtuese. Historikisht pushtetin e kanë mbajtur burrat, për këtë arsye gratë kanë fare pak përvojë në drejtimin e shtetit dhe të ndërtimit të politikave. Shoqërisht, ky pushtet i shoqëruar nga burrat është pranuar nga shoqëria njerëzore si një e drejtë e pakthyeshme, madje duke hartuar ligje dhe duke vendosur rregulla të rrepta penguese dhe diskriminuese. Kulturalisht, shumica e popujve, pavarësisht nga origjina, feja apo traditat e ndryshme, ka mbështetur në shekuj epërsinë e burrave në strukturat me autoritet. Politikisht burrave u ka interesuar fort kjo kulturë dhe ky mentalitet shoqëror për të ruajtur dhe për të ushtruar pushtetin e

tyre të paprekur. Ata kanë krijuar strategji, taktika, struktura dhe politika të shumta për ta ruajtur këtë pushtet të tyre. Ndryshimet rrënjësore dhe cilësore kanë ndodhur vetëm në shekullin e 20-të, kur në shumë vende të botës, kjo situatë ndryshoi me të drejtën e votës së grave, arsimimin e tyre, pjesmarrjen në jetën ekonomike dhe shoqërore. U arrit fare pak në pjesmarrjen në politikë dhe në vendimmarrje. Gratë sot kanë të drejtë vote dhe të drejtën të punojnë e të drejtojnë zyra e departamente të ndryshme, megjithatë përjashtimi i tyre nga politikat është ende shumë i dukshëm.

Të drejtat formale në kuadër të të drejtave themelore të njeriut janë bërë pjesë tashmë e kushtetutave dhe legjislacioneve kudo në botë, por gratë janë ende të papërfaqësuar denjësisht në parlamente kombëtare dhe pozita të tjera udhëheqëse e drejtuese apo dhe vendimarrëse. Ende ka mekanizma joformalë që e përjashtojnë gruan nga pushteti. Kriteret për të garuar në politikë përcaktohen kryesisht nga njerëzit që e zotërojnë pushtetin, pra nga burrat. Gratë nevojiten në jetën e vendit po aq sa burrat, dhe se gratë, ashtu si burrat, kanë përjasjet e tyre të ndryshme në zgjidhjen e problemeve. Nëse e konsiderojmë të rëndësishme përmirësimin e cilësisë së jetës dhe demokracisë për të gjithë qytetarët dhe duam që të dëgjohen të gjithë njerëzit dhe të vlerësohen përvojat e tyre, atëherë gratë duhet të kenë zërin e tyre.

Të drejtat e grave, realizimi i tyre dhe rritja e barazisë gjinore shtrohen sot me forcë jo vetëm për faktin se gratë përbëjnë gjysmën e shoqërisë, por nisur nga koncepti modern i vlerësimit të të drejtave tyre si pjesë integrale e të drejtave të njeriut. Përtej dallimit mashkull- femër dhe burrë-grua qëndron një thelb i përbashkët njerëzor dhe human. Është pikërisht kjo “esencë” njerëzore që i bën dhe duhet t’i bëjë gratë mbartëse legjitime të të drejtave të barabarta me burrat në kontekstin e një shoqërie të lirë dhe demokratike. Kombet e qytetëruara dhe me demokraci të zhvilluar kanë treguar se arritja e këtij synimi nuk është një utopi. Mjeti i domosdoshëm për

realizimin e këtij qëllimi është krijimi i shoqërisë dhe mundësive të barabarta për të dyja gjinitë dhe nëpërmjet bashkëveprimit të të dyja gjinive, të burrave dhe grave, në të gjitha fushat dhe sferat e organizimit shoqëror.

Barazia e vërtetë gjinore realizohet në kushtet e lirisë. Kalimi nga diktatura në demokraci, për shembull në vendin tonë ishte kalimi nga “mbretëria e domosdoshme në atë të lirisë” edhe për gratë shqiptare, të cilat, duke u bërë pjesë e këtij ndryshimi epokal, projektuan shpresa të reja dhe një perspektivë të re për arritjen e barazisë gjinore. Në realitetin e ri social – politik të këtyre viteve në demokraci janë krijuar shance dhe mundësi të reja për afirmimin e rolit të gruas në shoqëri, janë shembur mjaft tabu të së kaluarës dhe po strukturohet një kulturë e re e afirmimit të barazisë gjinore.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë është akti ligjor më i lartë, i cili sanksionon parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit, si parim përshkues i të gjithë legjislacionit. Ajo i ka hapur rrugë zhvillimit të së drejtës së brendshme në përqsje me standardet ndërkombëtare. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ndalon diskriminimin për shkak të gjinisë (neni 18/2). Kjo shprehet qartë kur i referohesh terminologjisë që përdoret në të. Në terminologjinë e Kushtetutës shqiptare nuk ka kategorizime apo “etiketime gjinore”. Në këtë dokument të rëndësishëm përdoren përemra të tillë, si: “të gjithë, kushdo, askujt, kujtdo, secili” etj. dhe kjo për të treguar se bashkësia njerëzore së cilës i drejtohet dispozita, nuk bën asnjë përjashtim. I gjithë sistemi ligjor shqiptar është bazuar në parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit. Gjithashtu, mbrojtja dhe respektimi i dinjitetit, i të drejtave dhe lirive të njeriut përbën detyrim kushtetues. Jeta, martesja, familja gëzojnë mbrojtje të veçantë nga ana e shtetit. Kushtetuta nuk e përjashton mbrojtjen e familjes edhe në rastet kur nuk është krijuar me martesë. Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti, Gjithashtu këto afirmime të

Kushtetutës parashtrajnë detyrime për ligjvënësin. Ligji “Për barazinë gjinore në shoqëri” ka paraqitur vështirësi për zbatimin e tij në praktikë në lidhje me mekanizmat institucionalë dhe përgjegjësitë e tyre. Mundësitë për t’u ankuar në rastin e një diskriminimi gjinor dhe në aspekte të tjera, ndonëse parashikon si detyrë të qeverisë dhe të administratës publike nxjerrjen e statistikave gjinore në të gjithë administratën publike dhe në sektorin privat, ai nuk përcakton strukturat e caktuara shtetërore për kryerjen e kësaj detyre dhe afatet kohore të realizimit të saj. Herë pas here, ligji ka natyrë përshkruese dhe nuk përcakton detyra të qarta për respektimin e barazisë gjinore. Të gjitha këto probleme kanë bërë që të ndërmerren nisma për amendimin e tij.

Shqipëria është mjaft e pasur me strategji dhe dokumenta për integrimin gjinor por kjo nuk është e mjaftueshme pasi stereotipet e roleve gjinore dhe natyra patriarkale e shoqërisë u identifikuan si pengesat kryesore për të arritur përrputhjen *de facto* me *de juro*. Shumë femra dhe meshkuj nuk e njohin diskriminimin gjinor si të tillë, por në fakt e shohin atë thjesht si një “mënyrë jetese.” Pabarazia është veçanërisht e dukshme në tre fusha: politike (udhëheqje dhe vendim-bërje), ekonomi (punësim dhe gjenerim i të ardhurave), dhe marrëdhëniet në martesë dhe familje.

Deri në mes të shekullit XX-të, shtetet dhe organizatat ndërkombëtare janë konsideruar si aktorë kryesore të së drejtës ndërkombëtare. Individët kishin status të veçantë dhe të rastit, si aktorë të së drejtës ndërkombëtare, kur kishin karakteristika grupi, si refugjatët dhe azilkërkuesit. Individët hynë në fokusin e së drejtës ndërkombëtare pas krijimit të Kombeve të Bashkuara dhe pas miratimit të Kartës së saj dhe Kartës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, dokumente që janë piketa të së drejtës moderne ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Diskutimi i të drejtave të njeriut në lidhje me pozicionin dhe çështjet e grave fillimisht ishte i pandjeshëm. Ai buronte nga koncepti dhe rregullat e së drejtës ndërkombëtare tradicionale të formuluar nga burrat. Për shkak të roleve të ndërvarura sociale të grave, ato nuk ishin të pranishme në këtë proces. Për më tepër, edhe vetë frymëzuesit dhe hartuesit e instrumenteve kryesore ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, ndërsa i drejtohen barazisë dhe mosdiskriminimit, “kanë harruar” të përdorin gjuhën e ndjeshme gjinore. Historia e zhvillimit të së drejtës së të drejtave të njeriut tregon se çështjet e ashtuquajtura të grave janë bërë të dukshme për shkak të rritjes së aktivitetit të grave në arenën ndërkombëtare. Karta e Kombeve të Bashkuara vendosi elemente të reja reale të një rëndësie të madhe për gratë. Kombeve të Bashkuara iu dha mandati të promovonin progresin dhe zhvillimin ekonomik e social dhe të krijonin organizma ndihmës. Organizatat e Grave e shfrytëzuan këtë mundësi. Puna e tyre dhe përpjekjet e avokatisë kontribuan dukshëm në njohjen e të drejtave të grave, si të drejta të njeriut. Rol të madh në këtë proces luajti Komisioni i Kombeve të Bashkuara për Statusin e Grave (themeluar në vitin 1947) i cili midis të tjerave hartoi Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (KEFDG–CEDAW) dhe ishte nismëtar i katër konferencave botërore për gratë (në Meksiko, Kopenhagen, Najrobi dhe Pekin). Këto konferenca rezultuan në dokumente të nënshkruara nga shumica e vendeve anëtare të Kombeve të Bashkuara. Me kalimin e viteve, të drejtat njerëzore të grave fituan respektin dhe njohjen që ato meritojnë, jo vetëm si tërësi e veçantë e së drejtës por edhe si pjesë integrale e të gjitha të drejtave të njeriut. Si në Konferencën Botërore të të Drejtave të Njeriut, në Vjenë, në vitin 1993, ashtu edhe në Konferencën Botërore në Pekin, të drejtat e grave u njohën si të drejta të njeriut. Për herë të parë, artikulli i tyre u pranua si aspekt i së drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Kjo njohje lehtësoi hyrjen e të drejtave të grave në kuadrin e së drejtës ndërkombëtare

dhe të politikës ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare të të drejtave të njeriut. Miratimi i KEFDG-së u shoqërua me një numër të madh instrumentesh ndërkombëtare dhe rajonale të të drejtave të njeriut dhe dokumentesh të politikës, që detyruan qeveritë të ndërmarrin hapa në politikat kombëtare me synim mbrojtjen, përmbushjen dhe zbatimin e të drejtave të grave. Në takimet globale të Pekinit +5 (2000) dhe Pekin +10 (2005) si edhe në konferencën MILENIUM të Kombeve të Bashkuara (2000) dhe në Konferencën Botërore kundër Racizmit, Diskriminimit Racial, Ksenofobisë dhe Intolerancës (në vitin 2001), shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara kanë ritheksuar angazhimin e tyre për të forcuar kapacitetin e tyre në nivel vendi për të zbatuar parimet dhe praktikatat e të drejtave njerëzore të grave.

Të gjitha format e dhunës kundër grave shkojnë përtej sjelljes shtypëse ose diskriminimit në përgjithësi dhe përbëjnë dëm, i cili rezulton nga forca ose detyrimi. Ato janë shoqëruar me pabarazi midis burrave dhe grave dhe strategji që përjetësojnë ose rrënjësojnë atë pabarazi. Kështu, dhuna kundër grave është një shfaqje e pozicioneve themelore të pabarabarta midis burrave dhe grave dhe përbën një formë të diskriminimit kundër grave.

Megjithëse instrumentit më të rëndësishëm ndërkombëtar në lidhje me gratë, KEFDG-së i mungon vëmendja e qartë për dhunën kundër grave, një numër i madh dokumentesh të tjera ligjore dhe të politikës së Kombeve të Bashkuara si dhe dokumente ndërkombëtare dhe rajonale argumentojnë, që dhuna gjinore është formë dalluese e diskriminimit, e cila përbën një dhunim të së drejtës ndërkombëtare të të drejtave njerëzore, në vetvete. Ky fakt u bë prezent për herë të parë në Konferencën e Parë Botërore për Gratë, në Najrobi, në vitin 1985. Dokumenti përmbyllës “Strategjitë e së ardhmes, Najrobi”, lidh barazinë dhe dhunën kundër grave duke pohuar se dhuna kundër grave është pengesë për barazinë dhe paqen. Qeverive iu rekomandua të intensifikonin përpjekjet për të vendosur ose për të forcuar format e ndihmës për viktimat e

dhunës përmes sigurimit të strehëzave, mbështetjes, shërbimeve ligjore si dhe të rritnin ndërgjegjësimin publik për dhunën ndaj gruas, si problem shoqëror. Në rekomandimin e përgjithshëm Komiteti KEFDG-së njih dhunën kundër grave, duke përfshirë dhunën në familje, si formë të diskriminimit. Ai pohon që ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit gjinor në konventë përfshin “dhunën gjinore, që është dhunë e drejtuar kundër një gruaje, sepse ajo është grua, ose që ndikon mbi gratë në mënyrë disproporcionale”. Kështu, përcaktimi i diskriminimit në nenin 1 të KEFDG-së përfshin edhe dhunën kundër grave. Kjo do të thotë se dhuna kundër grave mund të jetë dhunim i dispozitave të veçanta të KEFDG-së. Ndërsa aktet e dhunës janë kryer në të gjithë sektorët e shoqërisë, dhuna gjinore, si dhuna në familje, është drejtuar kryesisht tek gratë me qëllim që t’u heqë atyre një gamë të drejtash dhe të ruajë varësinë e tyre si grup.

Në deklaratën “Për eliminimin e dhunës kundër grave miratuar në vitin 1993, shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara e njohën dhunën kundër grave si një “shfaqje të marrëdhënieve historikisht të pabarabarta të fuqisë midis burrave dhe grave, të cilat kanë çuar në sundimin dhe diskriminimin kundër grave nga burrat dhe në parandalimin e përparimit të plotë të grave”. Kjo njohje u përsërit në dokumentet e politikës të Kombeve të Bashkuara, si: Platforma për Veprim e Pekinit (1995); dokumenti përfundimtar i Asamblesë së Përgjithshme, i sesionit të veçantë të 23-të, në vitin 2000, i njohur si Pekin +5; në rezolutën 2003/45 dhe në një seri raportesh të relatorit special për dhunën kundër grave, autorizuar nga Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut. Organizatat rajonale, gjithashtu, njohin dhunën kundër grave si dhunim të të drejtave njerëzore të grave duke kërkuar veprime të shteteve. Në deklaratën e tij të vitit 1993, Këshilli i Europës pohon se eliminimi i dhunës kundër grave është aspekt kyç i kundërvënies ndaj pabarazisë strukturore midis burrave dhe grave. Komiteti i Ministrave, gjithashtu, ka treguar

se marrëdhëniet e pabarabarta të fuqisë midis burrave dhe grave dhe struktura patriarkale e familjes janë faktorë që kontribuojnë në dhunën në familje.

Në rezolutën e 1997-ës, Parlamenti Europian pohon se dhuna kundër grave është “pa kurrfarë dyshimi e lidhur me një pabarazi të fuqisë midis sekseve në sferën sociale, ekonomike, fetare dhe politike, pavarësisht shpalljes së barazisë në legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar”. Trajtimi i dhunës kundër grave si formë diskriminimi është i pranishëm edhe në nivelin kombëtar. Në disa sisteme ligjore kombëtare, forma të caktuara të dhunës kundër grave i janë nënshtruar rishikimit gjyqësor në përputhje me legjislacionin përkatës jodiskriminues.

Dhuna në familje është një nga format më të përhapura të dhunës dhe të diskriminimit kundër grave. Pavarësisht nga treguesit e përhapjes së kësaj forme dhune, deri së fundi ajo nuk njihej si dhunim i të drejtave njerëzore të grave. Dhunën në familje, si dhunim të të drejtave njerëzore të grave, për herë të parë e njohu Konferenca e Dytë Botërore e Grave në Kopenhagë (1980). Konferenca miratoi një rezolutë “Për gratë e dhunuara dhe dhunën në familje” dhe iu referua dhunës së ushtruar në shtëpi në raportin e saj final. Kjo u shtjellua në dy rekomandime të përgjithshme të Komitetit KEFDG-së për dhunën kundër grave (Rekomandimi i përgjithshëm nr. 12, 1989 dhe Rekomandimi i përgjithshëm nr. 19, 1992), ku Komiteti autorizon shtetet anëtare “të mbrojnë gratë kundër dhunës së çdo lloji, të ndodhur brenda familjes, në vendin e punës ose në ndonjë fushë tjetër të jetës sociale”. Shteteve u është kërkuar të sigurojnë informacion në lidhje me legjislacionin dhe masa të tjera për të kundërvepruar ndaj dhunës kundër grave.

Gratë duhet të jenë të afta t'i përdorin këto dispozita kushtetuese dhe normative ndërkombëtare për të bërë presion për ndryshim legjislativ dhe për të kërkuar dëmshpërblim për dështimin e shtetit për të mbrojtur gratë në familje. Në vitin 1985, Asambleja e Përgjithshme miratoi rezolutën e parë për dhunën në familje, bazuar në një rekomandim të Komisionit për Statusin e

Grave të Këshillit Ekonomik dhe Social dhe në rezultatin e Kongresit të 6-të, të Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Krimit dhe Trajtimin e Kundërvajtësve.

1.2. Objekti i studimit

Tema në këtë punim shkencor ka të bëjë dhe synon të analizojë gjendjen dhe sistemin aktual të mbrojtjes së të drejtave të gruas dhe realizimit të barazisë reale në nivel praktik, dhe nevojën për ndryshimet që duhet të bëhen në të ardhmen për përmirësim, duke marrë për bazë standartet ndërkombëtare si dhe modelet e vendeve të tjera. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të drejta që lindin bashkë me çdo qenie njerëzore dhe kanë karakter universal. Mbrojtja dhe promovimi i tyre është (duhet të jetë) detyrimi parësor i çdo shteti dhe qeverie. Kjo do të thotë se parimet e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut janë pjesë integrale e të gjithë legjislacionit në përgjithësi dhe e çdo ligji e akti nënligjor në veçanti.

Qëllimi i studimit të kësaj teme është pikërisht fakti sepse si problem dhe dukuri shoqërore edhe pse është njohur dhe adresuar, trajtimi i saj përbën edhe sot e kësaj dite një ndër sfidat më të mëdha të teorisë dhe praktikës, jo vetëm të natyrës metodologjike, të shtruarjes së problemeve të kësaj fushe dhe posaçërisht në nxjerrjen e konkluzioneve dhe rekomandimeve të rëndësishme dhe të qëndrueshme për t'i avancuar studimet me qëllim që ato të jenë shtysë për zgjidhjen e problemeve që lidhen me rolin dhe fuqizimin e gruas në shoqëri, për barazinë gjinore pa asnjë paragjykim dhe diskriminim me bazë gjinore si një premisë për zhvillim dhe demokraci reale.

Prania ende e fuqishme e stereotipeve gjinore dhe e dhunës në familje është dëshmia më e qartë se problem i pabarazisë gjinore është prezent, strukturor dhe kompleks. Një nga shkaqet e lëvizjes së ngadalshme në rrugën e emancipimit shoqëror është fakti se shumë aktivitete, konferenca konceptohen si çështje ekskluzive të grave. Promovimi i të drejtave të grave dhe nismat për

përmirësimin e statutit të tyre në shoqëri shpesh bëhet nga këndvështrime feministe. Rrallë ndodh që në aktivitete të organizuara për probleme të barazisë gjinore të jenë ulur në një tavolinë dhe diskutojnë së bashku burrat dhe gratë. Adaptimi i një qasje të tillë është parakusht për transformimin e shoqërisë dhe kalimin nga kultura maskiliste në një kulturë të bazuar në barazinë gjinore. Fakti që të drejtat e grave janë legalizuar si pjesë integrale e të drejtave të njeriut, është një hap progresiv në rrugën e zhvillimit demokratik të vendit. Por retorikat patetike për respektin e të drejtave të grave nuk mund të fshehin realitetin gri, disavantazhet, pengesat dhe problemet sociale me të cilat ballafaqohen femrat në përpjekjet e tyre për pjesmarrje dhe status të barabartë në shoqëri.

Tranzicioni traumatik shqiptar ka prodhuar dukuri dhe problematika të reja sociale, sikurse janë tërheqja e grave nga jeta ekonomike dhe rreziku i rikthimit në strukturat patriarkale, sidomos në zonat rurale, zgjerimi i frikshëm i përmasave të dhunës në familje dhe trafikimi i femrave për qëllime prostitucioni dhe shfrytëzimi seksual. Statuti dhe roli dytësor i gruas në shoqëri është produkt i organizimit strukturor dhe funksionimit të shoqërisë, është shprehje e një kulture të tërë të sofistikuar në rrjedhën e historisë, e cila e ka legjitimuar pozitën superiore, dominuese dhe pushtetin e burrit në familje në sferat social – ekonomike dhe politike. Historikisht, mbi bazën e ndarjes tradicionale të roleve gjinore është ngritur struktura e organizimit të jetës në familje dhe më tej ky model është transplantuar dhe fuqizuar në jetën sociale, ekonomike dhe politike.

Progresi dhe arritja e barazisë reale gjinore në të tri fushat bazë, në familje, në fushën social – ekonomike, si dhe në jetën politike dhe publike, nuk mund të vijë spontanisht dhe as vetëm nëpërmjet shpresave për iluminimin e shoqërisë. Sigurisht që në promovimin e të drejtave të grave dhe parandalimin e formave më ekstremetë shkeljes së këtyre të drejtave, sikurse dhuna gjinore, duhet më shumë angazhim për sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e shoqërisë.

Transformimi kulturor i shoqërisë është një proces i gjatë dhe kompleks dhe si i tillë kërkon jo vetëm apel, por edhe përmirësim të instrumenteve ligjore, ngritjen e strukturave mbështetëse dhe krijimin e barazisë së mundësive për punë, karrierë, vendimmarrje dhe përfaqësim, si dhe ndërgjegjësimin e një shoqërie ku barazia gjinore të jetë pranuar si një realitet i ri, ku burrat dhe gratë të kenë të njëjtat detyrime dhe të njëjtat privilegje, të njëjtat mundësi reale për afirmim të personalitetit dhe pjesmarrjes në të gjitha sferat e jetës shoqërore. Përfshirja gjerësisht e shoqërisë civile, pjesmarrja e komunitetit dhe marrja e përgjegjësive nga pushteti vendor, fuqizimi i familjes dhe nxitja e një kulture të re të respektimit të të drejtave të grave, janë çelësi për të çuar përpara arritjen e barazisë gjinore në të gjitha fushat e jetës. Vetëm në këtë kontekst gjithëpërfshirës do të mund të parandalohen dhe eliminohen krimet në familje dhe format e dhunës gjinore. Ndryshe aspiratat dhe strategjitë për arritjen e barazisë gjinore sipas standarteve dhe koncepteve bashkëkohore do të mbeteshin thjesht një utopi.

1.3.Qëllimi dhe rëndësia e punimit

Diskutimi i të drejtave të njeriut në lidhje me pozicionin dhe çështjet e grave fillimisht ishte i pandjeshëm. Ai buronte nga koncepti dhe rregullat e së drejtës ndërkombëtare tradicionale të formuluar nga burrat. Për shkak të roleve të ndërvarura sociale të grave, ato nuk ishin të pranishme në këtë proces. Për më tepër, edhe vetë frymëzuesit dhe hartuesit e instrumenteve kryesore ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, ndërsa i drejtohen barazisë dhe mosdiskriminimit, “kanë harruar” të përdorin gjuhën e ndjeshme gjinore. Historia e zhvillimit të së drejtës së të drejtave të njeriut tregon se çështjet e ashtuquajtura të grave janë bërë të dukshme për shkak të rritjes së aktivitetit të grave në arenën ndërkombëtare. Karta e Kombeve të

Bashkuara vendosi elemente të reja reale të një rëndësie të madhe për gratë. Rol të madh në këtë proces luajti Komisioni i Kombeve të Bashkuara për Statusin e Grave (themeluar në vitin 1947) i cili midis të tjerave hartoi KEFDG, dhe ishte nismëtar i katër konferencave botërore për gratë. Këto konferenca rezultuan në dokumente të nënshkruara nga shumica e vendeve anëtare të Kombeve të Bashkuara.

Me kalimin e viteve, të drejtat njerëzore të grave fituan respektin dhe njohjen që ato meritojnë, jo vetëm si tërësi e veçantë e së drejtës por edhe si pjesë integrale e të gjitha të drejtave të njeriut me qëllim respektimin praktik të tyre nga ana e shteteve dhe marrjen e masave konkrete për realizimin e tyre dhe rritjen e grave në të gjitha sferat e jetës.

Kjo njohje lehtësoi hyrjen e të drejtave të grave në kuadrin e së drejtës ndërkombëtare dhe të politikës ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare të të drejtave të njeriut.

Miratimi i KEFDG-së u shoqërua me një numër të madh instrumentesh ndërkombëtare dhe rajonale të të drejtave të njeriut dhe dokumentesh të politikës, që detyruan qeveritë të ndërmarrin hapa në politikat kombëtare me synim mbrojtjen, përmbushjen dhe zbatimin e të drejtave të grave. Shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara kanë ritheksuar angazhimin e tyre për të forcuar kapacitetin e tyre në nivel vendi për të zbatuar parimet dhe praktikën e të drejtave njerëzore të grave.

Në BE koncepti i barazisë gjinore dhe diskriminimit është në evolucion të vazhdueshëm dhe interpretimet e tij rast pas rasti sjellin risi dhe ndryshime çdo ditë. Pas një lufte të gjatë lufta kundër diskriminimit është kthyer në një nga parimet kryesore të funksionimit të parimit të të drejtave të njeriut në BE dhe në veçanti të të drejtave të grave. Parimi i mosdiskriminimit duhet të kthehet në një parim bazë që të përshkojë të gjithë legjislacionin shqiptar. Mund të themi që niveli i përafritimit të legjislacionit në Shqipëri me standardet e BE-së është në nivele të

kënaqshme përse i përket procesit të hartimit dhe miratimit të legjislacionit kryesor, por jo të legjislacionit dytësor. Dhe për më tepër ende në Shqipëri jemi larg ngritjes dhe mirëfunksionimit të mekanizmave zbatues dhe mbikqyrës të legjislacionit kundër diskriminimit. Gjithashtu, siç është paraqitur disa herë si shqetësim, jo vetëm nga organizatat ndërkombëtare por edhe OJF-të vendase, sistemi gjyqësor, për shkak të nivelit të ulët dhe besimit të pakët në publik, nuk është në gjendje të ofrojë garanci në luftën kundër diskriminimit.

Për zbatimin e një politike të ndërgjegjshme nga pikëpamja gjinore, kërkohet një mjedis institucional i ndërgjegjshëm ndaj plotësisht të nevojave të veçanta të djemve dhe vajzave. Pra sa i ndërgjegjshëm është ky mjedis për të zbatuar tashmë programe që adresojnë pabarazitë gjinore dhe promovojnë barazinë.

Në aspektin sociologjik nuk janë të rëndësishme vetëm marrëdhëniet të cilat lindin, mbahen ose ndryshojnë në “shoqërinë familjare”, por edhe marrëdhëniet mes shoqërisë si tërësi në njërin anë dhe elementeve të cilat e përbëjnë strukturën e saj ku padyshim bën pjesë edhe familja në anën tjetër, me rolin e veçantë të gruas në të. Kontaktimi dhe gërshetimi i funksioneve familjare me ato shoqërore vjen në shprehje veçanërisht në familjen bashkëkohore dhe në shoqërinë e zhvilluar industriale e cila karakterizohet me zhvillim tekniko-teknologjik të lartë. Kur bëhet fjalë për raportin e familjes me shoqërinë globale duhet marrë parasysh kufiri kohor dhe hapësinor. Familja si institucion dhe ndërveprimi i saj me institucione të tjera përbëjnë bazat mbi të cilën ngrihet jeta sociale. Ato janë rregullatore jetike të marrëdhënieve që krijojnë qëniet njerëzore me njëra tjetrën me anë të cilëve sigurohet vazhdimësia e brezave (Giddens: 2007).

1.4. Metodologjia dhe metodat e kërkimit

Me rëndësi të veçantë paraqitet në një punim doktoral edhe metodologjia e cila është hartuar nëpërmjet metodave të ndryshme me qëllim vërtetimin e hipotezave kërkimore tëngritura.

Metodologjia e punës kërkimore është bazuar në përdorimin e metodave si cilësore ashtu edhe sasiore, në funksion të temës dhe strukturës së parashtruar të punimit.

Për efekt të qëllimeve të temës, metodat që spikasin janë *metoda historike, analitike, krahasimore* me qëllim të evidentimit të situatës aktuale dhe dhënies së rekomandimeve.

Përdorimi i kësaj metodologjie ka qenë në funksion të hipotezave të ngritura dhe pyetjeve kërkimore, duke më ndihmuar në nxjerrjen e përfundimeve të duhura për temën dhe sidomos për rekomandimet e propozuara. Pra, metodat e përdorura i përshtaten arritjes së qëllimeve të këtij punimi doktoral dhe metodat e hulumtimit shkencor të përdorura në këtë rast janë shfrytëzuar në vartësi të pyetjeve kërkimore dhe hipotezave të ngritura në këtë punim doktoral.

Për përgatitjen e këtij punimi është dashur një punë e gjatë, pasi materialet studimore për këtë temë janë të shumta përsa i përket legjislacionit të BE-së dhe KE-së, si edhe akteve ndërkombëtare dhe botimeve e materialeve të autorëve të ndryshëm në lidhje me temën e më pas në trajtimin e legjislacionit, jurisprudencës dhe praktikave të njohura të huaja e vendase.

Metoda historike është e një rëndësie të veçantë në punim pasi ajo përmbledh në mënyrë të përgjithshme historikun e çështjeve të barazisë gjinore me qëllim rritjen dhe fuqizimin e rolit tëgruas në shoqëri.

Metoda analitike po ashtu ka një rëndësi të veçantë pasi në këtë punim analizohen në mënyrë tëdetajuarliteratura, pra doktrina lidhur me të drejtat e grave, legjislacioni ndërkombëtar,

europian dhe kombëtar në mbrojtje të grave. Po ashtu analizohen në mënyrë të detajuar jurisprudenca europiane dhe rajonale lidhur me çështjet e diskriminimit dhe barazinë gjinore.

Në kuadër të integritit europian, analiza e gjerë e legjislacionit europian si dhe e jurisprudencës së GJEDNJ-së dhe GJED-së, më ka ndihmuar në trajtimin dhe analizën e bërë për të konkluduar me rekomandimet përkatëse.

Metoda krahasimore ka gjithashtu një rëndësi të veçantë pasi nëkëtë punim janë trajtuar të drejtat e gruas dhe çështjet e barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit edhe në nivel krahasimor. Krahasimi bëhet në mënyrë të veçantë me vendet e Bashkimit Europian. Analizohen këtu disa standarte të disa legjislacioneve europiane në lidhje me barazinë ligjore si Franca, Spanja, Gjermania, Sllovenia etj. Arsyet e kësaj përzgjedhje janë për shkak të afërsisë së problematikave, për shkak të mundësisë dhe aksesit në literaturë si dhe me qëllim dhënien e disa konkluzioneve dhe rekomandimeve në funksion të përmirësimit të legjislacionit tonë. Pra, qëllimi i këtij punimi është gjithashtu të analizojë në vështrim krahasimor në mënyrë që të evidentohen zgjidhjet më efikase në raport me vetë çështjet e trajtuara dhe të japin rekomandimet përkatëse për vendin tonë.

1.5. Pyetjet kërkimore dhe Hipotezat

Në lidhje me temën dhe fokusin/qëllimin e saj, pyetjet kërkimore dhe hipoteza kanë rëndësi esenciale për të realizuar një punim cilësor doktoral, duke qenë shtyllat bazë për garantimin e suksesit të punimit dhe orientimit të gjithë procesit të punës .

Pyetjet kërkimore të ngritura në këtë punim doktoral janë:

1. A garantohen të drejtat e gruas në shoqëritë e sotme dhe cili është niveli i realizimit të tyre?
2. A garantohet barazia reale mes burrit dhe gruas?

3. Cilat janë pengesat që hasin gratë për t'u bërë pjesë e jetës publike dhe për të rritur rolin e tyre në vendimarrje?
4. A janë politikat dhe masat 'positive diskriminuese' efikase dhe të përshtatshme për garantimin e barazisë gjinore dhe integritit gjinor?
5. Si ndikon pjesëmarrja e gruas në jetën publike në proceset politikëbërëse dhe vendimarrje?
6. A promovojnë gratë në pozitat drejtuese dhe të suksesshme në karrierë statusin e grave të tjera?
7. Përse pabarazia gjinore ende mbetet një problem ndërkombëtar pavarësisht masave dhe politikave të ndërmarra?
8. Çfarë masash duhet të merren për të nxitur dhe rritur pjesëmarrjen e grave në të gjitha fushat dhe nivelet?
9. Çfarë niveli pjesëmarrje kanë gratë në të drejtat ekonomike në vendin tonë? Sa realizohen ato dhe sa efektive është pjesëmarrja e grave në gëzimin dhe administrimin e pasurisë së tyre dhe\ose familjare?

Si rrjedhojë, nga ky këndvështrim **hipotezat** e ngritura në këtë punim dhe që kërkojnë të vërtetohen janë:

Hipoteza e parë: Të drejtat e gruas si të drejta e liri themelore dhe respektimi i tyre nën dritën e parimeve dhe vlerave kushtetuese që specifikuin implikojnë parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit edhe në vendin tonë janë garanci për mirëqeverisje dhe demokraci funksionale.

Hipoteza e dytë: Barazia gjinore dhe integrimi gjinor mbeten ende prioritete kryesore që duhen adresuar e që kërkojnë masa dhe politika konkrete për të garantuar barazi gjinore reale ndërmjet burrit dhe gruas në të gjitha fushat dhe në të gjitha nivelet.

Hipoteza e tretë: Gratë në vendin tonë, në kuadër të të drejtave politike, ekonomike dhe në çështjet familjare kanë një nivel jo të kënaqshëm përfaqësimi dhe pjesëmarrje. Edhe pse trumbetohet shumë rritja dhe fuqizimi i tyre në fakt në jetën e tyre sa i takon të drejtave ekonomike ato nuk janë në nivelet e standarteve të vendeve të tjera europiane.

Hipoteza e katert: Edhe pse legjislacioni lidhur me të drejta specifike është në përgjithësi i plotë dhe neutral, aksesimi i grave, respektimi dhe zbatimi i këtij legjislacioni në praktikë sjell vështirësi faktike për gratë, pra jo ligjore.

1.6. Kufizimet e punimit

Për sa i përket kufizimeve, ato lidhen si me përcaktimin e objektit të analizës, si me vështirësitë e ndeshura gjatë grumbullimit të të dhënave dhe burimeve. Lidhur me të parin, zgjedhja për ta kufizuar analizën e studimit tim është për arsye se çështja e të drejtave të grave janë pjesë e të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe është një fushë shumë e gjerë studimi. Po ashtu rritja dhe fuqizimi i rolit të grave në jetën ekonomike, sociale dhe politike është një çështje shumë e gjerë. Përveç kufizimeve nga pikëpamja e shtrirjes së studimit, punimi kufizohet edhe në kohë: në fakt, qëllimi i punimit është të analizojë të drejtat e grave në Shqipëri, me një fokus të veçantë por në vështrimin bashkëkohor të tij. Për këtë arsye, qasja historike do të jetë e kufizuar në funksion të argumentimit të zgjidhjeve aktuale, dhe në fokus të punimit do të jetë analiza e kuadrit normativ aktualisht në fuqi në vendin tonë, si dhe zgjidhjet respektive jurisprudenciale dhe doktrinale në këtë fushë. Përzgjedhja e analizës në katër vende të tjera, pra të disa legjislacioneve europiane në lidhje me barazinë ligjore si Franca, Spanja, Gjermania, Sllovenia është në fakt një kufizim për shkak të literaturës së shfrytëzuar si dhe për shkak të qasjes së këtyre problematikave. Analiza e të drejtave të grave në vështrim krahasimor pasqyron stadin aktual të rregullimit normativ në katër vendet e marra në analizë, duke nxjerrë në dukje ngjashmëritë dhe dallimet mes sistemeve, dhe mbi të gjitha rekomandon propozime specifike për zgjidhjen e çështjeve problematike të adresuara gjatë analizës, duke u bazuar në doktrinën dhe jurisprudencën vendase dhe të huaj si dhe në tendencat politik-bërëse më të fundit europiane.

1.7. Përmbledhja dhe struktura e punimit

Ky studim analizon në mënyrë të detajuar të drejtat e grave të para në këndvështrimin e legjislacionit ndërkombëtar, evropian dhe atë të brendshëm. Studimi në pjesën më të madhe të tij analizon jo vetëm legjislacionin, pra të drejtën pozitive por edhe jurisprudencën e gjykatave në këtë fushë. Një fokus të veçantë kanë edhe barazia gjinore dhe çështjet e mosdiskriminimit. Studimi është ndërtuar mbi bazën e shtatë kapitujve.

Në *kreun e parë* kemi trajtuar hyrjen, rëndësinë dhe objektin e studimit, si dhe pyetjet kërkimore tëngritura për studim së bashku me katër hipotezat. Po ashtu janë pjesë e këtij kapitulli përmbajtja dhe struktura.

Kreu i dytë i dedikohet gjithë bazës ligjore në nivel ndërkombëtar, rajonal dhe evropian, lidhur me të drejtat e grave dhe në veçanti ato që kanë të bëjnë me barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin. Këtu janë trajtuar aktet më të rëndësishme të OKB-së, si Deklarata Universale, Konventa KEFDG-së, etj. Po ashtu janë pjesë e këtij kapitulli analiza e detajuar e legjislacionit të Bashkimit Evropian si dhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të Drejtësisë. Një pjesë e rëndësishme e këtij kreu, është dhe studimi i akteve të rëndësishme të Këshillit të Evropës dhe jurisprudencës së Strasburgut. Një paragraf i posaçëm i dedikohet dhe OSBE-së.

Kreu i tretë trajton barazinë gjinore dhe integrimin gjinor së bashku me disa koncepte juridike si dhe praktikën. Paragrafi i parë përfshin përkufizimin e barazisë gjinore ndërkohë që më poshtë shtjellohet: barazia gjinore si gur themeli në zhvillimin e vendit si dhe në integrimin gjinor. Gjithashtu në këtë kapitull përfshihet: rëndësia e integritit gjinor dhe çështje të

(mos)diskriminimit dhe barazisë gjinore në këndvështrim të praktikës gjyqësore dhe jurisprudencës kushtetuese

Kreu i katërt përfshin të drejtat e grave, mbrojtjen si dhe garantimin e tyre në legjislacionin e brendshëm. Përgjatë këtij kreu trajtohen respektimi dhe mbrojtja e të drejtave të grave në legjislacionin tonë duke filluar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë si dhe Kodet si: Kodi Penal, Kodi i Proçedurës Penale, Kodi i Punës, Kodi i Familjes, Kodi Zgjedhor, si dhe të drejtat e grave sipas aspekteve që këto Kode përfshijnë. Pjesë e këtij kapitulli janë gjithashtu dhe disa ligje të tjera, që garantojnë mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të grave ku përmendet: barazia gjinore, masat ndaj dhunës në familje, ligji për sigurimet shoqërore, për mbrojtjen nga çdo formë e diskriminimit, për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, ligji mbi shëndetin riprodhues, ligji për ndërprerjen e shtatzënisë, ligji për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim, ligji për ekzekutimin e vendimeve penale. Në këte kre paraqiten edhe disa strategji kombëtare të rëndësishme në funksion të mbrojtjes së gruas. Këtu paraqiten konkretisht të drejtat e gruas në legjislacionin shqiptar si pjesë e të Drejtave të Njeriut. Fillimisht jepen liritë dhe të drejtat vetjake si: e drejta penale, e drejta e informimit, e drejta e pronës private dhe mbrojtja e të drejtave personale. Më tej do të vijojnë të drejtat dhe liritë politike, ku përfshihet: e drejta aktive dhe pasive e votimit si dhe e drejta e organizimit kolektiv. Pjesët e fundit të këtij kapitulli përbëhen nga liritë dhe të drejtat ekonomike, sociale e kulturore, në të cilat përfshihen të drejta si: ajo e punës dhe punësimit, për kujdes shëndetësor si dhe mbrojtja e shëndetit të gruas; e drejta martesore dhe familjare si dhe mbrojtja e gruas ndaj dhunës në familje.

Kreu i pestë trajton situatën aktuale të respektimit të të drejtave të grave në Shqipëri (kuotat gjinore) si dhe një analizë krahasimore të kësaj situatë me vendet evropiane të: Francës, Spanjës, Gjermanisë dhe Sllovenisë. Analiza e të drejtave të grave në vështrim krahasimor fokusohet

nëngjashmëritë dhe dallimet mes sistemeve, duke u bazuar në doktrinën dhe jurisprudencën vendase dhe të huaj si dhe në politikat më bashkëkohore europiane. Po ashtu, ky kreu trajton dhe aksesin e gruas në të drejtat me natyrë ekonomike dhe në mënyrë të veçantë fokusohet tek gëzimi dhe disponimi i pronës, trashëgimia, regjimi pasuror martesor. Po ashtu, pjesë e këtij kreu është analiza e aksesit të grave në kredi, hua bankare, ndihma hipotekare dhe forma të tjera të kreditit financiar. Pjesë e këtij kreu është gjithashtu e drejta për strehim. Në mënyrë të veçantë këtu trajtohen dhe mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe aksesit i tyre në këto mekanizma. Pjesa e fundit e këtij kreu me natyrë empirike do të jetë analizë e standarteve ligjore dhe zbatimi i tyre në praktikë për të drejtat pronësore të grave si dhe sfidat e çështjeve të ndryshme bashkëkohore.

Kreu i gjashtë dhe i fundit përfshin një përmbledhje me gjetje, konkluzione dhe rekomandime në kuadër të studimit të bërë.

KAPITULLI II-STANDEDET NDËRKOMBËTARE PËR TË DREJTAT E GRAVE SI TË DREJTA TË NJERIUT

2.1. Hyrje

Koncepti i barazisë përpara ligjit në pjesën më të madhe të demokracive moderne përjashton çdo mundësi diskriminimi mbi bazë origjine, etnie, sociale, seksi, besimi fetar, etj. Është pikërisht ky koncept ai që përbën themelin e zhvillimit demokratik të një shoqërie të emancipuar. Parimi i mosdiskriminimit është një parim që e hasim në të gjitha aktet ndërkombëtare me focus të drejtat e njeriut. Të drejtat e njeriut së pari janë të drejta të qenësishme për njerëzit e çdo kombësie, vendi, seksi, origjine etnike, ngjyre, besimi apo përkatësie fetare, gjuhe apo ndonjë statusi tjetër, të ndërthurura e të ndërvarura nga njëra -tjetra e të pandashme. Universaliteti i këtyre të drejtave është një tjetër parim mjaft i rëndësishëm, i cili i detyron shtetet palë ligjërisht të nxisin dhe të promovojnë të drejtat politike, civile, ekonomike, sociale e kulturore, përfshirë këtu dhe të drejtat e grave (Anastasi, Mandro-Balili, Shkurti, Bozo, 2012:8). Të gjithë duhet t'i gëzojnë këto të drejta në mënyrë të barabartë dhe të padiskriminuar.

Ekzistojnë tashmë një sërë dokumentesh juridike të karakterit ndërkombëtar, rajonal dhe kombëtar që i përcaktojnë këto të drejta, ku përcaktohen gjithashtu dhe detyrimet ligjore të shteteve anëtare për t'i respektuar këto të drejta në realitetin e tyre. (Përmbledhje aktesh kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e barazisë gjinore, 2007: 15)

Shtetet janë entitetet që kanë për detyrë të respektojnë, mbrojnë dhe përmbushin të drejtat e njeriut, pra të individëve që ndodhen në juridiksionin e tyre. Në shumë raste zbatimi nënkupton detyrën e shtetit dhe autoriteteve përkatëse të respektojnë të drejtat e pranuarat prej tij. Kjo është veçanërisht e vërtetë për të drejtat civile dhe politike, kurse për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore zbatimi nënkupton angazhimin pozitiv nga ana e shtetit, si për shembull garantimin ose

mundësimin e disa shërbimeve në fusha si arsimi dhe shëndetësia dhe sigurimin e disa standardeve minimale. Kjo nënkupton se përmbushja e këtyre të drejtave është ngushtësisht e varur nga mundësia, burimet dhe kapacitetet i një shteti të caktuar¹. Detyra për të mbrojtur kërkon që shteti të parandalojë dhunën dhe shkelje të tjera të të drejtave të njeriut brenda territorit të tij. Po kështu, të drejtat e njeriut kanë një dimension human, të cilit po i jepet rëndësi sidomos me përfshirjen e shteteve në procesin e globalizimit. Së bashku me barazinë përpara ligjit dhe mbrojtjen e barabartë të garantuar nga ligji pa asnjë diskriminim, mosdiskriminimi përbën themelin e gëzimit të të drejtave të njeriut.

2.2.Standartet ndërkombëtare lidhur me të drejtat e grave. Aktet e OKB që promovojnë barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin

Një rëndësi të veçantë në këtë studim ka analiza e bazës ligjore në nivel ndërkombëtar, rajonal dhe evropian, lidhur me të drejtat e grave dhe në veçanti ato që kanë të bëjnë me barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin. Do të shohim këtu mëkonkretisht standartet ndërkombëtare lidhur me të drejtat e grave si dhe aktet e OKB-së që promovojnë barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin. (Përmbledhje aktesh kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e barazisë gjinore,2007: 16)

Instrumentet e ndryshme ndërkombëtare kanë përkufizime të ndryshme për konceptin e diskriminimit dhe se çfarë përbën diskriminim ndajgrave(Anastasi, Mandro-Balili, Shkurti,

¹Për shembull, neni 13 i KNDESK-së njih të drejtën e gjithsekujt për t'u arsimuar.Megjithatë, ai sqaron se vetëm arsimi fillor duhet të ofrohet falas.Përsa i përket arsimin të mëtejshëm deri në nivelin e mesëm, ai duhet të jetë i disponueshëm për të gjithë por arsimi falas pritet të ofrohet vetëm në mënyrë progresive.Koncepti i përmbushjes graduale sipas kapacitetit aplikohet me disa të drejta ekonomike, sociale dhe kulturore.

Bozo, 2012:33). Parimi bazë i ndalimit të diskriminimit parashikohet në nenin 26 të Paktit për të Drejtat Civile dhe Politike: “Të gjithë personat janë të barabartë përpara ligjit dhe përfitojnë mbrojtje të barabartë nga ligji pa asnjë diskriminim. Po ashtu, *Konventa për Eleminimin e të gjitha formave të Diskriminimit Racial* (1965) ishte një nga konventat kryesore që trajtoi më me hollësi parimet e barazisë dhe ndalimit të diskriminimit të parashikuara në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut. (Përmbledhje aktesh kombëtare dhe ndërkombëtare ne fushën e barazisë gjinore,2007: 16). Përkufizimi i shprehjes diskriminim jepet për herë të parë në Konventën Ndërkombëtare mbi Eleminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial, sipas së cilës me diskriminim racial kuptohet “çdo dallim, përjashtim, kufizim, ose preferencë që bazohet mbi ngjyrën, prejardhjen ose origjinën kombëtare e etnike që ka për qëllim apo pasojë eleminimin apo dëmtimin e njohjes, gëzimit apo ushtrimit nga të gjithë individët mbi baza të barabarta të të gjitha të drejtave dhe lirive...”. Mund të arrihet në përkufizimin se diskriminim në ditët e sotme do të thotë “çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, mbi bazën e racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, besimit, opinionit politik apo opinionëve të tjera, prejardhjes kombëtare apo sociale, pasurisë, lindjes apo çdo statusi tjetër që ka për qëllim apo pasojë eleminimin apo dëmtimin e njohjes, gëzimit apo ushtrimit nga të gjithë individët mbi baza të barabarta të të gjitha të drejtave dhe lirive². Instrumentetë rëndësishme në nivel ndërkombëtar, që janë të ratifikuara edhe nga Shqipëria në luftën kundër diskriminimit janë *Konventa për Eleminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave* (1980), *Konventa kundër Diskriminimit në Arsim* (1960), *Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare* (1995), etj. (Përmbledhje aktesh kombëtare dhe ndërkombëtare ne fushën e barazisë gjinore,2007: 15) Konventa për Eleminimin

²Human Rights Committee, General Comment 18, Non-discrimination (Thirty-seventh session, 1989),<http://www1.umn.edu/humanrts/gencomm/hrcom18.htm>

e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave ka një vlerë të vecantë në këtë drejtim dhe ajo do të trajtohet më gjerësisht në këtë studim.

Kjo Konventë e përkufizon “diskriminimin kundër grave” si “çdo dallim, përjashtim apo kufizim të bazuar në seksin që ka për efekt apo qëllim të kompromentojë apo asgjësojë njohjen, gëzimin apo ushtrimin nga gratë, cilado qoftë gjendja e tyre martesore, mbi bazën e barazisë së burrit dhe gruas të të drejtave dhe të lirive themelore në fushat politike, shoqërore, kulturore e civile ose në çdo fushë tjetër. *Konventa nr. 111 e ONP-së (ONP) për Diskriminimin në Fushën e Punësimit dhe Profesionit (1958)* ishte një instrument tjetër ndërkombëtar që vendoste si kusht kryesor në nivel politikash kombëtare eliminimin e diskriminimit në fushën e punësimit, profesionit dhe kushteve të punës që bazohet në racën, ngjyrën, seksin, fenë, opinionin politik, prejardhjen kombëtare ose origjinën shoqërore dhe nxitjen e barazisë së mundësive dhe trajtimit. Kjo Konventë i vë shteteve ratifikuese synimin themelor të nxisin dhe ndjekin politika kombëtare që synojnë eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit në lidhje me punën dhe profesionin. (Përmbledhje aktesh kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e barazisë gjinore, 2007: 32) Konventa Nr.111/ONP jep gjithashtu një përkufizim tjetër për diskriminimin, sidomos në lidhje me punësimin dhe profesionin (1958), sipas të cilit: “Shprehja diskriminimi kupton: (a) çdo dallim, përjashtim ose preferencë, që bazohet në racën, ngjyrën, seksin, gjuhën, besimin, opinionet politike, prejardhjen kombëtare ose shoqërore, dhe që ka për qëllim ose pasojë eliminimin ose dëmtimin e barazisë së mundësisë ose trajtimit në punësim apo profesion. Të gjitha këto akte ndërkombëtare dhe këto koncepte do të trajtohen gjerësisht në paragrafet vijues.

2.2.1. Karta e Kombeve të Bashkuara

Përpara vitit 1945, çështjet e barazisë gjinore dhe ndalimi i diskriminimit trajtoheshin pak a shumë në të ashtuquajturat traktate për pakicat, të cilat ishin shumë të kufizuara në objektin dhe qëllimet që kërkonin të arrinin³. Me miratimin e Kartës së Kombeve të Bashkuara⁴, si pjesë e të drejtës ndërkombëtare u parashikua edhe një klauzolë për mosdiskriminimin. Ideja që Kombet e Bashkuara të bëheshin mbrojtësit kryesorë të të drejtave të njeriut lindi nga përvoja tragjike e Luftës së II Botërore dhe nga shkeljet e rënda dhe masive të të drejtave të njeriut gjatë holokaustit.

Vetë Karta e Kombeve të Bashkuara e saktëson që mbrojtja e të drejtave të njeriut është “nxitja dhe respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, pa dallime bazuar në racën, seksin, gjuhën apo besimin fetar”⁵. Megjithatë, këto dispozita nuk parashikuan detyrime të menjëhershme për të garantuar dhe respektuar të drejtat e njeriut. Megjithatë është fakt që e vetmja dispozitë që nuk lë vend vend për dyshime në Kartë është pikërisht ndalimi i diskriminimit (Buergenthal,1997:707). Përveç *procedurave të instrumenteve të të drejtave të njeriut*, si konventat për të drejtat e njeriut, janë edhe të ashtuquajturat *procedura të bazuara në Kartë*, të cilat u hartuan sipas Kartës së Kombeve të Bashkuara për të adresuar shkeljen e të drejtave të njeriut kudo në botë. Një prej tyre bazohet në Rez.1235, të miratuar nga Këshilli Shoqëror dhe Ekonomik i Kombeve të Bashkuara 12 më 1967-n, e cila lejon Komisionin e të Drejtave të Njeriut të merret me dhunime flagrante dhe sistematike të këtyre të drejtave në gjithë botën me anë të një procedure publike. Një tjetër procedurë është *procedura konfidenciale nr.1503*, bazuar në rezolutën 1503 të KShE-së (ECOSOC) më 1970, e cila lejon dërgimin e peticioneve në zyrën e Komisionerit të Lartë të të Drejtave të Njeriut në Gjenevë. Këto

³Traktate të tilla u nënshkruan ndërmjet forcave aleate fituese dhe Polonisë, Cekosllovakisë, Jugosllavisë, Greqisë, etj dhe garantonin vetëm personat që i përkisnin një pakice.

⁴Tre dispozitat kryesore që trajtojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut janë Nenet 13, 55/c. dhe 56.

⁵Karta e OKB-së, Neni 1(2)

peticionekëqyren nga një grup i kualifikuar i Nën-Komisionit të Kombevetë Bashkuara për Promovimin dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut. Kjo procedurë ndiqet kryesisht për dhunime flagrante të drejtave të njeriut. Në përfundim, situata në një vend të caktuar mund gjithashtu të diskutohet nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut.

Në punën e *Komisionit për të Drejtat e Njeriut* dhe *Nën-Komisionin* e tij, kanë fituar në vazhdimësi rëndësi të veçantë *procedurat e veçanta*, si aktivitetet e *reporterëve* dhe *përfaqësuesve të posaçëm* të Komisionit të të Drejtave të Njeriut ose të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për Çështjet e të Drejtave të Njeriut. Reporterët janë të ndarë në dy kategori, “Reporterë të një shteti” dhe “reporterë tematikë”⁶.

Me kërkesën e vazhdueshme të Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut janë ngritur *misione të Zyrës së Komisionerit të Lartë* në vende me situatë problematike të të drejtave të njeriut. Këto misione janë ngritur në vende si Afganistani, Bosnje Hercegovina, Kamboxhia, Kolumbia, Guatemala, Mali i Zi, Kosova, Serbia etj. Ato mbledhin informacion dhe promovojnë standardet e të drejtave të njeriut, si për shembull duke këshilluar gjatë procesit të reformave legislative ose duke marrë pjesë në punën e komunitetit ndërkombëtar. Qëllimi i aktiviteteve të këtyre institucioneve të veçanta është si mbrojtja ashtu edhe promovimi i të drejtave të njeriut. Ato promovojnë ndërgjegjësim më të mirë për të drejtat e njeriut dhe gjithashtu edhe përfshirjen e tyre në të gjitha aktivitetet në mënyrë që zgjidhjet të bazohen në perspektivën e të drejtave të njeriut. Në fakt, promovimi i të drejtave të njeriut nënkupton një detyrë më gjithëpërfshirëse, e cila nuk mund të përmbushet vetëm nga institucione dhe organizma.

⁶Si shembull i tyre mund të përmendim përfaqësuesin e posaçëm të Bosnje Hercegovinës, të Afganistanit, Sudanit etj, si dhe reporterët e posaçëm të torturës ose të dhunës kundër grave. Gjithësej janë afërsisht 40 institucione të tilla, të cilat mbledhin informacion sipas fushës së aktivitetit të tyre. Ka gjithashtu edhe *ekspertë të pavarur*, si ata për të drejtën për zhvillim. Janë ngritur gjithashtu edhe *grupe pune*, si ai për zhdukjet e pa aprovuara dhe ato të detyruara.

Promovimi i të drejtave të njeriut synon fillimisht të ndërgjegjësojë njerëzit për të drejtat e tyre, t'i informojë ata rreth tyre dhe t'u mësojë se si ata t'i përdorin të drejtat e tyre në mënyrën më të mirë. Për të arritur këto qëllime mund të përfshihen në këtë proces aktorë të ndryshëm si universitete, sektori arsimor por edhe organizatat jofitimprurëse.

Në nivel kombëtar, Kombet e Bashkuara rekomandojnë krijimin e *institucioneve kombëtare* për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si *Avokati i Popullit* apo *komisionet kombëtare për të drejtat e njeriut*. Asambleja e Kombeve të Bashkuara ka miratuar disa parime që kanë të bëjnë me kompetencat dhe përgjegjësitë, të cilat garantojnë pavarësinë dhe pluralizmin (OKB-Rez. 48/134 e 20 dhjetorit 1993).

2.2.2. *Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut*

Analizën e akteve në nivel ndërkombëtar e nisim pikërisht nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut. Pas Luftës së Dytë Botërore u krijua Lidhja e Kombeve dhe prej saj u krijua OKB-ja, krijimi i së cilës u shoqërua me miratimin e Kartës së OKB-së me anë të të cilës do të realizohej respektimi i disa të drejtave të njeriut (Alston, Philip dhe James Crawford, 2000: 125). Koncepti i të drejtave universale të njeriut, u bë i pranueshëm për të gjithë njerëzit vetëm pas Luftës së Dytë Botërore, kur nga 48 shtete u arrit marrëveshja për Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut. Që atëherë, ky koncept është bërë komponent i pandashëm i sistemit të Kombeve të Bashkuara. Diskriminimi si rezultat i persekutimit politik, racial, besimit fetar, fatkeqësive natyrore, trajtimit çnjerëzor e ka shoqëruar gjithmonë njerëzimin dhe është kryefjala e shkeljeve më të rënda të të drejtave të njeriut. Ashtu si Karta e OKB-se edhe Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut thekson parimin e barazisë së grave (Anastasi, Mandro-Balili,

Shkurti, Bozo, 2012:34). Neni 2 i kësaj Deklarate garanton qartë parimin e mosdiskriminimit. Sipas Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, ndalimi i diskriminimit përshkruhet si ndalimi i çdo veprimi që i mohon individit ose grupeve të individëve barazinë në trajtim. Nënkomisioni për Parandalimin e Diskriminimit dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut të Kombeve të Bashkuara theksoi se dallimi në trajtimin e individëve ose grupeve të individëve ishte i justifikuar kur ai ushtrohej në interes të tyre ose të mirëqënies së komunitetit në tërësi. Progres në këtë rast përbënte dallimi i qartë ndërmjet dallimit në trajtim që mund të justifikohet në interes të barazisë dhe diskriminimit që bazohej në dallime “të padëshiruara”, “të paarsyeshme” dhe të “papëlqyeshme”, dallim i cili nuk mund të justifikohet (McKean, 1983: 82). Sipas nenit 1 DUDNJ-së të gjithë individët kanë lindur me të drejta të barabarta dhe dinjitet, të cilat nuk mund t’i hiqen edhe në qoftë se ato nuk jepen dhe sigurohen nga shtetet, sepse i përkasin çdo individ. Në nenin 1 të Deklaratës theksohet se *“Të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe në të drejta. Ata kanë arsye dhe ndërgjegje dhe duhet të sillen ndaj njëri tjetrit me frymë vëllazërimi”* duke i dhënë kështu një rëndësi dhe dimension universal konceptit të lirisë dhe dinjitetit si elementë esenciale të jetesës dhe të jetuarit në harmoni në një shoqëri demokratike. (Baefsky, 2002:45). Në nenin 2 të Deklaratës përcaktohet se *“Secili gëzon të gjitha të drejtat dhe liritë e parashtruara në këtë Deklaratë pa kurrfarë kufizimesh përsa i përket racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, besimit fetar, mendimit politik ose tjetër, origjinës kombëtare a shoqërore, pasurisë, lindjes ose tjetër.*Neni 3 DUDNJ-së i cili përcakton se *“Gjithkush ka të drejtë të jetojë, të jetë i lirë dhe të ketë sigurimin vetjak.”* është në koherencë dhe në vijim të nenit 1. Po ashtu ky nen është vazhdimësi e përmbushjes së kuptimit dhe përmasat të nenit 1, duke veçuar në një nen të posaçëm, tri të drejta themelore: të drejtën e jetës, të lirisë, të sigurisë së personit. Ky nen parashtron tri kolonat themelore të të drejtave, të cilat shërbejnë si pikë nisje,

pa të cilat nuk garantohet ekzistenca dhe vazhdimësia e gjinisë “njerëzore”. (Alfredson, 1999:37).

2.2.3. *Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike*

Në vijim të këtyre dokumentave me rëndësi të madhe në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara u miratuan edhe instrumente të tjera ndërkombëtare të cilat parashikojnë dispozita të hollësishme dhe mjetet e zbatimit të tyre. Si të tillë mund të përmendim *Paktin për të Drejtat Civile dhe Politike* (1966) dhe *Paktin për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore* (1966).

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike është ratifikuar nga Shqipëria në 04.09.1991 (Përmbledhje aktesh kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e barazisë gjinore, 2007: 41) dhe përfshin të drejtën e vetëvendosjes: popujt duhet të vendosin vetë për statutin e tyre politik, për të drejtën e jetës, për të drejtën e mosnënshtrimit ndaj torturës dhe trajtimeve të tjera çnjerëzore, për të drejtën e mosmbajtjes në skllavëri dhe çfarëdo forme tjetër nënshtrimi, për të drejtën e lirisë dhe të sigurisë së personit, për të drejtën e trajtimit njerëzor dhe dinjitoz në rast dënimi, për të drejtën e mosburgimit në rast të pamundësisë së shlyerjes së një detyrimi kontraktor dhe për të drejtën e qarkullimit të lirë dhe të zgjedhjes lirisht të vendbanimit grave (Anastasi, Mandro-Balili, Shkurti, Bozo, 2012:35). Të gjithë individët, pa dallim apo diskriminim gëzojnë të drejtën e mosdëbimit në mënyrë arbitrare nga territori i një shteti, ata gëzojnë të drejtën e një procesi të barabartë, të drejtën e mos zbatimit të fuqisë prapavepruese të ligjit penal, të drejtën e personalitetit juridik, të drejtën e rezervimit, të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, të drejtën e lirisë së shprehjes, ndalimit të propagandës në favor të luftës dhe të thirrjeve për urrejtje kombëtare raciale ose fetare, të drejtën e mbledhjes, të

drejtën e lirisë së bashkimit me të tjerët, përfshirë këtu edhe formimin e sindikatave, të drejtën për t'u martuar dhe për të krijuar familje, të drejtat e fëmijëve, të drejtat për të marrë pjesë në drejtimin e vendit, qoftë drejtpërdrejt qoftë nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur lirish, barazia para ligjit, të drejtat e minoriteteve. *Neni 2* paragrafi (1) i këtij Pakti përcakton: “Shtetet palë në këtë pakt zotohen të respektojnë dhe të sigurojnë që të gjithë shtetasit e çdo vendi të jenë subjekt i mbrojtjes së të drejtave të tyre të përcaktuara në këtë konventë, pa dallim race, ngjyre, seksi, gjuhe, përkatësie rajonale apo politike, përkatësie kombëtare, origjinë sociale, pasurie apo dhe status lindjeje”. *Neni 3* i Paktit përcakton: “Shtetet palë në këtë pakt zotohen për të siguruar të drejta të barabarta ndërmjet burrit dhe gruas me qëllim përfitimin e të gjitha të drejtave civile e politike të përmendura në këtë Pakt”. *Neni 26* i kësaj Konvente përcakton: “Të gjithë personat janë të barabartë përpara ligjit dhe gëzojnë të drejta të barabarta mbrojtjeje nga ligji. Në këtë kuptim ligji ndalon çdo lloj dhe efektive pa asnjë diskriminim të bazuar në racë, ngjyrë, seks, gjuhë, përkatësi rajonale, politike, kombëtare, origjinë sociale, pasuri apo status lindjeje” diskriminimi dhe garanton për shtetasit mbrojtje të barabartë. Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike është akt ligjërish i detyrueshëm që krijon detyrime me anë të të cilave shtetet do të zotohen të respektojnë të drejtat e njeriut të përcaktuara në DUDNJ. (Hysi & Kamani & Methasani & Harasani,2008:7)

2.2.4. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale e Kulturore

Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore është një traktat, i miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në Dhjetor 1966 dhe hyri në

fuqi në vitin 1976.(Përmbledhje aktesh kombëtare dhe ndërkombëtare ne fushën e barazisë gjinore,2007: 42) Shqipëria është anëtare me të drejta të plota ne Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike Sociale dhe Kulturore që prej datës 09.04.1991. (Daci,2011:222). Pakti është i hapur për aderime të reja dhe procedura e aderimit përcaktohet në nenin 26 të tij paragrafi 1 i këtij Pakti shprehet se ky Pakt është i hapur për nënshkrimin e çdo shteti anëtar të Organizatës së Kombeve të Bashkuara ose anëtar i çfarëdo organizate të specializuar të tij, të çdo shteti palë në Statutin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë si dhe të çdo shteti tjetër të ftuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara. Si një dokument me vlerë ligjore ndërkombëtare në pikën 2 përcaktohet se ky Pakt i nënshtrohet ratifikimit. (Anastasi, Mandro-Balili, Shkurti, Bozo, 2012:35).

Parimi themelor i Paktit është parimi i mosdiskriminimit mbi bazën e të cilit shtetet palë duhet të respektojnë dhe t'u sigurojnë të gjithë njerëzve që ndodhen në territorin e tyre dhe që varen nga juridiksioni i tyre, të drejtat e njohura në këtë Pakt, pavarësisht racës, ngjyrës, seksit, gjuhës etj⁷. Pakti ka për qëllim të njohë, të proklamojë dhe të rregullojë të drejtat ekonomike, sociale kulturore të njeriut (Anastasi, Mandro-Balili, Shkurti, Bozo, 2012:35). Të drejtat e njeriut janë të ndarë në dy kategori kryesore: në të drejtat Civile dhe Politike, dhe Ekonomike Sociale dhe Kulturore. Pakti përfshin të drejtën për punë, të drejtën për kushte pune të drejta e të favorshme, të drejtën sindikale, të drejtën e sigurimit shoqëror, të drejtat në lidhje me familjen, përfshirë këtu edhe të drejtën e nënës që është në punë dhe të fëmijës për një mbrojtje të veçantë, të drejtën për një nivel jetese të mjaftueshëm, të drejtën për një gjendje më të mirë fizike dhe mendore që shteti është i aftë të arrijë, të drejtën për arsim, të drejtën e pjesëmarrjes në jetën kulturore dhe të përfitimit nga progresi shkencor. (Hysi & Kamani & Methasani & Harasani, 2008:8). Pakti përfshin parimin e mosdiskriminimit në nenin 2 par.1 si dhe barazinë në të drejta

⁷Shih nenin 2 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.

ndërmjet burrit dhe gruas me qëllim përfitimin e të gjitha të drejtave civile e politike të përmendura në këtë Pakt (neni 3). Po ashtu, në këtë Pakt Ndërkombëtar sanksionohet barazia përpara ligjit. Ligji, në fakt, ndalon çdo lloj diskriminimi dhe garanton për shtetasit mbrojtje të barabartë dhe efektive pa asnjë diskriminim të bazuar në racë, ngjyrë, seks, gjuhë, përkatësi rajonale, politike, kombëtare, origjinë sociale, pasuri apo status lindjeje (neni 26).

2.2.5 Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave

Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (KEFDG) e ratifikuar nga Shqipëria në 11.05.1994, ndryshe nga konventat e tjera ndërkombëtare sjell në qendër të shqetësimeve të akteve ndërkombëtare humanitare pikërisht gratë⁸. Kjo ishte dhe arsyeja madhore që solli hartimin e një dokumenti apo instrumenti shtesë vetëm për gratë, instrument ky që do të përforconte implementimin e këtyre konventave. Ajo do të merrej më ngushtë me situatën *de facto* të grave në botë. (Përmbledhje aktesh kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e barazisë gjinore, 2007: 27) Diskriminimi ndaj tyre ndodh në çdo shoqëri, përfshi edhe ato më të zhvilluarat. Konventa u krijua me qëllim përforcimin e dispozitave ekzistuese ligjore të Pakteve Ndërkombëtare si dhe për t'i dhënë fund diskriminimit ndaj grave sidomos në fusha të tilla të rëndësishme si atë politike, familjare, në fushën e punësimit, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. (NGO Report on the situation of women and girls in the Republic of Albania, 2006:20).

Në mënyrë që të luftohet diskriminimi me bazë gjinore, KEFDG i kërkon shteteve palë të njohin kontributin e rëndësishëm të grave në zhvillimin ekonomik e shoqëror, si në familje ashtu dhe në mbarë shoqëritë të cilave ato u takojnë. Koncepti i barazisë i përshkon të gjitha nenet e

⁸KEFDG u adoptua nga Asambleja e Përgjithshme në vitin 1979, si rezultat i punës tridhjetëvjeçare të komisionit të Kombeve të Bashkuara mbi statusin e grave.

KEFDG.(NGO Report on the situation of women and girls in the Republic of Albania, 2006:20)

Kjo konventë është konceptuar si një dokument juridik tredimensional, i përbërë nga dimensionet e të drejtave civile dhe statusit ligjor të grave, dimensionet e riprodhimit njerëzor dhe dimensionet kulturore në marrëdhëniet gjinore.(Anastasi, Mandro-Balili, Shkurti, Bozo, 2012:51)

Në nenin e saj të parë, KEFDG përcakton qartazi termin diskriminim, përcaktim ky që aplikohet në të gjitha nenet e tjera të konventës. Ndryshe nga instrumentet e tjera ndërkombëtare, të cilët i referohen diskriminimit thjesht si një “dallim” i bazuar mbi seksin, neni 1 i KEFDG jep një shpjegim të detajuar mbi kuptimin e diskriminimit, në mënyrë të veçantë të atij ndaj grave.(NGO Report on the situation of women and girls in the Republic of Albania, 2006:20). Madje në vitin 1992, Komiteti i KEFDG e zgjeroi përcaktimin mbi diskriminimin ndaj grave duke bërë pjesë të këtij përcaktimi dhe dhunën ndaj grave (dhuna me bazë gjinore)(Anastasi, Mandro-Balili, Shkurti, Bozo, 2012:52).

Neni 7 i Konventës përcakton qartë se *“Shtetet palë zotohen të ndërmarrin masat e nevojshme për të eliminuar diskriminimin ndaj grave në jetën politike dhe atë publike të vendit dhe merr përsipër të sigurojë të drejta të barabarta ndërmjet grave dhe burrave për të votuar në zgjedhje dhe referendume publike, për t’u zgjedhur në struktura të ndryshme publike, për të marrë pjesë në formulimin dhe implementimin e politikave qeveritar edhe për rrjedhojë të mbajë pozicione publike dhe të performojë në të gjitha nivelet qeverisëse të një vendi, si dhe për të marrë pjesë në shoqërinë civile - fokusi i punës së të cilës është jetapublike dhe politike e një vendi.”*

Neni 7 i KEFDG i kërkon shteteve palë të ndërmarrin masa veprimi në dy nivele në mënyrë që të sigurojnë barazinë e nevojshme për gratë në jetën politike dhe publike(NGO Report on the situation of women and girls in the Republic of Albania, 2006:20).

Së pari, shtetet palë duhet t'u sigurojnë grave të drejtën për të votuar në të gjitha llojet e zgjedhjeve dhe në referendumet publike në mënyrë anonime.

Së dyti, neni 7 i KEFDG vërtet e konsideron si themelore të drejtën e votës për gratë, por në të njëjtën kohë konfirmon se vetëm vota nuk mjafton për një pjesëmarrje të vërtetë dhe reale të grave në proceset politike të një vendi.

Shtetet duhet t'u sigurojnë grave të drejtën për t'u zgjedhur në detyra publike dhe për të mbajtur pozicione drejtuese nëpër sektorët publikë dhe ato jo-publikë. Këto të drejta mund të realizohen nëpërmjet përfshirjes së grave në listat e kandidatëve për në qeveri, nëpërmjet sistemit të kuotave, nëpërmjet eliminimit të kufizimeve gjinore për poste të caktuara qeverisëse, nëpërmjet rritjes së numrit të grave në programet qeveritare të zhvillimit dhe nëpërmjet programeve të zhvillimit të rolit të leadership-it politik. (Anastasi, Mandro-Balili, Shkurti, Bozo, 2012:53)

Konventa KEFDG jep përcaktimin e diskriminimit ndaj grave dhe kërkon nga Shtetet Palë të kësaj Konvente të marrin masat e nevojshme për të siguruar të drejta të barabarta mes grave dhe burrave dhe ndalimin e diskriminimit ndaj grave në të gjitha fushat⁹. Kuptimi i diskriminimit dhënë në Konventën e KEFDG është se “çdo dallim, përjashtim ose kufizim në bazë gjinie, që ka për pasojë ose për qëllim të dëmtojë ose të zhvlerësojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin nga gruaja, cilado qoftë gjendja e saj martesore, mbi bazën e barazisë së burrit dhe gruas, të të drejtave të Njeriut dhe lirive themelore, në fushat politike, ekonomike, shoqërore, kulturore e civile, ose në çdo fushë tjetër“. (NGO Report on the situation of women and girls in the Republic of Albania, 2006:24)

Parimet bazë që përshkojnë KEFDG janë: parimi i barazisë, parimi i mosdiskriminimit dhe parimi i detyrimit të respektimit të shtetit. Pas hyrjes në fuqi të Konventës, brenda vitit dhe më pas çdo katër vjet shtetet palë paraqesin një raport mbi masat me karakter legjislativ, gjyqësor

⁹Konventa KEFDG, neni 18.

administrativ dhe masa të tjera në zbatim të Konventës, progresin e bërë dhe vështirësitë e hasura¹⁰. Raporti shtetëror përbën një analizë të zbatimit të Konventës KEFDG, përmes masave ligjore, politike, administrative dhe masave të tjera të ndërmarra për zbatimin e kësaj Konvente. Edhe në shtete të tjera europiane janë adaptuar masa speciale, posaçërisht kuota zgjedhore në ligjet për zgjedhjet parlamentare dhe atyre të organeve të qeverisjes vendore (p.sh., Armenia, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia dhe Serbia).

Nëpërmjet nenit 17 KEFDG është themeluar *Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave* si një organ me mandat shqyrtimin e përparimit të bërë nga Shtetet Palë në zbatimin e Konventës. Ai e ka kryer funksionin e monitorimit kryesisht përmes shqyrtimit të raporteve të paraqitura nga Shtetet Palë (Neni 18 i Konventës). *Protokolli Shtesë i Konventës KEFDG* hyri në fuqi më 22 dhjetor 2000¹¹. Ai i ka shtuar një funksion gati gjyqësor Komitetit, përmes procedurës së ankimeve individuale. Ai parashikon dy procedura të tjera në Konventën KEFDG: komunikimin individual dhe procedurën e hetimit. Kur Komiteti e ka parë një komunikim si të pranueshëm, në mënyrë konfidenciale, ai i ka tërhequr vëmendjen për këtë komunikim Shtetit Palë, me kusht që ankimesi apo ankimesja të ketë pranuar që identiteti i tij apo i saj t'i bëhet i ditur Shtetit Palë. Shtetit Palë i jepen gjashtë muaj kohë për të dhënë një shpjegim me shkrim apo për të bërë një deklaratë për ankesën. Procedura tjetër e futur nga Protokolli Shtesë është procedura e hetimit, e cila i jep mundësi Komitetit të nisë hetime *suo moto*, për gjendje të shkeljeve të rënda apo të vazhdueshme të të drejtave të grave¹². (Anastasi, Mandro-Balili, Shkurti, Bozo, 2012:61)

¹⁰Raporti Kombëtar Periodik hartohet nga Ministria e Punëve të Jashtme në bashkëpunim me institucionet qeveritare, Avokatin e Popullit dhe OJF-të.

¹¹Shqipëria e ratifikoi *Protokollin Shtesë të Konventës KEFDG* në 2003, Ligji nr.9052, dt.17.04.2003.

¹²Udhëzues: Çështjet e barazisë gjinore në standardet ligjore dhe jurisprudencën kombëtare e ndërkombëtare, UNIFEM dhe Shkolla e Magjistraturë, Pegi: Tiranë, fq.10-11.

Ndërsa neni 21 i Konventës i jep Komitetit të drejtë të bëjë sugjerime dhe rekomandime mbështetur në shqyrtimin e raporteve dhe informacionin e marrë nga Shtetet Palë. Deri tani, Komiteti ka miratuar 25 rekomandime të përgjithshme për të sqaruar nene të veçanta apo çështje që mbulohen nga Konventa.

2.3. Standartet europiane në lidhje me të drejtat e gruas dhe barazinë gjinore

Përveç instrumenteve ndërkombëtarë të trajtuar më sipër me karakter universal për mbrojtjen e të drejtave të grave, janë zhvilluar gjithashtu edhe disa sisteme rajonale, të cilat zakonisht ofrojnë standarde më të larta për të drejtat dhe implementimin e tyre. Përparësia e sistemeve rajonale qëndron në mundësinë e tyre për adresim më efektiv të ankesave. Në rastin e gjykatave mund të nxirren vendime të karakterit të detyrueshëm për kompensim dhe, në përgjithësi, rekomandimet e Komisioneve për të Drejtat e Njeriut merren seriozisht nga ana e shteteve. Shtetet jo vetëm që mund të interpretojnë dhe sqarojnë dispozitat e instrumenteve për të drejtat e njeriut, por edhe të ndryshojnë legjislacionin e tyre të brendshëm, me qëllim harmonizimin e tyre me detyrimet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Për më tepër, sistemi rajonal ka tendencë të jetë më sensitiv ndaj problemeve kulturore dhe fetare, nëse ato ekzistojnë. (Hysi & Kamani & Methasani & Harasani,2008:6)

Sistemi evropian i të drejtave të njeriut ka tri nivele, sistemin e Këshillit të Evropës, Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë dhe Bashkimin Evropian. Për arsye të këtij studimi do të sjellim këtu një panoramë të përgjithshme të tre këtyre rajoneve të rëndësishme, pra në mënyrë të veçantë në rendin juridik të Këshillit të Evropës, të Bashkimit Evropian dhe atë të OSBE-së. (M.R.Alborzi,2006:138)

2.3.1. Këshilli i Europës.

Këshilli i Evropës miratoi në vitin 1950 Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, e njohur ndryshe dhe si Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Në kuadër të Këshillit të Europës me njërëndësi të veçantë prezantohet edhe Karta Sociale Evropiane e vitit 1961 dhe Karta Sociale e rishikuar e vitit 1996, së bashku me Protokollet shtesë të 1985 dhe 1995. Instrumenti kryesor i sistemit evropian për mbrojtjen e të drejtave të njeriut është *Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore* e vitit 1950. Vlera më madhore që KEDNJ-ja i sjell tërësisë së instrumenteve ligjore ndërkombëtarë është pikërisht fakti i të qenit i vetmi instrument ligjor ndërkombëtar që ofron një shkallë të lartë mbrojtjeje për individët brendakufijve të vet (juridiksion i shteteve Palë të Larta kontraktuese), pra, ato me natyrë mbi shtetërore. (Gomien, 2005:11)

2.3.1.1. Karta sociale evropiane

Para se të analizojmë në veçanti KEDNJ-në duhet të ndalemi tek Karta Sociale Evropiane e vitit 1961 dhe Karta Sociale e rishikuar e vitit 1996, së bashku me Protokollet shtesë të 1985 dhe 1995. (Korff, 2006:5) (Përmbledhje aktesh kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e barazise gjinore, 2007: 55)

Karta Sociale Evropiane e vitit 1961 është nxjerrë me qëllim shtimin e të drejtave ekonomike dhe sociale. (Daci, 2011:175) Që nga fillimi ajo ka vuajtur nga sistemi i dobët dhe joefektiv për implementim, pasi mungojnë mekanizma zbatues efikas (gjykata) si GJEDNJ-ja. Sidoqoftë, nga fundi i viteve 1980, krahas rritjes së vëmendjes për të drejtat ekonomike dhe sociale në nivel universal, një vëmendje e re, gjithashtu, i është përkushtuar Kartës Sociale

Evropiane, e cila është amenduar dy herë, më 1988 dhe 1995, e cila duke u bazuar në protokollin shtesë tani ofron mundësi edhe për ankesa kolektive. Kjo Kartë ndër të tjera garanton në thelb të drejtën për të përfituar nga të gjitha masat që ndërmerren dhe që të gëzojnë standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit: eliminimin e shkaqeve të sëmundjeve; parashikon ofrimin e shërbime këshilluese dhe edukimin shëndetësor, garanton të drejtën për mbrojtje sociale dhe mjekësore etj.(Anastasi, Mandro-Balili, Shkurti, Bozo, 2012:41)

Karta Sociale Evropiane e vitit 1961 nuk ka fituar kurrë rëndësi sa Konventa Evropiane e të drejtave dhe lirive themelore. Për funksionimin efikas të Konventës Këshilli i Europës hartoi një sërë mekanizmash nëpërmjet të cilëve çdo shtet detyrohej të përdorte detyrimin pozitiv të respektimit të saj. Një rol të rëndësishëm këtu paraqet pikërisht Gjykata Evropiane e të drejtave të Njeriut (Anastasi, Mandro-Balili, Shkurti, Bozo, 2012:41). Në frymën e mbrojtjes së jetës Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut konsiderohet si një ndër aktet më të rëndësishme ose e konsideruar ndryshe si pasaporta e të drejtave të njeriut. (Daci, 2011:176)

2.3.1.2. Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut është një ndër konventat më të rëndësishme të ratifikuara nga vendi ynë që zë vend të veçantë në hierarkinë e akteve normative¹³ e cila është ratifikuar me Ligjin nr.8137, datë 31/07/1996 “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore. Konventa parashikon në çdo nen të saj, të drejtat civile, politike, ekonomike, shoqërore, kulturore etj. Konventa ka karakter detyrues sepse u imponon shteteve anëtare detyrime negative dhe pozitive në favor të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.(Daci,2011:132) Konventa është plotësuar nga protokollat shtesë që kanë shërbyer për

¹³Neni 116 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, 1998.

forcimin e mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. (Daci, 2011:130). Konventa përmban kryesisht të drejta civile dhe politike. Preambula e Konventës thotë: *“Të vendosur, se qeveritë e vendeve evropiane ndajnë të njëjtat mendime, kanë një traditë të ngjashme politike të trashëguar nga e kaluara, kanë të njëjtat ideale, të njëjtat qasje ndaj shtetit të së drejtës, kanë vendosur të ndërmarrin hapat e parë për një zbatim të përbashkët të disa prej të drejtave të përcaktuara në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut”*.

Si një nga instrumentet më të hershme ligjore të detyrueshëm në fushën të drejtave të njeriut, Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, i ka kushtuar vëmendje barazisë dhe mosdiskriminimit. Neni 14 i KEDNj-së është dispozita bazë që garanton barazinë dhe mos diskriminimin. Në të përcaktohet se *gëzimi i të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Konventë, do të sigurohet pa diskriminim, për çdo lloj arsyeje si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimi politik apo të tjera, origjina kombëtare apo sociale, të shoqëruarit me statusin e pakicës kombëtare, pronës, lindjes, apo ndonjë status tjetër*¹⁴.

Si rrjedhojë e karakterit plotësues të dispozitave, ankesat në lidhje me shkeljet e pretenduara të Nenit 14, do të ishin të pranueshme vetëm në rast se tregohet një lidhje e mjaftueshme midis diskriminimit të pohuar dhe një prej të drejtave apo lirive të mbrojtura nga një dispozitë substantive e Konventës, me qëllim që të përdoret me sukses ndalimi i diskriminimit. (Anastasi, Mandro-Balili, Shkurti, Bozo, 2012:38)

Megjithatë, një problem i karakterit plotësues është fakti se ai e ndalon Gjykatën të shqyrtojë një gamë të gjerë pretendimesh për diskriminim dhe shkeljen e barazisë. Gjykata është veçanërisht e kufizuar në shqyrtimin e dallimeve, që shkelin të drejtat sociale apo ekonomike, meqenëse ajo rrallë konstaton se këto të drejta hyjnë në fushëveprimin e KEDNJ. Si pasojë, ankesa për trajtim jo të barabartë në lidhje me çështje të tilla si: punësim, trajnim profesional apo siguri sociale,

¹⁴Neni 14 i KEDNj-së – *Ndalimi i Diskriminimit*.

shpesh deklarohen të papranueshme, edhe kur dallimi mbështetet në shkaqe të dyshuara të tilla si, raca, kombësia ose gjinia.

Në vendimin *Belgian Linguistic Case*¹⁵ Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut përcaktoi se çfarë dallimi në trajtim do të përbënte diskriminim.(Anastasi, Mandro-Balili, Shkurti, Bozo, 2012:37). Sipas GJEDNJ-së përbënte diskriminim kur faktet e provuara tregojnë se ka patur një dallim në trajtim; kur dallimi në trajtim nuk ka justifikim objektiv dhe të arsyeshëm duke patur parasysh synimin dhe pasojat e masës që po trajtohet; dhe kur mjete i përdorur nuk është në përpjestim të arsyeshëm me synimin që kërkohet të arrihet.

Ky problem i hasur me nenin 14, u plotësua me Nenin 1 të Protokollit 12 të KEDNJ-së. Protokollin 12 e zgjeron fushën e zbatimit të Nenit 14, duke parashikuar një zbatim krejtësisht të pavarur të parimit të mos-diskriminimit *“për çdo të drejtë të përcaktuar me ligj”*. Ky protokoll zgjeron veçanërisht gamën e mbrojtjes nga mosdiskriminimi për të përfshirë detyrimin negativ të palëve kontraktuese si edhe një detyrim pozitiv, për të marrë masa për mbrojtje nga diskriminimi, edhe kur diskriminimi ndodh midis palëve private. Megjithatë, ky protokoll nuk garanton mos-diskriminim në terma absolute(Anastasi, Mandro-Balili, Shkurti, Bozo, 2012:38). Ai ndjek qasjen e miratuar nga GjEDNJ-ja në juridiksionin e saj. Protokollin 12 të KEDNJ¹⁶ garanton një të drejtë që qëndron më vete për barazinë. Neni 1 i këtij Protokollin përcakton ndalimin e përgjithshëm të diskriminimit ku thuhet: *“Gëzimi i një të drejte të parashikuar me ligj do të sigurohet pa diskriminim për asnjë shkak të tillë si, seksi, raca, ngjyra, feja, mendimi politik apo ndonjë mendim tjetër, origjina kombëtare apo shoqërore, lidhja me një pakicë kombëtare, pronë, lindje apo ndonjë status tjetër.*

¹⁵Vendim i 23 Korrikut 1968, kërkesat numër 1474/62; 1677/62; 1691/62; 1769/63; 1994/63; 2126/64, <http://cmiskp.echr.coe.int>.

¹⁶Shqipëria e ka ratifikuar Protokollin 12 të KEDNJ në 1 prill 2005.

Askush nuk duhet të diskriminohet nga ndonjë autoritet publik për shkaqe të tilla si ato që përmenden në paragrafin 1". Protokollin 12 është hartuar pikërisht për të avancuar nivelin e mbrojtjes së barazisë që ofron KEDNJ në plotësim të Nenit 14 KEDNJ, i ciligaranton të drejtën e mos-diskriminimit vetëm në lidhje me gëzimin e të drejtave të tjera sipas Konventës.

2.3.1.3. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe roli i saj në respektimin e garantimin e të drejtave të grave si pjesë e të drejtave të njeriut

Mekanizmi kryesor zbatues i mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Evropë është Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në Strasburg, juridiksioni i detyrueshëm i të cilës njihet sot nga të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Europës (Daci, 2011, 167). Ndonëse në fillimet e punës së Gjykatës, çështjet që lidhen me diskriminim nuk ishin të shumta, me kalimin e kohës jurisprudenca e GJEDNJ u pasurua dhe tashmë ka një praktikë të konsoliduar në këtë drejtim. Nga rastet e para të trajtuara në këtë juridiksion përmendim rastin *Airey vs. Irlandës* (1979). Në këtë rast, qeveria irlandeze i refuzoi ndihmën ligjore një gruaje e cila dëshironte të fitonte ndarje ligjore nga bashkëshorti i saj i dhunshëm. Gjykata vendosi se Neni 8 (i cili mbron jetën private e familjare) jo vetëm e detyron shtetin të tërhiqet nga ndërhyrje arbitrare, por i cakton atij detyrime positive në emër të respektit për jetën private e familjare. Gjykata gjeti në këtë rast edhe dhunim të së drejtës për të pasur një gjykim të paanshëm. (Gomien, 2007). Rasti *Marekx vs. Belgjikës* (1979). Një nënë dhe fëmija e saj natyror hodhën në gjyq autoritetet belge të cilat i kërkojnë nënës të marrë përsipër veprime të veçanta për t'i dhënë fëmijës së vet status ligjor si vajza e saj dhe për përjashtimin e fëmijës në fjalë nga statusi i plotë ligjor përballë pjesëtarëve të tjerë të familjes. Gjykata gjykoj se kjo është shkelje e

Nenit 8 sepse një shtet duhet të përcaktojë sistemin e brendshëm ligjor në mënyrë të tillë që personat për të cilët ngrihet ky sistem të bëjnë një jetë familjare normale. Në këtë aspekt, nuk duhet lejuar asnjë dallim ndërmjet trajtimit të fëmijëve ligjorë dhe atyre të lindur jashtë martese. (Gomien, 2007)

Gjykata e shpjegoi qasjen e saj ndaj pretendimeve për diskriminim në bazë seksi tek çështja *Abdulaziz, Cabales and Balkandali vs.UK*(1985) duke vendosur se “barazia e sekseve është ... një prej qëllimeve madhorë të Shteteve Anëtare të Këshillit të Europës” dhe se “shkaqe me shumë peshë duhet të paraqiteshin përpara se ndryshimi në trajtim për shkaqe seksi të mund të konsiderohej si i pajtueshëm me Konventën”.

Në këtë rast, GJEDNJ adoptoi qasjen e *njëjtësisë* ndaj barazisë së gjinive dhe prandaj shqyrtim i saj ishte shumë i ngurtë. Por jo gjithmonë ka qenë kështu trajtimi nga ana e GJEDNJ.

Në çështjen *Leyla Sahin vs.Turqisë* e vitti 2004, problemi i të drejtave të grave për barazi ishte një çështje substanciale për këtë vendim. GJEDNJ nuk e ndryshoi ndalimin nga Turqia të mbajtjes së shamive islamike në mjediset e Universitetit. Gjykata vendosi unanimitisht se kishte ndërhyrje në të drejtën e myslimanëve të shfaqnin fenë e tyre, por kjo ndërhyrje parashikohej me ligj dhe, e mbështetur në parimin e laicizmit dhe barazisë së grave dhe burrave, ishte legjitime. Në këtë çështje, Gjykata për herë të parë shpalli se parimi i barazisë gjinore ishte një nga parimet themelore që përshkonin Konventën. Gjykata nuk e diskutoi shprehimisht kuptimin e barazisë gjinore dhe se si veprimet e kërkueses kërcënonin të drejtat e grave, apo se si parimi mund të përlligjte ndalimin e një gruaje në moshë madhore të ndiqte atë që dukej se ishte një praktikë e përqaftuar lirisht dhe me rëndësi vetjake. Gjithashtu ajo nuk hetoi pasojat që do të kishte ky ndalim për kërkuesen dhe për shumë femra të tjera në Turqi, të cilat nuk do të mundeshin të kishin akses të lire në arsim, për shkak të mbajtjes së “shamisë” nga kategoria e grave, të drejtat

dhe barazia e të cilave duhej mbrojtur(Anastasi, 2009:160). Thelbi i vendimit të Gjykatës në këtë rast lidhet me qëndrimin se ndalimi i mbajtjes së shamisë myslimane në institucionet akademike publike mund të justifikohet si masë e nevojshme në një shoqëri demokratike(Daci, 2011, 169).

Siç u përmend, neni 14 KEDNJ nuk krijon detyrimin që shtetet të garantojnë mosdiskriminimin në parashikimin e atyre të drejtave dhe lirive të parashikuara në Konventë, si jeta, liria, siguria, jeta private, liria e mendimit, ndërgjegjes dhe besimit, shprehjes e kështu me tej. Ai nuk krijon një të drejtë të veçantë si “e drejta e barazisë”. Organet e Konventës, kanë përcaktuar, që megjithëse natyra shtesë e Nenit 14 nuk i jep atij një ekzistencë të pavarur, përsëri ai ka një kuptim autonom. Megjithëse, në disa raste Komisioni dhe Gjykata kanë deklaruar që një shkelje në pamje të parë të njëjës prej të drejtave apo lirive të mbrojtura nga Konventa duhet të përcaktohet me qëllim që të lejojë shqyrtimin e një pretendimi shtesë për një shkeljetë nenit 14, ata nuk i janë përmbajtur gjithnjë kësaj si pikëpamje e qëndrueshme. Statusi autonom i nenit 14 do të thotë që edhe në qoftë se asnjë nga dispozitat thelbësore të Konventes nuk është shkelur, organet e Konventës (GJEDNJ), mund të konstatojnë shkelje të ndalimit kundër diskriminimit në zbatimin e dispozitës në fjalë.

a) Parimet e përgjithshme të zbatimit të Nenit 14 KEDNJ: natyra e tij plotësuese

Pavarësisht nga objekti i tij i kufizuar, rastet gjyqësore të bazuara në nenin 14 të Konventës kanë qenë të ndërlikuara dhe të ndryshme. Dy dilemat kryesore që paraqiten në rastet gjyqësore kanë të bëjnë me natyrën plotësuese dhe statusin autonom të nenit në fjalë.

Gjykata i ka trajtuar këto dy çështje të zbatimit që në fillimet e vënies në jetë të Konventës, në çështjen “*Belgian Linguistics*”. Në këtë çështje kryesore të bazuar në nenin 14, duke konstatuar një shkelje të Nenit 2 të Protokollit Nr. 1 që garantonte të drejtën e arsimit në bashkëveprim me nenin

14, Gjykata formuloi parimet e mëposhtme:

“Megjithëse është e vërtetë që kjo garanci nuk ka ekzistencë të pavarur në kuptimin që ajo ka të bëjë vetëm me “të drejtat dhe liritë e parashikuara ne Konvente”, një masë e cila në vetvete është në përputhje me parashikimet e Nenit që thekson të drejtën apo lirinë në fjalë, mund të përbëjë një shkelje të këtij Neni kur ky trajtohet në lidhje me nenin 14, për arsye se ajo është e një natyre diskriminuese”. (Gomien, David Harris, Leo Zwaak1996)

Këto parime u ritheksuan në çështje të tjera të mëvonshme. Në çështjen *Abdulaziz, Cabales dheBalkandali*, Gjykata konstatoi një shkelje të të drejtës së jetës familjare të garantuar nga neni 8 në lidhje me diskriminimin mbi bazën e seksit të ndaluar nga neni 14 dhe vuri në dukje se Shtetet Kontraktuese nuk kanë detyrimin të respektojnë zgjedhjen e një çifti të martuar për vendin ku do të jetojnë dhe për këtë arsye të pranojnë vendosjen e bashkëshortëve që nuk janë shtetas. Megjithatë, Gjykata u shpreh se Mbretëria e Bashkuar kishte shkelur nenin 14 në lidhje me nenin 8 duke deklaruar: Nocioni i diskriminimit sipas kuptimit të Nenit 14 ka të bëjë në përgjithësi me rastet kur një person apo grup trajtohet, pa justifikimin e duhur, në një mënyrë më pak të favorshme sesa një tjetër, edhe sikur trajtimi me të favorshëm të mos parashikohet nga Konventa.¹⁷

Pra, është pabarazia e një trajtimi të veçantë që trajtohet nga Neni 14, dhe jo krahasimi i mundësive të ndryshme që një shtet mund të zgjedhë kur kufizon ushtrimin e një të drejte thelbësore të caktuar. Komisioni dhe Gjykata rrallëherë kanë gjykuar se kur nuk kemi shkelje të njëjës prej të drejtave dhe lirive themelore të garantuara nga Konventa, mund të ketë shkelje të njëjës prej dispozitave thelbësore të marrë në lidhje me nenin 14.

¹⁷Vendimi *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali* i 28 Majit 1985, Seria A nr. 94. Në rastin në fjale tre gra që kishin leje qëndrimi të përhershme në Mbretërinë e Bashkuar dëshironin që të merrnin leje që bashkëshortët e tyre të bashkoheshin me to. Legjislacioni mbi emigracionin, në fuqi në atë kohë në Mbretërinë e Bashkuar, i ndalonte burrat të bashkoheshin me gratë që qëndronin ligjërisht në vend, por nuk i ndalonte grate t'i bashkoheshin burrave që qëndronin ligjërisht në vend.

b) Parimi i autonomisë

Organet e Strasburgut duket sikur nuk e pranojnë këtë autonomi në çështjet kur ata zbulojnë realisht një shkelje të të drejtave dhe lirive themelore. Në një sërë çështjesh ku Gjykata ka konstatuar shkelje të tilla, ata e kanë deklaruar të panevojshëm shqyrtimin e pretendimit për diskriminim sipas nenit 14, duke i dhënë kështu këtij neni një status më tepër zëvendësues sesa plotësues. Gjykata e përcaktoi këtë parim në çështjen *Airey kundër Irlandës*, kur një gruajë të varfër irlandeze iu mohua ndihma ligjore për hartimin e një kërkesë për ndarje gjyqësore nga bashkëshorti i saj. Gjykata konstatoi një shkelje të të drejtave të saj sipas nenit 6 (*e drejta e aksesit në gjykatë*) dhe të nenit 8 (*e drejta e respektimit të jetes familjare*), por rrëzoi kërkesën për shqyrtimin e pretendimit të saj për diskriminim duke deklaruar: “Neni 14 nuk ka ekzistencë të pavarur; ai përbën një element të veçantë (mosdiskriminimi) të të drejtave të garantuara nga Konventa. Në qoftë se Gjykata nuk konstaton asnjë shkelje të veçantë të njerit prej këtyre neneve, atëherë duhet shqyrtuar çështja edhe në bazë të nenit 14. Nga ana tjetër, një shqyrtim i tillë nuk kërkohet në përgjithësi, kur Gjykata gjen një shkelje të Nenit të parë të marrë me vete. Pozicioni ndryshon, në qoftë se pabarazia e qartë në trajtim në gëzimin e të drejtës në fjalë është një aspekt themelor i çështjes. . .”¹⁸

Në çështjen *Dudgeon kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Gjykata konstatoi një shkelje të nenit 8, por deklaroi se “nuk ekziston një qëllim ligjor i dobishëm që të përdoret për të përcaktuar nëse kërkuesi kishte vuajtur më tej diskriminim në krahasim me personat e tjerë që i nënshtroheshin kufizimeve më të vogla të të njëjtës të drejtë”. Gjykata rrëzoi pretendimin në bazë të nenit 14.¹⁹ Fakte dhe pikëpamje të ngjashme u dhanë dhe në një çështje të më vonshme, atë *Norris kunder*

¹⁸ Vendimi *Airey* i 9 Tetorit 1979, Seria A nr. 32, p. 16, par. 30.

¹⁹ Vendimi *Dudgeon* i 22 Tetorit 1981, Seria A nr. 45.

*Irlandës.*²⁰ Përpara përfundimit të diskutimit të natyrës plotësuese dhe statusit autonom të Nenit 14, është e rëndësishme të trajtojmë një çështje që përbën një përjashtim të pastër nga rregulli që neni 14 zakonisht zbatohet si plotësues ndaj të drejtave të tjera themelore të Konventës. Në çështjen *East African Asians kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kjo e fundit refuzoi t'i lejonte mbajtësit e pasaportave Britanike, të dëbuar nga Uganda, Kenia, dhe Tanzania të hynin dhe të vendoseshin në Mbretërinë e Bashkuar. Individët pretendonin se refuzimi i hyrjes ishte bërë mbi baza raciale dhe si i tillë përbënte shkelje të nenit 14 dhe të klauzolës për trajtim degradues të nenit 3. Konventa nuk garanton të drejtën për të hyrë në një vend apo për të emigruar. Megjithëse raporti i Komisionit nuk u publikua, Komisioni dhe Komiteti i Ministrave theksuan në deklaratat e tyre publike mbi çështjen, se veprimet e bazuara në motive raciale në disa rrethana mund të përbëjnë një shkelje të Nenit 3²¹, edhe sikur thelbi i vetë diskriminimit të mos ketë lidhje me dispozitën apo mohimin e një të drejte të mbrojtur nga Konventa.²²

c) Dallimet nga diskriminimi

Për të përcaktuar pikën në të cilën një ligj apo praktikë e brendshme e ka kaluar cakun e diskriminimit të ndaluar, Komisioni dhe Gjykata zbatojnë disa prej parimeve të njëjta të interpretimit të zhvilluara në rastet gjyqësore që trajtojnë problemet që lindin në bazë të neneve që përmbajnë klauzola kufizuese (nenet 8-11). Kuptimi i nenit 14 si nën plotësues i neneve të tjera, mund ta justifikojë pjesërisht këtë trajtim në ato çështje që ngrenë probleme në bazë të nenit 8, duke lejuar kufizimin e vetë parashikimeve të tyre.

Në çështjen *Belgian Linguistics*, Gjykata zbatoi kritere të krahasueshme me ato që përdori në çështjet që ngrinin probleme në bazë të nenit 8 me klauzolat kufizuese, që nënkupton ligjshmërinë

²⁰ Vendimi *Norris* i 26 Tetorit 1988, Seria A nr. 142.

²¹ Ndalimi i torturës.

²² Nr. 4715/70, 4783/71 dhe 4827/71, Dec. 6.3.78, R.V. 13. Kjo çështje u zgjidh me pajtim.

e qëllimit që duhet të përmbushet nga një praktikë e caktuar dhe të përpjestueshmërisë ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit të ligjshëm. Komisioni dhe Gjykata u kanë lejuar Shteteve Palë hapësirë të gjerë vlerësimi për të përcaktuar rrethanat në të cilat disa dallime janë të përshtatshme, duke e përcaktuar parimin më qartë në dy drejtime çështjesh, ato që trajtojnë kufizimet e gëzimit të pasurisë sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 dhe ato që trajtojnë të drejtat e sindikatave dhe organizatave profesionale. Drejtimi i parë përfshin çështje të tilla si *Lithgow dhe të Tjerët*, dhe *James dhe të Tjerët*.²³ Çështja e parë trajton shtetëzimin, kompensimin dhe çështje të lidhura me to; çështja tjetër trajton miratimin e ligjeve që i lejojnë përdoruesve për një kohë të gjatë të pasurive të marra me qira të fitojnë titullin e pronësisë mbi pasurinë sipas disa kushteve të caktuara. Gjykata i ka quajtur të dyja llojet e legjislacioneve dhe zbatimin e tyre brenda lirisë së veprimit që i është dhënë Qeverisë.

Një dallim i tillë në trajtim është diskriminues në qoftë se mungon “një justifikim objektiv dhe i arsyeshëm”, që do të thotë se nuk justifikohet nga “një qëllim i ligjshëm” dhe në qoftë se nuk ekziston një “raport i arsyeshëm përpjestimi ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të arrihet”

Në vazhdim të tre kritereve të përmendura në çështjen *Belgian Linguistics*, një element plotësues mund të vlerësohet nga Komisioni dhe Gjykata, kur situata e kërkuesit është pak a shumë e ngjashme me atë të individëve që gëzojnë një mbrojtje më të favorshme të të drejtës së pretenduar. Gjykata vuri në dukje se ky standard nuk ishte përmbushur në çështjen *Marckx*, në të cilën një grua pretendonte shkeljen e Protokollit Nr. 1, Neni 1 (*gëzimi i pronësisë*), Neni 8 (*jeta familjare*) dhe Neni 14 për legjislacionin Belg që zbatohet në rastet e fëmijëve të lindur jashtë martese. Gjykata

²³ Vendimi *Lithgow dhe të Tjerët* i 8 Korrikut 1986, Seria A nr. 102; vendimi *James dhe të Tjerët* i 21 Shkurtit 1986, Seria A nr. 98. Per kete argumente shih Zaganjori, Xh.; Canaj, E. “E drejta e pronës sipas nenit 1, te Protokollit 1, të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe impakti i vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Shqipëri”, *Jus&Justicia*, Nr. 3, UET Press, 2009, f. 40; Besnik Maho “Fitimi i pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme” UETPRESS, 2009.

vuri në dukje se situata si e fëmijës dhe e nënës ishin pak a shumë të ngjashme me ato ndërmjet një gruaje të martuar dhe fëmijës së saj, kështu që shteti nuk mund ta justifikonte dallimin në trajtim që ai kishte vendosur.²⁴

Në çështjen *Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Qeveria kërkuese pretendonte se Mbretëria e Bashkuar e zbatonte Ligjin “Për Kompetencat e Veçanta”, i cili kishte si qëllim të luftonte terrorizmin, në mënyrë diskriminuese, duke u përqëndruar në zbatimin e tij vetëm mbi komunitetin Katolik duke përjashtuar komunitetin Protestant në Irlandën e Veriut. Pavarësisht nga provat statistikore që e mbështetnin këtë pretendim, as Komisioni dhe as Gjykata nuk vlerësuan shkeljen e Nenit 14 në lidhje me nenin 5, duke patur parasysh hapësirën e vlerësimit të Qeverisë.²⁵ Është e rëndësishme të vihet në dukje se dhe Qeveria Irlandeze dhe ajo e Mbretërisë së Bashkuar ranë dakord që ekzistonte një rrezik publik sipas kuptimit të nenit 15 (i cili parashikon shmangiet nga Konventa në rrethana të tilla). Gjykata vuri në dukje se çdo dallim në trajtim të këtyre veprimeve terroriste në Irlandën e Veriut mund të justifikohet me faktin se qëllimi i ndjekur ishte i ligjshëm dhe mjetet e përdorura nuk binin në kundërshtim me qëllimin që duhej përmbushur.

Sot Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut kërkon të shkojë përtej ndalimit të diskriminimit të drejtpërdrejtë në mënyrë që të përforcojë mbrojtjen e ofruar nga neni 14, por ende nuk ka zhvilluar një jurisprudencë sistematike në këtë drejtim. Gjykata është përballur shpesh me situata kur ligjet dhe praktikat e Shteteve Palë bënë dallime ndërmjet kategorive të ndryshme, duke ngritur pyetjen nëse dallime të tilla mund të konsideroheshin objektivist dhe arsyeshmërisht të justifikueshme. Vetëm në vitin 2000, në çështjen *Thlimmenos kundër Greqisë*²⁶, Gjykata e zgjeroi jurisprudencën e saj duke vlerësuar si shkelje të nenit 14, moskrijimin e përshtajës së arsyeshme për të përmbushur

²⁴ Vendimi *Marckx* i 13 Qershorit 1979, Seria A nr. 31.

²⁵ *Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar* i 18 Janarit 1978, Seria A nr. 25.

²⁶ *Thlimmenos kundër Greqisë* i 6 Prillit 2000, 34369/97.

nevojat e disa kategorive të veçanta. Në këtë rast, ankuesit, një dëshmitari të Jehovahit i ishte mohuar emërimi si ekspert kontabël i autorizuar për shkak se nuk kishte pranuar të kryente shërbimin ushtarak. Vendimi i Gjykatës në këtë çështje mund të përdoret për të përmbushur nevojat e Ciganëve që lindin nga tradita e tyre e jetesës si nomadë.

Një drejtim tjetër në të cilin Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut po shkon është letësimi i barrës së provës për diskriminimin. Kur provat mund të ofrohen në formën e të dhënave statistikore, kjo mund të çojë në një njohje graduale të faktit që ka diskriminim të ndaluar në bazë të Nenit 14. Në çështjen *Hugh Jordan kundër Mbretërisë së Bashkuar*²⁷, Gjykata konstatoi se gjatë 25 viteve të fundit në Irlandën e Veriut ishin vrarë 357 persona nga anëtarë të forcave të sigurimit, dhe shumica e të cilëve i përkisnin komunitetit katolik ose nacionalist. Kur e krahasoi me nivelin e vrasjeve të individëve të komunitetit protestant, Gjykata arriti në përfundim se kishim një dallim në trajtim të përdorimit të forcës vdekjeprurëse dhe mungesë të mbrojtjes së një pjese të komunitetit mbi bazën e prejardhjes ose bashkimit kombëtar. Gjykata e hodhi poshtë kërkesën e ankuesit për diskriminim.

2.3.1. 4. Aktivitete të KE-së për promovimin e barazisë gjinore

Deri në vitin 1979 puna e KE-së në fushën e barazisë, me fokus në përmirësimin e statusit ligjor të grave dhe situatën e tyre të punësimit, kryej kryesisht bazuar në raste të ndryshme. Për shembull, Karta Sociale Evropiane e 1961-it përmbante një numër të drejtash të veçanta për gratë si e drejta për shpërblim të barabartë për punëtorët meshkuj dhe femra, mbrojtja e nënave dhe grave që punojnë e kështu me radhë. Në vitin 1979 KE ngriti një komitet ekspertësh me detyrë promovimin e barazisë, bazuar në një plan veprimi për promovimin e barazisë ndërmjet grave e burrave. Ndër të tjera u studiua edhe situata e grave në politikë, barazia

²⁷*Hugh Jordan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 4 maj 2001, 24746/94.

dhe arsimit, si dhe dhuna e ushtruar ndaj grave. Disa të drejta që mungonin në Kartën Sociale Evropiane, të lidhura me trajtimin e barabartë në përgjithësi dhe mundësi e trajtim i barabartë për punëtorët e të dyja seksëve me përgjegjësi familjare u përfshinë në një protokoll shtesë të Kartës Sociale Evropiane në vitin 1988.

Në vitin 1988 Komiteti i Ministrave miratoi *Deklaratën e Barazisë së Grave e Burrave*, e cila theksoi se barazia ishte njëparim i të drejtave të njeriut dhe se “diskriminimi i bazuar në seks që ndodh në fusha të ndryshme përbën pengesë për njohjen, gëzimin dhe ushtrimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”. Hyrja e kësaj deklarate njeh përsëritjen e pabarazive dhe diskriminimit. Ajo shpreh përkushtimin ndaj parimit të barazisë së burrave e grave si *sine qua non* të demokracisë dhe domosdoshmëri të drejtësisë sociale. Kjo deklaratë përmban një numër përkushtimesh të detajuara si pjesëmarrje dhe akses në të gjitha nivelet e shërbimeve shoqërore, profesione, informacion, etj. Në vitin 1989, me rastin e përvjetorit të katërbëdhjetë, KE-ja ndërmori një studim gjithëpërfshirës mbi barazinë ndërmjet grave e burrave në Evropë, në të cilin u paraqit një analizë e përfshirjes së masave ndërkombëtare për barazinë në sistemet ligjore të shteteve anëtare dhe të veprimeve pozitive si raste të diskriminimit të mbrapsmë. Po në 1989-n Komiteti i Barazisë u transferua nga fusha e çështjeve sociale dhe ekonomike në atë të të drejtave të njeriut, veprim i cili shënon ndërgjegjësimin rreth të drejtave të grave si të drejta të njeriut.

Ndërsa në vitin 1992 Komiteti Evropian për Barazi ndërmjet Grave e Burrave u ngrit në nivelin e Komitetit Drejtues. Ky Komitet ngriti Pikën e Vëzhgimit të Barazisë ndërmjet Grave e Burrave dhe organizoi disa mbledhje pune dhe konferenca. Komiteti u mor gjithashtu me kushtet e pasigurta të grave në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore gjatë transformimit ekonomik. Brenda Sekretariatit të Këshillit të Evropës, diskriminimi pozitiv (mekanizmi pohues) u përfshi në rregulloren e stafit *duke i dhënë përparësi seksit të nën-përfaqësuar*. Këshilli i Evropës

publikon një raport vjetor mbi masat promovuese të Sekretariatit të tij. Përveç njohjes së të drejtave të grave si të drejta njeriu, Komiteti u fokusua në barazinë dhe demokracinë, në të gjitha format e dhunës kundra grave dhe në të drejtën për zgjedhje të lirë në çështje të riprodhimit dhe stilit të jetesës. Më 1995 KE organizoi një konferencë për “Barazinë dhe Demokracinë” si kontribut për Konferencën e Pekinit. Aty u theksua zgjedhja e lirë e mëmësisë si një vlerë demokratike. Në këto rrethana u pranua *promovimi i barazisë së vërtetë ndërmjet grave e burrave është sinonimi i promovimit të të drejtave të njeriut dhe demokracisë pluraliste.*

2.3.2. Bashkimi Evropian, të drejtat e gruas dhe barazia gjinore

Pavarësisht se Komuniteti Ekonomik Evropian, i krijuar më 1957-n, fillimisht nuk i kushtoi vëmendje çështjeve politike, si të drejtat e njeriut e integrimi politik i Evropës, të drejtat e njeriut dhe demokracia janë tashmë koncepte kyçe të rendit ligjor të përbashkët evropian.(Canaj Bana, 2014,15). Që prej viteve 80, në fakt, Komuniteti Evropian përgatiti gjithashtu politika për të drejtat e njeriut në lidhje me vendet e treta, të cilat pasqyrohen sot në të ashtuquajturat kritere të Kopenhagenit. Të drejtat e gruas dhe barazia gjinore janë çështje të adresuara që në fillimet e BE (KEE në atë kohë), ndonëse jo në dimensionin e plotë që njohim sot. (Shkurti, 2009:27). Kështu, Traktati i Romës i vitit 1957 përfshinte parimin e pagës së barabartë për punë të barabartë²⁸. Një rol të rëndësishëm luajti këtu Gjykata Evropiane e Drejtësisë, e cila hartoi juridiksionin e të drejtave të njeriut, i prejardhur nga tradita të përbashkëta kushtetuese të vendeve anëtare dhe marrëveshjeve ndërkombëtare ku këto vende anëtare ishin pjesë, si Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Disa të drejta u konsideruan si parime të përgjithshme të ligjit komunitar, si e drejta e pronës, liria e krijimit të shoqërive dhe fesë, ose parimi i barazisë, i cili ka një rëndësi të veçantë në ligjin komunitar evropian. Në 1976, Gjykata Evropiane e Drejtësisë (GJED) vendosi

²⁸Neni 119 KEE, e me pas neni 141 KE, tani Neni 157 TFBE.

në *çështjen Defrenne* se neni 119 EEC kishte jo vetëm një qëllim ekonomik por edhe social. Ky vendim i hapi rrugën të drejtës moderne europiane për *barazi gjinore*. Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Amsterdimit në vitin 1999, promovimi i barazisë midis burrave dhe grave u bë një nga detyrat thelbësore të Komunitetit Europian (neni 2 KE). Shtetet Anëtare vendosën njëzëri të shtojnë një nen të ri në Traktatin e Amsterdimit për të ndaluar diskriminimin në të gjithë Europën. Kështu u parashikua për herë të parë në mënyrë të shprehur lufta kundër diskriminimit, ku në Nenin 13 të Traktatit Themelues të Komunitetit Europiane, thuhet: “Pa paragjykuar dispozitat e tjera të këtij Traktati dhe brenda kufijve të kompetencave që i ka dhënë Komuniteti, Këshilli, duke vendosur njëzëri dhe me propozim të Komisionit, pas marrjes së mendimit të Parlamentit Europian, mund të ndërmarrë veprimt e duhura për të luftuar diskriminimin mbi bazën e seksit, prejardhjes raciale ose etnik, besimit ose fesë, aftësisë së kufizuar, moshës ose orientimit seksual”. Tek ky nen e ka zanafillën legjislativi dhe praktikat e BE në luftën e gjatë kundër diskriminimit e pabarazive (Anastasi, Mandro-Balili, Shkurti, Bozo, 2012:42).

2.3.2.9.Traktatet Themeluese dhe ato rishikuese të BE-së

Në fillimet e ekzistencës së integritetit Europian, lufta kundër diskriminimit nuk ishte pjesë e axhendës së Komunitetit Europian.Traktatet Themeluese të Komuniteteve Europiane²⁹ nuk parashikonin shprehimisht dispozita kundër diskriminimit, pasi dhe natyra e tyre ishte rregullimi i politikave dhe strategjive sektoriale (Blanpain, 2003, 155) (Përmbledhje aktesh kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e barazisë gjinore,2007: 137). Në vitin 1965 në Bruksel u nënshkrua Traktati i Bashkimit, i cili krijoi një Komision dhe Këshill të vetëm për të tre Komunitetet Europiane. Traktati i Bashkimit Europian që u nënshkrua në Maastricht 1992 që hyri në fuqi në

²⁹Deri në traktatin e Amsterdimit ekzistonin tre Komunitete: Komuniteti i Qymyrit dhe Çelikut (1951); Komuniteti Ekonomik Europian (1957); dhe Komuniteti Europian i Energjisë Atomike (1957).

nëntor 1993,ndryshoi emrin e Komunitetit Ekonomik Europian në atë të “Komunitetit Europian”. Traktati i Amsterdimit i nënshkruar në 1997 hyri në fuqi në 1999dhe ndryshoi e rinumërtoi Traktatet e BE-së dhe të Komunitetit Europian (Canaj Bana, 2014,15). Në asnjërin prej këtyre akteve themelore për krijimin e asaj që sot njihet si Bashkimi Europian nuk parashikoheshin shprehimisht dispozita kundër diskriminimit, por në nenin 119 të Traktatit të Amsterdimit parashikoheshin dy dispozita të përgjithshme që bënin fjalë për ndalimin e diskriminimit mbi bazën e shtetësisë dhe Nenin 119 për pagën e barabartë të burrave dhe grave (Canaj, 2014,20). Por të dyja këto dispozita shiheshin si instrumenta ndihmëse për krijimin e tregut të përbashkët, duke qënë se vetë thelbi i tij ishte krijimi i një tregu të përbashkët dhe zhvillimi ekonomik i një Europe të Bashkuar.(Gruda, 2008:12). Në fakt deri në fund të viteve ‘80 dhe fillimin e viteve ‘90, diskriminimi shihej si çështje e të drejtave të njeriut dhe nuk trajtohej nga BE, por me mjaft “dëshirë” i lihej për trajtim Këshillit të Europës dhe Konventës së të Drejtave të Njeriut. Megjithatë ishin bërë disa përpjekje për miratimin e ligjeve për barazinë gjinore. Në vitet ‘90 në axhendën europiane u përfshinë edhe “çështjet e diskriminimit mbi baza të tjera” përvec atij seksual.(Picari, 2008:14). Kjo erdhi si rezultat i *problemeve te reja sociale që u pranuan politikisht si çështje që kërkonin zgjidhje*.

Problemet e racizmit ishin bërë haptazi të dukshme dhe ishin kthyer në një problem mjaft delikat dhe serioz që kërkonte zgjidhje e për këtë arsye nuk mund të “injorohej” më nga BE, gjë kjo që kishte lidhje të fortë me emigrimin dhe politikën e azilit, si dhe me çështjet e punësimit dhe tregut të punës. Institucionet e BE-së u vunë përpara presionit për të nxitur integrimin e pakicave kombëtare dhe për të hartuar dhe zbatuar një kuadër ligjor më të plotë në punësimin e këtyre pakicave pa dallim në trajtim *Lobimi efikas i OJF dhe Parlamentit Europian si dhe i disa*

grupeve të interesit po ashtu pati ndikim mjaft të madh.(Gruda, 2008:8)Një koalicion OJF-sh³⁰ hodhi dhe nxiti idenë e hartimit të një Direktive kundër diskriminimit dhe pati një përkrahje të gjerë të shoqërisë civile, Komisionit dhe Parlamentit Europian.

Ishin këta faktorë kryesorë si dhe merita e hartuesve të Traktatit të Amsterdimit, të cilët, në Nenin 13 të TBE (Traktatit Themelues të Komunitetit Europian) për herë të parë, parashikuan në Traktat njohjen formalisht të të drejtave të njeriut. Në nenin 13 të Traktatit Themelues të KE-së u parashikua që Këshilli mund të ndërhynte dhe mund të ndërmernte veprimet e duhura për të luftuar diskriminimin e bazuar në seksin, prejardhjen raciale ose kombëtare, besimin ose fenë, moshën ose orientimin seksual. Gjithashtu:(Gruda, 2008:10)

- Neni 6 (Ish-Neni F) u ndryshua në mënyrë që të ritheksonte parimin e respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke iu referuar për këtë shprehimisht Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut;
- U parashikua ndërmarrja e veprimeve më efikase në luftën kundër diskriminimit bazuar jo vetëm në kombësinë, por edhe kundër diskriminimit bazuar në seksin, prejardhjen raciale apo etnike, besimin, moshën, etj.
- U parashikuan dispozita të reja që nxisnin trajtimin e barabartë të burrave dhe grave;

Megjithatë, edhe pse nuk dëshironin të kundërshtonin hapur këto masa kundër diskriminimit, shtetet anëtare dhanë një pëlqim të kufizuar dhe kjo duket në dy elemente të tekstit të miratuar: Së pari, në tekst parashikohet vetëm baza ligjore për ndërmarrjen e veprimeve. Neni 13 nuk sjell pasoja të drejtpërdrejta dhe nuk i detyron shtetet anëtare të ndalojnë diskriminimin. Së dyti, procedurat e vendimarrjes mund ta ngadalësojnë ndjeshëm një progres të shpejtë. Këshilli duhet

³⁰Bëhet fjalë për një rrjet të gjerë organizatash joqeveritare nën emrin “*Starting Line Group*”, të koordinuara nga Grupi i Politikave të Migrimit. Ky rrjet i krijuar në vitin 1991 ishte një bashkim i më shumë se 400 OJF nga të gjitha vendet e BE që vepronin në fushën e anti-diskriminimit; referuar nga “*The starting line and the Incorporation of the racial Equality directive into the National laws of the EU member States and accession states*”, Isabelle Chopin and Jan Niessen, www.cre.gov.uk/downloads/mpg.pdf.

të vendosë me unanimitet dhe Parlamenti luan vetëm një rol këshillues. Fakti që Shtetet Anëtare ishin ende shumë larg pranimit me dëshirë të zhvillimeve të reja në këtë fushë provohet edhe nga fakti se jo të gjitha Shtetet Anëtare ranë dakord fillimisht për të zbatuar Protokollin Social të Maastrichtit ose të miratonin Marrëveshjen e Politikave Sociale (Siofra O’Leary 2002, 86).

Megjithatë, kjo nuk e zhvleftëson rëndësinë e këtij akti në luftën kundër diskriminimit në BE dhe madje kjo shpjegon edhe fillimin e shpejtë të hartimit të legjislacionit të ri në BE. Që nga viti 1999, BE-ja ka pasur kompetencë të ndërmarrë veprime të mëtejshme për të luftuar diskriminimin në bazë të gjinisë (Neni 13 (1) KE, tani 19 (1) TFBE). Ky nen siguroi bazën ligjore për *Direktivën mbi parimin e trajtimit të barabartë midis burrave dhe grave në aksesin dhe furnizimin me mallra dhe shërbime (Direktivën 2004/113 / KE)*.

2.3.2.10. *Traktati i Lisbonës*

Traktati i Lisbonës i cili hyri në fuqi në vitin 2009, ka konfirmuar edhe një herë rëndësinë e barazisë gjinore në Bashkimin European. Për sa i përket strukturës Traktati i Lisbonës përbëhet nga dy pjesë: Traktati i Ri i Bashkimit European (TRBE)– Traktati që modifikon Traktatin e Bashkimit European- dhe Traktati mbi funksionimin e Bashkimit European (TFBE), të dyja me të njëjtën vlerë juridike. Në këtë mënyrë Traktati i Lisbonës nuk i shfuqizon traktatet ekzistuese por vetëm i modifikon ato. Ky traktat ka një vlerë të madhe, pasi, edhe pse shumë i kontestuar, vuri përsëri në lëvizje procesin e integrimit european. Duhet theksuar se Traktati i Lisbonës është një nga etapat e reja në procesin e krijimit të një Unioni gjithnjë e më të ngushtë mes popujve të Europës (neni 1 TRBE), në vazhdim të hapave të tjera që duhen ndërmarrë në kuadër të zhvillimit të integrimit european. Një element tjetër pozitiv në lidhje me Traktatin rishikues lidhet me faktin se ai mbart, edhe pse me një theks tjetër, thelbin e modifikimeve dhe të risive, të

sanksionuara në Traktatin kushtetues.³¹ Barazia midis burrave dhe grave përfshihet në mesin e vlerave të përbashkëta mbi të cilat është themeluar Bashkimi Europian³² që do të thotë, për shembull, se ajo do të përdoret si njësi matëse për të përcaktuar nëse një shtet europian mund të jetë kandidat për anëtarësim. Promovimi i barazisë midis burrave dhe grave është e listuar edhe ndërmjet detyrave të Bashkimit Europian³³ së bashku me detyrimin për të eliminuar pabarazitë. Traktati i Lisbonës përsërit qartë detyrimin për sigurimin e barazisë gjinore nga BE-ja dhe Shtetet Anëtare. Diskriminimi është parë si trajtim i ndryshëm i një individi apo grupi individësh nga një individ apo grup tjetër individësh me të njëjta veçori, pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm për t'u trajtuar është dhe Karta e të Drejtave Themelore të BE-së. Traktati i Lisbonës e bën Kartën të detyrueshme nëpërmjet modifikimit të nenit 6 dhe nuk e ka bërë pjesë të Traktatit, për shkak të kundërshtimeve të atyre shteteve që kishin frikë të

³¹Kushtetuta e BE, dokument i cili u hartua në vitin 2004 dhe duhet të hynte në fuqi pas ratifikimit nga të gjitha vendet anëtare të BE (*perspektivë kjo e cila duket tashmë shumë e largët, pas dështimeve në referendumat e mbajtura në Francë dhe Hollandë*), bëri një hap përpara në nxitjen e luftës kundër diskriminimit në BE.

1. Barazia dhe mosdiskriminimi përmenden shprehimisht si *vlera* të Bashkimit (Neni I-2). Ky nen mbi vlerat e Bashkimit shërben si mjet referimi për anëtarësimin e shteteve të reja si dhe në monitorimin e të drejtave të njeriut në shtetet anëtare. Lufta kundër diskriminimit përmendet shprehimisht si një nga objektivat e Bashkimit (Neni I-3).

2. Kushtetuta përfshin në vetvete Kartën e të Drejtave Themelore (si Kapitullin 2 të saj), ku Neni II-21 ndalon diskriminimin mbi një sërë bazash. Një klauzolë e tillë shërben si trajtim i përgjithshëm kundër diskriminimit.

3. Mosdiskriminimi duhet të përshkojë të gjitha fushat e politikave të BE, përfshirë edhe Politikën e Shtyllës së Drejtësisë dhe Punëve të Brendshme dhe atë të Sigurisë dhe Politikës së Jashtme (Nenet III-2 dhe 3). Kjo është një gjë e re në luftën kundër diskriminimit.

4. Legjislacioni kundër diskriminimit vazhdon t'i nënshtrohet parimit të unanimitetit të Këshillit, por Parlamenti Europian ka fituar kompetenca të reja të dhënies së pëlqimit në rast këshillimi. E drejta për të dhënë pëlqimin mund të jetë një instrument mjaft i fuqishëm.

5. Masat jashtëligjore mund të vendosen me shumicë të cilësuar votash, duke shtuar këtu edhe bashkë-vendimarrjen e Parlamentit Europian.

6. Neni II-81 parashikon shprehimisht ndalimin e diskriminimit mbi çfarëdo lloj baze.

Miratimi i kësaj Kushtetute do të ishte një hap përpara në luftën kundër diskriminimit në BE. Forcat në favor të një përcaktimi më efikas të normave kundër diskriminimit do të fitonin shumë me miratimin e kësaj Kushtetute. Të gjitha ata që luftuan për futjen e Nenet 13 në Traktatin e Amsterdamsit duhet të luftojnë akoma për rritjen e presionit në mënyrë që lufta kundër diskriminimit në BE të jetë reale, efikase dhe e suksesshme. Lufta kundër diskriminimit nuk mund të fitohet me një fitore apo rastësisht. Ajo është një luftë e gjatë dhe e vazhdueshme.

Pavarësisht se dështoi dhe nuk u miratua, pjesa dërrmuese e dispozitave, parimeve të saj u përfshinë në Traktatin e Lisbonës.

³²Neni 2 TBE.

³³Neni 3 (3) TBE.

kontrolloheshin me përpikëmeri nga ana e Gjykatës së Drejtësisë për këto fusha të veçanta, duke zgjidhur, në këtë mënyrë, të gjitha problematikat që janë shfaqur dhe të gjitha vështirësitë e cilësimit të vlerës së saj juridike.

Sipas këtij neni: *1. Bashkimi njeh të drejtat, liritë dhe parimet e sanksionuara në Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit European, të 7 dhjetorit të vitit 2000, të miratuar më 12 dhjetor të vitit 2007, në Strasburg, e cila ka të njëjtën vlerë juridike si dhe traktatet. Dispozitat e Kartës nuk i zgjerojnë në asnjë mënyrë kompetencat e Bashkimit European, të përcaktuara në traktate. Të drejtat, liritë dhe parimet e Kartës interpretohen konform dispozitave të përgjithshme të Titullit VII të Kartës, të cilat rregullojnë interpretimin dhe aplikimin e saj, si dhe duke pasur parasysh shpjegimet, të cilave i referohet Karta, që tregojnë burimet e këtyre dispozitave.* *2. Bashkimi European anëtarësohet në Konventën Europiane për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Ky anëtarësim nuk ndryshon kompetencat e Bashkimit European të përcaktuara në Traktate.* *3. Të drejtat themelore të sanksionuara nga Konventa Europiane për liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe ato që rezultojnë nga praktikat kushtetuese të përbashkëta të Shteteve anëtare janë pjesë e së drejtës së Bashkimit European si parime të përgjithshme.*

Pra, Karta nuk futet në tekstin e traktatit (ndryshe nga traktati kushtetues), por neni 6 i tij sanksion shprehimisht që ajo mbart të njëjtën vlerë juridike si dhe traktatet. Bëhet fjalë për një “rezervë” ndaj një instrumenti ligjor të cilit traktati i reformës i ka dhënë vlerë juridike të detyrueshme. Kjo Kartë do të trajtohet gjerësisht në vijim.

2.3.2.11. *Karta e të drejtave dhe lirive themelore të BE-së*

Barazia gjinore e BE-së është gjithashtu një pjesë integrale e Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian, e cila ndalon diskriminimin mbi çfarëdo bazë, duke përfshirë edhe seksin, (neni 21) dhe e njeh të drejtën e barazisë gjinore në të gjitha fushat si dhe domosdoshmërinë për ndërmarjen e veprimeve pozitive për promovimin e saj (neni 23). Karta e të Drejtave Themelore, e përgatitur midis dhjetorit të vitit 1999 dhe tetorit të vitit 2000, nga një Asamble e quajtur “Konventë”. Karta u shpall në Nisë, në 7 dhjetor të vitit 2000, nga presidentët e Parlamentit Europian, Këshillit dhe Komisionit Europian dhe nga shtetet anëtare të Bashkimit Europian, përfshirë këtu edhe Anglinë³⁴. Karta e përbërë prej 54 nenesh, sanksionon të drejtat themelore në lidhje me dinjitetin, lirinë, barazinë, solidaritetin, shtetësinë dhe drejtësinë, dhe bazohet në traktatet e Komunitetit, mbi traditat e përbashkëta të Shteteve anëtare, dhe mbi konventat ndërkombëtare, midis të cilave Konventa Europiane e të Drejtave dhe e Lirive Themelore (KEDNj) e vitit 1950 dhe Karta Sociale Europiane e vitit 1989. Karta mund të konsiderohet dokumenti i parë formal i BE-së, i cili përmbledh në një tekst të vetëm të gjithë kategorinë e të drejtave civile, politike, ekonomike, sociale, si dhe disa të drejta të tjera të kategorisë të “brezit të tretë”, siç është e drejta për një mjedis të pastër ose e drejta për miradministrim. Edhe pse u shpall në mënyre solemne si një dokument i rëndësishëm, vlera e saj juridike ishte e pasaktësuar, pasi ajo nuk pati formën e një dokumenti detyrues për Shtetet anëtare, pasi nuk ishte pjesë e legjislacionit të BE-së dhe, në këtë mënyrë, vështirësia qëndronte te zbatimi i saj (edhe pse të drejtat e sanksionuara njihen prej Shteteve anëtare, garantimi i këtyre të drejtave nuk mund ta gjente bazën ligjore vetëm te Karta për arsyet e lartpërmendura). Karta, për sa i përket strukturës, përmban 54 nene, të përmbledhura në nëntë tituj (dinjiteti, liria,

³⁴Shih për një analizë të dokumenteve të hartuara në punimet që u zhvilluan në Këshillin Europian në Nisë në website www.ue.eu.int/it/info/eurocouncil/index.htm ose www.presidente-europe.fr/pfue/static/access.html.

barazia, solidariteti, shtetësia, drejtësia dhe dispozita të përgjithshme), të cilat përcaktojnë interpretimin dhe zbatueshmërinë e Kartës. Duke realizuar një sintezë të të drejtave themelore, të njohura tashmë edhe në tekste të ndryshme (si, për shembull, Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, Karta Sociale Europiane etj.) dhe në traditat kushtetuese kombëtare, ajo ka prirje të themelore bazat e një Bashkimi Europian, i cili synon të garantojë dhe të respektojë më së miri edhe të drejtat e shtetasve europianë, të cilat nuk janë ekskluzivisht me karakter ekonomik.

Karta sanksionon një kompleks të drejtash themelore, bazuar mbi vlerat e dinjitetit, të solidaritetit, të shtetësisë europiane dhe të drejtësisë, të përforcuara nga parimi i ndalimit të diskriminimit, e cila duhet të sigurohet pa asnjë dallim bazuar për arsye të tilla, si origjina kombëtare. Konkretisht neni 21 thotë: “Ndalohet çdo lloj diskriminimi për shkaqe të tilla siç janë gjinia, raca, ngjyra, origjina etnike apo sociale, tiparet gjenetike, gjuha, feja apo besimi, mendimet politike apo të llojeve të tjera, përkatësia në një pakicë kombëtare, prona, lindja, aftësia e kufizuar, mosha apo orientimi seksual. 2. Brenda fushës së zbatimit të Traktateve dhe pa cënuar asnjë prej dispozitave të caktuara të tyre, ndalohet çdo lloj diskriminimi për shkak të shtetësisë”³⁵. Karta aplikohet në mënyrë universale. Kjo do të thotë që sfera e saj subjektive e zbatimit nuk kufizohet vetëm në lidhje me shtetasit që mbartin shtetësinë e një prej Shteteve anëtare të Bashkimit Europian³⁶. Ky pohim kaq i rëndësishëm rrjedh si pasojë e formulimit të vetë dispozitave të Kartës. Një shembull i tillë është përdorimi i shprehjes “*çdo individ*” dhe jo “*çdo shtetas* që ka shtetësinë e një prej Shteteve anëtare të BE-së”. Pra, Karta gjen zbatim edhe te personat me shtetësi të një shteti që nuk bën pjesë në BE, të cilësuar më sipër emigrantë ekonomikë jo komunitarë (L.Manca, 2003). Në Kartë ka disa dispozita, të cilat, duke iu referuar

³⁵ Në Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian ka një sërë të drejtash, të cilat zbatohen duke mos e marrë për bazë shtetësinë, kështu që, në këtë aspekt, emigrantë europianë dhe të huaj, që qëndrojnë në mënyrë të ligjshme ose klandestinë këtu barazohen.

³⁶ Shih për shembull vendimet e Gjykatës Europiane të Drejtësisë: *Carpenter*, 11 korrik, 2002, çështja C-60/00; *MRAX*, 25 korrik, 2002, çështja C-459/99, e publikuar në vitin 2002; *Boumbast*, 17 shtator, 2002, çështja C-413/99 të gjitha të publikuara në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Europian në vitin 2002.

individit si qenie njerëzore në përgjithësi, gjejnë zbatim edhe për të huajt që ndodhen përkohësisht ose përgjithmonë në territorin e një prej Shteteve anëtare të BE-së: dispozitat që kanë të bëjnë me të drejtën për jetën (neni 2), me të drejtën për integritetin fizik dhe psikik (neni 3), me të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare (neni 7), me të drejtën për një proces të rregullt dhe të paanshëm (neni 47), me të drejtën për shkollim dhe për formim profesional (neni 14), me të drejtën për të punuar dhe për të ushtruar një profesion të përzgjedhur (neni 15) etj..(G.Tucci-A.Di Muro, 2003; U.Villani, 1/2004).

2.3.2.12. *Aktet dytësore. Direktivat*

Trajtimi i barabartë është objekt rregullimi në shumë Direktiva³⁷ të miratuara nga Këshilli European. Pothuajse të gjitha këto Direktiva kanë si objekt të rregullimit të tyre barazinë gjinore në fusha të ndryshme të punësimit apo sigurimeve shoqërore.(Picari, 2008:16). Për herë të parë nocioni i trajtimit të barabartë dhe anti-diskriminimit në instrumentet ligjor të BE-së përkufizohet shprehimisht në Direktivën 2000/43/KE “Për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht nga prejardhja e tyre raciale ose etnike” dhe Direktivën 2000/78/KE “Mbi krijimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punë dhe profesion”. Sipas direktivave të lartpërmendura “Parimi i trajtimit të barabartë do të kuptojë ndalimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë apo jo i drejtpërdrejtë të bazuar mbi besimin apo fenë, aftësinë e

³⁷ Direktiva 75/117/KEE, të 10 Shkurtit 1975 “Për përafrimin e legjislacionit të Shteteve Anëtare në lidhje me zbatimin e parimit të pagës së barabartë për burrat dhe gratë”; Direktiva 76/207/KEE e 9 Shkurtit 1976 “Për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë në lidhje me hyrjen në punësim, trajnim profesional dhe ngritje në detyrë si dhe kushtet e punës”; Direktiva 79/7/KEE 1 19 Dhjetorit 1978 “Për zbatimin gradual të parimit të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë në çështjet e sigurimeve shoqërore; Direktiva 86/378/KEE e 24 Korrikut 1986 “Për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në skemat e sigurimeve shoqërore për punësimin”; Direktiva 86/613/KEE e 11 Dhjetorit 1986 “Për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave që marrin pjesë në aktivitete si bujqësia, vetë-punësimi dhe mbrojtja gjatë shtatzanisë”; Direktiva 97/80/KE e 15 nëntorit 197 “Për barrën e provës në rastet e diskriminimit të bazuar në seksin”;

kufizuar, moshën apo orientimin seksual në lidhje me punësimin dhe profesionin”³⁸. (Anastasi, Mandro-Balili, Shkurti, Bozo, 2012:45)

Ndonëse BE nuk ka aderuar në Konventën KEFDG, vendet anëtare të saj e kanë njohur dhe ratifikuar këtë Konventë. Neni 141/KE-së ndalon jo vetëm diskriminimin e drejtpërdrejt, bazuar në gjini, në fushën e pagës, por edhe diskriminimin e tërthortë. (Gruda, 2008:10) Diskriminimi i drejtpërdrejt për shkak të seksit ndodh kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme për shkak të seksit të tij apo të saj. Diskriminimi i tërthortë i referohet diskriminimit i cili është rezultat i zbatimit të kriterit asnjës ndaj seksit, i cili i ve në pozitë të pafavorshme veçanërisht personat që i përkasin njërit seks krahasuar me personat e seksit tjetër³⁹.

Koncepti i diskriminimit sipas legjislacionit të BE-së, përfshin aspektet e mëposhtme: diskriminimin e drejtpërdrejtë, diskriminim e jo i drejtpërdrejtë, ngacmimin dhe nxitjen për diskriminim⁴⁰, që trajtohen më gjersisht në vijim.

2.3.2.13. *Diskriminimi i drejtpërdrejtë*

Legjislacioni aktual i BE-së në luftën kundër diskriminimit dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut e ka ndarë diskriminimin në të drejtpërdrejtë dhe jo të drejtpërdrejtë. (Gruda, 2008:9) Sipas interpretimit të dy Direktivave kryesore të Këshillit diskriminimi i drejtpërdrejtë (direkt) ndodh

³⁸ Nenet 1 dhe 2 të Direktivës 2000/78/KE dhe Nenet 1 dhe 2 të Direktivës 2000/43/KE.

³⁹ Udhëzues: Çështjet e barazisë gjinore në standardet ligjore dhe jurisprudencën kombëtare e ndërkombëtare, UNIFEM dhe Shkolla e Magjistraturë, Pegi: Tiranë, fq.25.

⁴⁰ Ndersa në legjislacionin shqiptar, te cilin do e analizojme gjersisht ne kapitujt ne vijim, dhe konkretisht në ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi përkufizimi i fjalës diskriminim jepet si “çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur si më poshtë, gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.

kur një individ ose grup individësh trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një individ ose një grup tjetër individësh po trajtohen, janë trajtuar apo do të trajtohen në një situatë të ngjashme në bazë të njërit prej kushteve të përcaktuar nga Direktivat (*prejardhjen raciale ose etnike, besimin ose fenë, aftësinë e kufizuar, moshën ose orientimin seksual*). Thelbi kryesor i diskriminimit të drejtpërdrejtë qëndron në zgjedhjet që bën një person (*në rastin e Direktivave të lartpërmendura*) mbi bazën e kritereve të tilla ngjyra, raca, etj. Por jo çdo dallim në këtë trajtim përbën diskriminimin, pasi nuk ka asnjë dyshim se çdo proces zgjedhjeje pas sjell në njëfarë mënyre diskriminimin. Dallimi në trajtim do të jetë i paligjshëm, pra do të përbëjë edhe diskriminim të ndaluar, kur zgjedhja e bërë në bazë të një kriteri të ndaluar që mund të çojë në diskriminimin, sjell një trajtim të pafavorshëm në rrethana të caktuara.

Legjislacionet e shumicës së Shteteve Anëtare, në këtë drejtim, përputhen me direktivat e BE-së përse i përket kushteve që duhen përmbushur që një diskriminim të quhet i drejtpërdrejtë dhe konkretisht:

- Domosdoshmëria për të provuar trajtimin më pak të favorshëm;
- Krahasimi me një person apo grup tjetër në një situatë të ngjashme, por me karakteristika të veçanta;
- Bazën diskriminuese pra, prejardhjen, besimin, orientimin seksual, etj;
- Mundësinë e përdorimit të një kriteri krahasimor nga e shkuara ose një kriteri krahasimor të supozuar;
- Mosjustifikimi i dallimit në trajtim.

Mendojmë se përveç këtyre kritereve diskriminimi i drejtpërdrejtë kërkon edhe njëfarë shkalle të vetëdijes së personit që po shkakton diskriminimin. Pra, punëdhënësi duhet të jetë i vetëdijshëm

se po bën një dallim të paligjshëm në trajtim bazuar në disa veçori të individit apo grupit, veçori këto që parashikohen si kritere të ndaluara për dallimin në trajtim. Këto elemente mund të gjenden në shumicën e legjislacionit të Shteteve Anëtare. Por në Shtete të tjera Anëtare legjislacioni që zbaton Direktivat në fjalë bashkëjeton me legjislacionin tjetër që mund të mund ta parashikojë ndryshe diskriminimin e drejtpërdrejtë. Në Francë dhe Hollandë, për shembull, diskriminimi i drejtpërdrejtë është i ndaluar, por nuk përkufizohet më tej në legjislacion. Përsa i përket kritereve krahasuese, ligjet në Spanjë dhe Hungari nuk e lejojnë shprehimisht përdorimin e një kriteri krahasues të të shkuarës apo hipotetik. Në Irlandë, kushti për një kriter krahasues është përpunuar nëpërmjet jurisprudencës. Ky është edhe i vetmi vend ku jurisprudenca ka përcaktuar me hollësi kriterin krahasues të përshatshëm në rastet e diskriminimit. Përsa i përket kushtit se diskriminimi i drejtpërdrejtë nuk justifikohet, ka patur shumë debate për mundësinë e justifikimit objektiv të këtij diskriminimi. Është arritur në përfundimin se diskriminimi i drejtpërdrejtë mund të justifikohet vetëm kur kemi të bëjmë me kushte të mirëfillta për punësim, por edhe në këto raste interpretimi i këtyre kushteve duhet të jetë sa më i ngushtë.

2.3.2.1. Diskriminimi jo i drejtpërdrejtë

Sipas legjislacionit të BE “diskriminimi jo i drejtpërdrejtë” (*indirekt*) ndodh kur një dispozitë, kriter apo praktikë në dukje neutrale, vendosin një person të një feje apo besimi të caktuar, aftësie të kufizuar të caktuar, moshe të caktuar, orientimi seksual të caktuar, në një pozicion të caktuar të pafavorshëm krahasuar me personat e tjerë, përveçse kur dispozita, kriteri apo praktika është objektivisht e justifikueshme nga një qëllim i ligjshëm dhe kur mjetet e arritjes së këtij qëllimi janë në përpjestim dhe të nevojshme. Koncepti i diskriminimit jo të drejtpërdrejtë si

koncept i legjislacionit të Komunitetit filloi me jurisprudencën e Gjykatës Europiane të Drejtësisë në çështjen Defrenne II⁴¹.

Në këtë çështje diskriminimi jo i drejtpërdrejtë trajtohej si diskriminimi i fshehtë. Gjykata bëri dallimin ndërmjet:

“diskriminimit të drejtpërdrejtë dhe të hapur që mund të identifikohet vetëm me ndihmën e kritereve të bazuara në punën dhe pagën e barbartë parashikuar në Nenin në fjalë dhe diskriminimit jo të drejtpërdrejtë dhe të fshehur që mund të identifikohet duke iu referuar dispozitave zbatuese të shprehura me karakter komunitar apo kombëtar”.

Por, nocioni bashkëkohor i diskriminimit jo të drejtpërdrejtë u hodh veçanërisht në rastet e diskriminimit seksual⁴² në rastet e punës me kohë të pjesshme, për shkak se në këto lloje punësh punonin më shumë gra se burra si dhe me pagën që ato përfitonin. Në çështjen Jenkins⁴³ dallimet në pagë ndërmjet punonjësve me kohë të plotë dhe atyre me kohë të pjesshme [*në përpjestim me kohën e punës*] u cilësuan nga Gjykata si diskriminim i fshehtë. Përkufizimi i ri, që njohim sot u frymëzua nga vendimi i Gjykatës Europiane të Drejtësisë për lëvizjen e lirë të punonjësve⁴⁴. (Semini, 2013: 25) Pavarësisht se një kriter, praktikë apo dispozitë neutrale në dukje mund ta vërë dikë në një pozicion të pafavorshëm në krahasim me persona të tjerë, sipas Notës Shpjeguese 15 të të dyja Direktivave, legjislacioni i brendshëm mund të parashikojë që diskriminimi jo i drejtpërdrejtë të konstatohet edhe mbi bazën e statistikave. Ndryshe nga diskriminimi i drejtpërdrejtë, përkufizimi i diskriminimit jo të drejtpërdrejtë përfshin mungesën e justifikimit objektiv për dallimin në trajtim. Justifikimi duhet të jetë objektiv dhe i bazuar në një qëllim të ligjshëm; mjetet për arritjen e qëllimit të ligjshëm duhet të jenë të përshtatshme dhe të nevojshme

41Çështja 43/75, Gabrielle Defrenne kundër Société Anonyme Belge de Navigation Aérienne Sabena (Defrenne II) [1976] ECR 455.

42Çështja Kachelmann, 26 Shtator 2000, C-322/98, ECR 2000, p-7505, <http://curia.europa.eu/>

43Çështja 96/80 J.P. Jenkins kundër Kingsgate (Clothing Productions) Ltd [1981] ECR 911.

44Çështja O'Flynn, 23 Maj 1996, C-237/94, ECR 1996, p. I-2617, <http://curia.europa.eu/jurisp/>

(neni 2(2)(b) i të dyja Direktivave). Testi i justifikimit është i ngjashëm me atë të përcaktuar për rastet e diskriminimit seksual (Çështja Bilka⁴⁵). (Semini, 2013: 9)

Gjykata Europiane e Drejtësisë i ka lënë një hapësirë të gjerë vlerësimi shteteve anëtare për përcaktimin e diskriminimit jo të drejtpërdrejtë, në shumicën e të cilëve dispozitat ligjore që janë pjesë e politikave sociale janë ende nën shqyrtim⁴⁶.

Britania e Madhe ka qënë pararoja e zbatimit të parimit të barazisë, nëpërmjet legjislacionit të anti-diskriminimit. Në vitin 1968, Ligji për Marrëdhëniet Raciale parashikonte se ngjyra, raca, dhe prejardhja etnike ose kombëtare nuk ishin kritere që duheshin marrë parasysh në shpërndarjen e disa të mirave. Megjithatë, ky ligj shpejt u konsiderua si jo efikas në arritjen e qëllimit të tij. Arsyet kishin të bënin me barrë e provës (kërkohej provueshmëria e qëllimit të dallimit në trajtim), por edhe se çfarë kriteri ndalues bënte që dallimi në trajtim të quhej si diskriminim i paligjshëm. (Semini, 2013: 25) Ky ligj për herë të parë përdori shprehjen “diskriminim jo i drejtpërdrejtë”. Në Hungari diskriminimi jo i drejtpërdrejtë quhet se ndodh kur një dispozitë ligjore e vë një individ ose grup individësh me karakteristika të veçanta në një pozicion ndjeshëm të pafavorshëm në krahasim me një individ apo grup tjetër në një situatë të ngjashme⁴⁷. Në Letoni, legjislacioni i referohet masave që sjellin “pasoja të papranueshme” dhe jo një “disavantazhi të veçantë”. Në Lituani vlerësohet nëse masat krijojnë favorizime diskriminuese. Ligji polak vendos si kusht shkaktimin e një dëmi ndaj një individi apo grupi të caktuar, ndërsa në Britaninë e Madhe diskriminimi jo i drejtpërdrejtë kërkon prova që masa e marrë e ka vendosur individin ankues në një pozicion të pafavorshëm. Direktivat po i paraprijnë

⁴⁵Çështja Bilka - Kaufhaus GmbH kundër Karin Weber von Hartz [1986] ECR 1607 <http://curia.europa.eu/jurisp/cgi-bin/form..>

⁴⁶Çështja Megner and Scheffel, 14 Dhjetor 1995, çështja C-444/93, ECR 1995, fq. I-4741, <http://curia.europa.eu/jurisp/>

⁴⁷Neni 9 i Ligjit për Trajtimin e Barabartë dhe Ligji për Nxitjen e Barazisë së Mundësive, referuar nga raportet kombëtare dhe analiza krahasuese ndërmjet tyre, botim i Komisionit Europian, fq 28, Shtator 2005.

një krahasimi ndërmjet pasojës së masës mbi personat apo grupet e veçanta dhe ndikimit të tyre tek personat e tjerë⁴⁸.

2.3.2.1. Ngacmimi

Një koncept i ri i futur nga Direktiva 2000/78 EC për Punësimin është ai i ngacmimit (*Neni 2/3*). Ngacmimi, si formë e diskriminimit, përkufizohet si “*një sjellje e padëshirueshme në lidhje me një nga kushtet e Direktivës (prejardhja raciale apo etnike, feja ose besimi, aftësia e kufizuar, mosha, ose orientimi seksual) që ndodh me qëllim apo pasojë cënimit e dinjitetit të një personi dhe krijimin e një mjedisi kërcënues, pengues, degraudes, poshtërues për individin në fjalë*. Direktiva e lë në vlerësim të Shteteve Anëtare që të përkufizojnë nocionin e ngacmimit nëpërmjet ligjeve ose praktikave të tyre. Shumica e Shteteve Anëtare e kanë përkufizuar konceptin e ngacmimit, përkufizime të cilat janë të ngjashme me atë të Direktivës. Nga ana tjetër Direktiva i referohet “sjelljes së padëshiruar...me qëllimin ose pasojën e cënimit të dinjitetit të personit”.⁴⁹ Kjo do të thotë që ngacmimi ndodh edhe kur nuk ka patur cënim real por vetëm qëllim ose pasojë të cënimit të dinjitetit të personit. Në disa Shtete koncepti është përkufizuar në mënyrë më të kufizuar sesa në disa të tjera. Kështu për shembull në Estoni, ngacmimi përkufizohet si: “sjellje apo veprim, verbal, jo verbal ose fizik, që e vë një person në pozitën e varësisë apo nënshtrimit”⁵⁰. Legjislacionet në Austri dhe Suedi⁵¹ kërkojnë që dinjiteti i viktimës të jetë cënuar plotësisht. Direktiva nuk parashikon rregulla specifike për të përcaktuar nëse sjellja është e tillë saqë të cënojë dinjitetin e personit ose të krijojë një mjedis cënues. Shtete të

⁴⁸ “Raportet kombëtare dhe analiza krahasuese ndërmjet tyre”, botim i Komisionit Europian, Shtator 2005.

⁴⁹ Neni 2 (3) të Direktivave 2000/43 dhe 2000/78.

⁵⁰ Neni 10(4) i Ligjit për Kontratat e Punës, referuar nga raportet kombëtare dhe analiza krahasuese ndërmjet tyre, botim i Komisionit Europian, fq 29.

⁵¹ Referuar nga “Raportet kombëtare dhe analiza krahasuese ndërmjet tyre”, botim i Komisionit Europian, Shtator 2005.

ndryshme kanë kërkuar ta sqarojnë këtë pikë në legjislacionin e tyre të brendshëm. Në Sllovaki, i referohen trajtimit të cilit personi mund ta perceptojë në mënyrë të arsyshme si ngacmim. Ky prag e vë theksin tek perceptimi i viktimës dhe i takon gjykatave të përcaktojnë standardin e arsyeshmërisë. Një tjetër çështje që është lënë hapur nga Direktiva është përgjegjësia e punëdhënësit për veprimet e ngacmimit të shkaktuara nga punonjësit e tjerë ose palët e treta. Në shumë shtete, punëdhënësit mund të quhen përgjegjës për veprimet e punëmarrësve, ose, ndaj punëmarrësve të tyre, por deri në një farë mase. Disa Shtete Anëtare kanë zgjedhur të vendosin detyrimin ndaj punëdhënësve që të ndërmarrin veprime për parandalimin e ngacmimit. Për shembull, në Finlandë dhe në Suedi kur një punëdhënës vihet në dijeni të ngacmimit ai ka detyrimin të hetojë dhe të marrë masa në përfundim të hetimit. Nenet 122-152 të Kodit të Punës Francez për shembull e vendosin detyrimin për punëdhënësin që të marra të gjitha masat e nevojshme për t'i dhënë fund ngacmimit. Në Britaninë e Madhe dhe Irlandë nuk ekziston një detyrim i shprehur i punëdhënësve për marrjen e masave për parandalimin e ngacmimit. Megjithatë, punëdhënësit nuk quhen përgjegjës për aktet e ngacmimit të punonjësve të tyre në rast se ata provojnë se kanë marrë masa të arsyeshme dhe praktike për parandalimin e tyre. Ngacmimi i përkufizuar në Direktiva dhe i përkufizuar në legjislacionet e brendshme të Shteteve Anëtare kundër diskriminimit nuk duhet të mbivendoset me legjislacionin tjetër specifik që ndalon ngacmimin. Në disa raste si në Francë apo Belgjikë ngacmimi parashikohet në legjislacionin që trajton ngacmimin moral apo seksual. Duhet patur parasysh që ngacmimi moral është i vazhdueshëm dhe çon në cënimin e dinjitetit të individit. Mendoj se do të ishte mjaft pozitive që të ndiqej shembulli i Irlandës dhe Britanisë së Madhe ku ngacmimi të përkufizohej dhe trajtohej me hollësi në Kodet Etike të profesioneve të ndryshme.

Direktiva ka bërë një hap përpara duke parashikuar në Nenin 2/4 se nxitja për diskriminim kundër personave për secilin prej kushteve të përmendura më lart, përbën diskriminim. Nxitja për diskriminim ndodh, për shembull, kur një punëdhënës detyron anëtarët e komisioneve të intervistimit të kandidatëve për punë të mos punësojnë individë me disa karakteristika të veçanta (*gra, njerëz me ngjyrë, etj.*).

Direktiva e ka ngritur një nivel më lart ndalimin e diskriminimit duke quajtur të paligjshëm jo vetëm veprimin e personit që kryen diskriminimin por edhe veprimin e atij që udhëzon kryerjen e një diskriminimi të tillë. Pothuajse, në legjislacionin e të gjitha Shteteve Anëtare ka një dispozitë të ngjashme që ndalon nxitjen për diskriminim në kuadrin e përfshirjes së dy direktivave të lartpërmendura në sistemin e brendshëm ligjor⁵². Megjithatë, parimet e përgjithshme për përgjegjësinë dhe bashkëpunimin në diskriminim mund të sjellin efekte të njëjta. Në Mbretërinë e Bashkuar, situata ligjore është më e ndërlikuar. Nxitja, presioni apo shtyrja për të diskriminuar janë veprime të paligjshme brenda kuadrit ligjor kundër diskriminimit në bazë të racës, aftësisë së kufizuar apo besimit. Viktimat e pretenduara nuk mund të fillojnë çështje kundër nxitjes për diskriminim. Për më tepër, legjislacioni i ri kundër diskriminimit në bazë të orientimit seksual dhe besimit ose fesë nuk parashikon dispozita specifike që të ndalojnë nxitjen për të diskriminuar. Në përgjithësi, nxitja për diskriminimin dhe urrejtje raciale parashikohet si vepër penale në Kodet Penale të Shteteve Anëtare⁵³, por detyrë kryesore e Shteteve anëtare është përfshirja e këtij nocioni në legjislacionin civil, veçanërisht atë që rregullon parimin e barazisë në fushën e punësimit.⁵⁴

⁵²Referuar nga nga “Raportet kombëtare dhe analiza krahasuese ndërmjet tyre”, botim i Komisionit European, Shtator 2005.

⁵³Shih Legjislacionin kundër diskriminimit në Shtetet Anëtare të BE-së, botime të Qendrës Europiane të Monitorimit për Racizmin dhe Ksenofobinë, referuar nga <http://eumc.eu.int/eumc/material/pub/Art13/>

⁵⁴Po aty.

Ndërkohë Komisioni European miratoi edhe Strategjinë për barazi midis grave dhe burrave (2010-2015). Strategjia për barazinë ndërmjet grave dhe burrave për periudhën 2010-2015 reflekton përkushtimin e Komisionit për të përsheptuar aktivitetet e tij në fushën e barazisë gjinore. (Picari, 2008:24). Kjo strategji përcaktonte gjashtë fusha prioritare:

- Pavarësi e barabartë ekonomike për gratë dhe burrat;
- Paga të barabarta për punë me vlerë të barabartë;
- Barazi në vendimmarrje;
- Respektimi i dinjitetit, integritetit dhe dhënia fund dhunës gjinore;
- Promovimi i barazisë gjinore përtej BE-së;
- Çështjet horizontale.

Komisioni European parashikon çdo vit një vlerësim të hollësishëm të barazisë midis grave dhe burrave në të gjitha fushat prioritare të Strategjisë. Raporti i vitit 2014 mbi barazinë midis grave dhe burrave është botuar më 6 mars 2015.

2.3.5. Jurisprudenca e Gjykatës Europiane e Drejtësisë në lidhje me barazinë dhe mosdiskriminimin

Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit European është institucioni i cili, me anë të ushtrimit të funksionit të tij juridiksional, siguron respektimin e të drejtës komunitare në interpretimin dhe zbatimin e traktateve dhe akteve normative që rrjedhin prej tyre (neni 19 TBE). Lidhur me barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin, miratimi në vitin 2000 i dy Direktivave kryesore të Këshillit kundër diskriminimit ka ndikuar në interpretimin e konceptit të trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues. Kjo influencohej drejtpërdrejt nga Direktivat e BE-së të përmendura më lart

(De Schutter2005). Ndikimi i jurisprudencës së GJED-së në interpretimin e Direktivave të miratuara në bazë të Nenit 13 mund të shihet në vendimin e Shteteve Anëtare për t'i dhënë më shumë kompetenca Këshillit për të marrë masa kundër diskriminimit bazuar në një sërë kushtesh: origjinën raciale dhe etnike, fenë ose besimin, aftësinë e kufizuar dhe moshën; dhe më pas në zgjedhjen e Këshillit për të ofruar një mbrojtje më të gjerë kundër diskriminimit bazuar në racën apo prejardhjen etnike. (Semini, 2013: 9) Megjithatë, në bazë të Nenit 2(5) të Direktivës Kuadër për Punësimin, kjo Direktivë është një instrument “që nuk paragjykon masat e marra në bazë të ligjit të brendshëm, që në një shoqëri demokratike janë të domosdoshme për sigurinë publike, ruajtjen e rendit publik dhe parandalimin e veprave penale, për mbrojtjen e shëndeti dhe për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve”. Megjithëse është formuluar sipas modelit të Nenit 9(2) të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, që parashikon kushtet se kur mund të kufizohet liria e besimit, Neni 2(5) i Direktivës Kuadër për Punësimin është deri diku më i kufizuar në masat justifikuese që lejojnë dallimin në trajtim, pasi “mbrojtja e moralit” nuk përbën një objekt të ligjshëm që mund të justifikojë kufizimet e të drejtave të parashikuara në këtë Direktivë.

Në Korrik 2004, Komisioni dërgoi përpara Gjykatës Europiane të Drejtësisë pesë Shtete Anëtare (Austrinë, Finlandën, Gjermaninë, Greqinë dhe Luksemburgun) për moszbatim të Direktivës për Barazinë Raciale. Ende nuk është marrë një vendim përfundimtar mbi këtë çështje. Në Dhjetor 2004, Komisioni i dërgoi të njëjtat Shtete Anëtare përpara Gjykatës për moszbatim të Direktivës Kuadër për Barazinë në Punësim. Edhe në këtë rast njoftimi paraprak i Komisionit nuk e zgjidhi çështjen ndërkohë që në disa raste të tilla kishte qënë i suksesshëm (Belgjika, Danimarka, Irlanda, Holanda, Portugalia dhe Mbretëria e Bashkuar). Ndërkohë që nën presionin e Komisionit, në fund të vitit 2004 në Greqi u miratua ligji kundër diskriminimit ndërsa në

Finlandë dhe në Austri vetëm në disa zona nuk janë zbatuar ende Direktivat. Në Shkurt 2005 Finlanda dhe Luksemburgu u dënuan nga Gjykata për moszbatimin e Direktivës për Barazinë Raciale.⁵⁵ Në fund të 2004 nga të 10 Shtetet e reja Anëtare vetëm Republika Çeke e kishte njoftuar zyrtarisht Komisionin për zbatimin e Direktivave. Aktualisht, Komisioni po vlerëson situatën dhe mund të dërgojë përpara Gjykatës jo më një shtet, por disa prej tyre me të njëjtën kërkesë.

Fillimisht diskriminimi i parashikuar nga legjislacioni i BE ishte vetëm i një lloji. Është meritë e Gjykatës Europiane të Drejtësisë, e cila me anë të jurisprudencës së saj bëri dallimin ndërmjet diskriminimit të drejtpërdrejtë dhe atij jo të drejtpërdrejtë.

Në çështjen *Finanzamt Köln-Altstadt kundër Schumacker*⁵⁶, Gjykata u shpreh se “diskriminimi mund të lindë vetëm nëpërmjet zbatimit të rregullave të ndryshme për situata të ngjashme ose zbatimin e të njëjtit rregull për raste të ndryshme. (Semini, 2013: 46)Ky parim u përsërit edhe në çështjet *Ugliola*⁵⁷ dhe *Sotgiu*⁵⁸. Gjykata ka përcaktuar se në çështjet që kanë të bëjnë me lëvizjen e lirë të punonjësive “parimi i trajtimit të barabartë...ndalon jo vetëm diskriminimin e hapur bazuar në kombësinë, por edhe format e tjera të diskriminimit, të cilat duke përdorur kritere të tjera dalluese çojnë në të njëjtin rezultat. Nga ky vendim nuk mund të mendohet se kritere të tilla si vendi i origjinës, ose vendbanimi i një punonjësi, mund në varësi të rrethanave dhe pasojave të tyre të çojnë në diskriminim të njëjtë me atë mbi bazën e kombësisë, parashikuar nga Traktati. Pra, ideja e Gjykatës është se nuk do të ndalohen vetëm ato forma të dukshme të diskriminimit por edhe ato forma më pak të dukshme të tij, por që sjellin të njëjtin efekt ose rezultat.

⁵⁵Çështjet C-327/04 dhe C- 320/04, 24 Skurt 2005, www.curia.eu.int.

⁵⁶Çështja C-279/93 *Finanzamt Köln-Altstadt kundër Schumacker* [1995] ECR I-225 para 30.

⁵⁷Çështjas 15/69 [1969] ECR 363 *Wurtembergische Milchverwertung-Sudmilch-AG kundër Salvatore Ugliola*,

⁵⁸Çështja 152/73,

Përsa i përket diskriminimit të drejtpërdrejtë një zhvillim të madh jurisprudenca e GJED arriti në çështjen *Defrenne II*⁵⁹ kur ajo u shpreh se Neni 119 i Traktatit të BE-së kishte efekt të drejtpërdrejtë në të gjitha Shtetet Anëtare duke i lejuar gratë ta përdornin si bazë ligjore për të drejtën e pagës së barbartë përpara gjykata kombëtare. Për më tepër në çështjen *Defrenne III*⁶⁰ Gjykata u shpreh se eliminimi i diskriminimit mbi bazën e seksit është pjesë e të drejtave themelore respektimi i të cilave është një parim i përgjithshëm i Komunitetit. Gjykata e trajtoi temën e diskriminimit të drejtpërdrejtë dhe atij jo të drejtpërdrejtë edhe në çështjen *M. L. Ruzius-Wilbrink kundër Bestuur van de Bedrijfsvereniging voor Overheidsdiensten*⁶¹, por pa i përkufizuar konceptet.

Në çështjen *Dekker*⁶², Gjykata theksoi se përgjigja e pyetjes nëse një masë përbën diskriminim të drejtpërdrejtë varet nga fakti nëse arsyeja themelore e refuzimit për punësim zbatohet pa dallim ndaj punonjësve të njërit seks ose kur zbatohet ekskluzivisht ndaj njërit seks. Ky përkufizim u bë bazë e shumë vendimeve të tjera. Në këtë rast Gjykata u shpreh se ky diskriminim i drejtpërdrejtë nuk mund të justifikohet në bazë të humbjeve financiare që do të pësonte punëdhënësi, i cili do të punësonte një grua shtatzënë, gjatë lejes së saj të lindjes.

Përsa i përket diskriminimit jo të drejtpërdrejtë, siç u tha edhe më lart, koncepti filloi të përpunohej nga Gjykata në çështjen *Defrenne II*, koncept i cili mori natyrën që përdoret tani në çështjen *Jenkins*. Në çështjen *Bilka-Kaufhaus*⁶³ Gjykata e përpunoi formulën e saj duke arritur një përkufizim të ri të diskriminimit jo të drejtpërdrejtë, që më pas e zbatoi në të gjitha çështjet që kishin të bënin me diskriminimin jo të drejtpërdrejtë, sipas të cilit:

⁵⁹Shih trajtimin edhe me siper per kete ceshtje.

⁶⁰Çështja 149/77 Gabrielle Defrenne kundër Société anonyme belge de navigation aérienne Sabena (*Defrenne III*) [1978] ECR 1365, referuar nga Magnus Strand, *The Formal Concept of Discrimination*, Tezë për Master, Universiteti i Drejtësisë Lund, 2006.

⁶¹Çështja C-182/88 M. L. Ruzius-Wilbrink kundër Bestuur van de Bedrijfsvereniging voor Overheidsdiensten [1989] ECR 4311.

⁶²Çështja C-177/88 *Dekker kundër VJV-Centrum* [1990] ECR I-3941

⁶³Çështja 170/84 *Bilka - Kaufhaus GmbH kundër Karin Weber von Hartz* [1986] ECR 1607.

Në qoftë se do të konstatohet se një numër shumë më i vogël grash punojnë me kohë të plotë në krahasim me burrat, përjashtimi i punonjësve me kohë të pjesshme nga skemat e pensioneve do të ishin në kundërshtim me Nenin 119 të Traktatit, kur kjo masë nuk do të mund të justifikohet nga faktorë që përjashtojnë çdo diskriminim në bazë të seksit. ... Fakti se kjo masë prek më shumë gratë se burrat nuk është e mjaftueshme për të provuar se ato përbëjnë shkelje të Nenit 119.

Pra, në qoftë se ankuesi mund të provonte me të dhëna statistikore se më shumë gra se burra janë në një pozicion më të pafavorshëm për shkak të një dispozite në dukje neutrale, lind prezumimi i diskriminimit të drejtpërdrejtë. Në këtë rast, barra e provës i kalon palës tjetër të paraqesë justifike të arsyeshme në këtë drejtim.

Ndërsa në çështjen *O'Flynn*, Gjykata futi për herë të parë nocionin e pasojës diskriminuese duke u shprehur se:

“Nuk është e nevojshme që të konstatohet se dispozita në fjalë cënon praktikisht një numër më të lartë të punonjësve migrantë. Mjafton të provohet se ajo mund ta sjellë një pasojë të tillë”.

Përsa i përket masave pozitive që duhet të ndërmarrin Shtetet Anëtare në luftën kundër diskriminimit, Gjykata bëri një hap shumë të madh në çështjen *Kalanke*⁶⁴, kur ajo theksoi se gratë nuk do të kishin përparësi ndaj burrave dhe udhëzoi interpretimin sa më të ngushtë në Nenit 2(4) të Direktivës. Deri në atë kohë mendohej se për të luftuar diskriminimin seksual në tregun e punës, në qoftë se kandidatët për punësim do të kishin të dhëna të njëjta në aspektet e tjera, duhej

⁶⁴Çështja C-450/93 *Eckhard Kalanke kundër Freie Hansestadt Bremen* [1995] ECR I-3051.

të punësohej një grua, pra diskriminimi lejohej. Në çështjen *Badeck*⁶⁵, Gjykata u shpreh se vlerësimi objektiv duhej të merrte parasysh të gjitha rrethanat specifike të kandidatëve. Në vendim sqarohet se qëllimi i Gjykatës ishte të parandalonte pengesat ndaj punësimit të kandidatëve meshkuj të cilët kishin situata të ngjashme me ato që mund të pengonin kandidatet femra, pra burrat që gjendeshin në pozita jo të favorshme për shkak të përkushtimit të tyre ndaj shtëpisë. Në çështjen *Lommers*⁶⁶, (Semini, 2013: 21) Gjykata pasi konstatoi diskriminimin në bazë të seksit shprehushqetësimin e saj se disa lloje ofertash punësimi (kujdesi për fëmijët e punonjësve femra i ofroheshin meshkujve vetëm në rastet e urgjencave), mund të forconin stereotipet diskriminuese tradicionale.

Në çështjen *Sirdar*⁶⁷ Gjykata vlerësoi se megjithëse Shtetet Anëtare kanë liri të plotë për të vendosur për të organizuar forcat e tyre të armatosura, këto vendime përsëri janë objekt i legjislacionit të komunitetit. Veçanërisht vendimet për aksesin në punësim në këto forca duhet të respektojnë parimin e trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave. Megjithatë, Gjykata arrin në përfundimin se Shtetet Anëtare mund të bëjnë përjashtime (por të përshtatshme dhe të nevojshme për të arritur qëllimin e kërkuar) nga zbatimi i parimit të barazisë ndërmjet sekseve, kur seksi është faktor përcaktuar në ushtrimin e aktivitetit dhe Shtetet Anëtare kanë liri veprimi për të përcaktuar masat që ata i konsiderojnë të nevojshme për të garantuar sigurinë publike.

Përsa i përket diskriminimit mbi bazën e moshës, në çështjen *Mangold*⁶⁸ Gjykata vlerësoi se parashikimi në legjislacionin gjerman për lidhjen e kontratave të punës me kohë të përcaktuar për personat që kishin arritur moshën 52 vjeçare përbënte diskriminim mbi bazën e moshës dhe që binte në kundërshtim me Direktivën Kuadër për Punësimin. Gjykata shpjegoi se ndonëse një

⁶⁵Çështja C-158/97 *Georg Badeck dhe Të tjerët, ndërhyrës: Hessische Ministerpräsident dhe Landesanwalt beim Staatsgerichtshof des Landes Hessen* [2000] ECR I-1875.

⁶⁶Çështja C-476/99 *H. Lommers v Minister van Landbouw, Natuurbeheer en Visserij* [2002] ECR I-2891.

⁶⁷Çështja C-273/97, *Sirdar kundër Ministrisë së Mbrojtjes*, vendim i 26 Tetorit 1999.

⁶⁸Çështja C-144/04 *Arbeitsgericht München Werner Mangold kundër Rüdiger Helm*.

parashikim i tillë bënte pjesë në politikat sociale të Shtetit Anëtar dhe legjislacioni i BE i lë hapësirë të gjerë vlerësimi shteteve në këto politika, në këtë rast legjislacioni gjerman e kishte tejkaluar marrjen e masave të justifikueshme dhe të arsyeshme për justifikimin e dallimeve në trajtim të parashikuara në këtë rast.

Legjislacioni i kohëve të fundit kundër diskriminimit në BE parashikon shprehimisht detyrimin e Shteteve Anëtare të krijojnë sisteme për rivendosjen në vend të të drejtave të shkelura si dhe parimin e efikasitetit të normave ligjore të komunitetit. (Picari, 2008:16). Përveç masave ligjore të ndërmara, jurisprudenca e Gjykatës Europiane ka ndikuar shumë në ndryshimin e rregullave procedurale kombëtare që mund të vijnë në kundërshtim me parashikimin e masave efektive në rastet e cënimit të të drejtës europiane. Parimi i efikasitetit ndikon në të gjitha fazat e procesit gjyqësor, përfshirë aksesin në gjykatë, rregullat procedurale për zhvillimin e gjykimit si dhe rregullat për paraqitjen e provave (Kennett 2000). Megjithatë, masa në të cilën Gjykata i ka kërkuar legjislacionit të brendshëm të përfshihet nga legjislacioni komunitar, ka ndryshuar disa herë. Në disa raste është shprehur një konstatim i pastër dhe i fortë i supremacisë së të drejtës komunitare mbi atë kombëtare dhe nevojës për të ofruar mjete efikase dhe të përshtatshme në gjykatat kombëtare.⁶⁹ Në disa raste të tjera Gjykata është treguar tolerante ndaj legjislacionit të brendshëm dhe ka hetuar nëse rregullat procedurale e kanë bërë zbatimin e legjislacionit komunitar tejmase të vështirë⁷⁰. E drejta për rivendosjen në vend të të drejtave të shkelura ka ekzistuar si pasojë e vendimeve të Gjykatës Europiane të Drejtësisë. Këtë hap gjykata e ka

⁶⁹ Çështja 106/77 *Amministrazione delle finanze dello Stato kundër Simmenthal SPA* [1978] ECR 629; çështjen C-271/91 *Marshall II kundër Southampton and South West Hampshire Area Health Authority* [1993] ECR I-4367.

⁷⁰ Shih çështjen 33/76 *Rewe-ZentralfinanzG et Rewe-Zentral AG kundër Landwirtschaftskammer für das Saarland* [1976] ECR 1989; çështjen C-410/92 *Johnston v Chief Adjudication Officer* [1994] ECR-I-5493; dhe çështjen C-66/95 *R kundër Secretary of State for Social Security* [1997] ECR I-4705. Shih Semini M., 2013, 54.

ndërmarrë fillimisht në zbatim të Nenit 6 të Direktivës së Dytë për Barazinë Seksuale⁷¹. Direktiva, thjesht parashikonte të drejtën procedurale për të filluar procedurat në rast të një diskriminimi të pretenduar. Por në çështjen kryesore në këtë drejtim *Von Colson dhe Kamann*⁷² Avokati i Përgjithshëm deklaroi se një dispozitë e tillë si ajo e Nenit 6 sugjeron se një shkelje nuk do të mbetet e pandëshkuar nga sanksionet e brendshme të shtetit. Pra, me pak fjalë kërkohej që një garancie procedurale t'i bashkëngjitej edhe një garanci materiale. Gjykata ra dakord me këtë mendim dhe deklaroi se qëllimi i Direktivës pa një sistem të mirë sanksionesh do të ishte i padobishëm dhe viktimat e diskriminimit kanë të drejtë që të rifitojnë të drejtat e tyre.

Në këtë çështje, gjykata iu referua Nenit 249 të Traktatit të BE, i cili i detyron Shtetet Anëtare të marrin masat e nevojshme për të arritur rezultatet e paprashikuara në Direktiva.

Në çështjen *Johnston*⁷³ Gjykata deklaroi se kushti i kontrollit gjyqësor efikas pasqyron parimin e përgjithshëm që thekson traditën kushtetuese të Shteteve Anëtare dhe që parashikohet edhe në Nenet 6 dhe 13 të KEDNJ. Gjithashtu, duhet të përmendet se kur ekziston një parashikim si ai i Nenit 6 të Direktivës së Dytë për barazinë Seksuale, ky nen ka zbatim të drejtpërdrejtë përsa i përket rikthimit të të drejtave ose të drejtës për dëmshpërblim. Në çështjen *Coote*⁷⁴ Gjykata deklaroi se mbrotjtja e ofruar nga Direktiva shtrihet edhe pas përfundimit të kontratës së punës, pasi parimi i kontrollit efikas gjyqësor do të humbte në këtë rast pjesën e tij thelbësore. Në çështjen *Dekker*⁷⁵, Gjykata theksoi se përgjegjësia nga ana e personit të gjetur fajtor për diskriminimin nuk kushtëzohet vetëm në provat e shkeljes apo mungesën e bazës së diskriminimit pasi edhe në këtë rast efekti praktik i trajtimit të barabartë do të dobësohej në

⁷¹ Direktiva 2002/73/KE e Parlamentit dhe Këshillit Europian e 23 Shtatorit 2002, që ndryshon Direktivën e Këshillit 76/207/KEE për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë për gratë dhe burrat për punësimin, trainimin profesional, ngritjen në detyrë dhe kushtet e punës.

⁷²Çështja 14/83 [1984] ECR 1891.

⁷³ Çështja 222/84 Johnston kundër Chief Constable of RUC [1986] ECR 1651.

⁷⁴ Çështja C-185/97, Coote kundër Granada Hospitality Ltd. [1998] ECR I-5199.

⁷⁵Çështja C-177/88, Dekker kundër VJV-Centrum [1990] ECR I-3941.

mënyrë të konsiderueshme. Me fjalë të tjera, vlerësimi i faktit të diskriminimit nuk varet nga provat që ka paraqitur viktimja e pretenduar e diskriminimit apo faji i punëdhënësit nga ana tjetër. Ky vendim ndryshoi tërësisht legjislacionin mbi përgjegjësinë dhe të drejtën private të brendshme të Holandës. Në rastin e masave riparuese ndaj diskriminimit, theksi është venë tek efikasiteti, përpjestueshmëria dhe bindshmëria e masës. Sipas Gjykatës, Direktiva nuk mund të specifikojë një sanksion të caktuar. I takon Shteteve Anëtare të vendosin sanksione, por të cilat duhet të jenë efektive, në përpjestim dhe bindëse. Në këtë rast Shtetet Anëtare kanë hapësirë të gjerë vlerësimi dhe i jep gjykatave të brendshme njëfarë kompetence për të garantuar që qeveria e tyre do të përmbushë standardet minimale. Në çështjen *Marshall II*, Gjykata shpjegoi se në rastet e pushimeve nga puna me karakter diskriminues, situata e barazisë nuk mund të rivendoset pa e rikthyer viktimën në punë ose pa i dhënë një kompensim financiar për humbjen e pësuar. Në këtë rast zgjedhja e Shtetit Anëtar është e kufizuar. Nga të gjitha rastet që u përshkruan më lart arrijmë në përfundimin se Direktivat nuk janë të pakushtëzuara dhe mjaftueshëmrisht të sakta. Është e vërtetë se ato kanë efekt teorik të drejtpërdrejtë, por nuk mund të përdorin vetëm ato si baza për të kërkuar të drejtat kundër diskriminimit përpara gjykatave kombëtare. Për këtë arsye është e rëndësishme që të miratohen ligje të brendshme për zbatimin e këtyre Direktivave në praktikë.

Përsa i përket çështjes së dëmshpërblimit dhe rivendosjes së të drejtave, në çështjen *Rewe*⁷⁶ Gjykata refuzoi t'i jepte një dëmshpërblim të caktuar ankuesit duke deklaruar se në caktimin e masave për rivendosjen e të drejtës duhet zbatuar parimi i përpjestueshmërisë dhe efikasitetit. I takon gjykatave të brendshme ta bëjnë një gjë të tillë, por jo në masën të t'i bëjnë ligjet e komunitetit të pazbatueshme ose të zbatueshme me vështirësi.

⁷⁶Çështja 33/76 *Rewe-ZentralfinanzG et Rewe-Zentral AG kundër Landärirtschaftskammer für das Saarland* [1976] ECR 1989.

Jursiprudenca e Gjykatës nuk është shumë e detajuar dhe nuk jep udhëzime se cilat parime duhet të zbatohen në sistemin e brendshëm ligjor për caktimin e dëmshpërblimit, por këto masa duhet të jenë efikase, në përpjestim dhe nga ana tjetër të njëjta me masat që do të merreshin në rast të një ankimi të brendshëm përpara gjykatave të brendshme. Këto masa duhen vlerësuar gjithmonë pasi të vlerësohen të gjitha faktorët e çështjes⁷⁷. Në përfundim të këtij kapitulli mendojmë se nocioni i zbatimit dhe efektit të drejtpërdrejtë të Direktivave të BE-së është jo real dhe nuk përputhet me atë që po ndoh në realitet. Madje disa studies të fushës i shohin normat kundër diskriminimit si të paefektshme. Pa interpretimin e Gjykatës Europiane të Drejtësisë, mund të themi se, pa dyshim, sistemi i zbatimit të legjislacionit të Komunitetit European do të varej tërësisht nga dëshira dhe vullneti i Shteteve Anëtare për të përmbushur detyrimet e tyre. Pra, balanca po anon nga modeli privat i zbatimit të normave të BE-së, nëpërmjet ankesve të qytetarëve në gjykatat kombëtare të cilat më pas ia referojnë çështjet (kur bëhet fjalë për trajtimin e ligjit komunitar) GJED për vendime paraprake. Dhe pikërisht janë procedurat dhe sanksionet e parashikuara nga kjo Gjykatë, të cilat tashmë plotësojnë kuadrin e të drejtave themelore europiane.

2.3.3. OSBE-ja dhe aspektet gjinore

Sic u theksua edhe OSBE ka rëndësinë e vet në procesin e rritjes dhe të fuqizimit të grave në jetën shoqërore, ekonomike dhe sociale. Në fakt, procesi i demokratizimit dhe promovimi i të drejtave të njeriut mbështetet nga Zyra e Institucioneve Demokratike dhe të Drejtave të Njeriut (ODIHR), e vendosur në Varshavë. Edhe pse barazia dhe mos-diskriminimi janë përfshirë në standardet e aprovuara nga KSBE që prej 1975-s, çështjet gjinore morën hapësirë të

⁷⁷Çështja C-276/01 *Joachim Steffensen* [2003] ECR I-3735.

konsiderueshme në programin e OSBE-së prej vitit 1998. Fillimisht u ngrit Pika Fokale e Çështjeve Gjinore dhe Këshilltari i Integritit Gjinor dhe i të Drejtave të Njeriut të Grave në ODIHR për ndërgjegjësimin dhe integrimin gjinor. Janë organizuar mbledhje pune dhe projekte kërkimore për promovimin e pjesëmarrjes së grave në politikë, zgjidhje konfliktesh dhe riparim pas konfliktesh, si dhe për të fuqizuar respektimin e të drejtave të tyre njerëzore. Çështjet gjinore janë të përfshira gjithashtu edhe në programin e trajnimit të OSBE-së për stafin e ri të misionit.

2.3.4 Të drejtat e grave, mbrojtja dhe garantimi i tyre në legjislacionin e brendshëm. Një vështrim i shkurtër

Në periudhën e viteve 1945 – 1990, Shqipëria ishte një vend socialist i udhëhequr nga një parti e vetme dhe sistemi i qeverisjes klasifikohet si diktaturë e proletariatit. Gjatë kësaj kohe statusi ligjor i grave u përmirësua në shumë aspekte. Kushtetuta e vitit 1946 shpalli barazinë pavarësisht nga seksi, shprehimisht “gratë janë të barabarta me burrat në të gjithë aspektet e shtetit, jetës ekonomike dhe shoqërore politike“. Gjatë periudhës 1945- 1990, gratë kishin shumë të drejta duke përfshirë të drejtën e votës dhe të drejtën për shërbime të kujdesit shëndetësor. E drejta për arsim dhe punësim të barabartë me burrat i lejoi gratë të studionin dhe të punonin në “fusha tradicionale të meshkujve“ si inxhinieri, mjekësi e bujqësi. Koha e punës nuk diferenconte në bazë të përkatësisë gjinore. Ndonëse këto të përpjektje për të zbatuar të drejtat e grave në fushën publike nuk u shoqëruan më të njëjtin intensitet në fushën private, gratë mbetën kujdestaret kryesore, shpesh duke mbajtur ngarkesën e dyfishtë për të qenë të suksesshme në fushën publike dhe atë private.

Ashtu si në vendet e Evropës Lindore, aplikimi i “terapisë së shokut“ në ekonominë e re të tregut në Shqipëri në fillim të viteve 1990 pati pasojë për të gjithë popullsinë, por gratë ishin ato të cilat

u prekën më rëndë. Papunësia në rradhët e grave u rrit ndjeshëm, duke i bërë gratë të varura nga të ardhurat e anëtarëve meshkuj në familje: shumë shërbime shoqërore u ndërprejnë. Ndryshimi u shoqërua me ringjalljen e pikëpamjeve tradicionale dhe paragjykimëve që e kthenin gruan në rolin e shtëpiakes. Në zonat rurale, situata e grave u përkeqësua ndjeshëm. Pas privatizimit të tokës dhe ndërprerjes së financimeve nga shteti, gratë u mbingarkuan me punë. Burimet financiare shumë të kufizuara të familjeve rurale shqiptare i kanë detyruar këto familje të përdorin punën e gruas në vend të makunerive. Gjithashtu emigrimi i meshkujve ka shtuar ngarkesën e punëve për gratë, pasi këto duhet të kujdesen më shumë për shtëpinë, fëmijët dhe të moshuarit. Kështu, kufizimi i mundësive për t'u punësuar dhe përballimi i gjithë barrës shoqërore, ka kufizuar marrjen e informacionit, gjetjen e mundësive dhe pjesëmarrjen e saj në aktivitete të ndryshme.

Në tërësi, është pranuar se barazia dhe mosdiskriminimi janë deklaratimet pozitive dhe negative të të njëjtit parim (F. Bayefsky1990). Me fjalë të tjera, barazi do të thotë mosdiskriminimin dhe ruajtja e parimit të mosdiskriminimit ndërmjet grupeve do të sjellë barazinë. Të japësh një përkufizim të asaj që quhet diskriminim (Strand 2006) nuk është e lehtë.

Megjithatë, studiues të ndryshëm kanë rënë dakord që diskriminim do të thotë “trajtim i ndryshëm dhe i pabarabartë i një personi mbi bazën e disa cilësive të tij”. Por mbetet gjithmonë çështje provueshmërie se çfarë përbën trajtim të ndryshëm dhe çfarë përbën diskriminimin, pasi jo çdo trajtim i ndryshëm përbën diskriminim. Shqipëria ka ratifikuar një pjesë të konsiderueshme të instrumenteve ndërkombëtare që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të grave dhe të drejtave të njeriut. Kushtetuta ka përcaktuar vendin që kanë instrumentet ndërkombëtare në sistemin e brendshëm si edhe mënyrën e zbatimit të tyre.

Pa dyshim që ratifikimi i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut reformoi dhe përqasi gjithë legjislacionin shqiptar me standardet dhe praktikën e vendosur nga GJEDNJ në jurisprudence e saj. Në nenin 17 të Kushtetutës, nënvizohet se edhe kur ka raste të kufizimit të të drejtave dhe lirive të parashikuara nga Kushtetuta, këto kufizime mund të vendosen vetëm me një ligj për interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Gjithashtu këto kufizime duhet të jenë të tilla që të mos çënojnë thelbin e lirive dhe të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara nga KEDNJ.

Të drejtat e grave në analizë me të detajuar, në fakt, do të trajtohen gjerësisht në kreun e katërt dhe një kategori prej këtyre të drejtave, ato me natyrë ekonomike, familjare dhe të shëndetit do të jenë në fokus të studimit tonë në kreun e pestë si raste specifike studimore.

KAPITULLI III: BARAZIA GJINORE DHE INTEGRIMI GJINOR. KORNIZAT KONCEPTUALE JURDIKE DHE INSTITUCIONALE

3.1. Barazia gjinore dhe korniza konceptuale e saj.

Përkufizuar si barazi midis burrave dhe grave në të gjitha sferat, si publike dhe private, barazi gjinore do të thotë akses dhe kontroll i barabartë mbi burimet dhe përfitimet, pjesëmarrje e barabartë në vendim-marrjen politike dhe barazi me ligj për gratë dhe burrat. (Shkurti, 2009:19)

Gjinia nuk është vetëm një definicion i ndërtuar në mënyrë sociale mbi gratë dhe burrat, ai është një definicion social i ndërtuar mbi marrëdhëniet ndërmjet gjinive. Politikat dhe strukturat luajnë një rol shumë të rëndësishëm në kushtet e jetës dhe ato shpesh institucionalizojnë mirëmbajtjen e ndërtimit social të gjinisë (Anastasi, Mandro-Balili, Shkurti, Bozo, 2012:8). Ky ndërtim social përmban një marrëdhënie fuqie jo të barabartë me dominimin mashkullor dhe nënshtrimin femëror në shumicën e sferave të jetës. Burrat dhe punët, rolet, funksionet dhe vlerat që i kontribohet atyre vlerësohen më tepër në shumë aspekte me shumë sesa ato që shoqërojnë gratë. Pranohet gjerësisht në shoqëri që norma mashkullore quhet si normë për shoqërinë në tërësi dhe kjo reflektohet në politikat dhe strukturat. Këto të fundit shpesh në mënyrë të paqëllimshme riprodhojnë pabarazinë gjinore (Scott 1986:1067)⁷⁸.

Barazi gjinore do të thotë të pranosh dhe të vlerësosh njëllor diferencat mes burrave dhe grave dhe rolet e ndryshme që ato luajnë në shoqëri. Barazia gjinore përfshin të drejtën për të qenë i ndryshëm dhe për të marrë parasysh diferencat ekzistuese mes burrave dhe grave në lidhje me klasën, opinionin politik, fenë, racën dhe orientimin seksual. Barazi gjinore do të thotë të diskutosh se çfarë mundësie ke për të shkuar më tej, për të ndryshuar strukturat në shoqëri që

⁷⁸ Definicioni i Scottit mbi gjininë lidh gjininë me fuqinë, sepse deklaron që “gjinia është një mënyrë primare që përcakton marrëdhëniet e fuqisë” sipas Scottit, gjinia implikohet në konceptin e ndërtimit të vetë fuqisë sepse referencat gjinore vendosin deri në një farë mase shpërndarjen e fuqisë që është kontroll mbi burimet material dhe simbolike.

kontribojnë më mirëmbajtjen e një marrëdhënie fuqie jo të barabartë mes burrave dhe grave dhe për të arritur një balance më të mirë në vlerat dhe prioritetet e ndryshme femërore dhe mashkullore. (Shkurti, 2009:129) Problemi qëndron tek hierarkia gjinore jo tek gratë. Në vetvete ndërtimi social i gjinisë nuk lë vend për diferenca dhe nuk përmban nocionin e hierarkisë që i vendos burrat më lart se gratë (UNIFEM 1995: 7.). Kjo do të thotë një *partnership real* mes burrave dhe grave dhe përgjegjësi të tyre të ndara në zhvendosjen e disbalancave në jetën e tyre publike dhe reale. Çështja mbetet tek përdorimi i kompetencave, vlerave dhe talenteve të çdo qytetari si dhe tek përfshirja e grave dhe burrave në ndërtimin e shoqërisë. Pabarazia gjinore duhet të luftohet, mbrohet dhe promovohet si një e drejtë humane. Të arrish barazinë gjinore është një proces i vazhdueshëm i cili shpesh është vënë në pikëpyetje është rimenduar dhe ripërcaktuar.

Barazi gjinore do të thotë pjesëmarrje, fuqizim dhe vizibilitet i të dyja seksve në të gjitha sferat e jetës publike dhe private. Barazia gjinore është e kundërta e pabarazisë gjinore, pa diferencë gjinore dhe synon promovimin e pjesëmarrjes së plotë të gruas dhe të burrit në shoqëri. (Jacoba, 2012:15)

Për një kohë të gjatë barazia gjinore në Europë perceptohej si dhënia *de jure* e të drejtave, mundësive, kushteve dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në të gjitha fushat e jetës dhe sferat e shoqërisë. Në ditët e sotme është e pranuar që barazia *de jure* nuk të çon automatikisht në barazi *de facto*. Është e rëndësishme të kuptohet që kushtet e jetesës së burrave dhe grave janë të ndryshme— deri në njëfarë masë, për shkak të funksionit mëmësor të gruas. Problemi kryesor nuk është ekzistenca e këtyre ndryshimeve por fakti që këto ndryshime nuk duhet të kenë një impakt negativ në kushtet e jetesës së burrave dhe grave, si dhe nuk duhet të jenë shkak diskriminimi kundrejt tyre, por duhet të kontribuojnë në një ndarje të barabartë të fuqisë në ekonomi, shoqëri,

dhe proceset politikëbërëse. Për të përcaktuar barazinë gjinore duhet të hidhet një vështrim aty ku shihet më ngushtë koncepti gjinor. Dy aspekte janë të rëndësishme në këtë kontekst: ndërtimi social i gjinisë dhe marrëdhënia ndërmjet sekseve. Gjinia është një definicion i ndërtuar në mënyrë sociale mbi gratë dhe burrat. Ajo është përshkrimi social i seksit biologjik, i përcaktuar nga punët, funksionet dhe rolet që i atribuohen burrave dhe grave në shoqëri dhe në jetën publike dhe private. Ajo është një përcaktim specifik kulturor i feminitetit dhe maskilitetit dhe si e tillë ndryshon në kohë dhe në hapësirë. Ndërtimi dhe riprodhimi i gjinisë ndodh në nivel individual dhe social ku të dyja janë njëlloj të rëndësishme. Qëniet humane i formësojnë rolet dhe normat gjinore përmes aktiviteteve të tyre. Ka një konsensus në rritje që gjinia duhet të konsiderohet edhe në nivel politik dhe institucional (UNIFEM 1995: 7)⁷⁹.

Një objektiv i rëndësishëm është njohja dhe implementimi i plotë i të drejtave të grave si të drejta humane. Kjo do të thotë të respektosh të mbrosh dhe të promovosh të drejtat humane të grave dhe burrave njëlloj duke i siguruar të dy palëve respektimin e plotë të këtyre të drejtave. Ajo gjithashtu do të thotë të luftosh interferencat me lirinë dhe dinjitetin femëror. Përvec të drejtave humane zhvillimi dhe përmirësimi i demokracisë përfqësuese është pika më e rëndësishme. Përfaqësimi i ulët ose ndonjëherë mungesa e grave në vendimarrje në të gjitha nivelet dhe fushat e jetës është një problem madhor, ndonëse ka variacione të mëdha në këtë aspekt mes vendeve të ndryshme. Kur gratë ose burrat përbëjnë rreth 1/3 e anëtarëve të një trupi vendimarrës ato influencojnë axhendën dhe ekziston një mundësi reale për ndryshim. (Shkurti, 2009:19) Është e rëndësishme që gratë të jenë të dukshme në eventet sociale po aq sa burrat dhe në historinë e çdo vendi.

⁷⁹ Shih gjithashtu Konkluzionet e konferencës “Barazia dhe demokracia: Utopia ose sfida” Këshilli i Europës 1995, Raporti final i grupit të specialistëve për barazinë dhe demokracinë, Këshilli Europës 1996.

Një objektiv tjetër i rëndësishëm për barazinë gjinore është pavarësia ekonomike individuale që çon në sigurimin e pagës së njëjtë, aksesit të njëjtë për kredi, kushtet e njëjta të tregut të punës dhe shpërndarjen e aseteve që marrin parasysh diferencat gjinore në jetën private. Pozicioni i grave dhe i burrave në ekonomi është në shumë mënyra jetësor në balancën e fuqisë mes tyre. Të luftosh feminizimin e varfërisë është gjithashtu shumë e rëndësishme.

Edukimi është një objektiv kyç në barazinë gjinore sepse përfshin mënyrat sesi shoqëritë transformojnë normat, njohuritë dhe aftësitë. Është e rëndësishme që sistemet e edukimit të fuqizojnë si vajzat si djemtë dhe të kujdesen në kundërbalancimin e hierarkive gjinore ekzistuese. Media gjithashtu ka një pozicion shumë të fuqishëm në transferimin dhe konsolidimin e këtyre normave dhe njohurive. Objektivi i fundit që duhet të përmendim është pranimi i nevojës që burrat dhe gratë kanë për të zhdukur disbalancat në shoqëri dhe përgjegjësinë e tyre të ndarë për ta bërë këtë. (Balmori, 2009: 11)

Edhe në Europë për shembull ka akoma probleme me barazinë gjinore. Arritja më e rëndësishme në barazinë gjinore është një ndërgjegjësim në rritje i nevojës dhe i dëshirës për të promovuar barazinë gjinore (Lejenaar:1997). Disa vende kanë ngritur mekanizma të politikave të barazisë, që zhvillohen dhe implementohen duke i dhënë një vëmendje të veçantë problemeve specifike të grave. Paralel me këtë ka një zhvillim të njohurisë dhe ekspertizës mbi pozicionin e grave dhe problemet gjinore. Ka gjithashtu një ndërgjegjësim në rritje të rolit të burrave në promovimin e barazisë gjinore⁸⁰. Një arritje tjetër e rëndësishme është avancimi efektiv i grave. Në Europë niveli i edukimit të grave është në rritje, ato marrin pjesë më shumë se më parë në tregun e punës dhe kanë një rol aktiv në jetën publike dhe politike si dhe në vendimmarrje.

⁸⁰ Samiti Ndërkombëtar i Këshillit të Europës mbi "Promovimi i barazisë : Një çështje e përbashkët për burrat dhe gratë " Këshilli i Europës 1997.

Megjithatë ka prapë pak progres në këtë fushë në shumë vende Europiane⁸¹. Në Europën Lindore dhe Qëndrore kanë mjaft presion mbi arritjet e mëparshme në termat e barazisë gjinore. Megjithatë zhvillimi i shoqërisë civile në këto vende i jep grave më shumë hapësirë për të ngritur OJQ-të e tyre dhe i ofron mundësi të reja për të marrë pjesë në vendimarrje. Megjithatë këto arritje nuk duhet të mbivlerësohen. Forma të reja pabarazie janë zhvilluar dhe ka një rritje të diversitetit edhe mes grave (Walby 1997:5).

Në fakt, progresi drejt barazisë gjinore duket sikur po has një numër pengesash në Europë. Ndryshimet strukturale që kanë ndodhur në Europë në dy dekadat e fundit, si pasojë e procesit të globalizimit të sistemeve financiare dhe ekonomike, inovacionit teknologjik, konkurencës më të lartë botërore dhe liberalizimit në rritje, janë ndjekur nga një sërë problemesh sociale serioze. Papunësia masive, pabarazitë më të mëdha, zhvlerësimi i punës humane, përjashtimi social, luftrat dhe konfliktet e armatosura dhe disbalancat ekologjike janë disa nga problemet që mobilizojnë vëmendjen e qeverive dhe të autoriteteve publike. Këto probleme i afektojnë gratë ndryshe nga burrat dhe mund të limitojnë deri në një farë mase të drejtën e tyre për një zgjedhje të lirë, psh në çështje që lidhen me seksualitetin, shëndetin riprodhues dhe stilet e tyre të jetës (Walby 1998). Ato gjithashtu kanë vënë re që barazia gjinore në shumë vende nuk konsiderohet si një prioritet.

Europa është duke kaluar ndryshime në nivele politike dhe institucionale. Në Europën Perëndimore po zhvillohet një vizion i ri i funksioneve dhe roleve qeveritare. Qeveritë e konsiderojnë veten si manaxher aktiv dhe e lënë pjesën tjetër të menaxhimit forcave të tregut dhe shoqërisë civile. Politika të tilla të manaxhimit nuk janë aspak të favorshme për barazinë gjinore, sepse ato nuk e shohin nevojën e përshtatjes të punës me jetën familjare dhe e masin progresin më shumë nga ana ekonomike sesa nga ana humane.

⁸¹ Dokumenti mbi "Gratë në politikë" Këshilli i Europës 1997

Shumë rregjime të Evropës Qendrore dhe Lindore karakterizohen nga një infrastrukturë e organizuar mirë, që i lejonte gratë të kombinonin punën me familjen, i jepnin një nivel të lartë sigurie shoqërore, një sistem shëndetësor të aksesueshem dhe një legjislacion liberal. Këto rregulla vinin nga një ideologji barazie. Objektivi kryesor ishte integrimi i plotë i grave në procesin e prodhimit. Të drejtat dhe barazia shpesh përcaktoheshin si njëllojshmëri. Kështu, qëndrimi kundrejt politikave të barazisë shpesh është një qëndrim hezitant për më shumë problemet makro ekonomike (Balmori, 2009: 12) i bëjnë qeveritë të koncentrojnë përpjekjet e tyre mbi fusha më të rëndësishme të politikës (Fank and Mueller: 1993, Knezevic: 1997).

Të dhënat mbi situatën aktuale të burrave dhe grave dhe marrëdhënieve gjinore janë të nevojshme për integrimin. Problemi nuk është që statistikat nuk janë gjithmonë të ndara sipas seksit por të dhënat mund të jenë të paragjykuara nga gjinia. Statistika të mira përbejnë të dhënat që janë relevante për burrat dhe gratë dhe janë të ndara nga seksi dhe nga variabla të tjerë .(Jacoba, 2012:15)

Është e rëndësishme që gratë të hyjnë në jetën politike dhe publike në numra shumë më të mëdhenj. Të hyjnë në proceset e vendim marrjes dhe të sigurohen që vlera të ndryshme interesi dhe eksperiencat e jetës së grave të merren në konsideratë kur merren vendimet. Është e qartë që jo çdo grua natyrshëm është një avokate për çështjet e grave por fakti është që shumica e avokateve për marrëdhëniet gjinore janë gra. Eksperienca ka treguar që aty ku gratë marrin pjesë në një numër më të madh në vendimarrje ndryshimet janë më të konsiderueshme dhe ndodhin më shpejt. Çfarë ndodh nëse këto prerekuizita ose kushte ndihmuese nuk janë prezent? Prerekuizita më e nevojshme është vullneti politik. Pa vullnetin politik nuk ka rialokim të fondeve për të zhvilluar njohuritë mbi çështjet gjinore dhe për të implementuar politika të perspektivave gjinore

dhe gjithëpërfshirëse. Integrimi gjinor çon në një ndërgjegjësim të rritur të pabarazive gjinore dhe në zhvillimin e njohurive për çështjet gjinore.(Jacoba, 2012:15)

3.2. Rëndësia e integrimit gjinor

Integrimi gjinor është konceptuar dhe përkufizuar së fundmi si (ri)organizimi, përmirësimi, zhvillimi dhe vlerësimi i proceseve politike, në mënyrë që perspektiva e barazisë gjinore të përfshihet në të gjitha nivelet dhe në të gjitha fazat, nga aktorët që përfshihen në hartimin e politikave. Integrimi gjinor i vendos njerëzit në zemër të politikëbërjes dhe çon në një qeverisje më të mirë (Përkufizimet dhe konceptet gjinore, 2012:12). Rëndësia e integrimit gjinor lidhet me disa arsye specifike që nënvizojnë vlerën e shtuar të integrimit.(Jacoba, 2012:15)

Ligji mbi barazine gjinore e parashikon integrimin gjinor si strategji për arritjen e barazisë gjinore në shoqëri nëpërmjet përfshirjes së perspektivës së secilës nga gjinitë në të gjitha proceset ligjvënëse, politikëbërëse, planifikuese, zbatuese e monitoruese. (Integrimi gjinor në praktike, 2007:11) Programi i Përbashkët i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore ka qenë një nga kontribuesit kryesorë për të siguruar procesin e integrimit gjinor, veçanërisht buxhetimin gjinor (Balmori, 2009: 12)në nivel lokal. Këto ndërhyrje kanë qenë në nivel pilot. Vlerësimi afatmesëm i këtij programi tregoi se është arritur progres modest në zhvillimin e proceseve për të integruar çështje të barazisë gjinore në politika dhe buxhete qendrore dhe lokale. Përvojat lidhur me buxhetimin gjinor në nivel lokal kanë evidentuar nevojën për zhvillimin e kapaciteteve në autoritetet lokale, të tilla që të sigurojnë aplikimin e praktikës së buxheteve gjinore. (Jacoba, 2012:15).

Fjala kyçe në konceptin e integritit gjinor është fjala perspektivë. Për të vënë në zbatim këtë koncept, nevojitet ndryshim i madh në të menduar dhe vepruar. (Integrimi gjinor ne praktike, 2007:11) Kur barazia gjinore diskutohet si politikë në vete, atëherë fokusi është tek strukturat gjinore, jo vetëm tek gratë si grupe të nën-përfaqësuara gjinore. Kur flitet për integrim gjinor, flitet për politika, legjislacion, dhe programe me një varg instrumente politikash, përfshirë analizën gjinore, buxhetin e përgjegjshëm gjinor, statistika të ndara në bazë gjinore, dhe kështu me radhë. (Balmori, 2009: 13) Problemet e barazisë së integritit nënvizojnë nevojën për t'u bazuar dhe vlerësuar çdo politikë në varësi të impaktit që ajo ka mbi individët dhe grupet sociale, burra ose gra, me nevojë dhe vlerat e tyre. (Integrimi gjinor ne praktike, 2007:11) Një qasje e tillë përmirëson praktikën që vlerëson politikat e përgjithshme sipas rezultateve të tyre dhe hap rrugë të reja për të zëvendësuar praktikën “tradicionale” të indikatorëve ekonomik dhe ideologjik me indikatorë më të vlefshëm dhe më konkret që lidhen me mirëqënien e njerëzve.

Integrimi i barazisë gjinore mund të jetë një hap përpara në një qasje më humane dhe më pak ekonomike të zhvillimit të përgjithshëm dhe menaxhimit të shoqërive demokratike, duke përdorur perspektivën e barazisë gjinore politikat do të jenë të shprehura më qartë në lidhje me nevojat e vërteta të grave dhe burrave, duke i përmirësuar ato dhe duke i cuar një strategji fituese. (Gruda, 2008:38)

Integrimi gjinor do të çojë në një politikëbërje më të mirë dhe më informuese dhe rrjedhimisht në një qeverisje më të mirë. Ajo sfidon politikat si gjini neutral, që faktikisht nuk janë – dhe do të tregojë supozimet e fshehura mbi realitetin dhe vlerat. Integrimi do të çojë në një transparencë më të madhe dhe hapje në procesin e politikës. (Integrimi gjinor ne praktike, 2007:11)

Në të vërtetë, deri tani puna për promovimin e barazisë gjinore është kryer nga grate. Integrimi gjinor përfshin në fakt si gratë ashtu edhe burrat. Kjo bën të qartë që shoqëria varet nga

përdorimi i të gjithë burimeve njerëzore dhe nga eksperiencia si e grave dhe e burrave dhe një përgjegjësitë e tyre të ndara në heqjen e disbalancave në shoqëri.(Jacoba, 2012:15)

Së fundmi, është përfshirë edhe një numër më i madh aktorësh të jashtëm në procesin politik pasi integrimi gjinor mund të ndihmojë në uljen e defiçitit demokratik që karakterizon shumë demokraci të sotme.(Integrimi gjinor ne praktike, 2007:11)

Integrimi gjinor jep gjithashtu edhe një ide të qartë të pasojave dhe impaktit të iniciativave politike të grave dhe burrave dhe të balancës mes tyre. Problemet e barazisë gjinore bëhen më të dukshme dhe integrohen në shoqëri ndërkohë që deri më sot kanë qenë gjithmonë të mënjanuara. Barazia gjinore është një problem i rëndësishëm social më pasoja për të gjithë dhe nuk është “thjesht një kosto ose një luks” (Rubery: 1996). Integrimi gjinor njih pabarazinë mes burrave dhe grave që nuk mund të luftohet në mënyrë efiçente pa interesin dhe angazhimin në sistemin politik dhe shoqërisë si një e tërë. Integrimi gjinor ndryshon qëndrimin kundrejt barazisë gjinore që shpesh është negative dhe fillon një debat të ri mbi problemet e barazisë.

Është e ditur që gratë dhe burrat nuk janë një grup homogjen⁸²; për t'i kushtuar vëmendjen e duhur këtij diversiteti politik dhe instrumentat politikë duhet të lejojnë që të merret parasysh diversiteti. Nga një perspektivë e integritit gjinor, problem nuk është fakti që ka ndryshime por që këto ndryshime janë të lidhura me hierarkinë dhe ka një rrezik që të gjithë qytetarët të maten më norma mashkullore. Në këtë sens në këtë kuptim integrimi gjinor shkon një hap më tutje se sa thjesht të punosh drejt barazisë gjinore. Ajo lë vend për diversitet johierarkik në terma të seksit, races, klasës ose një kombinimi të faktorëve.

⁸² Burrat dhe gratë ndryshojnë në aspekte të ndryshme si:biologjike, grupi/klasa ku bejne pjese, raca, bindjet politike/opinion politik, etniciteti, mosha, feja ose orientimi seksual.

4.2. Barazia gjinore si një gur themeli dhe katalizator në procesin e zhvillimit të vendit

Barazia gjinore dhe në përgjithësi drejtësia gjinore konsiderohet në periudhën bashkëkohore si një gur themeli në procesin e zhvillimit të vendit. Studime të ndryshme kanë trajtuar dhe analizuar të dhëna mbi familjen si bërthama e shoqërisë. Në këtë punim do të parashtrijmë në këndvështrimin kritik disa të dhëna ekzistuese gjinore për familjen të klasifikuar sipas mjedisit politik dhe atij institucional. (Gruda, 2008:39)

I gjithë sistemi ligjor shqiptar është bazuar në parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit. Jeta, martesat, familja gëzojnë mbrojtje të veçantë nga ana e shtetit. Ligji “Për barazinë gjinore në shoqëri” ka paraqitur vështirësi për zbatimin e tij në praktikë në lidhje me mekanizmat institucionalë dhe përgjegjësitë e tyre. Mundësitë për t’u ankuar në rastin e një diskriminimi gjinor dhe në aspekte të tjera, ndonëse parashikon si detyrë të qeverisë dhe të administratës publike nxjerrjen e statistikave gjinore në të gjithë administratën publike dhe në sektorin privat, ai nuk përcakton strukturat e caktuara shtetërore për kryerjen e kësaj detyre dhe afatet kohore të realizimit të saj. (Jacoba, 2012:16)

Për zbatimin e një politike të ndërgjegjshme nga pikëpamja gjinore, kërkohet një mjedis institucional i ndërgjegjshëm ndaj plotësimit të nevojave të veçanta të djemve dhe vajzave. Pra sa i ndërgjegjshëm është ky mjedis për të zbatuar tashmë programe që adresojnë pabarazitë gjinore dhe promovojnë barazinë. Institucionet sociale përbëjnë bazat mbi të cilën ngrihet jeta sociale. Ato janë rregullatore jetike të marrëdhënieve që krijojnë qëniet njerëzore me njëra tjetrën me anë të cilëve sigurohet vazhdimësia e brezave (Anthony Giddens). Një kusht strukturor që dëmton fuqinë e gruas në familje dhe kontribuon në fuqinë e burrit të saj dhe familjes së tij është praktika e përhapur e patriarkalitetit, në të cilën gruaja e re lëviz në shtëpinë e burrit.

Barazia gjinore është një gur themeli në procesin e zhvillimit të vendit. Po ashtu konsiderohet se barazia gjinore është një katalizator në procesin e zhvillimit të një vendi. Për ta arritur atë, duhen shqyrtuar shkaqet e pabarazisë që ndeshen në familje, në komunitet, në tregun e punës dhe në përgjithësi në shoqërinë shqiptare. Ndarja e punës sipas gjinive krijon ngarkesa (të matura sipas kohës dhe energjive), shkallë të njohjes (të prestigjit), si dhe pushtete të ndryshme për gratë dhe burrat. Pabarazia gjinore ndikon negativisht barazpeshimin ndërmjet mundësive, kushteve të jetesës dhe statusit shoqëror e politik të grave e vajzave dhe burrave e djemve. Në të gjithë botën jeta është e ndryshme për burrat dhe gratë. Zakonisht, gratë kanë shumë më pak të drejta dhe burime të ardhurash. Këto pabarazi kufizojnë mundësitë dhe arritjet e grave dhe kontribuojnë në një zhvillim të pabarabartë, e si rrjedhojë përjetësojnë statusin e ulët të gruas në shoqëri. Shoqëria shqiptare është patriarkale, me pritshmëri të ndryshme përsa i përket sjelljes së duhur dhe roleve të pranueshme për burrat e gratë. Egzistojnë mjaft stereotipe për gratë, për shembull gratë konsiderohen inferiore ndaj burrave, arsimimi i grave vlerësohet më pak, gratë janë të destinuara vetëm për t'u martuar, e kështu me radhë. Si rezultat, gratë kanë fuqi të vogël përsa i përket burimeve ekonomike, kanë nivel më të lartë të papunësisë sesa burrat, bien viktimë e çdo lloj dhune dhe përjetojnë përmirësime të vogla të cilësisë së jetës së tyre, megjithë përpjekjet e tyre të pareshtura për zhvillim. Megjithatë, marrëdhëniet gjinore ndryshojnë nga njëra krahinë në tjetrën dhe janë mjaft të dukshme në zonat rurale të Shqipërisë. Pabarazia gjinore në shoqërinë shqiptare nuk është vetëm një çështje e të drejtave të njeriut por edhe një çështje zhvillimi. Integrimi i perspektivës gjinore është një punë e vështirë. Integrimi gjinor ka të bëjë me ndryshimin e qëndrimeve përsa i përket roleve, vlerave dhe statusit të burrave e grave së bashku. Ndryshimi politik e social i kërkuar nga integrimi gjinor është një

proces i gjatë por me vlera. Synimi është që politikë-bërësit shqiptarë të hartojnë politika e programe të cilat do të sigurojnë barazinë ndërmjet burrit e gruas në jetën.

4.3. Barazia gjinore si një domosdoshmëri për integrimin gjinor

Kur flasim për integrim gjinor në një kontekst të caktuar padyshim që duhet të ndalemi tek masat e marra dhe të implementuara për tendencat kryesore të perspektivës gjinore në politika të përgjithshme, planifikime programesh si dhe aktivitete të të gjitha niveleve të shoqërisë. Mbi këtë bazë do të përgatitej mandej një kornizë konceptuale dhe një metodologji për tendencat e barazisë gjinore dhe do të identifikoheshin teknikat, mjetet dhe aktorët për të integruar dhe për të vlerësuar dimensionin gjinor në një mënyrë efektive dhe të dukshme.

Integrimi si një koncept i ri u shfaq për herë të parë në tekstet ndërkombëtare në Konferencën e Tretë Botërore të Kombeve të bashkuara për gratë (Nairobi 1985) në lidhje me debatin e komisionit të Kombeve të Bashkuara mbi statusin e grave dhe rolin e grave në zhvillim. Janë të shumta diskutimet për integrimin gjinor dhe ka pak konsensus rreth përcaktimit të integritit gjinor. Integrimi gjinor është organizimi, përmirësimi, zhvillimi dhe vlerësimi i proceseve të politikave, në mënyrë që perspektiva e barazisë gjinore të inkorporohet në të gjitha politikat dhe nivelet nga aktorët që bëjnë pjesë në politikëbërje. Integrimi gjinor do të thotë që ky proces duhet të riorganizohet në mënyrë që aktorët të dinë si të inkorporojnë një perspektivë dhe ekspertizë gjinore si një kërkesë normale për politikëbërësit. Integrimi i nxjerr problemet e barazisë gjinore jashtë integritit të mekanizmave të barazisë gjinore dhe përfshin më shumë aktorë të rinj në ndërtimin e një shoqërie të balancuar. Duke bërë këtë, procesi i transformimit të marrëdhënieve gjinore në drejtimin e barazisë gjinore mund të përshpejtohet dhe të forcohet.

Integrimi gjinor vendos strategjinë e tendencës në kontekstin e arritjeve në termat e barazisë gjinore.

Integrimi si një koncept i ri u shfaq për herë të parë në tekstet ndërkombëtare në Konferencën e III Botërore të Kombeve të Bashkuara për gratë (Nairobi 1985) në lidhje me debatin e komisionit të Kombeve të Bashkuara mbi statusin e grave dhe rolin e grave në zhvillim. Kjo u pa si një mënyrë për të promovuar rolin e grave në fushën e zhvillimit dhe të integritit të vlerave të grave në punën kërkimore⁸³. Në konferencën e IV Botërore të Kombeve të Bashkuara mbi Gratë (Pekin 1995), strategjia e integritit gjinor u adoptua nga platforma e Pekinit. Kjo platformë synon promovimin e politikës së integritit gjinor duke kërkuar që “qeveritë dhe aktorët e tjerë duhet të promovojnë një politikë aktive dhe të dukshme të integritit të perspektivës gjinore në të gjitha politikat dhe programet në mënyrë që para se të merren vendimet të bëhet një analizë respektive rreth efekteve mbi gratë dhe burrat”. Shumë vende kanë adaptuar një plan kombëtar për integrimin gjinor si rezultat i Platformës për Veprim.

Në vitet e fundit brenda organizatave Europiane ndërqeveritare koncepti i integritit gjinor është promovuar mjaft. Në Komisionin Europian, program i veprimit të komunitetit mbi mundësitë e njëjta për gratë dhe burrat (1991- 1995) e ka bërë një çështje kryesore këtë program veprimi. Komisioni ka adaptuar një komunikatë mbi integrimin gjinor⁸⁴. Për më shumë u vendos të merreshin hapa aktivë për të pasur modele për integrimin e një perspektive gjinore. Një projekt pilot 3 vjecar u lançua në 1997 që kishte për qëllim zhvillimin dhe testimin e metodave për integrimin gjinor.

⁸³ Një rezolutë mbi punën e ardhshme të këtij komisioni u aprovua në 1986 që vendosi të integrojë Strategjitë e së Ardhmes në programet ekonomike dhe të zhvillimit social.

⁸⁴ Kjo komunikatë thotë që integrimi Involvon “Mobilizimin e politikave të përgjithshme dhe masave specifike për arritjen e qëllimit të barazisë duke parasysh në mënyrë të qartë dhe aktive në fazën e planifikimit efektet e mundshme të tyre mbi situatat respektive të burrave dhe grave” COM (96)67 Komunikata finale 21.02.1996

Janë të shumta diskutimet për integrimin gjinor dhe ka pak konsensus rreth përcaktimit të integritit gjinor dhe si realizohet ky aspekt në praktikë. Në mënyrë të përmbledhur, më poshtë disa nga konkluzionet lidhur me përkufizimet e këtij koncepti:

- Të gjitha përkufizimet fokusohen mbi qëllimin e madh të arritjes së barazisë gjinore. Ato fokusohen mbi atë që është quajtur perspektiva e barazisë gjinore ose perspektiva e gruas.
- Shumë përkufizime shpesh reduktojnë përkufizimin në aspekte pjesore të integritit gjinor: ato fokusohen mbi pjesëmarrjen e plotë të grave në vendimarrje ose mbi studimin e propozimeve të politikave nga një perspektivë gjinore.
- Disa definicione fokusohen mbi efektet e integritit gjinor dhe çfarë ai sjell në funksionimin dhe strukturimin e shoqërisë. Këto përkufizime tregojnë ndryshimet në kulturat organizative dhe mënyrën sesi punojnë institucionet ose mënyrat e reja të mendimit dhe të politikave. Zakonisht këto lidhen me OJF-të.
- Shumë përkufizime presupozojnë që integrimi përfshin një zhvendosje të aktorëve, që do të thotë që aktorë të zakonshëm përfshihen në integrimin e perspektivës gjinore.

Integrimi është i vështirë të përkthehet në shumë gjuhë dhe shpesh reduktohet në terma si “*qasje e bazuar në gjini*”, por sigurisht integrimi është shumë më tepër se kaq: ai është një përpjekje për t’i përcjellë problemet e barazisë gjinore në integrimin e shoqërisë, në organizatat dhe idetë që marrin vendime për politikën dhe burime të rëndësishme si edukim. Në çdo vend koncepti duhet të përkthehet dhe të shpjegohet më shumë kujdes për të theksuar integrimin e një perspektive gjinore. Në lidhje me përkufizimin duhen përfshirë aspekte të ndryshme në të:

Së pari, asaj çfarë duhet të integrohet në tendencën kryesore gjinore p.sh., një perspektivë barazie gjinore dhe një qëllim që duhet të arrihet p.sh., barazia gjinore.

Së dyti, implikimet strukturale dhe funksionale që involvon integrimi gjinor p.sh., riorganizimi, përmirësimi, zhvillimi i proceseve të politikës. Integrimi gjinor është një proces sa politik aq dhe teknik (IDS:1997). Integrimi gjinor përfshin riorganizimin e proceseve politike sepse kërkon vëmendjen e politikave të barazisë gjinore, ndryshimin në kulturat organizative dhe institucionale.

Së treti, përkufizimi nuk është parcial dhe i kufizuar në aspekte të veçanta dhe teknika të integritit gjinor. Ai kërkon nevojën e mjeteve dhe teknikave të shumta si dhe përfshin pjesëmarrjen e plotë të grave në të gjitha aspektet e jetës si dhe analizën e të gjitha propozimeve dhe politikave të ndryshme nga një perspektivë e barazisë gjinore.

Integrimi gjinor do të thotë që procesi i politikës duhet të riorganizohet në mënyrë që aktorët të dinë si të inkorporojnë një perspektivë dhe ekspertizë gjinore si një kërkesë normale për politikëbërësit. Integrimi i nxjerr problemet e barazisë gjinore jashtë integritit të mekanizmave të barazisë gjinore dhe përfshin më shumë aktorë të rinj në ndërtimin e një shoqërie të ballancuar. Duke bërë këtë procesi i transformimit të marrëdhënieve gjinore në drejtimin e barazisë gjinore mund të përshpejtohet dhe të forcohet.

3.5 Barazia gjinore si një domosdoshmëri për integrimin e Shqipërisë në BE

Çështjet e barazisë gjinore janë në qendër të politikave sociale të vendeve të Bashkimit European (BE) dhe një nga kërkesat për vendet që kanë hyrë në procesin e integritit european. Barazia gjinore nuk është vetëm një nevojshmëri demokratike në vetvete, por gjithashtu një

nevojshmëri ekonomike, politike dhe shoqërore për uljen e varfërisë dhe integrimin e Shqipërisë në BE. (Gruda, 2008:54) Në dekadën e parë të këtij shekulli, ka pasur zhvillime të rëndësishme institucionale dhe strukturore për përparimin dhe emancipimin e mëtejshëm të grave në shoqërinë shqiptare, si dhe për të siguruar pjesëmarrjen aktive të tyre njëlloj si burrat në jetën politike, ekonomike dhe shoqërore të vendit. Lënia jashtë vëmendjes apo mostrajtimi me kujdes i pabarazive gjinore, do të sillte për pasojë rrezikun e mospërfitimit maksimal të rreth 50% të popullsisë, nga progresi i arritur nëpërmjet reformave shoqërore, politike dhe ekonomike. Pabarazia gjinore, e cila evidentohet në të gjitha aspektet e jetës shoqërore në Shqipëri, nëse nuk do të vihet në qendër të politikave sociale, do të dëmtojë përpjekjet e Shqipërisë për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm, pasi nuk do të shfrytëzohet potenciali i plotë njerëzor i vendit. Integrimi gjinor, d.m.th., procesi që siguron që perspektiva gjinore dhe qëllimi për barazi gjinore të jenë në qendër të të gjitha aktiviteteve – zhvillim politikash, kërkime, advokim/dialog, legjislacion, shpërndarje e burimeve si dhe planifikim, zbatim dhe monitorim i programeve dhe projekteve, si një strategji për të promovuar dhe arritur barazinë gjinore, duhet të jetë pjesë e të gjitha politikave sociale, ekonomike dhe politike në Shqipëri. Një strategji e tillë jo vetëm siguron arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm nëpërmjet shfrytëzimit të potencialit të plotë njerëzor të vendit, por edhe garanton që të gjitha grupet shoqërore t'i gëzojnë këto arritje. Në përgjithësi synimet kryesore për rritjen dhe fuqizimin e gruas shqiptare në shoqëri mendojmë që janë këto:

- ✓ përpjekje drejt arritjes së barazisë gjinore në Shqipëri, nëpërmjet integritit të perspektivës gjinore në të gjitha aspektet e hartimit dhe zbatimit të politikave;

- ✓ përmirësimi i mbrojtjes, reagimit të autoriteteve publike dhe mbështetjen për viktimat e dhunës me bazë gjinore, si dhe të theksojë punën parandaluese, duke adresuar shkaqet e dhunës dhe abuzimit në familje dhe shoqëri.
- ✓ Mekanizmat ligjorë dhe institucionalë që sigurojnë barazinë gjinore në Shqipëri;
- ✓ Fuqizimi ekonomik i grave si një ndër kushtet themelore për arritjen e barazisë gjinore;
- ✓ Drejtpeshimi gjinor në vendim-marrje;
- ✓ Reduktimi i Dhunës me Bazë Gjinore ndarë sipas kategorive: parandalim, reagim, dhe rehabilitim e ri-integrim.

Kjo do të thotë pjesëmarrje e barabartë e grave dhe vajzave, burrave dhe djemve në jetën sociale, ekonomike e politike të vendit, si dhe mundësi të barabarta për të gëzuar të gjitha të drejtat e tyre dhe për të vënë në shërbim potencialet e tyre individuale në dobi të shoqërisë.

3.6. Mekanizmat Institucionalë shtetërore që sigurojnë zbatimin e ligjeve, parimin e mos-diskriminimit dhe barazisë midis burrave dhe grave.

Një rëndësi të veçantë në zbatimin e ligjeve, parimin e mos-diskriminimit dhe barazisë midis burrave dhe grave, përveç institucioneve ligjvënëse dhe ligjzbatuese kanë edhe mekanizma të tjerë institucionalë shtetërore që sigurojnë gëzimin e të drejtave njerëzore të grave dhe mbi të gjitha që nxisin përparimin e barazisë gjinore. (Gruda, 2008:55)

Mekanizmi Shtetëror i Barazisë Gjinore, i cili përbëhet nga një sërë strukturash shtetërore është ngritur për të nxitur përparimin e barazisë gjinore dhe për të siguruar gëzimin e të drejtave njerëzore të grave.(Picari, 2008:38). Ky mekanizëm është ngritur në zbatim të rekomandimeve

nga CEDAW, Platforma për Veprim e Pekinit (PVP) dhe në zbatim të Ligjit mbi Barazinë Gjinore. Funkzioni i tij kryesor është të monitorojë dhe të sigurojë zbatimin e ligjeve, të parimit të mos-diskriminimit dhe barazisë midis burrave dhe grave. LBGJSH përcakton si autoritet përgjegjës për çështjet e barazisë gjinore Ministrin e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Bazuar në Ligjin mbi Barazinë Gjinore si dhe Ligjin kundër Dhunës në Familje, Ministri e kryen funksionin e mësipërm i ndihmuar nga struktura e specializuar brenda dikasterit të tij, Drejtoria e Politikave për Shanset e Barabarta dhe Familjen, e cila funksionon në këtë Ministri që prej vitit 2006. Misioni kryesor i saj është të nxisë barazinë gjinore dhe një pjesëmarrje të gjerë të gruas në jetën ekonomike, politike e kulturore të vendit si dhe formulimin dhe zhvillimin e politikave për parandalimin dhe reduktimin e dhunës në marrëdhëniet familjare, e në përgjithësi të dhunës me bazë gjinore. (Pikat fokale të barazisë gjinore në Shqipëri, 2008: 15) DPSHBF përbëhet nga dy sektorë: Sektori i Barazisë Gjinore dhe Për Masat Ndaj Dhunës në Familje dhe Sektori Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve. Pas daljes së LMD, kësaj Drejtorie u ngarkua edhe detyra që të punonte edhe për zbatimin e këtij ligji. Në bazë të LBGJSH, propozimi i politikave mbi barazinë gjinore i ngarkohet Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore. Ky këshill ka për detyrë të këshillojë Qeverinë për përcaktimin e drejtimit të politikave shtetërore për barazi gjinore, me përjashtim të çështjeve që merren në shqyrtim nga Këshilli Kombëtar i Punës dhe të sigurojë integrimin gjinor në të gjitha fushat. Ai është ngritur me VKM Nr. 122, datë 2.2.2009 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore”, drejtohet nga Ministri që mbulon çështjet e barazisë gjinore (aktualisht nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta) dhe në përbërje ka 9 zëvendësministra të MPÇSSHB, Ministrisë së Integritimit (MI), Ministrisë së Financave (MF), Ministrisë së Drejtësisë (MD), Ministrisë së Brendshme (MB), Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH), Ministrisë

së Shëndetësisë (MSH), Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MTKRS), Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MBUMK) si dhe tre anëtarë përfaqësues të shoqërisë civile. (Pikat fokale të barazisë gjinore në Shqipëri, 2008: 15).

Miratimi i LBGJSH shtroi edhe detyrimin institucional për emërimin e Nëpunësve Gjinorë (NGJ) në çdo ministri të linjës dhe në organet e pushtetit vendor. Neni 13/3 përcakton se “Institucionet shtetërore, në nivel qendror dhe vendor, kanë detyrimin ligjor për të bashkëpunuar me ministrin përkatës, për shkëmbimin e informacionit dhe lehtësimin e përmbushjes së funksionit të tij.” Ligji shtron detyrimin që nëpunësit për çështjet gjinore të emërohen në Ministri dhe në organet e pushtetit vendor. Në nivel qendror vetëm MSH ka institucionalizuar pozicionin e NGJ me kohë të plotë, siç e kërkon ligji, ndërkohë që në ministritë e tjera ka pika fokale gjinore, pra persona që mbulojnë detyra të tjera, por u është ngarkuar të merren edhe me çështjet e barazisë gjinore. Në nivel vendor janë zyrtarizuar 12 NGJ, edhe pse ka pika fokale për barazinë gjinore në 65 njësi vendore. (Pikat fokale të barazisë gjinore në Shqipëri, 2008: 15)

Në këtë analizë mendojmë që edhe pse parashikimet ligjore dhe institucionet janë të ngritura dhe funksionale ende mbetet shumë për të bërë për të krijuar mjedisin e duhur për funksionimin efektiv të mekanizmit institucional. Përtej statistikave të institucioneve të ndryshme mendojmë se jo të gjitha institucionet në nivel qendror dhe vendor kanë burimet e duhura njerëzore, financiare dhe teknike për funksionim efektiv.

Në nivel parlamentar deri në vitin 2009 brenda Komisionit Parlamentar të Punës dhe Çështjeve Sociale, ka funksionuar Nënkomisioni për Minorenët dhe Shanset e Barabarta. Ky Komision, shqyrton projektligje dhe ndërmerri nisma ligjore në fushat e përgjegjësisë së vet dhe ndërton bashkëpunim me MPÇSSHB për çështjet e barazisë gjinore dhe fëmijëve.

Me hyrjen në fuqi të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, u krijua edhe institucioni i Komisionerit, i cili kryen funksionet e një ombudsmani për çështje të diskriminimit për çfarëdo shkak, përfshi gjininë, por edhe identitetin gjinor, shtatzaninë, orientimin seksual, gjendjen familjare apo martesore, përgjegjësinë prindërore, të cilat tipikisht janë të lidhura ngushtë me gjininë e personit. Ky institucion ka kompetencë të shqyrtojë ankesat për diskriminim nga individët, grupet e tyre apo organizatat, të kryejë hetime, të monitorojë zbatimin e këtij ligji, të vendosë sanksione, të zhvillojë aktivitete ndërgjegjësimi dhe edukimi që ndihmojnë në zbatimin e këtij ligji. (Pikat fokale të barazisë gjinore në Shqipëri, 2008: 15).

KAPITULLI IV: TË DREJTAT E GRAVE SI PJESE E TE DREJTAVE TE NJERIUT DHE MBROJTJA E GARANTIMI I TYRE NË LEGJISLACIONIN E BRENDSSHËM DHE JURISPRUDENCE

4.1. Mbrojtja dhe respektimi i të drejtave të grave si pjesë e të drejtave themelore në Kushtetutën e RSH

Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të drejta që lindin bashkë me çdo qenie njerëzore dhe kanë karakter universal. Mbrojtja dhe promovimi i tyre është dhe duhet të jetë detyrimi parësor i çdo shteti të së drejtës dhe shoqërie demokratike. Ka një sërë arsyesh që na shtynë ta nisim analizën e të drejtave të grave në kontekstin e të drejtave të njeriut pikërisht nga Kushtetuta. Kushtetuta është ligji suprem në të cilin deklarohen politikat dhe vlerat kryesore të shtetit shqiptar. Sipas nenit 3 të Kushtetutës: «... Dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij..., janë baza e këtij shteti, i cila ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë». Gjithë sistemi ligjor shqiptar është bazuar në rregullimet dhe parimet kushtetuese. Kjo do të thotë se parimet e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut janë pjesë integrale e të gjithë legjislacionit në përgjithësi dhe e çdo ligji e akti nënligjor në veçanti.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë nuk trajton në mënyrë të veçantë të drejtat e grave por duke qenë një dokument sa politik aq edhe normativ, ajo i ka gjetur vendin e duhur kujdesit ndaj gruas. *Kushtetuta ka shprehur detyrimin për një mbrojtje të veçantë nga shteti për nënat e reja dhe gratë shtatzëna pikërisht në nenin 54 të saj.* Në mënyrë të veçantë, Kushtetuta garanton të drejtën për t’u martuar dhe pasur një familje, të drejtën për kujdes shëndetësor, të drejtën e sigurimeve shoqërore në pleqëridhe në rastin e paafësisë për punë, etj. Përveç garantimit të tyre në kuadrin e të drejtave për të gjithë individët, Kushtetuta ka sanksionuar të drejtën për një

mbrojtje të veçantë nga Shteti, për *gratë shtatzëna dhe nënat e reja, si dhe për fëmijët dhe të rinjtë*. Kjo do të thotë se është detyrë e ligjvënësit dhe e qeverisë shqiptare që, të marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar një mbrojtje të veçantë për këto kategori, duke respektuar parimin e barazisë gjinore (Anastasi:2010).

Në Kushtetutën shqiptare përdoren përemra të tillë si «të gjithë», «kushdo», «askujt», «kujtdo», «secili», etj, për të treguar se bashkësia njerëzore të cilit i drejtohet dispozita nuk bën asnjë përjashtim, asnjë diskriminim, pasi të drejtat dhe liritë themelore u garantohen të gjithëve, gra e burra, të mitur e madhorë, shtetas shqiptarë e shtetas të huaj dhe personave pa shtetësi (me përjashtim të rasteve kur Kushtetuta e lidh në mënyrë të posaçme me shtetësinë shqiptare ushtrimin e të drejtave e lirive të caktuara), pakicave kombëtare, etj.

Pjesa e dytë e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i kushtohet «*Të drejtave dhe lirive themelore të njeriut*». Kjo pjesë është e ndarë në katër krerë. «Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik».

Në kreun e parë të kësaj pjese trajtohen Parimet e Përgjithshme. Vetë Kushtetuta nënvizon se të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik. Kufizimet e të drejtave dhe lirive kushtetuese mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Asnjëherë kufizimet nuk mund të çenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave.

Në nenin 15/2 të Kushtetutës parashikohet detyrimi i *organeve të pushtetit publik, që në përmbushje të detyrave të tyre, të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre*.

Në kontekstin e të drejtave të grave, një vend të veçantë zë neni 18 i Kushtetutës, i njohur ndryshe edhe si *neni antidiskriminim*.

Në kreun e dytë trajtohen liritë dhe të drejtat vetjake, ndër të cilat përmendim: e drejta e jetës, e drejta e informimit, liria e shprehjes, e ndërgjegjes dhe e fesë, ndalimi i torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës, ndalimi i punës së detyruar, mbrojtja e të dhënave personale, liria dhe fshehtësia e korrespondencës, paprekshmëria e banesës, e drejta e lëvizjes së lirë dhe e zgjedhjes së vendbanimit, e drejta e pronës private, e drejta e ankimit.

Po në këtë pjesë, Kushtetuta paraqet në mënyrë të përmbledhur parimet kryesore të drejtësisë penale dhe garancitë procedurale të të pandehurit.

Në kreun e tretë të Kushtetutës trajtohen të drejtat dhe liritë politike. Këtu përfshihen: E drejta aktive dhe pasive e votimit, e drejta e organizimit kolektiv, e drejta për të drejtuar kërkesa, ankesa ose vërejtje organeve publike.

Në kreun e katërt trajtohen liritë dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore. Disa prej tyre janë: e drejta për punë dhe e mbrojtjes shoqërore të punës, e drejta e grevës, e drejta e sigurimeve shoqërore në pleqëri dhe në rastet e paaftësisë për punë, e drejta e ndihmës në kushtet e parashikuara me ligj, e drejta për martesë dhe familje, e drejta për kujdes shëndetësor nga shteti, e drejta për arsimim.

Një nga çështjet kryesore duket se mbetet hendeku ndërmjet barazisë *de jure* (ajo çka ligji deklaron) dhe *de facto* (realitetit konkret). Nga këndvështrimi i instrumenteve ligjore duhet pranuar se vendi ynë nuk vuan nga mungesa e legjislacionit. Por, ndërsa kushtetuta e ligji gjithnjë e më shumë është një instrument i sigurimit të barazisë nga këndvështrimi gjinor, në praktikë vihet re se ende ka moskoherencë ndërmjet asaj çka kushtetuta dhe ligji deklaron dhe realitetit. Në këtë mënyrë ka një ndryshim të dukshëm të konceptit të barazisë midis burrave dhe

grave sipas parashikimeve ligjore me atë që ndodh dhe zbatohet realisht. Gjithsesi ka një tendencë që ky boshllëk të plotësohet me praktika pozitive.

Një kontribut me vlerë në këtë drejtim kanë dhënë dhe vazhdojnë të japin OJF-të e dedikuara në fushën e ndërgjegjësimit dhe mbrojtjes së të drejtave të grave. Shpeshherë gratë nuk i njohin të drejtat që ligji u jep, sikurse janë në pamundësi për t'i mbrojtur ato për shkak të vështirësive ekonomike, sociale, kulturore etj. Në këto kushte, veprimtaria e OJF-ve ka sjellë efekte pozitive në disa drejtime dhe ka ndikuar në krijimin e një legjislacioni antidiskriminues, në ndërmarrjen e politikave ose veprimeve pozitive, ofrimin e shërbimeve të drejtpërdrejta për gratë, etj.

4.2. Respektimi i të drejtave të grave në aktet ligjore. Kodet e Republikës së Shqipërisë.

Respektimi i të drejtave të grave si pjesë e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut garantohet edhe nga akte të tjera ligjore me rëndësi siç janë Kodet e ndryshme të Republikës së Shqipërisë. Në fakt një sërë Kodesh të miratuara pas vitit 1995, përmbajnë dispozita në mbrojtje të të drejtave të njeriut dhe sanksionojnë parimin e barazisë burrë-grua. Këtu i referohemi shprehimisht Kodit Penal, Kodit të Procedurës Penale, Kodit të Punës, Kodit të Familjes dhe Kodit Zgjedhor.

Analizën në këtë paragraf e nisim fillimisht me *Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë*. Kodi Penal ka në përmbajtje një sërë dispozitash ligjore të cilat mbrojnë në mënyrë të veçantë gruan. Dispozitat e Kodit Penal shqiptar zbatohen edhe kur një shtetas i huaj që jashtë territorit të R.SH kryen krimin e organizimit të prostitucionit, trafikimit të jashtëligjshëm të njerëzve, fëmijëve dhe grave. Kodi Penal thekson se gratë janë të përjashtuara nga dënimi me burgim të

përrjetshëm dhe vuajtja e dënimit me burgim për gratë bëhet në institucione të veçanta nga burrat. Po ashtu, është rrethanë rënduese kryerja e veprës penale kundër gruas shtatzënë; po ashtu vrasja e gruas shtatzënë konsiderohet si vrasje në rrethana cilësuese. (Krijimi i mundësive ekonomike për grate dhe vajzat në Shqipëri, 2006: 38)

Ka një seksion të veçantë (V) në Kodin Penal që i referohet veprave penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzënisë ose mosdhënia e ndihmës. Këtu përfshihen ndërprerja e shtatzënisë pa pëlqim të gruas, ndërprerja e shtatzënisë e kryer në vende dhe nga persona të paautorizuar, dhënia e mjeteve për ndërprerjen e shtatzënisë, etj. (NGO Report on the situation of women and girls in the Republic of Albania, 2006:28)

Seksioni 4 i referohet krimeve seksuale. Këtu me dispozita të veçanta parashikohen marrëdhëniet seksuale me dhunë me të rritura, marrëdhëniet homoseksuale me dhunë me të rritur, marrëdhëniet seksuale dhe homoseksuale me persona të pazotë për t'u mbrojtur, marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale me kërcënim me përdorim të armës, marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar detyrën.

Seksioni i veprave penale kundër lirisë së personit përfshin rrëmbimin ose mbajtjen peng të personit, heqjen e paligjshme të lirisë dhe trafikimin e njerëzve. Seksioni 8 trajton veprat penale kundër moralit dhe dinjitetit të tilla si: prostitucioni, shfrytëzimi i prostitucionit, trafikimi i femrave për prostitucion. Seksioni 9 parashikon veprat penale kundër fëmijëve familjes e martesës, ku përfshihen: mosdhënia e mjeteve për jetesë, shtrëngimi ose pengimi për të bashkëjetuar ose për të lidhur martesë.

Ndërsa *Kodi i Procedurës Penale* parashikon garancitë procedurale të cilat bazohen në Kushtetutën e RSH, KEDNJ, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë dhe nuk bën asnjë dallim ose diskriminim për gratë e proceduara penalisht. Kodi i Procedurës Penale parashikon se

nuk mund të vendoset arresti në burg ndaj një gruaje që është shtatzënë ose me fëmijë në gji (neni 230). Gjykata që ka dhënë vendimin e dënimit mund të vendosë shtyrjen e ekzekutimit të vendimit në rast se e dënuara është shtatzënë ose me fëmijë nën 1 vjeç. Ekzekutimi shtyhet deri sa fëmija të bëhet 1 vjeç. Nuk pranohet kërkesa për ekstradim kur ka arsye të mendohet se personi që kërkohet do t'u nënshtrohet persekutimeve ose diskriminimeve për shkak të racës, fesë, seksit, etj ose dënimeve a trajtimeve të egra, çnjerëzore a poshtëruese ose veprimeve që përbëjnë shkelje të një të drejte themelore të njeriut. Vendimi i gjykatës së huaj nuk mund të njihet kur ka arsye të bazuara për të menduar se kanë ndikuar në përfundimin e procesit konsiderata lidhur me racën, fenë, seksin, gjuhën apo bindjet politike. (NGO Report on the situation of women and girls in the Republic of Albania, 2006:20)

Nga ana tjetër, Ministria e Drejtësisë nuk mund të kërkojë ekzekutimin jashtë shtetit të një vendimi penal dënimi me kufizim të lirisë personale kur ka arsye të çmohet se i dënuari do t'u nënshtrohet akteve persekutuese ose diskriminuese për shkak të racës, fesë, seksit, kombësisë, etj.

Në të njëjtën frymë *Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*, i cili bazohet në parimet kryesore kushtetuese, respekton po ashtu, konventat ndërkombëtare të ratifikuara dhe të drejtat ndërkombëtare të njohura.

Ndalimi i diskriminimit qëndron si një e drejtë themelore në Kodin e Punës. Në këtë mënyrë, Kodi ndalon çdo lloj diskriminimi në fushën e marrjes në punë dhe të profesionit dhe jep qartësisht kuptimin e diskriminimit duke renditur ndër të tjera si të tilla dallimin, përjashtim ose parapëlqim për shkak të seksit që cënon të drejtën e individit për të qenë i barabartë në punësim dhe trajtim. Rastet kur këto dallime, përjashtime ose parapëlqime nuk duhet të konsiderohen si

diskriminim. Në Kodin e Punës gjejmë të pasqyruara parime të rëndësishme të barazisë në marrëdhëniet e punës dhe të punësisimit. Si të tillë përmendim:

- Barazinë në shpërblim (neni 115 parashikon të njëjtën pagë si për gratë edhe për burrat që kryejnë punë me vlerë të barabartë), çka e bën legjislacionin tonë në harmoni me standardet ndërkombëtare dhe Konventat e ONP (Organizata Ndërkombëtare e Punës) në këtë fushë;
- Ndalimin e punës së detyruar për të gjithë pa përjashtim;
- Mbrojtjen dhe parandalimin e cënimit të personalitetit e dinjitetit të punëmarrësit si një detyrim të punëdhënësit, përfshi këtu edhe shqetësimin seksual;
- Mos mbledhjen e informatave (neni 33) nga punëdhënësi lidhur me punëmarrësit gjatë marrëdhënieve të punës (përveç rasteve kur këto informata lidhen me aftësitë profesionale të punëmarrësve ose janë të nevojshme për zbatimin e kontratës). Kjo nënkupton mosmarrjen e informatave të tilla që kanë të bëjnë me orientimin seksual, statusin martesor dhe familjar, etj.
- Lirinë sindikale;
- Regjistrimin e punëmarrësit në sigurimet shoqërore;
- Të drejtën për trajnim dhe kualifikim.

Kodi i Punës përfshin në përmbajtjen e vet një kre të rëndësishëm, të titulluar “Mbrojtje e veçantë për gratë”, në të cilin gjenden rregullime ligjore të cilat mbajnë në konsideratë rolin e veçantë të gruas në shoqëri dhe familje. Vlen të përmendim:

- Ndalimin e punës për gratë shtatzëna dhe nënat e reja (neni 104).
- Lejen e lindjes

- Lejen e birësimit
- Pavlefshmërinë e zgjidhjes së kontratës së punës nga punëdhënësi në periudhën e lejes së lindjes ose të lejes së birësimit (neni 107).
- Ndalimin e punës së natës për gratë shtatzëna (neni 108).

Fryma afirmative vihet re edhe në pjesë të tjera të Kodit të Punës. Kështu, në kushtet e punës përfshihet: E drejta për pushim të paguar prej 20 minuta në çdo 3 orë për gratë shtatzëna; Ndalimi i mbajtjes së peshave mbi 20 kg për gratë; E drejta e pushimit të paguar (12 deri 15 ditë në vit) në rast përkujdesjesh të domosdoshme për fëmijët në ngarkim, si një e drejtë pa diskriminim e nënës dhe atit të fëmijës (neni 132).

Lidhur me punët e vështira, Këshilli i Ministrave vendos rregulla të veçanta për kohëzgjatjen dhe kushtet e kryerjes së punëve të vështira ose të rrezikshme për të miturit mbi 16 vjeç dhe për gratë shtatzëna. Ndalohet puna e natës për gratë shtatzëna por edhe në rastet e tjera Këshilli i Ministrave vendos rregulla të veçanta për rastet kur lejohet puna e natës për gratë.

Edhe *Kodi i Familjes* mbron po ashtu në mënyrë të veçantë gratë. Qysh në kreun e parimeve të përgjithshme Kodi i Familjes nënvizon se martesë, si një bashkëjetesë ligjore, mbështetet në barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve, në ndjenjën e dashurisë, respektit dhe mirëkuptimit reciprok, si baza e unitetit në familje. Martesa dhe familja si institucione shumë të rëndësishme gëzojnë mbrojtjen e veçantë të shtetit.

Ai sanksionon disa parime themelore si:

- i) Parimin e reciprocitetit i të drejtave dhe detyrimeve
- ii) Parimin e barazisë në të drejta dhe detyrime
- iii) Vendosja mbi gjithçka e interesave të fëmijëve, martesës dhe familjes

iv) Reciprociteti në besnikëri, për ndihmë morale, për ndihmë material, për bashkëpunim në interes të familjes dhe bashkëjetesës.

Kodi i familjes është i ndarë në tri pjesë. Pjesa e parë trajton parime të përgjithshme, pjesa e dytë i dedikohet bashkëshortëve dhe pjesa e tretë i dedikohet fëmijëve. Ky kod rregullon lidhjen e martesës duke parashikuar të njëjtat kushte dhe ndalesa si për gruan dhe burrin, pavlefshmërinë, mbarimin e martesës dhe pasojat e zgjidhjes së saj, të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga martesë, marrëdhëniet personale dhe pasurore të bashkëshortëve, çështje të amësisë dhe atësisë, birësimit, kujdestarisë etj.

Nga një analizë e përgjithshme e dispozitave të Kodit të Familjes konstatohet lehtësisht se në të gjithë dimensionin e tij nënvizohen parime të tilla si:

- Reciprociteti në të drejta dhe detyrime.
- Baraziteti i bashkëshortëve në raport me njëri tjetrin, fëmijët, martesën e familjen.
- Mosdiskriminimi për shkak të të qenit burrë ose grua.

Martesë mund të lidhë gruaja ose burri që ka mbushur moshën 18 vjeç. Në këtë mënyrë ky kod ka unifikuar moshën e martesës. Barazia midis bashkëshortëve është pranuar si koncept shoqëror dhe si parim i së drejtës familjare vetëm si rezultat i përpjekjeve të mëdha për përparim e zhvillim. Më parë, kjo barazi, jo vetëm nuk gjente sanksionim ligjor, por, në të kundërt, si morali shoqëror, ashtu edhe vetë dispozitat ligjore të kohës përlligjinin mosbarazinë dhe diskriminimin e gruas. Të drejtat dhe detyrimet ndërmjet bashkëshortëve nuk çenojnë dhe nuk prekin thelbin e të drejtave të tyre njerëzore. Të drejtat dhe detyrimet bashkëshortore kanë rëndësi të veçantë edhe për garantimin e të drejtave që gëzojnë fëmijët e lindur nga kjo martesë.

Në nenin 50 të Kodit të Familjes përcaktohet shprehimisht se “*Me martesë, burri dhe gruaja përfitojnë të njëjtat të drejta dhe marrin përsipër të njëjtat detyrime.*” Në të gjitha dispozitat ligjore të këtij Kodi, që trajtojnë të drejtat dhe detyrimet bashkëshortore, vërejmë se ato janë trajtuar si të drejta dhe detyrime për secilin bashkëshort, pa bërë dallim midis burrit dhe gruas. Secili prej tyre ka të drejtën dhe detyrimin të shprehë vullnetin e lirë e të plotë në lidhje me çështjet kryesore të jetës martesore, përfshi këtu edhe çështjet e lidhura me fëmijët e lindur nga martesë, të japë ndihmesën për realizimin e bashkëjetesës dhe të familjes, por edhe të ndërmarrë nisma ligjore, për të sprapsur veprimet e bashkëshortit tjetër që pengojnë ushtrimin prej tij të të drejtave dhe detyrimeve martesore. Ndaj disa të drejtave dhe detyrimeve bashkëshortët ruajnë njëlloj autonomie, ndërsa disa të tjera nuk lënë mundësi të tillë. Nisur nga rëndësia që ka një e drejtë ose detyrim bashkëshortor varet edhe autonomia e bashkëshortëve. Kjo është arsyeja që edhe rregullat që rregullojnë të drejtat dhe detyrimet e bashkëshortëve ndahen në: *Detyruese dhe Lejuese.*

Martesa si raport i bën bashkëshortët titullarë të një statusi që buron nga qenia e tyre burrë e grua. Ky status martesor u jep atyre disa të drejta dhe disa detyrime specifike me *karakterpersonal/jo pasuror*, të tilla si: detyrimi dhe e drejta për besnikëri; detyrimi dhe e drejta për ndihmë morale; mbiemri i bashkëshortëve; mbiemri i fëmijëve; detyrimi dhe e drejta për jetë të përbashkët; shtetësia; përfaqësimi.

Kodi i familjes paraqitet nën një dimension bashkëkohor në drejtim të barazizmit, reciprocitetit dhe mos diskriminimit, me qëllim që të mbrohet martesë dhe familja si edhe të drejtat dhe detyrimet e të gjithë anëtarëve të saj. Kur bashkëshortët nuk merren vesh për mbiemrin e fëmijës, atëherë neni 52 i Kodit të Familjes urdhëron që fëmija do të marrë mbiemrin e atit. Sipas nenit 54 të Kodit të Familjes, bashkëshortët “...*dotë kontribuojnë për nevojat e*

familjes në përputhje me kushtet dhe aftësitë e tyre “. Kjo do të thotë që nëse nuk i kanë kushtet dhe aftësitë të barabarta kështu do të jetë edhe kontributi i tyre. Nëna e fëmijës së lindur jashtë martese ka të drejtë të kërkojë gyqësisht njohjen e atësisë së fëmijës edhe kur ajo vet nuk ka mbushur moshën madhore. Duhet nënvizuar se këto kufizime nuk çenojnë thelbin e të drejtës së barazisë midis bashkëshortëve, sepse interesat e martesës, të fëmijëve dhe të familjes janë parësore.

Kodi i Familjes ka parashikuar (nenet 58 – 64) ndërhyrjet e autoritetit publik (gjykatës) kur njëri bashkëshort nuk dëshiron të plotësojë detyrimet vullnetarisht. Gjykata vihet në lëvizje me kërkesën e bashkëshortit tjetër. Raste të tilla janë: Autorizimi prej gjykatës i njërit bashkëshort për të kryer veprime juridike në interes të familjes, në rastet kur bashkëshorti tjetër kundërshton këtë veprim ose nuk është në gjendje ta kryejë atë (neni 58); Përfaqësimi i bashkëshortit në rastet kur ai është në pamundësi të shprehë vullnetin e tij prej bashkëshortit tjetër (neni 59); Plotësimi nga njëri bashkëshort i nevojave urgjente të familjes, të tilla si mbajtjen e familjes, edukimin e fëmijëve, interesat e familjes dhe zgjidhjen e situatave të tjera me karakter urgjent (neni 60); Rastet kur njëri bashkëshort nuk plotëson në mënyrë të dukshme detyrimet e tij dhe vë në rrezik interesat e familjes.

Me rëndësi të veçantë paraqitet në këtë pjesë edhe Kodi Zgjedhor(KZ). E drejta aktive dhe pasive e votimit (e drejta për të zgjedhur e për t'u zgjedhur) si e drejtë që garantohet direkt nga Kushtetuta për të gjithë shtetasit shqiptar pa dallime gjinore e mandej elaborohen në Kodin Zgjedhor. KZ garanton se *çdo shtetas shqiptar, pa dallim race, etnie, gjinie, gjuhe, bindjeje politike, besimi ose gjendjeje ekonomike, ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë Kod*. Neni 3\2 i Kodit Zgjedhor përcakton qartë se *zgjedhësit janë të barabartë në ushtrimin e të drejtës për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur*. Vendi ynë ka ratifikuar një sërë instrumentesh që garantojnë të drejtat politike të grave, si Protokollin 1 i KEDNJ. Por pavarësisht këtij legjislacioni me frymë të fortë antidiskriminuese dhe

instrumenteve ndërkombëtarë, konstatohet lehtësisht se pjesëmarrja e gruas në jetën publike është e kufizuar.

4.3. Respektimi i të drejtave të grave në aktet e tjera ligjore.

Respektimi i të drejtave të grave si pjesë e të drejtave të njeriut, përveç Kushtetutes dhe Kodeve garantohet edhe në ligje. Këto të drejta janë shumë të gjera megjithatë në këtë punim doktoral do të sjellim këtu një panoramë të përgjithshme të këtij legjislacioni. Ligjet kryesore janë: Ligji për Barazinë Gjinore në Shoqëri (LBGJSH); Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi (LMD); Ligji për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare (LDHF).

Vlen të fillojmë analizën me *Ligjin nr. 9970, dt.24.7.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri"* i cili rregullon çështjet themelore të barazisë gjinore në jetën publike, të mbrojtjes dhe trajtimit të barabartë të grave e burrave lidhur me mundësitë dhe shanset e barabarta për ushtrimin e të drejtave, si dhe me pjesëmarrjen e ndihmesën e tyre për zhvillimin e të gjitha fushave të jetës shoqërore. Ligji synon të sigurojë realizimin e të drejtave të barabarta të grave dhe burrave, të garantuara në nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe KEFDG, të përcaktojë masa për të eliminuar diskriminimin gjinor të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë në jetën publike të vendit dhe të përcaktojë përgjegjësitë e administratës qendrore dhe vendore për të hartuar politika për përkrahjen e një shoqërie gjinore të barabartë. (Krijimi i mundësive ekonomike për gratë dhe vajzat në Shqipëri, 2006: 38) Ligji përcakton organet përgjegjëse për mbarëvajtjen e barazisë gjinore dhe detyrat e tyre përkatëse. (Anastasi, Mandro-Balili, Shkurti, Bozo, 2012:67)

Sipas këtij ligji, përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor dhe të institucioneve të tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim në masën jo më pak se 30% i secilës gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese; sigurohet respektimi në mënyrë të njëjtë për secilën gjini i procedurave dhe kritereve të konkurrimit gjatë

emërimit në këto organe; sigurohet përfshirje jo më pak se 30% e secilës gjini në listën e kandidatëve për zgjedhjet në organet përfaqësuese vendore. Kjo listë emërore rendit që nga kreu kandidatët femra dhe meshkuj në mënyrë të alternuar; sigurohet përfshirje jo më pak se 30% e secilës gjini në listën e kandidatëve të paraqitur nga partitë politike për sistemin proporcional për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë. Në ligj përcaktohen po ashtu detyrimet e punëdhënësit për të mos diskriminuar në të gjitha aspektet e marrëdhënieve të punës dhe të punësimit e kualifikimit, si edhe përgjegjësitë e punëdhënësit për mbrojtjen nga diskriminimi, ngacmimi dhe shqetësimi seksual; masat e veçanta të përkohshme, etj.(Anastasi, Mandro-Balili, Shkurti, Bozo, 2012:68)

Pjesë e rëndësishme është detyrimi për edukimin e barazisë gjinore; mbrojtja dhe trajtimi i barabartë në bazë të përkatësisë gjinore në arsim dhe kualifikim si dhe mbrojtja dhe trajtimi i barabartë në bazë të përkatësisë gjinore në media. Qëllimi i ligjit nuk është thjesht deklarativ pasi ai është i shoqëruar edhe me një sërë sanksionesh. Risetë që sjell ky ligj kanë të bëjnë me futjen e përkufizimeve të reja si: ndalimi i diskriminimit për shkak të gjinisë i cili është në përputhje me përkufizimin e diskriminimit dhënë në Konventen CEDAW, integrimi gjinor, përkufizimi dhe ndalimi i ngacmimit për shkak të përkatësisë gjinore, përkufizimi i barazisë gjinore, përkufizimi i përfaqësimit të barabartë gjinor dhe parashikimi i masave të posaçme të përkohshme në vendimmarrjen politike e publike të parashikuara në formën e kuotës neutrale në masën jo më pak se 30% për gjininë më pak të përfaqësuar; përkufizimi dhe lejimi si jodiskriminuese i masave të veçanta të përkohshme; krijimi i strukturave të reja politikëbërëse, ekzekutuese dhe mbrojtëse; futja e masave të posaçme në sistemin arsimor dhe fushën e punësimit; puna e papaguar; si dhe detyrimi për mbledhjen e statistikave gjinore.(Anastasi, Mandro-Balili, Shkurti, Bozo, 2012:69)

Po ashtu, me rëndësi paraqitet edhe *Ligji Nr. 10221, dt. 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga të gjitha format e diskriminimit në RSH”*. Ky ligj rregullon zbatimin dhe mbrojtjen e parimit të barazisë së individëve dhe grupimeve të tyre, nga të gjitha format e diskriminimit, duke ndihmuar në parandalimin e këtyre formave. Në nenin 2 të ligjit përcaktohet edhe qëllimi i tij. Kështu qëllimi i ligjit është të *sigurojë të drejtën e çdo individi për: barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; barazi të shanseve dhe të mundësive për gëzimin e lirive, ushtrimin e të drejtave, si dhe të pjesëmarrjes në jetën publike; mbrojtje efikase nga diskriminimi dhe nga çdo formë e nxitjes së diskriminimit.*(Anastasi, Mandro-Balili, Shkurti, Bozo, 2012:72).

Ligji i referohet të gjitha formave të diskriminimit, në çdo rast, për të garantuar barazi në trajtim, por kuptohet që pjesë e këtij rregullimi janë edhe femrat. Kështu, neni 3 jep edhe konceptin e diskriminimit mbi bazën e vlerave dhe parimeve kushtetuese të sanksionuara. Ligjet, nuk mund të parashikojnë diskriminime të padrejta, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në rrethana të njëjta, për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore, ngjyra, mosha, identiteti seksual, gjendja familjare a martesore, gjendja shëndetësore, gjendja e pronësisë, gjendja e paaftësisë, përkatësia ndaj një grupi të cënuar, ose për çdo shkak tjetër që përbën diskriminim. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike, ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijon baza për mohimin e barazisë ndaj një personi a grupi personash, ose i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë disfavorizues, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me individë a grupe të tjerë, përbën diskriminim. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe diskriminimit të padrejtë, garantohet për këdo, në bazë të ushtrimit të të gjitha të drejtave vetjake, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore të siguruara

nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Aktet Ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

Mbrojtja e shëndetit të gruas, pra e drejta për kujdes shëndetësor është një tjetër fushë e rëndësishme në jetën e grave. Në këtë kuadër hyjnë një numër i madh ligjesh, të cilat kanë për synim respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave shoqërore dhe të shëndetit. Si të tillë përmendim: *Ligjin nr. 8876 datë 4.04.2002 “Mbi shëndetin riprodhues”*; *Ligjin nr.8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatzënisë”*; *Ligjin nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në R.Sh”*; *Ligjin nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore”*, etj.

Ligji nr.8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatzënisë” garanton respektimin e çdo qenie njerëzore që në fillim të jetës; të drejtën e informimit dhe këshillimit të gruas përpara ndërprerjes së shtatzënisë; rregullat dhe procedurat mbi ndërprerjen e shtatzënisë dhe sigurimin e shërbimit shëndetësor për ndërprerjen e shtatzënisë dhe trajtimin e ndërlikimeve të mundshme pas ndërprerjes së shtatzënisë. Ndërprerja e shtatzënisë lejohet vetëm kur vërtetohen rrethana të padëshiruara në këtë ligj dhe në çdo rast me pëlqimin e gruas. Ligji ia jep të drejtën në këtë rast vetëm gruas si subjekti kryesor dhe i vetëm në dhënien e pëlqimit për ndërprerjen e shtatzënisë.

Ndërsa *Ligji nr. 8876, datë 04.04.2002 “Për shëndetin riprodhues”*, mbron të drejtat riprodhuese të çdo individi e të çiftit dhe siguron që të drejtat riprodhuese të çdo individi të mbrohen në përputhje me ligjet dhe politikat kombëtare dhe standardet ndërkombëtare. Ligji i drejtohet shpesh herë në mënyrë të përveçme gruas si një subjekt i veçantë në këtë kontekst. Kështu, çdo grua, e lirë dhe e përjashtuar nga çdo formë diskriminimi, detyrimi dhe dhune, ka të drejtë për t’u kontrolluar e për të vendosur lirisht për të gjitha çështjet që lidhen me seksualitetin e saj dhe shëndetin seksual e riprodhues. Ligji nënvizon parimin e barazisë ndërmjet burrave dhe

grave.(Anastasi, Mandro-Balili, Shkurti, Bozo, 2012:201). Në të nënvizohet respektimi reciprok i marrëdhënieve të barabarta nga ana e grave dhe burrave gjatë lidhjeve seksuale dhe riprodhimit. Kjo nënkupton respektin, mosçënimin e integritetit të secilit, garantimin e çdo individi në vendimmarrjen për ushtrimin e të drejtave riprodhuese sipas dëshirës dhe interesit të tyre të lirë nga diskriminimi, detyrimi dhe dhuna. Burrat dhe gratë kanë të drejtën për të ruajtur qelizat seksuale. Ligji tregon kujdes të veçantë në mbrojtjen e mëmësisë së sigurt dhe trajton teknikat e riprodhimit mjekësor të asistuar.

Asnjë grua nuk duhet të detyrohet të jetë shtatzënë. Gruaja ka të drejtë për një mëmësi të sigurt dhe për mënjanimin e shtatzënisë së padëshiruar, e cila mund të kërcënojë jetën e saj. Jeta e gruas nuk duhet ekspozuar ndaj rrezikut të lidhur me shtatzëninë, lindjen e pengesa të tjera që lidhen me pabarazinë gjinore. Çdo grua ka të drejtë për mbrojtje shëndetësore gjatë shtatzënisë, për asistencë gjatë lindjes dhe të përfitojë zbatimin e metodave e praktikave që minimizojnë rrezikun për shëndetin e saj ose shëndetin e fetusit, të të porsalindurit dhe fëmijës. Mëmësia dhe fëmija kanë të drejtën për kujdes shëndetësor dhe mbështetje të veçantë. Gratë shtatzëna përfitojnë falas ndjekjen periodike mjekësore të shtatzënisë, të lindjes dhe paslindjes, veçanërisht ekzaminimet e paralindjes dhe të pas lindjes, të detyrueshme. Gratë shtatzëna kanë të drejtë të kryejnë pa pagesë ekzaminimet e detyrueshme të përshkuara nga mjeku dhe të marrin falas fletoren personale të ndjekjes së shtatzënisë.

Nuk mund të mos përmendim nën këtë kontekst edhe ligjin *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”* i cili ka në themel të vet respektimin e të drejtave të njeriut në institucionet e vuajtjes së dënimit me burgim ku çdo i dënuar ka të drejtë të trajtohet me dinjitet dhe në mënyrë njerëzore. Statistikat kanë treguar se ndonëse më pak se burrat, gratë janë pjesë e kontingjentit të personave të dënuar. Trajtimi i tyre, sipas ligjit duhet të bëhet pa njëanshmëri apo

diskriminim. Ekzekutimi i dënimit për gratë kryesisht bëhet në burgjet e sigurisë së ulët ndërsa vetëm për sjellje dhe vepra veçanërisht të rënda ato mund të vendosen në burgjet e sigurisë së lartë. Sipas ligjit, gratë si rregull e vuajnë dënimin në institucione të posaçme vetëm për to dhe në pamundësi, në seksione të veçanta të institucioneve të tjera sipas kriterëve të përcaktuara me ligj. Nënave u lejohej që të mbajnë me vete fëmijët deri në moshën 3 vjeç. Për kujdesin dhe asistencën ndaj këtyre fëmijëve funksionojnë çerdhe të posaçme. Në institucionet ku vuajnë dënimin gratë funksionojnë shërbimet speciale në ndihmë të grave shtatzëna dhe të atyre me fëmijë në gji.

Gratë shtatzëna, gjatë vuajtjes së dënimit me burgim nuk mund të detyrohen të punojnë për aq kohë sa parashikon ligji në fuqi. Sikurse për të dënuarit e mitur, edhe për gratë që kanë fëmijë të mitur bëhet një program i posaçëm dhe favorizues për lidhjet me familjen. Për gratë shtatzëna ose që u është lënë fëmija, mund të zbatohen vetëm masat disiplinore të tilla si qortim individual dhe vërejtje në prani të të dënuarve. Masat e tjera disiplinore të parashikuara nga ligji, jepen deri në gjysmën e kohës së parashikuar.

- Ligji *“Për ekzekutimin e vendimeve penale”* nënvizon parimin e barazisë dhe të antidiskriminimit për shkak të seksit (etj) për të gjithë personat e gjykuar si dhe ekzekutimin e vendimeve për të miturit dhe gratë në vende dhe mënyra të veçanta e favorizuese.

- *Dhuna në familje dhe mbrojtja e gruas*

Nuk mund të leme pa përmendur në këtë pjesë të analizës edhe legjislacionin për mbrojtjen nga dhuna në familje. Për herë të parë dispozitat kundër dhunës në familje i gjejmë në Kodin e Familjes. Në të vërtetë Kodi mbron nga dhuna bashkëshortore bashkëshortin/en viktimë, duke i bërë në këtë mënyrë një trajtim të kufizuar mbrojtjes së anëtarëve të tjerë të familjes (neni

62)⁸⁵.Rëndësia e kësaj dispozite të Kodit të Familjes qëndron në faktin që përmes saj u vendos një standard i cili u pasua nga një shtjellim i plotë në një ligj të veçantë, Ligji Nr. 9669, dt.18.12.2006“Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”. Qëllimi i ligjit është që të parandalojë dhe reduktojë dhunën në familje në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore, si edhe të garantojë mbrojtjen me masa ligjore të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimat e dhunës në familje, duke i kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara. Dhunën në familje ligji shqiptar e përkufizon si *“çdo veprim ose mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër që sjell si pasojë cënimin e integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social dhe ekonomik, i ushtruar midis personave që janë apo kanë qenë në marrëdhënie familjare”*.

Dhuna nuk është vetëm simptoma e një martese ose bashkëjetese në krizë, por përgjithësisht e një sjelljeje të papranueshme. Reagimet institucionale ndaj situatave të dhunës ndaj fëmijëve në familje ka ndryshuar në mënyrë radikale kryesisht për shkak të ndikimit që buron prej zbatimit konkret të Ligjit Nr. 9669 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”. Pra, siç vihet re, femrat preken në mënyrë të zhdrejtë nga dhuna në familje. Prandaj shpeshherë dhuna në familje shihet si një nga format e dhunës me bazë gjinore, pasi ajo ushtrohet ndaj gruas pikërisht pse është grua. Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” është një ligj me karakter administrative-civil e jo penal. Ai funksionon si një mjet më shumë krahas Kodit Penal. Dy janë autoritete kryesore kundër dhunës në familje: autoritetet administrative dhe ato gjyqësore Ligji parashikon një kuadër të plotë masash mbrojtëse ndaj viktimave të dhunës në familje. Në këtë mënyrë, ky ligj shkon tej masave të parashikuara në Kodin e Familjes, duke ofruar siguri të lartë dhe mbrojtje për fëmijën dhe të afërmit e tij/saj nga

⁸⁵Neni 62 thote konkretisht: *Bashkëshorti ndaj të cilit ushtrohet dhunë, ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës me kërkesë për vendosjen si masë urgjente largimin e bashkëshortit që ushtron dhunë nga banesa bashkëshortore.*

njëra anë dhe rehabilitim të dhunuesit nga ana tjetër. Masat janë të karakterit mbrojtës, rehabilitues të viktimës, si dhe të karakterit ekonomik. Gjykatat lëshojnë, sipas rastit, urdhrin mbrojtës ose urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes.

4.4. Disa strategji kombëtare të rëndësishme në funksion të mbrojtjes dhe fuqizimit të rolit të gruas në shoqëri.

Shqipëria ka ndërmarrë angazhime ligjore të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare për të luftuar diskriminimin dhe për të promovuar e bërë realitet barazinë gjinore. Në këtë kontekst, strukturat qeveritare, në bashkëpunim me shoqërinë civile e organizatat ndërkombëtare, kanë punuar në mënyrë të veçantë në drejtim të përmirësimit të legjislacionit e politikave të ndjeshme gjinore, ngritjes dhe fuqizimit të strukturave në mbështetje të barazisë gjinore dhe për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Qeveritë shqiptare ndër vite, me mbështetjen e disa organizatave ndërkombëtare dhe OJF-ve të ndryshme kanë hartuar disa strategji që janë në funksion të mbrojtjes së të drejtave të grave si:

Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje (2007-2010), e cila përcakton politikat dhe veprimet konkrete të strukturave, përfshi edhe organet e policisë për parandalimin dhe reagimin ndaj dhunës në familje. Hartimi dhe zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Eliminimin e Dhunës në Familje shënoi një hap cilësor në angazhimin e Qeverisë shqiptare për të adresuar çështje që lidheshin me integrimin gjinor në politikat publike dhe me mbrojtjen e vajzave dhe grave nga abuzimi dhe dhuna.

Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore, Reduktimin e Dhunës me Bazë Gjinore e Dhunës në Familje, 2011-2015, e rishikuar, si dhe Plani i Veprimit janë konceptuar mbi analizën dhe trajtimin e dy çështjeve kryesore: Barazia Gjinore dhe Reduktimi i Dhunës me Bazë Gjinore.

Elementë të tjerë po aq të rëndësishëm janë katër qëllimet strategjike: Forcimi i mekanizmit institucional dhe ligjor; Rritja e pjesëmarrjes së grave në vendim-marrje; Fuqizimi ekonomik i vajzave dhe grave; si dhe Zvogëlimi i Dhunës me Bazë Gjinore. Strategjia shoqërohet nga një plan veprimi i mirëpërcaktuar, i shoqëruar edhe me objektiva të matshme e të monitorueshme. Nëpërmjet zbatimit të objektivave të Strategjisë synojmë ngjitjen e shkallëve domethënëse në arritjen e barazisë gjinore në Shqipëri nëpërmjet integritit të perspektivës gjinore në të gjitha aspektet e hartimit dhe zbatimit të politikave. Kjo do të thotë pjesëmarrje e barabartë e grave dhe vajzave, burrave dhe djemve në jetën sociale, ekonomike e politike të vendit, si dhe mundësi të barabarta për të gëzuar të gjitha të drejtat e tyre dhe për të vënë në shërbim potencialet e tyre individuale në dobi të shoqërisë.

Strategjia e Shërbimeve Shoqërore 2005-2010 e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta – Drejtoria e Shërbimeve Sociale i miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, nr. 265, datë 28.4.2005, po ashtu ka rëndësi të veçantë. Në kuadër të kësaj strategjie janë evidentuar grupe kryesore të 50 individëve që kanë nevojë për mbështetje dhe shërbime sociale. Një prej tyre janë gratë ku, përveç grupeve të tjera, përfshihen: gratë e dhunuara (viktima të dhunës në familje) dhe gratë e divorcuara. Le të shohim shkurtimisht këtu këto Strategji dhe të analizojmë rëndësinë e tyre.

Strategjia Kombëtare për Zhvillimin Social dhe Ekonomi.

Kjo strategji synon zbatimin e politikave sociale zbutëse të varfërisë. Ajo ve theksin tek sigurimi i shërbimeve të veçanta që do t'u ofrohen kategorive të prekshme të popullsisë (fëmijëve, të

rinjve, grave, të moshuarve) për t'iu përgjigjur nevojave të tyre. Strategjia nuk përmend në mënyrë të veçantë dhunën në familje dhe nuk parashikon politika mbrojtëse, por i shërben vetem parandalimit të saj.

Strategjia e Punësimit dhe e Formimit Profesional

Në kuadrin e kësaj strategjie parashikohet të aplikohen programe për gratë e papuna dhe me probleme të thella sociale, duke i shërbyer kështu parandalimit të fenomenit të dhunës në familje.

Strategjia Kombëtare Shqiptare për Luftën kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore

Kuadri Strategjik dhe Plani Kombëtar i Veprimit 2008-2010.

Planet e kësaj strategjie kanë mbuluar shtyllat: ndjekje penale, parandalim, mbrojtje dhe koordinim. Kjo strategji u rishikua dhe rinovua më 23 Korrik 2008.

Strategjia kombëtare për barazinë gjinore dhe reduktimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje (2011-2015)

Strategjia kombëtare për barazinë gjinore dhe reduktimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje është miratuar me VKM Nr.573, datë 16/06/2011

Vizioni i mishëruar në këtë Strategji është krijimi i “një shoqërie në të cilën barazia gjinore respektohet, vlerësohet, mësohet, mbështetet dhe nxitet; ku dhuna me bazë gjinore e çdo lloj forme nuk tolerohet, por dënohet; ku të prekurit prej saj përkrahen dhe mbrohen dhe ku barazia në mundësi dhe trajtim është realitet për të gjithë, pavarësisht përkatësisë gjinore”.

4.5. Analizë e lirive dhe të drejtave vetjake të gruas si pjesë e të drejtave themelore të individit

Liritë dhe të drejtat vetjake të njohura nën kontekstin e të drejtave të njeriut përfshijnë një gamë të gjerë të drejtash. Trajtimi i tyre në tërësi është një fokus tepër i gjerë ndaj në vazhdim do të trajtojmë vetëm disa prej tyre.

4.5.1. E drejta e pronës private

E drejta e pronës është një e drejtë themelore dhe shumë e rëndësishme në një shtet demokratik. E drejta e pronës parashikohet shprehimisht në disa instrumente ligjore me karakter ndërkombëtar dhe rajonal. Sa i takon kësaj të drejte dispozitat ligjore në fuqi nuk bëjnë në drejtim të pronës asnjë trajtim të diferencuar. E drejta e pronës si një nga të drejtat themelore, është në çdo moment një diskutim me vlerë dhe i pashkëputur nga të drejtat e tjera të çdo individi dhe shoqërie si për burrat ashtu edhe për gratë. Kodi Civil i R.Sh, Ligji nr.9235\29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” dhe Ligji i fundit i miratuar nr. 133/2015 « *Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave* » trajtojnë në mënyrë të barabartë të gjithë subjektet e së drejtës. E drejta e pronës private garantohej nga neni 41 i Kushtetutës, duke përcaktuar gjithashtu edhe mënyrat e fitimit të pronës (dhurata, trashëgimia, blerja e pronave e të tjera, siç parashikohet në Kodin Civil). Ky parim trajtohet edhe në nenin 153 të Kodit Civil, i cili parandalon humbjen e plotë ose të pjesshme të pronësisë së fituar ligjërisht (përveç rasteve të nevojave publike, shpronësimeve). Kodi Civil parashikon humbjen e pronësisë (neni 191) kur ajo fitohet nga një person tjetër ose kur hiqet dorë nga pronësia (në këtë rast është i nevojshëm akti noterial). Për më tepër, pasuritë e paluajtshme duhet të regjistrohen në përputhje me nenin 192 të Kodit Civil. Çdo bashkëpronar ka të drejta dhe detyrime që rrjedhin prej pronës, por ata nuk mund të shesin pjesën e tyre pa u dhënë më parë mundësinë pronarëve të tjerë për ta blerë atë.

4.5.2. Mbrojtja e të dhënave personale si një e drejtë e njohur nga Kushtetuta

Mbrojtja e të dhënave personale është objekt i një ligji të veçantë. Me “të dhënë personale” do të kuptohet çdo e dhënë për një individ të identifikuar ose të identifikueshëm nga kjo e dhënë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. Ligji bën fjalë edhe për të dhëna personale “sensitive”, të tilla si origjina racore dhe etnike, bindjet dhe përkatësitë politike, bindjet fetare dhe të tjera, gjendja shëndetësore, jeta seksuale dhe gjendja penale. Trajtimi i të dhënave në fushën mjekësore paraqet një nga momentet më delikate dhe ku rreziku për të drejtat dhe liritë themelore të subjektit të të dhënave është më i madh, duke qenë se objekt i trajtimit janë informacione që lidhen me sferën më intime të një personi, siç janë të dhënat për gjendjen shëndetësore dhe sjelljen seksuale. Ajo që e lidh të sëmurin me mjekun është fakti që mjeku, për shkak të ushtrimit të detyrave të tij, vjen në dijeni të të dhënave që lidhen me gjendjen shëndetësore të të sëmurit. Për të rregulluar pikërisht këtë moment, në bazë të ligjit Nr.8615, datë 1.6.2000 “Për urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë”, është miratuar “Kodi i Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore”. “Kodi i Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore”, në kreun 2 të tij, me titull “Detyrat e mjekut ndaj të sëmurit”, në nenin 21 përcakton detyrimin që ka mjeku në shpërndarjen e informacioneve që lidhen me gjendjen shëndetësore të të sëmurit.

Ruajtja e sekretit. Të dhënat që mjeku mëson gjatë kryerjes së detyrës konsiderohen si të fshehta mjekësore. Me dëshirën e të sëmurit mjeku është i detyruar të mbajë të fshehtë edhe ndaj familjarëve e personave të tjerë, madje edhe pas vdekjes së të sëmurit, me përjashtim të rasteve kur ajo përbën rrezik për shëndetin dhe jetën e të tjerëve. Duke parë karakterin ngushtësisht personal të këtyre të dhënave, nga zbulimi i tyre përjashtohen edhe personat e afërt të familjes. Ka vetëm një përjashtim nga ky detyrim dhe ai lidhet me një interes të përgjithshëm,

siç mund të jetë vënia në rrezik e jetës së personave të tjerë. Të shkuarit përtej një interesi personal kur ky mund të cenojë interesin e përgjithshëm nuk përbën cenim të jetës private.

Zbulimi i sekretit. Mjeku ka të drejtë të zbulojë të fshehtat mjekësore të të sëmurit në rastet kur fshehja e tyre rrezikon jetën e të sëmurit ose kur kërkohet nga një organ i njohur me ligj. Kur mjeku i përdor të dhënat mjekësore të një të sëmuri për t'i publikuar ato ai është i detyruar që identiteti i të sëmurit të mos zbulohet.

4.5.3. E drejta e informimit

E renditur ndër të drejtat kushtetuese, e drejta për informim është rregulluar në një sërë ligjesh. Ligji më i rëndësishëm lidhur me këtë të drejtë është ai Nr. 119/2014 Për të drejtën e informimit. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet (neni 3). Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit (neni 4). Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” është përgatitur programi i transparencës për Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së autoritetit në kuadër të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”⁸⁶. Edhe në këtë ligj është pasqyruar plotësisht parimi i barazisë lidhur me të drejtën për informim. Ndërsa Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale monitoron zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit, duke nxitur parimin e

⁸⁶<http://www.idp.al/index.php/sq/>

transparencës në punën e autoriteteve publike, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për çështje të së drejtës së informimit. Komisioneri bën rekomandime për autoritetet publike, lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparencës⁸⁷.

4.6. Analizë të drejtave dhe e lirive politike. E drejta aktive dhe pasive e votimit dhe e drejta e organizimit kolektivisht

E drejta aktive dhe pasive e votimit (e drejta për të zgjedhur e për tu zgjedhur). Këto janë të drejta të garantuara nga Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor për të gjithë shtetasit shqiptar pa dallime gjinore. Kodi zgjedhor shqiptar garanton se çdo shtetas shqiptar, pa dallim race, etnie, gjinie, gjuhe, bindjeje politike, besimi ose gjendjeje ekonomike, ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë Kod. Neni 3\2 i Kodit Zgjedhor përcakton qartë se zgjedhësit janë të barabartë në ushtrimin e të drejtës për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur. Vendi ynë ka ratifikuar një sërë instrumentesh që garantojnë të drejtat politike të grave. Por pavarësisht këtij legjislacioni me frymë të fortë anti diskriminuese dhe instrumenteve ndërkombëtarë, konstatohet lehtësisht se pjesëmarrja e gruas në jetën publike është shumë e kufizuar (Përfaqësimi dhe cilësia e demokracisë në Shqipëri, një perspektive gjinore, 2006:14).

E drejta e organizimit kolektiv. Kjo e drejtë është gjithashtu një e drejtë kushtetuese e cila rregullohet edhe nga legjislacioni në fuqi. Gratë kanë luajtur një rol aktiv në këtë drejtim përmes krijimit të një sërë OJF-ve, të cilat në pjesën më të madhe të tyre ofrojnë shërbime ndaj kategorive më në nevojë në shoqëri.

⁸⁷<http://www.idp.al/index.php/sq/programi-i-transparences/programi-i-transparences-kdimdp>

4.7. Liritë dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore

Në kuadër të grupit për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore bëjnë pjesë e drejta në sigurimin social, e drejta në punë, në mbrojtje nga papunësia dhe e drejta në pagë të njëjtë për punë të njëjtë, e drejta në standard të jetesës, i cili siguron shëndetin dhe mirëqenien e secilit dhe të familjes dhe e drejta në sigurim në rast të papunësisë, sëmundjes, paaftësisë, pleqërisë, e drejta në shkollim dhe e drejta për të marrë pjesë në jetën kulturore të komunitetit.

4.7.1.E drejta për punë dhe punësim

Siç u theksua edhe më sipër ndalimi i diskriminimit qëndron si një e drejtë themelore edhe në marrëdhëniet e punës dhe në punësim. Kodi i Punës ndalon çdo lloj diskriminimi në fushën e marrjes në punë dhe të profesionit dhe jep qartësisht kuptimin e diskriminimit duke renditur ndër të tjera si të tilla dallimin, përjashtimin ose parapëlqimin për shkak të seksit që cenon të drejtën e individit për të qenë i barabartë në punësim dhe trajtim, si dhe përcakton rastet kur këto dallime, përjashtime ose parapëlqime nuk duhet të konsiderohen si diskriminim. Në Kodin e Punës gjejmë të pasqyruara parime të rëndësishme të barazisë në marrëdhëniet e punës dhe të punësimit. Si të tillë përmendim: barazinë në shpërblim (neni 115 parashikon të njëjtën pagë si për gratë edhe për burrat që kryejnë punë me vlerë të barabartë), çka e bën legjislacionin tonë në harmoni me standardet ndërkombëtare dhe Konventat e ONP në këtë fushë; ndalimin e punës së detyruar për të gjithë pa përjashtim; mbrojtjen dhe parandalimin e cenimit të personalitetit e dinjitetit të punëmarrësit si një detyrim të punëdhënësit, përfshi këtu edhe ngacmimin seksual; mosmbledhjen e informatave (neni 33) nga punëdhënësi lidhur me punëmarrësit gjatë marrëdhënieve të punës (përveç rasteve kur këto informata lidhen me aftësitë profesionale të

punëmarrësve ose janë të nevojshme për zbatimin e kontratës). Kjo nënkupton mosmarrjen e informatave të tilla që kanë të bëjnë me orientimin seksual, statusin martesor dhe familjar, etj. lirinë sindikale; regjistrimin e punëmarrësit në sigurimet shoqërore; të drejtën për trajnim dhe kualifikim⁸⁸.

Po ashtu edhe Ligji nr. 152, datë 30.5.2013 Për nëpunësin civil - ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014 sanksionon në nenin 5, por edhe në nene të tjera parimin e barazisë. Sipas këtij parimi Administrimi i shërbimit civil udhëhiqet nga ligji dhe bazohet në parimin e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, si dhe garanton qëndrueshmërinë në detyrë të nëpunësit civil dhe vazhdimësinë e shërbimit civil.`` Ky ligj përcakton rregulla të njëjta për kushtet dhe procedurat e pranimit në shërbimin civil, për mënyrën e fillimit dhe mbarimit të marrëdhënieve të punës, për zhvillimin e karrierës, për garantimin e të drejtave dhe përcaktimin e detyrimeve të nëpunësve civilë, me synim krijimin e një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional dhe efikas. Nëpunës civilë janë të gjithë nëpunësit e institucioneve të administratës publike të nivelit qendror apo vendor, të cilët ushtrojnë autoritetin publik në detyra të natyrës drejtuese, organizuese, mbikëqyrëse apo ekzekutuese. Shërbimi civil është i ndërtuar dhe vepron mbi bazën e parimeve të

⁸⁸Kodi i Punës përfshin në përmbajtjen e vet një kre të rëndësishëm (10/B), të titulluar “Mbrotje e veçantë për gratë”, në të cilin gjenden rregullime ligjore të cilat mbajnë në konsideratë rolin e veçantë të gruas-nënë në shoqëri. Vlen të përmendim: ndalimin e punës për gratë shtatzëna dhe nënat e reja (neni 104), lejen e lindjes (neni 105 i Kodit të Punës dhe ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore”, ndryshuar), Lejen e birësimit (neni 106 i Kodit të Punës shih edhe ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore”, ndryshuar), pavlefshmërinë e zgjidhjes së kontratës së punës nga punëdhënësi në periudhën e lejes së lindjes ose të lejes së birësimit (neni 107), ndalimin e punës së natës për gratë shtatzëna (neni 108). Fryma afirmative vihet re edhe në pjesë të tjera të Kodit të Punës. Kështu, në kushtet e punës përfshihet: e drejta për pushim të paguar prej 20 minuta në çdo 3 orë për gratë shtatzëna, ndalimi i mbajtjes së peshave mbi 20 kg për gratë. Lidhur me punët e vështira, Këshilli i Ministrave vendos rregulla të veçanta për kohëzgjatjen dhe kushtet e kryerjes së punëve të vështira ose të rrezikshme për të miturit mbi 16 vjeç dhe për gratë shtatzëna. Ndalohet puna e natës për gratë shtatzëna por edhe në rastet e tjera Këshilli i Ministrave vendos rregulla të veçanta për rastet kur lejohet puna e natës për gratë. E drejta e pushimit të paguar (12 deri 15 ditë në vit) në rast përkujdesjesh të domosdoshme për fëmijët nëngarkim, si një e drejtë pa diskriminim e nënës dhe atit të fëmijës (neni 132).

profesionalizmit, të pavarësisë dhe integritetit, të paanësisë politike, të transparencës, të shërbimit ndaj publikut, të vazhdimësisë së karrierës, të përgjegjësisë dhe korrektësisë në zbatimin e legjislacionit në fuqi. Ligji nuk përmban dispozita diskriminuese lidhur me kërkesat për pranimin në shërbimin civil dhe mënyra e pranimit në të bëhet nëpërmjet konkurrimit të hapur, bazuar në merita. Disa nga të drejtat e nëpunësit civil janë: Puna e garantuar në shërbimin civil, në përputhje me dispozitat ligjore, ngritja në detyrë dhe lëvizja në mënyrë paralele, në përputhje me ligjin, mbrojtja nga shteti, e drejta për të punuar jashtë detyrës dhe kohës së punës, në qoftë se një gjë e tillë nuk paraqet konflikt interesash me detyrën e tyre zyrtare dhe nuk i pengon ata në ushtrimin e saj, liria sindikale e rregulluar me ligj të veçantë (Gerxhi 2009:27-38).

4.7.2. E drejta për kujdes shëndetësor dhe mbrojtja e shëndetit të gruas

Në këtë kuadër hyjnë një numër i madh ligjesh, të cilat kanë për synim respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave shoqërore dhe të shëndetit të gruas. Si të tillë përmendim Ligjin nr. 8876 datë 4.04. 2002 “Mbi shëndetin riprodhues”, Ligjin nr. 8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatzënisë”, Ligjin nr. 7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në R.Sh”, Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore”, Ligjin nr. 8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatzënisë”. Në këto ligje garantohet respektimi i çdo qenieje njerëzore që në fillim të jetës, të drejtën e informimit dhe këshillimit të gruas përpara ndërprerjes së shtatzënisë, rregullat dhe procedurat mbi ndërprerjen e shtatzënisë dhe sigurimin e shërbimit shëndetësor për ndërprerjen e shtatzënisë dhe trajtimin e ndërlikimeve të mundshme pas ndërprerjes së shtatzënisë. Ndërprerja e shtatzënisë lejohet vetëm kur vërtetohen rrethana të padëshiruara në këtë ligj dhe në çdo rast me pëlqimin e gruas. Ligji ia jep të drejtën në këtë rast vetëm gruas si subjekti kryesor dhe i vetëm në dhënien e pëlqimit për ndërprerjen e shtatzënisë.

Ndersa Ligji nr. 8876, datë 04.04.2002 “Për shëndetin riprodhues”, mbron të drejtat riprodhuese të çdo individi e të çiftit dhe siguron që të drejtat riprodhuese të çdo individi të mbrohen në përputhje me ligjet dhe politikat kombëtare dhe standardet ndërkombëtare. Ligji i drejtohet shpesh herë në mënyrë të posaçme gruas si një subjekt i veçantë në këtë kontekst. Kështu, çdo grua, e lirë dhe e përjashtuar nga çdo formë diskriminimi, detyrimi dhe dhune, ka të drejtë për t’u kontrolluar e për të vendosur lirisht për të gjitha çështjet që lidhen me seksualitetin e saj dhe shëndetin seksual e riprodhues. Ligji nënvizon parimin e barazisë ndërmjet burrave dhe grave. Në të nënvizohet respektimi reciprok i marrëdhënieve të barabarta nga ana e grave dhe burrave gjatë lidhjeve seksuale dhe riprodhimit. Kjo nënkupton respektin, moscenimin e integritetit të secilit, garantimin e çdo individi në vendimmarrjen për ushtrimin e të drejtave riprodhuese sipas dëshirës dhe interesit të tyre të lirë nga diskriminimi, detyrimi dhe dhuna. Burrat dhe gratë kanë të drejtën për të ruajtur qelizat seksuale. Ligji tregon kujdes të veçantë në mbrojtjen e mëmësisë së sigurt dhe trajton teknikat e riprodhimit mjekësor të asistuar.

Asnjë grua nuk duhet të detyrohet të jetë shtatzënë. Gruaja ka të drejtë për një mëmësi të sigurt dhe për mënjanimin e shtatzënisë së padëshiruar, e cila mund të kërcënojë jetën e saj. Jeta e gruas nuk duhet ekspozuar ndaj rrezikut të lidhur me shtatzëninë, lindjen e pengesa të tjera që lidhen me pabarazinë gjinore. Çdo grua ka të drejtë për mbrojtje shëndetësore gjatë shtatzënisë, për asistencë gjatë lindjes dhe të përfitojë zbatimin e metodave e praktikave që minimizojnë rrezikun për shëndetin e saj ose shëndetin e fetusit, të të porsalindurit dhe fëmijës. Mëmësia dhe fëmija kanë të drejtën për kujdes shëndetësor dhe mbështetje të veçantë. Gratë shtatzëna përfitojnë falas ndjekjen periodike mjekësore të shtatzënisë, të lindjes dhe paslindjes, veçanërisht ekzaminimet e paralindjes dhe të pas lindjes, të detyrueshme. Gratë shtatzëna kanë të drejtë të

kryejnë pa pagesë ekzaminimet e detyrueshme të përshkuara nga mjeku dhe të marrin falas fletoren personale të ndjekjes së shtatzënisë.

4.8.E drejta per martesë dhe familjare

Martesa, si institut i së drejtes, mbështetet në barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve, në ndjenjën e dashurisë, respektit dhe mirëkuptimit reciprok, si baza e unitetit në familje. Marrëdhëniet e shëndosha familjare e martesore janë një kontribut në eliminimin e stereotipave gjinore. Gjithçka fillon në familje dhe transmetohet në shoqëri. Për këtë arsye, me të drejtë, nëse duam të dime sa i respekton parimet e mosdiskriminimit dhe të barazisë gjinore një shoqëri, është shumë efektive që këtë analizë ta realizojmë edhe për familjen. Si martesa ashtu edhe familja si institucione shumë të rëndësishme gëzojnë mbrojtjen e veçantë të shtetit. Parimet e përgjithshme që i përshkruajnë këto institute janë: i) parimi i reciprocitetit i të drejtave dhe detyrimeve ii) parimi i barazisë së drejta dhe detyrimeve iii) vendosja mbi gjithçka e interesave të: fëmijëve, martesës, familjes iv) reciprociteti: në besnikëri, për ndihmë morale, për ndihmë materiale, për bashkëpunim në interes të familjes dhe bashkëjetesës. Kodi i familjes është i ndarë në tri pjesë. Pjesa e parë trajton parime të përgjithshme, pjesa e dytë i dedikohet bashkëshortëve dhe pjesa e tretë i dedikohet fëmijëve. Ky kod rregullon lidhjen e martesës duke parashikuar të njëjtat kushte dhe ndalesa si për gruan dhe burrin, pavlefshmërinë, mbarimin e martesës dhe pasojat e zgjidhjes së saj, të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga martesa, marrëdhëniet personale dhe pasurore të bashkëshortëve, çështje të amësisë dhe atësisë, birësimit, kujdestarisë etj. Kodi i Familjes në të gjithë dimensionin e tij përshkruhet nga parime të tilla si reciprociteti në të drejta dhe detyrime, barazitizmi i bashkëshortëve në raport me njëri tjetrin, fëmijët, martesën e familjen, mosdiskriminimi për shkak të të qenit burrë ose grua.

Barazia midis bashkëshortëve është pranuar si koncept shoqëror dhe si parim i së drejtës familjare vetëm si rezultat i përpjekjeve të mëdha për përparim e zhvillim. Më parë, kjo barazi, jo vetëm nuk gjente sanksionim ligjor, por, në të kundërt, si morali shoqëror, ashtu edhe vetë dispozitat ligjore të kohës përlligjinin mosbarazinë dhe diskriminimin e gruas.

Të drejtat dhe detyrimet ndërmjet bashkëshortëve nuk cenojnë dhe nuk prekin thelbin e të drejtave të tyre njerëzore. Të drejtat dhe detyrimet bashkëshortore kanë rëndësi të veçantë edhe për garantimin e të drejtave që gëzojnë fëmijët e lindur nga kjo martesë.

Në nenin 50 të Kodit të Familjes përcaktohet shprehimisht se “Me martesë, burri dhe gruaja përfitojnë të njëjtat të drejta dhe marrin përsipër të njëjtat detyrime.” Në të gjitha dispozitat ligjore të këtij Kodi, që trajtojnë të drejtat dhe detyrimet bashkëshortore, vërejmë se ato janë trajtuar si të drejta dhe detyrime për secilin bashkëshort, pa bërë dallim midis burrit dhe gruas. Secili prej tyre ka të drejtën dhe detyrimin të shprehë vullnetin e lirë e të plotë në lidhje me çështjet kryesore të jetës martesore, përfshi këtu edhe çështjet e lidhura me fëmijët e lindur nga martesë, të japë ndihmesën për realizimin e bashkëjetesës dhe të familjes, por edhe të ndërmarrë nisma ligjore, për të sprapsur veprimet e bashkëshortit tjetër që pengojnë ushtrimin prej tij të të drejtave dhe detyrimeve martesore. Ndaj disa të drejtave dhe detyrimeve bashkëshortët ruajnë një lloj autonomie, ndërsa disa të tjera nuk lënë mundësi të tillë. Nisur nga rëndësia që ka një e drejtë ose detyrim bashkëshortor varet edhe autonomia e bashkëshortëve. Martesa si raport i bën bashkëshortët titullarë të një statusi që buron nga qenia e tyre burrë e grua. Ky status martesor u jep atyre disa të drejta dhe disa detyrime specifike me karakter personal/jo pasuror, të tilla si: detyrimi dhe e drejta për besnikëri, detyrimi dhe e drejta për ndihmë morale, mbiemri i bashkëshortëve, mbiemri i fëmijëve, detyrimi dhe e drejta për jetë të përbashkët, shtetësia, përfaqësimi si të drejta-detyrime me karakter pasuror/material përmendim: Detyrimet për ndihmë

material, kontributi i bashkëshortëve lidhur me detyrimet që lindin nga martesë - Masa e tyre mund të përcaktohet nga kontrata nëse ka një të tillë, ose - masa e tyre varet nga kushtet dhe aftësitë e bashkëshortëve. Kodi i familjes paraqitet nën një dimension bashkëkohor në drejtim të barazimit, reciprocitetit dhe mos diskriminimit, me qëllim që të mbrohet martesë dhe familja si edhe të drejtat dhe detyrimet e të gjithë anëtarëve të saj. Vini re nenet 52 e 54 të Kodit të Familjes: Kur bashkëshortët nuk merren vesh për mbiemrin e fëmijës, atëherë neni 52 i Kodit të Familjes urdhëron që fëmija do të marrë mbiemrin e atit. Sipas nenit 54 të Kodit të Familjes, bashkëshortët "...do të kontribuojnë për nevojat e familjes në përputhje me kushtet dhe aftësitë e tyre". Kjo do të thotë që nëse nuk i kanë kushtet dhe aftësitë të barabarta kështu do të jetë edhe kontributi i tyre. Nëna e fëmijës së lindur jashtë martese ka të drejtë të kërkojë gjyqësisht njohjen e atësisë së fëmijës edhe kur ajo vete nuk ka mbushur moshën madhore. Duhet nënvizuar se këto kufizime nuk cenojnë thelbin e të drejtës së barazisë midis bashkëshortëve, sepse interesat e martesës, të fëmijëve dhe të familjes janë parësore.

Po ashtu, Kodi i Familjes ka parashikuar (nenet 58 – 64) ndërhyrjet e autoritetit publik (gjykatës) kur njëri bashkëshort nuk dëshiron të plotësojë detyrimet vullnetarisht. Gjykata vihet në lëvizje me kërkesën e bashkëshortit tjetër. Raste të tilla janë: autorizimi prej gjykatës i njërit bashkëshort për të kryer veprime juridike në interes të familjes, në rastet kur bashkëshorti tjetër kundërshton këtë veprim ose nuk është në gjendje ta kryejë atë (neni 58); përfaqësimi i bashkëshortit në rastet kur ai është në pamundësi të shprehë vullnetin e tij prej bashkëshortit tjetër (neni 59). plotësimi nga njëri bashkëshort i nevojave urgjente të familjes, të tilla si mbajtjen e familjes, edukimin e fëmijëve, interesat e familjes dhe zgjidhjen e situatave të tjera me karakter urgjent (neni 60), rastet kur njëri bashkëshort nuk plotëson në mënyrë të dukshme detyrimet e tij dhe vë në rrezik interesat e familjes.

4.9. Mbrojtja e gruas ndaj dhunës në familje

Dhunën në familje ligji shqiptar e përkufizon si “çdo veprim ose mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër që sjell si pasojë cenimin e integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social dhe ekonomik, i ushtruar midis personave që janë apo kanë qenë në marrëdhënie familjare”. Në shumicën e rasteve dhuna drejtohet: ndaj grave brenda çiftit, ndaj fëmijëve nga prindërit, midis vetë fëmijëve, nga fëmijët drejtuar prindërve, ndaj të moshuarve, ndaj personave me paaftësi.

Për herë të parë dispozitat kundër dhunës në familje i gjejmë në Kodin e Familjes. Në të vërtetë Kodi mbron nga dhuna bashkëshortore bashkëshortin/en viktimë, duke i bërë në këtë mënyrë një trajtim të kufizuar mbrojtjes së anëtarëve të tjerë të familjes. Neni 62: Bashkëshorti ndaj të cilit ushtrohet dhunë, ka të drejtë t’i drejtohet gjykatës me kërkesë për vendosjen si masë urgjente largimin e bashkëshortit që ushtron dhunë nga banesa bashkëshortore. Rëndësia e kësaj dispozite të Kodit të Familjes qëndron në faktin që përmes saj u vendos një standard i cili u pasua nga një shtjellim i plotë në një ligj të veçantë, Ligji Nr. 9669\18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”. Qëllimi i ligjit është që të parandalojë dhe reduktojë dhunën në familje në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore, si edhe të garantojë mbrojtjen me masa ligjore të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimat e dhunës në familje, duke i kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuar.

Dhuna nuk është vetëm simptoma e një martese ose bashkëjetese në krizë, por përgjithësisht e një sjelljeje të papranueshme me të cilën duhet të merret ligji. Reagimet institucionale ndaj situatave të dhunës ndaj fëmijëve në familje ka ndryshuar në mënyrë radikale kryesisht për shkak të ndikimit që buron prej zbatimit konkret të Ligjit Nr. 9669 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.

Femrat preken në mënyre të zhdrejtë nga dhuna në familje. Prandaj shpeshherë dhuna në familje shihet si një nga format e dhunës me bazë gjinore, pasi ajo ushtrohet ndaj gruas pikërisht pse është grua. Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” është një ligj me karakter administrative-civil e jo penal. Ai funksionon si një mjet më shumë krahas Kodit Penal. Dy janë autoritete kryesore kundër dhunës në familje: `Autoritetet Administrative dhe Autoritetet Gjyqësore`.

Ligji parashikon një kuadër të plotë masash mbrojtëse ndaj viktimave të dhunës në familje. Në këtë mënyrë, ky ligj shkon tej masave të parashikuara në Kodin e Familjes, duke ofruar siguri të lartë dhe mbrojtje për fëmijën dhe të afërmit e tij/saj nga njëra anë dhe rehabilitim të dhunuesit nga ana tjetër. Masat janë të karakterit mbrojtës, rehabilitues të viktimës, si dhe të karakterit ekonomik. Gjykatat lëshojnë, sipas rastit, urdhrin mbrojtës ose urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes.

4.5. Çështje të (mos)diskriminimit dhe barazisë gjinore në këndvështrim të praktikës sonë gjyqësore dhe jurisprudences kushtetuese

Eshte me interes te shohim ketu, pas analizes se legjislacionit, edhecështje të (mos)diskriminimit dhe barazisë gjinore në këndvështrim të praktikës sonë gjyqësore dhe jurisprudences kushtetuese. Kushtetuta shqiptare është e hapur për zbatimin e traktateve ndërkombëtare, të cilët janë ratifikuar. Gjykata Kushtetuese shqiptare u referohet vazhdimisht konventave ndërkombëtare si KEDNj-ja.

Në një çështje *prone* në Gjykatën e Lartë të Shqipërisë, Gjykata vendosi që titullare e së drejtës së pronësisë së një objekti të dhuruar është vetëm bashkëshortja, e cila përfiton nga një dhurim

edhe kur dhurues është bashkëshorti i saj, duke interpretuar Nenin 87 të Kodit Civil të vitit 1982, i cili lejonte tjetërsimin e pronës së paluajtshme vetëm me miratimin e të dy bashkëshortëve, në dritën e një dispozite më të re, e cila parashikon që objektet e përfuara nga dhurimi gjatë martesës bëhen pjesë e pasurisë personale të bashkëshortit përfitues. Kështu Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendim unifikues nënvizuan⁸⁹:

“Në rastin e një dhurimi të objekteve personale të bashkëshortit dhurues apo të objekteve në bashkëpronësi, objekti/prona e dhuruar do t’i transferohet pronës personale të bashkëshortit përfitues, dhe, në këto rrethana, ky objekt nuk është më pjesë e pronës së përbashkët së bashkëshortëve. Në rast se objekti i kontratës së dhurimit është transferimi i të drejtës së pronësisë, bashkëshorti tjetër përfiton me cilësinë e pronës vetjake të gjithë pronën, e cila është transferuar në pronësinë e këtij të fundit. Titullar i së drejtës së pronësisë së objektit të dhuruar është vetëm bashkëshorti, që përfiton nga dhurimi. Objekti/prona e përfuar nuk është pjesë e bashkëpronësisë martesore, dhe si e tillë, bashkëshorti pronar mund ta tjetërsojë atë tek një subjekt tjetër vetë, duke mos pasur nevojë të marrë miratimin e bashkëshortit tjetër.”

Për më tepër, ideja e *veprimeve pozitive* si edhe *mbrojtja e grupeve të posaçme* është e mirëpritur në juridiksionin shqiptar. Në 18 dhjetor 2006, Kuvendi miratoi Ligjin Nr. 9660 “Për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare”. Që në fazat e para të zbatimit efektiv të ligjit, në gjykatë janë sjellë një numër i madh kërkesash *për urdhra mbrojtës*. Parimi i trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit është një parim kushtetues, i mishëruar në Nenin 18 të Kushtetutës Shqiptare. Në përputhje me juridiksionin e KEDNj-së, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë ka vendosur një praktikë të saj ku shprehet se, “Barazia në ligj dhe përpara ligjit nuk do të thotë se zgjidhje të ngjashme zbatohen për individë apo kategori personash, që ndodhen në kushte objektivisht të

⁸⁹Vendim Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të GjL, Vendimi 3/2006.

ndryshme. Barazia në ligj dhe përpara ligjit nënkupton barazinë e individëve, që janë në kushte të barabarta,” dhe “vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive, mund të përligjen trajtime të ndryshme të kategorive të caktuara, që përfitojnë nga kjo e drejtë”.

Në një rast që trajton pavlefshmërinë e *prishjes së një kontrate pune* dhe detyrimin e punëdhënësit për të paguar kompensime, që arrijnë shumën e pagës së një viti, Gjykata e Lartë e pezulloi çështjen dhe e çoi në Gjykatën Kushtetuese. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë i kërkojnë Gjykatës Kushtetuese të shprehet për mospajtueshmëri me Nenin 18 të Kushtetutës, i cili parashikon parimin e mosdiskriminimit, të disa neneve të Kodit të Punës, duke parashtruar se disa dispozita të Kodit të Punës bien ndesh me parimin e barazisë përpara ligjit sepse lejojnë diskriminimin për shkaqe sociale, krijojnë mundësi që punëdhënësit të fshehin motivin e diskriminimit dhe transferojnë barrën e provës tek punëmarrësit.

Gjykata Kushtetuese vuri në dukje se dispozitat trajtonin çështje të ndryshme. Ngjashmëria/barazia e tyre qëndron vetëm në të drejtat e ngjashme për të arritur një kontratë pune dhe për ta prishur atë për arsye të parashikuara në kontratë dhe në ligj. Nga njëra anë, punëdhënësi, sipas Kodit të Punës, ka disa detyrime për të plotësuar ndërsa respekton një kontratë pune, dhe nga ana tjetër, duhet që punëmarrësi, në të njëjtin kontekst, të plotësojë disa detyrime. (Anastasi, Mandro-Balili, Shkurti, Bozo, 2012:127)

Sipas Nenit 146/2 të Kodit të Punës, është e drejta e punëdhënësit të bëjë padi kundër punëmarrësit në rast se kontrata priset pa shkaqe të arsyeshme, që do të thotë se në pozitën e paditësit, punëdhënësi ka barrën e provës për praninë apo mungesën e shkaqeve të paarsyeshme për prishjen e kontratës së punës.

Gjykata Kushtetuese deklaroi se këto dy subjekte, edhe në kuadër të procedurës civile, janë në pozita të përcaktuara procedurale, njëri në pozitën e paditësit dhe tjetri në atë të të paditurit në

një procedurë gjyqësore, ku njëra palë pretendon diçka, ndërsa pala tjetër mund të kundërshtojë këtë pretendim në përputhje me parimin e kundërshtisë.

Do të ishte diskriminuese një dispozitë që do të bënte dallimin, nga pikëpamja e barrës së provës, midis argumenteve të ndryshëm, si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, besimi politik, statusi ekonomik apo varësia prindërore, duke e trajtuar një grup ndryshe nga një tjetër, por të gjithë brenda kategorisë së punëmarrësit,

Gjykata Kushtetuese iu referua Nenit 14 të KEDNJ-së, sipas të cilit të drejtat dhe liritë e pranuar në këtë Konventë, duhet të sigurohen pa dallime për shkaqe seksi, race, ngjyre, gjuhe, feje, opinionit politik apo ndonjë opinionit tjetër, origjine kombëtare apo sociale, varësie të një pakice kombëtare, pasurie, prone, lindje, apo ndonjë rrethane tjetër, dhe deklaroi se diskriminimi nuk mund të qëndrojë si një motiv në vetvete, por duhet të lidhet ngushtë me disa të drejta të tjera themelore të parashikuara në Kushtetutë.

Ky qëndrim pasqyrohet gjithashtu edhe në praktikën e GjEDNJ-së e cila ka theksuar: “Neni 14 i Konventës plotëson të drejtat e tjera themelore të parashikuara nga kjo Konventë dhe protokollet e saj. Ky nen nuk qëndron më vete meqenëse ai ndikon në ‘gëzimin e të drejtave dhe lirive’ të parashikuara në këto dispozita. Ndonëse zbatimi i Nenit 14 nuk prezumon shkeljen e këtyre dispozitave, nuk ka vend për zbatimin e tij, me përjashtim të rasteve kur faktet e çështjes janë të lidhura me respektimin e të drejtave të tjera të Konventës”.

Neni 146/2 i Kodit të Punës që synon t’u japë punëmarrësve mundësi të gjykojnë elementët diskriminues në gjykatë, me qëllim që të kenë mundësi për të marrë shpërblim për prishjen e një kontrate pa shkaqe të arsyeshme. Por, në të njëjtën kohë, ligjvënësi donte t’i jepte punëmarrësit mundësi për prishjen e kontratës sipas dëshirës së tij, nëpërmes zbatimit të neneve 141, 143, 144 të Kodit të Punës apo, në të kundërtën, punëmarrësi të mund të mbrohet në rast se kontrata

prishet nga punëdhënësi, kur ky i fundit respekton kushtet dhe procedurat e prishjes së kontratës së punës. Mbështetur në të gjitha këto arsye, Gjykata Kushtetuese hodhi poshtë kërkesën e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Me rendesi paraqitet edhe vendimi nr.6042/30.05.2013 të GjRrGj Tiranë, me objekt zgjidhje martesë me pëlqim reciprok, mësohet se kërkuessit88 janë njohur në rrethin etyre shoqëror dhe pas një periudhe të shkurtër kanë vendosur të martohen.Martesa është lidhur në datën 21.01.2013 dhe duket se ka zgjatur *vetëm 4 muaj*.Kërkuessit, pas martesës së tyre, kanë jetuar në banesën e kërkuesses N.B [bashkëshortes], e cila ka shërbyer edhe si banesë bashkëshortore.Martesa që në fillimet e saj duket se paraqitet relativisht e vështirë. Nga vendimi del se çifti ka mosmarrëveshje në lidhje me të konceptuarit e jetës. Palët kërkuessë kishin interesa të ndryshme, dhe kërkuessja N.B kërkonte më shumë hapësirë për t'ju përkushtuar arsimimit dhe profesionit të saj.Kjo dëshirë nuk ka gjetur mbështetjen e bashkëshortit F.B. Kur martesa lidhet, ka shumë rëndësi që çifti të ketë kuptuar rëndësinë që ka respektimi i të drejtave të bashkëshortit/es, qoftë në realizimin e tij/saj në jetën publike, qoftë në atë private. Ky rast i përzgjedhur ndër vendimet gjyqësore, është vërtet interesant sepse, bashkëshorti është gati të qëndrojë në shtëpinë e gruas, është gati edhe të marrë mbiemrin e saj, por ajo që imponohet prej tij dhe që duket prish gjithë mundin për të arritur deri në martesë, është që bashkëshortja duhet të qëndrojë brenda mureve të shtëpisë dhe të privohet nga e drejta e ushtrimit të profesionit dhe arsimimit. Me profesionin janë të lidhura ngushtë të ardhurat.Sipas nenit 63 KF secili nga bashkëshortët mund të ushtrojë lirisht një profesion, të disponojë të ardhurat nga puna dhe të ardhurat e tjera, sipas regjimit pasuror martesor përkatës, pasi të ketë kontribuar në detyrimet që rrjedhin nga martesa.

Vlen te trajtojme ketu edhe vendimin nr. 6042/30.05.2013 të GjRrGj Tiranë, mendojmë për çështjen e mbiemrit të ndryshuar gjatë martesës dhe kujdesit që duhet të tregohet përmes

disponimit të gjykatës lidhur me të pas zgjidhjes së martesës. Nga ky vendim rezulton se bashkëshorti F ka marrë mbiemrin e gruas [bashkëshortes], situatë kjo që nuk është tipike në realitetin shqiptar, dhe, në marrëveshjen e paraqitur përpara gjykatës për zgjidhjen e martesës me pëlqimin reciprok, çifti ka rënë dakord që F të mbajë këtë mbiemër edhe pas zgjidhjes së martesës. Gjykata, siç del nga vendimi, e ka pranuar këtë pa bërë ndonjë vlerësim të interesit të bashkëshortit për të mbajtur këtë mbiemër sipas kërkesave të nenit 146 KF, ndërkohë që, përsërisim, është fjala për një çift që nuk ka fëmijë dhe martesë ka zgjatur vetëm katër muaj. “Gjykata, me kërkesën e bashkëshortit dhe kur është në interes të tij ose të fëmijëve, mund të lejojë që ai të mbajë mbiemrin që ka marrë me lidhjen e martesës.” Lidhur me çështjen e mbiemrit vlen të rikthehemi tek ky vendim e të ndalemi në mënyrë të veçantë sepse çifti duket sikur ka lidhur martesë sa për të ndryshuar mbiemrin e bashkëshortit. Nga faktet e paraqitura, martesë zgjat vetëm 4 muaj. Çifti nuk ka fëmijë. Bashkëshorti del se ka patur konceptime të ndryshme për jetën dhe të drejtat e bashkëshortes, ai është larguar gati menjëherë pas martesë për në Austri, por në marrëveshjen e paraqitur, ai kërkon të mbajë mbiemrin e bashkëshortes dhe kjo e fundit nuk ka kundërshtime. Asnjë analizë nga gjykata lidhur me interesin që ka bashkëshorti për të mbajtur këtë mbiemër. Duke cituar pjesën e vendimit lidhur me mbiemrin kemi: “Në respektim të nenin 146 të Kodit të Familjes, në të cilin parashikohet se: *“Bashkëshorti që me lidhjen e martesës ka ndryshuar mbiemrin e tij, pas zgjidhjes së martesës merr mbiemrin që kapasur para lidhjes së martesës. Gjykata me kërkesën e bashkëshortit dhe kur është në interes të tij ose të fëmijëve, mund të lejojë që ai të mbajë mbiemrin që ka marrë me lidhjen e martesës”* nisur edhe nga parashikimi në Projekt-marrëveshje në mënyrë të shprehur të vullnetit të kërkuësve, ashtu edhe gjatë gjykimit, ku kërkuësja N.B, mbiemri i së cilës ishte vendosur si mbiemër i përbashkët, ka dhënë pëlqimin e saj dhe ka qenë dakord që kërkuësi F.B pas zgjidhjes

së martesës, të mbajë mbiemrin e marrë pas lidhjes së martesës, “B”,

Gjykata çmon se kjo kërkesë është e mbështetur në ligj. Nëse lexojmë dispozitat e LGJC 2009 [ndryshuar] lidhur me ndryshimin e emrit dhe mbiemrit mund të konkludojmë që është shumë më e thjeshtë që të lidhesh e zgjidhesh një martesë e të marrësh mbiemër të ri se sa të bësh procedurën e ndryshimit të tyre. Kjo mundet të shndërrohet në abuzivitet për të fshehur të dhëna që lidhen me identitetin.

Me vlerë në këtë studim ka edhe Vendimi nr. 71 datë 27.11.2015 e Gjykatës Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën i paragrafit të parë të nenit 113 të Kodit Penal. Vlerësohet se paragrafi i parë i nenit 113 të KP-së është në kundërshtim me nenin 18 dhe 17 të Kushtetutës, si dhe me nenin 6 të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW). Në mënyrë të përmblodhur gjykata referuese ka pretenduar shkelje të: Parimit të mosdiskriminimit, pasi edhe pse dispozita nuk e ndan dënimin për ushtrim prostitucioni në subjekte të seksit mashkull apo femër, në praktikë dhe nga statistikat, rezultojnë shumica e subjekteve që ushtrojnë prostitucion janë femra. Prandaj, kjo dispozitë rëndon dhe diskriminon femrat në raport me meshkujt. Dispozita nuk duhet të synojë dënimin e ushtrimit të prostitucionit, por trafikimin dhe shfrytëzimin për prostitucion të vajzave dhe grave, pasi këto të fundit në shumicën e rasteve janë viktimat dhe jo fajtores.

Gjykata vlerësoi se neni 113 i KP-së nuk përmban diferencim në përcaktimin ligjor, pasi dënon autorët e prostitucionit, që mund të jenë femra ose meshkuj. Për më tepër, dispozita dënon subjektet, kategorinë e meshkujve/femrave që ushtrojnë prostitucion me vullnet të lirë. Ndërkohë, pala e interesuar, QNLQ-ja, kërkon të mbrojtë kategorinë e vajzave dhe të grave që ushtrojnë prostitucion nën kushtet e dhunës dhe të kanosjes. Në fakt, kjo kategori, pra, viktimat, mbrohet sipas nenit 114 të KP-së, i cili parashikon se shtytja, ndërmjetësimi ose marrja

shpërblim për ushtrimin e prostitucionit, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet. Po e njëjta dispozitë, shkronja “a”, parashikon “shfrytëzimin e prostitucionit në rrethana rënduese” dhe dënimin nga 7 deri 15 vjet, si dhe konfiskimin e mjeteve dhe të përfitimeve, kurse shkronja “b” parashikon “trafikimin e femrave” dhe dënimin e autorëve për këtë vepër penale. Për rrjedhojë, është kjo dispozitë me përcaktimet përkatëse që mbron vajzat dhe gratë e shfrytëzuara e të dhunuara, si dhe dënon shfrytëzuesit dhe trafikuesit e prostitucionit. Gjykata Kushtetuese gjithsesi vendosi rrëzimin e kërkesës.

KAPITULLI V Analizë krahasimore e situates aktuale te barazise gjinore dhe mosdiskriminimit në Shqipëri me disa vende europiane.

5.1. Hyrje

Miratimi i legjislacionit antidiskriminim dhe ratifikimi i konventave ndërkombëtare që nënvizojnë parimet dhe standardet e barazisë dhe mosdiskriminimit është vetëm fillimi i përpjekjeve për të njohur të drejtat e grave dhe zbatimimi i praktikave të drejta edhe në Shqipëri. Shqipëria ka ratifikuar protokollin nr. 12 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore duke ofruar kështu për shtetasit e vet një ndalim të përgjithshëm të “diskriminimit” bazuar në gjini, racë, besim fetar, përkatësi etnike, gjuhësore, politike, fetare apo të llojit si besimet filozofike, situatat ekonomike, arsimimi, statusi social, origjina”. Shqipëria ka ratifikuar KEFDG në 1994 pa rezerva. Komiteti gjithashtu mirëpriti krijimin e shpejtë të një mekanizmi për përparimin e grave dhe të drejtave gjinore dhe krijimin e Institucionit të Avokatit të Popullit, i cili mund të hetojë pretendime të dhunimit të të drejtave të qenieve njerëzore, duke përfshirë edhe të drejtat e grave dhe për të bërë rekomandime për kompensimin e dëmshpërblimin për rastet e dhunës. Nga ana tjetër, në kuadër të procesit të integrimit të Shqipërisë në BE, Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA) e nënshkruar në vitin 2007 solli një sërë angazhimesh, si dhe realizimin e tyre brenda afateve të përcaktuara. Ky dokument është një instrument i procesit të stabilizim asociimit, me anë të së cilit synohet t’iofrohet mbështetje e mëtejshme qeverisë shqiptare për realizimin e integrimit evropian. Zbatimimi i Partneritetit Evropian me Shqipërinë monitorohet në kuadër të procesit të stabilizim asociimit dhe mekanizmave të tij. Në mënyrë specifike, Komisioni prezanton raportin vjetor, i quajtur Raporti i Progresit për Shqipërinë. Qëllimi i Raportit të Progresit është të monitorojë, vlerësojë e raportojë arritjet e vendit kandidat ose kandidat i mundshëm gjatë vitit, në këtë rast të Shqipërisë. Në Raportin e Progresit i jepet rëndësi e veçantë barazisë gjinore, duke nënvizuar arritjet dhe mangësitë në këtë fushë. (Picari, 2008:48).

Objektivi kryesor i qeverive shqiptare për arritjen e barazisë gjinore është *“harmonizimi në mënyrë progresive i legjislacionit shqiptar me atë të Komunitetit në fushën e kushteve të punës, veçanërisht të shëndetit dhe sigurisë në punë, mundësive të barabarta dhe bashkëpunimit për lehtësimin e politikave shqiptare të punësimit, në kuadër të forcimit të reformave ekonomike*

dhe të procesit të integritit, duke synuar mbështetjen e përshtatjes së sistemit shqiptar të sigurimeve shoqërore me kërkesat e reja ekonomike dhe sociale, si dhe përfshirjen e përshtatjen e legjislacionit shqiptar për sa i përket kushteve të punës dhe mundësive të barabarta për gratë. (Neni 77 dhe 99 i MSA-së)”.

Keto objektiva janë vendosur edhe në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2014 – 2020 e miratuar në vitin 2014 (Picari, 2008:49) si dhe në Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së 2007- 2012 dhe në atë vijues 2014-2020.

Shqipëria i është bashkangjitur sfidës globale për të luftuar kundër diskriminimit për shkak të orientimit seksual. Zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, Reduktimin e Dhunës me Bazë Gjinore e Dhunës në Familje, 2011-2015, e rishikuar si dhe Plani i Veprimit për zbatimin e saj, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 573, datë 16.6.2011 nëpërmjet 4 objektivave strategjike:

1. Forcimi i Mekanizmit Institucional dhe Ligjor për Barazinë Gjinore;
2. Rritja e Pjesëmarrjes së Grave në Vendim-marrje;
3. Fuqizimi Ekonomik i Vajzave dhe Grave;
4. Zvogëlimi i Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunës në Familje.

Pavarësisht mungesës së të dhënave të konsoliduara mbi diskriminimin në Shqipëri, është e qartë se diskriminimi është i përhapur në të gjitha fushat e jetës shoqërore. Bazat e argumentuara të diskriminimit kanë qenë kryesisht: raca, statusi shëndetësor, aftësitë e kufizuara dhe besimet politike). Gjithsesi kohët e fundit ka një ndërgjegjësim më të madh të publikut të gjerë dhe grupeve të veçanta mbi mjetet juridike për mbrojtjen nga diskriminimi. Kjo vërtetohet nga rritja e numrit të ankesave të regjistruara në KMD, dhe nga zbatimi i Ligjit "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" në gjykata. Efektivisht janë bërë disa ndryshime legjislative në Kodin Penal, dhe me gjere⁹⁰ por mbetet ende një domosdoshmëri për të rishikuar legjislacionin ekzistues dhe masat e duhura për të siguruar respektimin e të drejtave të individëve që mund të jenë viktimë të sjelljeve diskriminuese si romët dhe egjiptianët (rishikimi i kriterëve për ndihmë ekonomike, për

⁹⁰Një nga zhvillimet më të rëndësishme në fushën e të drejtave të fëmijëve është plotësimi i kuadrit ligjor me Ligjin Nr. 10347 datë 04.11.2010, "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve" si dhe aktet nënligjore që dolën në bazë dhe për zbatim të tij. Ligji përcakton të drejtat e fëmijëve në koherencë me Konventën e OKB për të Drejtat e Fëmijës si dhe mekanizmat zbatues e monitorues. Ligji përcakton në mënyrë të qartë përgjegjësitë e pushtetit qendror e vendor, ngritjen e mekanizmave institucionalë përgjegjës, dhe synon të përçojë frymën e bashkëpunimit ndërmjet të gjithë aktorëve në nivel qendror dhe vendor për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

tu regjistruar apo për të përfituar strehim social), gratë, fëmijët, personat me aftësi të kufizuara⁹¹. Te gjithë aktoret e perfshire e kanë për qëllim të luftojnë diskriminimin gjinor, dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje, në bashkëpunim të ngushtë me shoqërinë civile dhe organizata ndërkombëtare. Në këtë kontekst është duke u punuar për harmonizimin e legjislacionit me instrumente ndërkombëtare, për zbatimin e strategjisë kombëtare “Për barazinë gjinore, reduktimin e dhunës në baza gjinore dhe dhunën në familje 2011-2015”, ngritjen dhe forcimin e strukturave shtetërore në mbështetje të barazisë gjinore, kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi këto çështje. Megjithatë, deri më tani mungesa e mekanizmave konkretë për zbatimin e ligjeve ekzistuese në mënyrë efikase ka rezultuar në pabarazi të theksuar gjinore, e cila ndihmon në mënyrë të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procesit të zhvillimit ekonomik, demokratizimit dhe stabilitetit politik të vendit.

5.2. Arritjet kryesore në legjislacion

Ligji shqiptar për mbrojtjen nga diskriminimi është plotësisht në përputhje me katër direktiva të BE⁹². Mbetet një prioritet përafrimi i legjislacionit të brendshëm shqiptar me ligjin anti-diskriminim, ashtu siç parashikohet në kompetencat e KMD që të bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri ose ndryshimin e legjislacionit ekzistues (neni 32, paragrafi 1/ë). Në fushën e punësimit, prioritetet kryesore janë: Modernizimi i SHKP (Shërbimi Kombëtar i Punësimit) dhe shërbimeve të ofruara nga zyrat e tyre, si dhe mbështetjen e programeve aktive të punës. Në fushën e arsimit dhe formimit profesional: reforma e sistemit të AFP-së në miratimin me nevojat e tregut të punës. Përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit me BE-në dhe zbatimin e tij të plotë, sidomos çështjet e punësimit të të huajve, mbuluar nga MMSR.

Miratimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë krijoi më shumë mundësi në edukim, punësim, kulturë dhe rritjen e pjesëmarrjessë të rinjve në shoqëri dhe vendimarrje si dhe krijimin e qendrave rinore. ISSH është e angazhuar plotësisht në procesin e reformimit të sistemit,

⁹¹Programi i mbrojtjes sociale përfshin, skemën e ndihmës ekonomike, skemën e mbështetjes me pagesa për personat me aftësi të kufizuara dhe skemën e shërbimeve të përkujdesit shoqëror për individët në nevojë (fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, gratë, të moshuarit).

⁹²Direktiva 2006/54/EC, Direktiva 2002/73/EC, Direktiva 86/378/EEC, Direktiva 92/85 EEC. Legjislacion është konform edhe Rregullores 883/2004/KE, Rekomandimit të Këshillit 96/694/EC, Rekomandimit Nr. (2002)5 të Komitetit të Ministrave.

përgatitjen dhe hartimin e reformës, ndryshimin legjislativ dhe dhënien e ekspertizës për realizimin e projekteve për projekt procedurat. Sa i përket shëndetit dhe sigurisë në punë, përpjekje të mëtejshme nevojiten për të përmirësuar kushtet e shëndetit dhe sigurisë në punë. Shqipëria është e inkurajuar për të marrë hapat e nevojshëm për të përmirësuar raportimin dhe administrimin e të dhënave për aksidentet në punë dhe krijimin e një sistemi të duhur dhe efektiv të mbledhjes së të dhënave për aksidentet në punë dhe sëmundje profesionale, duke përfshirë futjen e deklaramit të detyrueshëm të aksidenteve në punë të sigurimet shoqërore, si dhe përfshirje më të fortë të inspektorëve të punës në hetimin e aksidenteve në punë. Shqipëria është e inkurajuar gjithashtu që të përqendroje përpjekjet në zhvillimin e kapaciteteve për implementimin e Direktivave themelore të BE-së në fushën e shëndetit dhe sigurisë ndërsa vazhdon punën me transpozimin e *acquis* në këtë fushë. Riorganizimi i kapaciteteve administrative duhet të monitorohet me kujdes. Fokusi kryesor i Qeverisë në fushën e sigurimeve shoqërore, për periudhën afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë është drejtuar në përmirësimin e skemave aktuale nëpërmjet reformimit të shtyllës publike të pensioneve. Reforma sistematike do konsistojë në rritjen e qëndrueshmërisë financiare të skemës, forcimin e lidhjes midis kontributeve të paguara dhe përfitimeve të ardhshme, krijimin e llogarive personale të çdokontribuuesi dhe përfituesi për arritjen e transparencës maksimale, duke përgatitur skemën dhe sistemin për integrimin në Bashkimin Evropian. Një tjetër prioritet do të jetë forcimi i sistemit aktual të mbrojtjes së fëmijëve, prioritet i cili do të synohet të arrihet përmes vendosjes së mekanizmave të rregullt të kontrollit të NJMF; përcaktimit të standardeve dhe një metodologjie monitoruese për shërbimet e ofruara nga NJMF-të ; sigurimit të alokimit të buxheteve të nevojshme për funksionimin e NJMF; fuqizimit dhe ngritjes së kapaciteteve të punonjësve për mbrojtjen e fëmijës; miratimin e rregullores për funksionimin e grupeve multidisiplinare në nivel lokal që merren me çështjet e fëmijëve Po punohet për përgatitjen e Protokollit të ri të Punës së Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijës në bashki/komunë, i cili do të shërbejë si një Udhëzues Metodologjik, ku do të specifikohen në detaje mënyra e ndjekjes së procedurave për menaxhimin e fëmijës në rrezik, duke unifikuar kështu mënyrën e punës së të gjithë NJMF në vend. Hartimi dhe Zbatimi i Planit të Ndërhyrjes në kuadër të Nismës “Ndihmë për Fëmijët dhe Familjet në Situatë rruge” si dhe Udhëzuesi i Procedurave për fëmijët në situatë rruge është një tjetër hap i rëndësishëm që po ndërmerret në kuadër të mbrojtjes së fëmijëve nga

format e abuzimit, shfrytëzimit. Kjo Nisëm synon të ndërmarrë veprime të koordinuara sistemike për adresimin e situatës aktuale të fëmijëve që jetojnë, punojnë, lypin dhe shfrytëzohen në rrugë. Për më shumë, duhet të ngrihet një grup pune ndërministror për të garantuar zbatimin e planit të veprimit për të drejtat e personave LGBTI. Në lidhje me minoritetin Rom, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë mbikëqyr masat e parashikuara në kuadër të Strategjisë Kombëtare "Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit Rom", në Planin e Veprimit të Dekadës së Përfshirjes së Romëve dhe Planit të Veprimit bazuar në rekomandimet e seminarit të shkurtit 2014, duke u përqendruar në:

1. Mbajtjen e kontakteve me ministrinë përkatëse
2. Mbajtjen e kontakteve me strukturat rajonale dhe lokale
3. Bashkëpunimin dhe koordinimin me OJQ-të që përfaqësojnë Romë, dhe të tjera
4. Bashkëpunimin me donatorë të ndryshëm për të koordinuar dhe të adresojnë fonde në dobi të komunitetit.

Prioritet në këtë fushë do të jetë shqyrtimi i legjislacionit nga këndvështrimi gjinor, përmes një analize mbi mundësi të mundshme ligjore. Shqyrtimi do të bazohet në legjislacionin e BE; konventa ndërkombëtare veçanërisht Konventa për Eliminimin e të Gjithave Formave të Diskriminimit kundër Femrave, dhe konventa e KE-së, "Parandalimi dhe lufta kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje." Fokusi kryesor do të jetë Kodi i Punës për të ndryshuar barrën e provës; rishikim ligjor i sigurimeve shoqërore për përfitime të balancuara të sigurimeve shoqërore midis burrave dhe grave, si dhe leje prindërore për baballarët. Reformat e ndërmarra nga qeveria shqiptare në fushën e mbrojtjes sociale janë: Modernizimi i ndihmës sociale në Shqipëri, që mbështet zbatimin e reformës në Shqipëri për të përmirësuar barazinë dhe efikasitetin e programeve të asistencës sociale (ndihmë ekonomike dhe për njerëzit me aftësi të kufizuara) "Reforma e Shërbimeve Sociale në Shqipëri", e cila synon decentralizimin e shërbimeve të kujdesit social, deinstitutionalizimin e shërbimeve të ofruara në qendrat e kujdesit social dhe të shërbimeve të integruara të kujdesit social. Qëllimi i këtij ligji është të krijojë skemën e detyrueshme të sigurimeve shëndetësore, parimet dhe procedurat e funksionimit të saj dhe rregullojë menaxhimin nga Fondi i Sigurimeve Shëndetësore. Rëndësi të veçantë ka shndërrimi i Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor (ISKSH) në Fondin e Sigurimeve Shëndetësore. Ky i fundit është krijimi i një institucioni i cili do të sigurojë fleksibilitet në financimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, do të rrisë transparencën në administratë dhe

besueshmërinë të personat e siguruar. Skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor bazohet në kontribute, parimin e solidaritetit dhe instrumenteve ligjore të standardeve evropiane dhe ndërkombëtare. Kjo skemë synon të arrijë një mbulim të plotë të popullatës me shërbime të kujdesit shëndetësor. Prioritet i qeverisë Shqiptare është miratimi i amendimeve të Kodit të Punës brenda vitit 2014. Prioritet në fushën e dialogut social është zgjerimi i dialogut social trepalësh në nivel rajonal, i cili do të realizohet duke implementuar modelin e Këshillit Kombëtar të Punës (KKP).

5.3. Praktikët kundër diskriminimit në Shqipëri

Vlen të shtrojmë në këtë studim brenda kufizimeve të mundshme dhe të evidentuara që në Kreun I, si është gjendja dhe situata e diskriminimit në praktikë në vendin tonë. Në Shqipëri është e vështirë të japësh një mendim bazuar mbi të dhëna statistikore, pasi këto pothuajse mungojnë. Madje nuk ka as të dhëna të sakta për numrin e popullsisë që i përket pakicave kombëtare ose gjuhësore. Mungesa e të dhënave statistikore, duke filluar që me mosrifresikimin e të dhënave të vitit 1989 ka qënë një shqetësim i vazhdueshëm edhe i atyre organeve ndërkombëtare që mbikqyrin zbatimin e Konventave Ndërkombëtare në fushën e diskriminimit racial apo dhe kundër grave në Shqipëri⁹³. Gjithashtu, mungojnë të dhënat e sakta nga gjyqësori, për rastet kur procedura apo trajtime të ndryshme janë ankumuar në gjykatat shqiptare si raste diskriminuese. Ekzistojnë vetëm ato të dhëna të përmendura më lart për veprat penale për nxitjen e diskriminimit. Kjo nuk do të thotë që raste të tilla nuk ka, por për arsye të ndryshme, puna për evidentimin e tyre nuk është në nivelet e duhura si dhe sepse shumica e këtyre rasteve nuk ankimohen në gjykatat tona. (Shkurti, 2009:19) Mendoj se kjo vjen jo vetëm nga niveli i ulët i ndërgjegjësimit të publikut shqiptar për diskriminimin, por edhe për vetë faktin se edhe edukata juridike është e tillë që rastet e diskriminimit t'i gjykojë si raste të cilat mund dhe duhet të goditen në Gjykatë. Nga ana tjetër problemet e gjyqësorit në Shqipëri pengojnë zbatimin e legjislacionit kundër diskriminimit dhe racizmit.⁹⁴ Gjithashtu, në një treg pune relativisht të padisiplinuar ligjërisht, ku puna e ashtuquajtur në të zezë zë ende një vëllim të madh në

⁹³Shih raportet e ECRI të vitit 1999 dhe 2003.

⁹⁴Shih Raportin e ECRI 2005.

transaksionet e punësimit, është i vështirë evidentimi i rasteve konkrete dhe veçanërisht i arsyeve që mund të çojnë dallimin në trajtim dhe që mund të përbëjnë në diskriminim.

Përsa i përket diskriminimit në Shqipëri, burime të konsiderueshme deri tani janë raportet e OJF-ve që kanë si objekt të punës së tyre luftën kundër diskriminimit për kategori të caktuara individësh apo grupesh vulnerabël, si p.sh për gratë, pakicat etnike, personat me aftësi të kufizuar, etj si dhe raportet e organeve ndërkombëtare mbikqyrëse të traktateve.

Nga organizatat ndërkombëtare të cilat merren me mbikqyrjen e zbatimit të traktateve dhe Konventave të ratifikuara nga Shqipëria, vendi ynë konsiderohet si një nga ato vende ku legjislacioni kryesor është në përgjithësi në përputhje të plotë me normat ndërkombëtare në luftën kundër diskriminimit. Problem përbën gjendja reale e diskriminimit në vendin tonë. Megjithatë, për të qenë sa më realistë duhet thënë se edhe mendimet e shprehura në raportet e këtyre organizmave ka një dozë të madhe subjektiviteti, pasi siç e thashë mungojnë studimet e mirëfillta qoftë sasiore, qoftë cilësore në këtë fushë.

Organizmat ndërkombëtare vazhdojnë të cilësojnë si problem real në Shqipëri diskriminimin mbi bazën e prejardhjes *raciale dhe etnike*. Këtu bëhet fjalë për pakicat kombëtare, gjuhësore dhe raciale në Shqipëri. Ndonëse Shteti Shqiptar në këto vite ka krijuar një kuadër të plotë ligjor për shmangien në praktikë të diskriminimit kundër grupeve dhe individëve që mund të çenohen nga ky lloj diskriminimi, gjendja në praktikë ka shumë pak përmirësim. Edhe ndërmjet pakicave që jetojnë në Shqipëri vlerësohet se ka një dallim diskriminues. Kështu, mendojmë se pjesëtarët e pakicave kombëtare greke tashmë janë të integruar në jetën politike, ekonomike dhe kulturore në Shqipëri. Pjesëtarët e kësaj pakice kanë patur edhe detyra të larta politike (si ministra), kështu që tashmë lufta kundër diskriminimit për këtë pakicë është shtrirë në fushën e arsimit ku kërkohen më shumë shkolla për fëmijët e pakicave greke. Problem vazhdon të jetë dhe mbetet diskriminimi kundër pakicave gjuhësore rome dhe egjiptiane. Për vetë nivelin kulturor, arsimor, socialo-ekonomik si dhe mënyrën e tyre të jetesës, këto pakica kanë qënë gjithmonë vulnerabël dhe të marxhinuara si dhe janë përballur me veprime praktike diskriminuese. Kjo ishte edhe arsyeja që u miratua Strategjia për Përmirësimin e Jetesës të Komunitetit Rom, strategji e cila ka mbetur më tepër si mjet propagandistik dhe demagogjik dhe nuk është bërë ndonjë hap me rëndësi për zbatimin e saj praktik, përveç disa nismave për t'u përgëzuar të shoqërisë civile. Madje edhe në këtë strategji pranohet se pakicat rome janë të diskriminuara ndaj pjesës tjetër të popullsisë. Rastet e dhunës dhe trajtimit arbitrar

të këtij komuniteti përbëjnë probleme shqetësuese për komunitetin ndërkombëtar dhe OJF-të shqiptare që vlerësojnë situatën e diskriminimit në Shqipëri⁹⁵.

Shqetësues është paraqitur edhe fakti i arsimimit të fëmijëve të komunitetit rom dhe egjiptianë dhe veçanërisht përqindja e braktisjes së shkollës prej tyre. Për shembull, sipas të dhënave të organizata jo qeveritare të komunitetit rom, numri i studentëve romë në Shqipëri është vetëm 2⁹⁶. Në këtë stad e rëndësishme është të studiohet sesa kanë ndikuar paragjykimet dhe stereotipet e punonjësve të sistemit arsimor në këtë fenomen⁹⁷. Të gjitha nismat e marra nga qeveria dhe organizata joqeveritare, duke përjashtuar këtu regjistrimin e fëmijëve romë në zyrat e gjendjes civile⁹⁸, nuk kanë sjellë ndonjë përmirësim të dukshëm të jetesës së këtij komuniteti. Papunësia është në nivele mjaft të larta, pa folur këto për gratë që i përkasin këtij komuniteti të cilat kanë qënë shpeshherë objekt trafikimi dhe prostituimi. Sot problemi i komunitetit Rom shihet si një problem madhor jo vetëm në Shqipëri por edhe në të gjithë vendet e Europës Lindore dhe Qendrore, të cilat kanë popullsi rome. Në të gjitha raportet mbi luftën kundër diskriminimit në këto vende, një vend të veçantë zë problemi i diskriminimit kundër komunitetit rom. (NGO Report on the situation of women and girls in the Republic of Albania, 2006:33) Kjo e udhëhequr edhe nga jursiprudenca e kohëve të fundit të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut⁹⁹ për rastet e diskriminimit të pjesëtarëve të këtij komuniteti. Krahas strategjisë kombëtare, të përmendur më lart, në planin afatgjatë, po punohet për hartimin e një strategji kombëtare 2007-2015 për komunitetin rom dhe paaftësinë. (NGO Report on the situation of women and girls in the Republic of Albania, 2006:20)

Strategjia Rome në kuadër të punësimit ka përcaktuar si objektiv zbatimin e disa programeve speciale për punësimin e Romëve. Këto programe parashikojnë që çdo punëdhënës që përfiton nga programet e nxitjes së punësimit dhe punëson femra rome u jepet: a) në vitin e parë 70% të sigurimeve shoqërore dhe 4 paga minimale të në shkallë vendi; b) në vitin e dytë të zbatimit të kontratës 85% e sigurimeve shoqërore të detyrueshme dhe 6 paga minimale në shkallë vendi; c)

⁹⁵Raporti i Komitetit për Elelminimin e Formave të Diskriminimit Racial 2003.

⁹⁶<http://www.unioniamarodrom.org/gjendjakt.htm>.

⁹⁷Raportet e ECRi 2003, 2005.

⁹⁸Me miratimin e Ligjit nr. 8950, datë 10.10.2002 “Për Gjendjen Civile”, u rrit shumë numri i personave që nuk arrinin të regjistrojnë fëmijët e tyre brenda afatit 45 ditor nga dita e lindjes në Zyrat e Gjendjes Civile. Nga ky fenomen u prekën më shumë pakicat rome dhe ato egjiptiane.

⁹⁹Moldovan dhe të tjerët kundër Rumanisë; fshati i Hadareni, kërkesat nr. 41138/98 and 64320/01; Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë [shih më lart]; *Balogh kundër Hungarisë*, Kërkesa nr. 47940/99

në vitin e tretë të zbatimit të kontratës 100% e sigurimeve shoqërore të detyrueshme dhe 8 paga minimale në shkallë vendi.

Problem tjetër është cilësuar dhe pjesëmarrja e pakicave në zgjedhje. Përveç përmirësimeve ligjore që tashmë kanë hyrë në fuqi, qoftë në Kodin Zgjedhor qoftë në aktet e tjera nënligjore,¹⁰⁰ KQZ, si masa zbatuese, ka parashikuar zbatimin e programeve në drejtim të dedukimit zgjedhor të persnave që i përkasin pakicave. Në këtë kuadër në Planin Kombëtar të Përafrimit të Legjislacionit parashikohet se KQZ në bashkëpunim edhe me institucione të tjera shteteërore si Ministria e Punëve të Jashtme apo INSTAT po evidenton dhe mbledh të dhëna mbi llojet e pakicave në Shqipëri si dhe shpërndarjen e tyre dhe po përgatit materiale informuese në dy gjuhë. Në këtë kuadër po punohet edhe me subjekte të shoqërisë civile dhe priten edhe donacione të ndryshme. Është rishikuar pjesa kryesore e legjislacionit për mediat në Shqipëri, në mënyrë që të lehtësohet akses i pakicave në organet e medias, por pritet që të bëhet më shumë për zbatimin praktik të këtyre dispozitave.

Legjislacioni shqiptar parashikon lirinë e lëvizjes së personave që i përkasin pakicave kombëtare të lëvizin lirisht, të marrin pjese në organizime të nivelit kombëtar dhe ndërkombëtar si dhe të gjitha të drejtat e tjera që parashikohen edhe për shtetasit shqiptarë që nuk i përkasin këtyre pakicave.

5.4. Situata aktuale e (pa) barazisë gjinore në Shqipëri

Në Shqipëri, periudha e tranzicionit ka ndikuar negativisht në integrimin e gruas në tregun e punës, duke shkaktuar rënien në mënyrë të konsiderueshme të pjesëmarrjes së gruas në vendimmarrje, (Leskaj, Meminaj, Avdulaj, 2007: 6) duke bërë që kjo pjesëmarrje të mbetet më e ulët në krahasim me vendet e tjera të Evropës Qendrore dhe Lindore. (NGO Report on the situation of women and girls in the Republic of Albania, 2006:20) Faktorët që kanë çuar në një situatë të tillë janë të shumtë, ndër të cilët mund të përmenden zhvillimi i ngadaltë ekonomik, ristrukturimi i burimeve, mentalitet ekzistues të trashëguara, pritshmëritë e shoqërisë për gratë dhe mungesa e vullnetit politik për të përfshirë gratë në vendimmarrje dhe sidomos në politike (Përfaqësimi dhe cilësia e demokracisë në Shqipëri, një perspektivë gjinore, 2006:46).Statistikat

¹⁰⁰Rregullore për rritjen e informimit të pakicave nga ana e organeve të pushtetit vendor.

flasin për një diskriminim të dukshëm të grave në pjesëmarrjen në tregun e punës, në diferencimin në sistemin e pagave, në nivelin e papunësisë si dhe në pjesëmarrjen në pronën private, përfaqësim apo vendimmarrje politike dhe më gjerë(Leskaj, Meminaj, Avdulaj, 2007: 7). Programi për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara ka konstatuar se pagat e grave në Shqipëri janë 20 deri 50% më të ulta krahasuar me pagat të burrave, të cilët kanë në zotërim 92% të të gjithë pronës private. Sipas të njëjtit burim, burrat rezultojnë të kontribuojnë në rreth 84% të produktivitetit ekonomik kombëtar.Statistikat e INSTAT-it mbi treguesit gjinorë të papunësisë tregojnë se burrat gjenden më shpesh të papunë gjatë pjesës më të madhe të jetës së tyre, në krahasim me gratë.(Miluka, 2011:8)

Grupmosha kur gratë preken lehtësisht më tepër nga fenomeni i papunësisë sesa burrat është nga 34-47 vjeç, me një diferencë prej 2% në favor të burrave.Ndërsa, në grupmoshat e reja 15- 30 vjeç, gratë preken shumë më pak se burrat nga papunësia.Diferenca në këtë rast arrin në shifra pothuajse dyfish më të larta për burrat. Gratë preken nga papunësia më pak sesa burrat edhe në grupmoshat e vona, konkretisht nga 52-62 vjeç, kur diferenca mes tyre dhe burrave thellohet në afro 7% në favor të grave.(Miluka, 2011:8)

Aktualisht në vendin tonë vetëm 7,1% e parlamentarëve shqiptarë janë gra. Ndonëse janë emëruar dy ministre gra, ndër 14 pozicione të tilla, përgjithësisht kjo shifër ka qenë në nivelin e një gruaje ministre. Sidoqoftë, me hyrjen në fuqi të ligjit të ri‘Për barazi gjinore në shoqëri’ mendohet që pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2009, përfaqësimi i grave në parlament dhe në kabinetin qeveritar është më i balancuar.(Miluka, 2011:11)

Për sa i përket dhunimit të të drejtave të grave brenda familjes, dhuna në familje vazhdon të mbetet një nga tematikat më problematike në vendin tonë. Në shumicën dërrmuese të rasteve, të përgjegjshëm për aktet e dhunës janë partnerët etyre. Po sipas këtij publikimi 52.2% e grave që vuajnë ngadhuna në familje, nuk u kanë folur kurrë të tjerëve për dhunën e ushtruar ndaj tyre. Kjo shifër shpreh mungesën e ndërgjegjësimit të grave, që nuk e shohin dhunën si një akt që duhet denoncuar. Gjithashtu rezultojnë se 11.5 për qind e vajzave dhe grave shqiptare të grupmoshës 15-44 vjeç, kur kanë qenë fëmijë kanë qenë dëshmitare të dhunës në familje dhe 27.2 për qind e tyre kanë qenë viktimat e dhunës fizike në familje. Pra, gratë vazhdojnë të mbeten seksi më i diskriminuar dhe më i dhunuar në familje, gjë që po reflektohet edhe në rastet e vetëvrasjeve, si pasojë e dhunës në familje.

Të dhënat mbi përhapjen e fenomenit të dhunës në familje vazhdojnë të jenë të kufizuara. Kështu komisaritet e policisë, zyrat juridike, qendrat e kujdesit shëndetësor dhe ato të shërbimeve sociale grumbullojnë dhe prezantojnë të dhëna mbi dhunën por ato duhen përpunuar e analizuar me qëllim reflektimi dhe marrjen e masave konkrete parandaluese. (Shkurti, 2009:19) Shqipëria është një nga vendet e pakta në Evropë që nuk regjistron, publikon dhe prezanton zyrtarisht rregullisht të dhëna mbi përmasat dhe përhapjen e këtij fenomeni.

5.4.1 Kuotat gjinore

Krijimi i mundësive të pjesëmarrjes dhe përfaqësimit aktiv të grave në të gjitha nivelet e proceseve të vendimmarrjes përbën një aspekt kyç të zhvillimit demokratik. (Picari, 2008:42). Megjithatë, gratë përballen me një sërë vështirësish, ku përfshihen stereotipet gjinore dhe paragjykimet kundrejt aspiratave të tyre për të garuar si kandidatë dhe për t'u "bërë politikanë". (Anastasi, Mandro-Balili, Shkurti, Bozo, 2012:91) Gratë vazhdojnë të hasin vështirësi për të pasur akses te drejtuesit partiakë dhe vendimmarrësit, ndërsa u duhet të sfidojnë dinamikën e brendshme partiake dhe, në fund, por jo nga rëndësia, atyre u duhet të përballen edhe me nevojat dhe kërkesat e jetës familjare (Leskaj, Meminaj, Avdulaj, 2007: 7).

Në Shqipëri, përkatësia gjinore në procesin e vendimmarrjes paraqitet në nivele të ulta, për shkak të stereotipeve të ndryshme që ekzistojnë në shoqërinë shqiptare (Përfaqësimi dhe cilësia e demokracisë në Shqipëri, një perspektivë gjinore, 2006:7). Gratë përbëjnë 7 përqind të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, gjatë periudhës 2005 – 2009, dhe një përqindje më të ulët në postet drejtuese të qeverisë qendrore e vendore. Ndonëse prania e grave dhe vajzave në administratën publike është disi më e ndjeshme, burrat mbeten dominues në pozicione drejtuese (Përfaqësimi dhe cilësia e demokracisë në Shqipëri, një perspektivë gjinore, 2006:13). Nëse do të bënim një krahasim të standarteve të arritura nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, do të

konstatonim se Shqipëria nuk arrin asnjë nga standartet e vendosura prej tyre në përfaqësimin e grave në Parlament. Ky fakt, është një pengesë e madhe në realizimin e reformave dhe politikave të orientuara sipas nevojave të grave, fëmijëve dhe familjes. Ligji “Për barazinë gjinore në shoqëri”, ishte i pari ligj që i ka dhënë një kuptim konkret parimit të përfaqësimit të barabartë gjinor. Në bazë të këtij ligji, ky parim realizohet përmes përfaqësimit të secilës prej gjinive me mbi 30 përqind në institucionet publike dhe nivelet e tyre drejtuese. Kodi i ri Zgjedhor parashikoi dhe rregullat për zbatimin e kuotës Kombëtare. Shqipëria u rendit në rradhën e atyre vendeve evropiane të cilat kanë parashikuar një kuotë gjinore me ligj, si një masë të vecantë për të nxitur vendosjen e balancës gjinore në vendimarrje (neni 15 i Ligjit). Edhe në shtete të tjera evropiane gjejmë kuotat gjinore.

Një ndër indikatorët më të rëndësishëm i cili ndihmon në promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e femrës është pjesmarrja e femrës në politikë dhe akoma më tej përqindja e femrave në parlament. (NGO Report on the situation of women and girls in the Republic of Albania, 2006:45) Në një popullsi, 50% e secilës përbëhet nga femra, pjesmarrja në pozicionet vendimarrëse e të dy sekseve duhet të ishte në të njëjtat kuota. Përgjithësisht në botë shifrat flasin për shoqëri të drejtuara nga meshkujt, ku pjesmarrja e femrës po mund të imponohet kryesisht nga organizata ndërkombëtare. Në platformën Beijiing është rekomanduar që shtetet të mundësonin të paktën nivelin 30% të vendeve në parlament për femrat, fakt ky i përmendur jo rrallë nga partitë politike në prag të fushatave elektorale në Shqipëri, të cilat nënvizojnë faktin se femrat duhet të jenë një zë jo i vogël në vendimarrje dhe në parlamentin shqiptar.

Duke patur parasysh se % e vendeve që zënë femrat në parlament ndihmon për të gjykuar mbi demokracinë e një vendi, Shqipëria pjesëmarrjen më të lartë të femrave në parlament e ka pasur para viteve ‘90. Vitet pas zhvillimeve të vrullshme të ‘90 janë shoqëruar me ulje të pjesëmarrjes

së femrave në organin legjislativ shqiptar, për të arritur minimumin në vitet 2000 – 2004 me 5.7%. Zgjedhjet e vitit 2009 duket se kanë sjellë përmirësime të dukshme duke e çuar në 16.4% numrin e vendeve të rezervuar për femrat, duke qenë përsëri larg angazhimit të politikës për nivelin 30%. Të shumta janë arsyet pse gjithmonë vendoset theksi mbi pjesëmarrjen e femrave në politikë, e mbi të gjitha në parlament. Së pari, mundësia e barabartë për pjesmarrje është e drejtë e gjithsecilit. Së dyti, femrat dhe meshkujt kanë perceptime të ndryshme mbi prioritetin e politikave të një vendi (Thomas 1991; Carroll 2001).

Të dhënat tregojnë se femrat janë më të përfshira në ligjet nga të cilat përfitojnë gratë, fëmijët dhe familjet. Një element tjetër, shumë i rëndësishëm, është se evidencat flasin për përmirësim të qeverisjes dhe ulje të korrupsionit falë pjesmarrjes së femrave. Një hap i mirë për sigurimin e pjesmarrjes së femrave në parlament është përfshirja e tyre në listën zgjedhore në sistemet propocionale me listë të mbyllur, por jo dodmosdoshmërisht kjo rezulton në një reform të suksesshme. Në sisteme të tilla, si ai shqiptar, shtetasit votojnë për partinë, e cila ka përcaktuar listën e deputetëve sipas një rendi të caktuar. Vendosja 30% të kandidaturave femra, nuk do të thotë se 30% e vendeve në parlament (nga secila parti) do të përbëhet nga femra. Është e nevojshme që ato të renditen në zonën e zgjedhshme, pra që ka një propabilitet shumë të lartë për të fituar. Në rast të kundërt, rezultati do të jetë ai i vitit 2009. Pra, partitë janë parimisht në rregull me plotësimin e normave të kandidaturave, por i rendisin femrat në pozicione që një pjesë e vogël kanë mundësi të fitojnë.

Cështja për një pjesëmarrje të barabartë dhe të drejtë është baza e një demokracie ideale që mbështet energjikisht integrimin e gruas në politikë, por dhe në fusha të vendimarrjes, duke i krijuar kështu mundësi aplikimi për të nxjerrë në sipërfaqe probleme të dukshme të vetë sistemit. Kjo do të përforcohej dhe përmes integritit të një fushe siç është sfera publike, duke shfaqur

kështu se pozicioni i gruas në shoqëri dhe në përgjithësi pozicioni gender luan një rol të rëndësishëm në politikë. Ekziston nevoja, jo vetëm në decentralizimin e mekanizmave ekzistues dhe organizmave shtetërorë, por të ndryshojnë stereotipat dhe politikat e një diskriminimi kulturor vendor në përgjithësi. Pra një reformim në nivel të gjerë social që shoqërohet me ndryshime në jetën e përditshme në një raport dialektik dhe reciprok. Pra ideja e barazisë gjinore nënkupton pjesmarrjen në kushte të barabarta brenda një kuadri social dhe politik të një reforme dhe bashkëpunimi që duhet të ekzistojë mes shtetit dhe organizatave jo qeveritare. Kjo nevojë nga njëra anë forcon pozicionin e shtetit dhe iniciacionin agjendën internacionale për të progresuar pozicionin e gender në një plan me iniciativë të reja. Partitë politike duhet të zhvillojnë pjesmarrjen e gruas duke vendosur përqindje, ashtu siç është parashikuar por me kritere cilësore dhe jo sasiorë duke përfshirë një pjesë kualifikuese të vetë grave drejt një rrugë të madhe brenda politikës. Duhet të theksojmë diferencën cilësore që arrihet prej përfaqësimit në politikë të gruas me përcaktimin e programeve qeveritare, në rregullimin, në mbështetjen e shtetit ligjor dhe demokracisë. Çështja e raportit të femrave me politikën, nuk duhet të perceptohet e njëanëhme dhe e një grupi të caktuar, e ndarë nga grupi elektoral i zgjedhjeve. Realisht çështja e gruas fsheh dhe çështjen e demokracisë aktuale në vetvete. Propozimi për inkurajimin e demokracisë mbështetet në investigimin e fillimeve të reja dhe procedurave të përafuara me ato të Bashkimit Evropian, për të pasur një themel të etikës politike. Përpjekja për një pjesmarrje thelbësore të grave duhet të fillojë dhe të pranohet së pari nga vetë partitë politike dhe jo të detyruar nga mekanizma të jashtëm. Këto përpjekje do të përcjellin limite të reja në drejtësi, të individit, të marrëdhënies mes shtetit dhe qytetarit/es.

Për herë të parë në historinë e vendit, në zgjedhjet parlamentare në 28 Qershor 2009, Kodi zgjedhor dhe Ligji “Për barazinë gjinore në shoqëri” parashikuan pjesmarrjen e grave në

zgjedhjet nëpërmjet një kuote minimum 30%, për gjininë më pak të përfaqësuar. Megjithë premtimet para-elektorale të drejtuesve të partive politike senë listat e kandidatëve për deputetë do të kishin minimum 30% gra candidate, finalizimi i listave tregoi të kundërtën. Vendosi e kuotës gjinore 30 përqind ishte fryt i një punë të gjatë lobimi të përfaqësuesve të shoqërisë civile, forumeve të grave të partive politike dhe një sërë partnerësh institucionalë, të cilët besojnë se mungesa e eksperiencës demokratike në politikë, përfaqësimi i tejskajshëm i burrave në Kuvendin e Shqipërisë dhe në procesin e vendimarrjes në tërësi e bën të domosdoshme zbatimin e metodave alternative të pjesmarrjes në jetën politike për gratë dhe vajzat. Sipas një studimi të Unionit Ndërparlamentar, pjesmarrja e grave në Kuvendin e vitit 2005 – 2009 e rendiste Shqipërinë në vendin 116 nga 187 vende, dhe në vend të fundit në krahasim me vendet e tjera të Evropës Juglindore. Në zgjedhjet vendore të vitit 2007, vetëm 33 prej 1.073 kandidatëve të propozuar për kryetarë të bashkive dhe komunave ishin gra dhe nga këto, vetëm 9 prej tyre u zgjodhën. Zgjedhjet parlamentare u zhvilluan në Qershor nën një frymë përgjithësisht të qetë dhe demokratike. Megjithatë mungesa në kod e rregullave të qarta për numrin e përgjithshëm të emrave të kandidatëve në lista, bëri që thuajse të gjitha partitë politike të shfrytëzojnë këtë mangësi për të paraqitur më shumë kandidatë sesa numri i vendeve për deputetë në Kuvendin e ardhshëm. Kjo manovër ligjore, ndonëse në pamje të parë plotësonte një nga kërkesat e Kodit Zgjedhor, për prezencën në lista të minimumit të 30 përqind gra, në të vërtetë ishte në kundërshtim të hapur me vetë frymën e Kodit. Një pjesë e emrave të grave candidate për deputetë në listë, rezultoi se u vunë sa për të plotësuar kuotën 30 përqind dhe jo si një mundësi për të garantuar pjesmarrjen e grave në politikë. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, reagoi shumë pak ose aspak, për të kërkuar nga partitë politike, dorëzimin e listave që bënin të mundur pjesmarrje dhe garim të njëjtë, si për gratë ashtu dhe për burrat. Nisur nga këndvështrimi i listave

të partive politike, në ditën e shpalljes publike së tyre, rezultoi se në përgjithësi një numër I madh kandidatësh gra, të ndara sipas rajoneve elektorale, ishin tashmë të vendosura në mes apo në fund të listës së kandidatëve, pra me shumë pak shanse për të dalë fituese në zgjedhje. Këto taktika elektorale, të përdorura nga partitë politike, ndikuan gjerësisht në rezultatet finale të zgjedhjeve. Ndonëse Kodi Zgjedhor nuk garantonte se në dalje listat e deputetëve të ardhshëm në Kuvendin e Shqipërisë do të përmbanin 30 përqind gra, përsëri ai do të krijonte premisa që partitë politike të përmbushnin premtimet dhe detyrimet e tyre përkarshi grave. Megjithatë Shqipëria është ende shumë larg arritjes së barazisë së vërtetë ndërmjet burrave dhe grave në politikë dhe vendimmarrje. Rritja e numrit të grave në Kuvend dhe në vendimmarrje, i jep mundësi krijimit të një modeli të ri të pjesëmarrjes së grave në politikë, i cili më pas do të reflektohet në zgjedhjet e ardhshme lokale dhe ato parlamentare.

5.4.2 Barazia gjinore dhe mosdiskriminimi në punësim

Përsa i përket barazisë gjinore është vënë theksi tek diskriminimi ndaj aksesit të barabartë në punë të grave me burrat. Megjithëse gratë kanë pothuajse të njëjtin nivel edukimi dhe në mënyrë sporadike kanë mbuluar dhe mbulojnë detyra të larta shtetërore, ky problem mbetet shqetësuar veçanërisht në zonat rurale dhe sidomos të Shqipërisë së Veriut. Këtu duhet përmendur edhe niveli mjaft i ulët në punësim i grave që i përkasin komunitetit rom.¹⁰¹ Komiteti Shtetëror për Mundësi të Barabarta duhet të luajë një rol më të madh në përafrimin e praktikave ligjore të trajtimit të barbartë të grave dhe burrave. (NGO Report on the situation of women and girls in the Republic of Albania, 2006:35) Platforma Kombëtare për Përparimin e Grave, platformë e cila

¹⁰¹Raport i Komitetit për eliminimin e diskriminimit kundër grave, Janar 2003.

u ngrit për zbatimin e Konventës për Eleminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave në konktesktin e zbatimit të Platformës për Veprim të Pekinit e zbatuar në bashkëpunim me OJF-të shqiptare është një instrumen mjaft i vlefshëm për përpararimin e grave në vendimarrjen në Shqipëri. Është sugjeruar gjithashtu, ngritja e një instituti gjinor në Fakultetin e Sociologjisë, për të rritur ndërgjegjësimin e partive politike për rritjen e pjesëmarrjes së grave në vendimarrje si dhe krijimin e një sistemi kuotash në ligjin elektorale, propozime të cilat praktikisht sot janë vënë në veprim. Problem tjetër që është parashtruar me forcë është niveli i lartë i përshkallëzimit të dhunës në familje, sidomos ndaj grave në zonat rurale. Komiteti për Eleminimin e Diskriminimit kundër Grave ka bërë thirrje që ky problem të mos vlerësohet si problem të ngushtë familjar por si problem social dhe të krijojë një kuadër ligjor dhe struktura të përshtatshme për trajtimin e këtyre rasteve duke filluar që nga aksesin në drejtësi e deri tek dëmshpërbimet e mundshme që duhet të përfitojnë viktimat e këtij trajtimi. Shqetësuese janë edhe rastet e “rinjalljes” së ligjeve diskriminuese të kanunit në veri të vendit. Gjithashtu, shqetësues janë edhe faktorët diskriminues për gratë në zonat rurale të vendit të cilët vuajnë nga aksesin i kufizuar në punësim dhe arsimimin, trajnimin profesional dhe në pozitat e barabarta me burrat. (Miluka, 2011:12) Për sa themë më lart Qeveria ka marrë përsipër që në strategjinë e saj afatshkurtër të hartojë dhe miratojë “Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore” si dhe “Strategjinë Kombëtare mbi luftën kundër dhunës në familje”, që në planin afatmesëm synojnë harmonizimin progresiv të legjislacionit shqiptar me *acquis* në fushën e kushteve të punës, veçanërisht të shëndetit e sigurisë në punë dhe mundësive të barabarta. (Anastasi, Mandro-Balili, Shkurti, Bozo, 2012:167)

Në kuadrin e barazisë gjinore në fushën e sigurimeve shoqërore vihet re një diskriminim pozitiv në favor të gruas, në fushën e pensioneve të pleqërisë, pasi gratë dalin në pension pleqërie në

moshë më të re se burrat, gjë kjo që nuk reflekton përmbajtjen e Direktivës 79/7/KEE. Por, për femrat njihen si periudhë sigurimi periudha e studimeve universitare/pasuniversitare; barrë lindje, etj. Skema e sigurimeve shoqërore është shtrirë pjesërisht edhe mbi personat e vetëpunësuar në bujqësi duke reflektuar parimet e Direktivës 86/613/KEE për trajtimin e barbartë të burrave dhe grave të vetëpunësuar në bujqësi.

Krahas masave të përmendura më lart për punësimin e grave në përgjithësi dhe ato që i përkasin komunitetit rom në veçanti, po merren edhe masa për të përmirësuar komponentët e shërbimit të punësimit që të rritet efica e tij, ku bëhet fjalë për punësimin e viktimave të trafikeve, personave me aftësi të kufizuar si dhe menaxhimin e burimeve dhe aftësive profesionale. Këto ndryshime do të vijnë si rezultat i përafrimit të legjislacionit me Konventën 168 të ILO, e cila është në proces ratifikimi si dhe kartës Sociale të Rishikuar. Në këtë kuadër do të miratohen edhe një numër aktesh nënligjore¹⁰² që do të ndihmojnë në krijimin e një kuadri të plotë ligjor në përputhje me standardet e BE-së dhe në zbatimin e masave zbatuese që synojnë krijimin e një tregu të rregullt dhe të informatizuar të punës, si dhe kryerjen e studimeve për tregun e punës dhe diskriminimin gjinor në tregun e punës në Shqipëri. Në Shqipëri vihen re veprime abuzive dhe subjektive nga ana e disa punëdhënësve kundrejt punëmarrësve të cilat rrjedhin jo nga padijenja dhe moskuptimi i ligjit, por nga veprime të qëllimta dhe aspak justifikuese, duke i mbuluar këto me një mbulesë formale ligjore, gjë që ngre çështjen sesi po i kryejnë detyrat e tyre ato organizma shtetërore që kanë për detyrë mbikqyrjen e tregut të punës në Shqipëri. Problem tjetër mjaft shqetësues është numri i madh i fëmijëve nën moshën e caktuar që janë të detyruar të punojnë dhe kushtet në të cilat ata punojnë.

¹⁰²Shih Planin Kombëtar të Përafrimit të Legjislacionit, fq 268

Në përfundim të këtij debati nga Komisioni Europian kundër Racizmit dhe Intolerancës është sugjeruar¹⁰³ që të krijohet një kuadër ligjor i plotë për ndalimin e diskriminimit në fushën e shëndetit, strehimit, dhe sigurimeve shoqërore. Mendoj që kjo do të ishte një gjë jashtëzakonisht e favorshme për Shqipërinë, por në kushtet e sotme kur edhe shumë nga vendet e përparuara të Europës perëndimore e shohin rregullimin ligjor kundër diskriminimit në këto fusha si veçanërisht të vështirë për të rregulluar, në kushtet kur Shqipëria nuk ka as burimet financiare dhe as ato njerëzore për të zbatuar një kuadër ligjor të plotë në këto fusha, kjo gjë do të krijonte probleme të mëdha për situatën makro dhe mikroekonomike në Shqipëri.

Mendoj se dy janë problemet kryesore në këtë fushë, por që mund të përgjithësohen edhe për kuadrin e përgjithshëm të luftës kundër diskriminimit në Shqipëri. Së pari, shteti shqiptar duhet të fillojë sa më shpejt e mundur përfshirjen e akteve kryesore të BE-së kundër diskriminimit në sistemin e brendshëm ligjor të Shqipërisë.

Së dyti, problemi që ngrihet është se mekanizmat monitoruese në Shqipëri në luftën kundër diskriminimit janë shumë të pakta, madje edhe ato që ekzistojnë janë shumë të kufizura në punën e tyre. Kjo ndoshta për shkak të mangësive financiare apo edhe për shkak të rolit dhe objektivit të tyre të kufizuar në këtë fushë. Ndonëse ka shumë dispozita të shpërndara për mbrojtjen kundër diskriminimit, ka shumë pak ligje të veçanta dhe specifike për luftën ndaj tij. Edhe ai legjislacion që është, vlerësohet si i pafuqishëm për ta luftuar diskriminimin në nivelin e duhur¹⁰⁴. Ende më i vështirë është trajtimi në praktikë i rasteve konkrete të diskriminimit. Trajtimi me hollësi i situatës së diskriminimit në Shqipëri duhet bërë duke u shmangur nga stereotipet e zakonshme për të thënë “që patjetër që ka diskriminimin”, por ajo duhet vlerësuar me objektivitet.

¹⁰³Raport i ECRI, 1999.

¹⁰⁴Çështje gjyqësore të diskriminimit të racës në Europë: Probleme dhe Perspektiva, Xhejms Goldston, *Revista Ligjore “Klinika” Botim i Fondacionit Klinika e Ligjit, Gusht 2001.*

Siç e kam trajtuar edhe më lart, mendoj se legjislacioni kryesor [*parësor*] shqiptar është në vija të përgjithshme në përputhje me standardet dhe normat ndërkombëtare.

5.4.3. Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimi në ceshtjet martesore dhe familjare.

Caktimi i vendbanimit të bashkeshortëve

Vendbanimi i familjes është vendi që bashkëshortët zgjedhin me marrëveshje të përbashkët. Në rast mosmarrëveshjeje, secili nga bashkëshortët mund t'i drejtohet gjykatës, e cila, pasi dëgjon mendimet e të dy bashkëshortëve dhe, nëse është rasti, edhe mendimin e fëmijës që ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç, mundohet të arrijë një zgjidhje me mirëkuptim. Kur kjo nuk është e mundur, gjykata vendos zgjidhjen që e quan më të përshtatshme për kërkesat e familjes. Komiteti CEDAW duke nënvizuar influencën e së drejtës zakonore, nënvizon se shqyrtimi i raporteve të Shteteve palë demonstroi që një gruaje nuk i lejohet gjithmonë të zgjedhë vendbanimin e vet. Komiteti vë në pah se vendbanimi, si edhe nënshtetësia, duhet të ketë mundësi të ndërrohet sipas dëshirës së gruas në moshë madhore pavarësisht nga statusi i saj martesor. Çfarëdo kufizimi mbi të drejtën e një gruaje për të zgjedhur vendbanimin, mbi të njëjtat baza si një burrë, mund të kufizojë aksesin e saj ndaj gjykatave në vendin ku ajo banon apo ta ndalojë të hyjë dhe të dalë nga një vend lirisht. Vendimi nr 2843/19.03.2013 i GjRrGj Tiranë, paraqet situatën se si mosmarrëveshjet lidhur me vendbanimin e imponuar nga njëri bashkëshort, bëhen shkak deri në zgjidhjen e martesës. Në këtë proces gjyqësor, paditësja shpjegoi se disa kohë pas lidhjes së martesës, i padituri është larguar në Kanada. Duke qenë se paditësja kishte detyrime të tjera familjare për një fëmijë nga një bashkëjetesë e mëparshme ajo nuk mund të shkonte dot në

Kanada. Në këto kushte, paditësja i ka kërkuar të paditurit që të kthehej e të jetonin së bashku, por nga i padituri iu vu kusht se martesë do të vazhdonte nëse ajo do të shkonte në Kanada, në të kundërt martesë quhej e përfunduar.

5.4.3.1. Barazia dhe mosdiskriminimi në marrëdhëniet pasurore midis bashkëshortëve

Regjimi pasuror duhet të qartësohet përpara lidhjes së martesës. Nëse bashkëshortët e ardhshëm, përpara lidhjes së martesës, zgjedhin si regjim pasuror martesor atë me kontratë, janë ata që përcaktojnë rregullat mbi regjimin pasuror. Marrëveshja e tillë, kalon në filtrin e respektimit të rregullave të përcaktuara sipas Kodit të Familjes dhe që duhet të respektohen nga noteri dhe bashkëshortët e ardhshëm në çdo negociatë lidhur me regjimin pasuror. Përtej sa përmban ligji, është shumë e rëndësishme që në marrëveshje të tilla, pra në kontratën paramartesore, të ruhet balanca e mosdiskriminimit gjinor të bashkëshortëve, parë në tri drejtime kryesore: të drejtat pasurore të bashkëshortëve gjatë martesës; detyrimet e tyre pasurore dhe tagrat apo thënë ndryshe pushtetet. Rregullat e regjimit pasuror martesor do të luajnë rolin e tyre gjatë martesës dhe në mbarim të martesës ose më saktë në mbarim të atij regjimi që jo domosdoshmërisht mund të jetë mbarimi i martesës. Kështu që statusi ligjor i regjimit të zgjedhur duhet të kuptohet drejt duke e matur efektin e regjimit në episodet e sipërpërmendura të jetës martesore. Veç elementëve të formës për këtë kërkohet një balancë e fortë midis të drejtave dhe ‘interetit të familjes dhe martesës’ dhe të drejtave dhe “interesave të bashkëshortëve”.

Të tria, përfshirë edhe formën, duhet të shihen si komplementare dhe në unitet dhe jo si forca divergjente me njëra tjetrën. Gjithsesi, në vlerësimin e interesave, kanë prioritet ato që lidhen ngushtësisht me familjen dhe martesën sepse qëllimi i regjimit nuk është që të devijojë

ngadetyrimet për këto institute. Ndonëse kontrata paramartesore apo martesore përcakton një regjim pasuror dhe qëllimi është që çifti të përcaktojë vetë rregullat që qeverisin marrëdhëniet e tyre pasurore, gjithsesi ata nuk mund të parashikojnë shmangien nga juridiksioni i gjykatës, prandaj, kur ka mosmarrëveshje, është kjo e fundit që në çdo rast, me vendimin e saj përfundimtar, do të vendosë për vlerën e kësaj kontrate.

Kur çështja e regjimit me marrëveshje paraqitet në gjykatë, kjo e fundit duhet të vendosë, sipas pretendimeve të palëve, nëse, kësaj kontrate dot'i japë vlerë deçizive, do e ulë pjesërisht vlerën e saj apo nuk do e marrëfare në konsideratë. Për këtë gjykata duhet të ketë parasysh dhe të vlerësojë këta elementë, të dhënë në mënyrë jo shteruese, që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në vlerën e saj.

Të tillë konsiderohen: Presioni që ushtrohet nga njëra palë mbi tjetrën¹⁰⁵; Cilësia e autonomisë dhe lirisë së vullnetit kundrejt moshës dhe pjekurisë së bashkëshortëve¹⁰⁶, Pozita ekonomike dhe sociale që njëra palë ka kundrejt tjetrës dhe ndarja e kontributeve për detyrimet që rrjedhin nga martesja, nëse këto janë parashikuar në regjimin me kontratë, kundrejt kësaj pozite¹⁰⁷; Njohuritë e

¹⁰⁵Nga gjykata duhen mbajtur në konsideratë rrethanat në të cilat arrihet marrëveshja. Duhet të verifikohet nëse ato janë të tilla ku palët kanë shprehur vullnetin e tyre të lirë, apo vullneti i tyre ka qenë i vesuar. Nëse ka qenë i lirë gjykata do t'i japë kontratës para-martesore vlerë të konsiderueshme, por nëse vullneti ka qenë i vesuar gjykata duhet të jetë shumë e kujdesshme në lidhje me fuqinë që do i japë asaj kontrate si dhe të ketë si qëllim dhënien e drejtësisë me vendimin që do të japë.

¹⁰⁶Asnjëri nga bashkëshortët nuk mund të detyrohet apo të detyrojë tjetrin në përcaktimin e një regjimi pasuror. Asnjë jashtë tyre nuk mund të detyrojë ata të zgjedhin një regjim të caktuar. Kur bashkëshortët ose njëri prej tyre janë nën 18 vjeç dhe gjykata ka lejuar lidhjen e martesës midis tyre, për shkaqe me rëndësi, ata nuk mund të vendosin për një regjim me marrëveshje. Në këtë rast duhet të veprojnë rregullat e bashkësisë ligjore. Por, mundet që negociata e regjimeve me marrëveshje të bëhet përpara moshës 18 vjeç dhe martesja të lidhet pas moshës 18 vjeç. Kështu, është shumë e rëndësishme që gjykata të verifikojë këtë. Nëse palët e kontratës kanë qenë të rritur, kontratës duhet t'i jepet më shumë vlerë, se sa kur ato janë të rinj. Kjo duhet çmuar edhe në lidhje me paafësitë fizike ose mendore të secilës palë. Pra moshja, pjekuria luajnë një rol shumë të rëndësishëm në përcaktimin e vlerës së këtyre kontratave. Prania dhe pëlqimi i njëkohshëm është gjithashtu i detyrueshëm, por jo si një element formal por substancial ku prania duhet të evidentohet aktivisht në negociata dhe pëlqimi të mos jetë sa për sy e faqe.

¹⁰⁷Sipas nenit 54 të KF, “në qoftë se kontributi i bashkëshortëve për detyrimet që rrjedhin nga martesja nuk është rregulluar me kontratën martesore, ata do të kontribuojnë për nevojat e familjes në përputhje me kushtet dhe aftësitë e tyre”. Kontributi për nevojat e familjes duket se është një institut kyç në cilësinë e jetës familjare. Kujdesi për të realizuar/përmbushur këtë kontribut shfaqet në dispozita të ndryshme të KF. Kështu kontributi, në kuptimin e masës, duhet parë në raport me të ardhurat dhe burimet që kanë bashkëshortët duke ruajtur balancën: në kuptimin që kush ka më pak burime e të ardhura nuk mund të kontribuojë më shumë. Nuk mund të lihet mënjane në listën e

pamjaftueshme të njëres palë lidhur me kontratën paramartesore¹⁰⁸; Mundësia për të patur ose jo këshillim ligjor cilësor¹⁰⁹; Një ndryshim thelbësor i rrethanave kur gjykohet çështja kundrejt rrethanave kur është lidhur kontrata Jeta familjare ka dinamikën e vet¹¹⁰. Pamundësia për të bërë një parashikim të mirë dhe të plotë të së ardhmes në momentin e lidhjes së kontratës¹¹¹ etj.

kontributeve ato që vijnë si kontribut nga puna e papaguar në shërbim dhe përkujdesje për familjen. Nisur nga rëndësia që ka kontributi për detyrimet që burojnë nga martesë, në nenin 65 ka kufizime lidhur me disponimin e të ardhurave të çdo natyre qofshin ato. Ky nen parashikon se, secili nga bashkëshortët mund të disponojë të ardhurat nga puna dhe të ardhurat e tjera, sipas regjimit pasuror martesor përkatës, pasi të ketë kontribuar në detyrimet që rrjedhin nga martesë.

¹⁰⁸Duhet që palët jo vetëm të nënshkruajnë këtë marrëveshje por edhe të kenë si qëllim atë që ato kanë nënshkruar. A janë të ndriçuar mjaftueshëm bashkëshortët e ardhshëm dhe a i kuptojnë në mënyrë të njëjtë klauzolat kontraktore? Kjo vlerësohet në raport me negociatat që palët kanë bërë para lidhjes së kontratës lidhur me regjimin pasuror martesor. Për të kuptuar këtë duhet ditur se cili ka qenë edukimi apo kualifikimi i secilës, për të parë nëse ato kanë qenë në gjendje të vlerësojnë drejt kushtet e kontratës që kanë nënshkruar si dhe a kanë patur ato mundësi për të parashikuar të ardhmen në mënyrë të tillë që të kenë qenë të bindura për pasojat që dëshironin. Pra, duhet të shikohet nëse nënshkrimi i kësaj kontrate dhe i kushteve të parashikuara në të, ka qenë ajo që palët kanë dëshiruar në të vërtetë.

¹⁰⁹Në rastet kur palët kanë lidhur një kontratë të tillë para-martesore me këshillën e avokatëve të tyre, gjykata duhet t'i japë vlerë këtij fakti, përveç rastit kur gjykata arrin në konkluzionin se marrja në konsideratë e marrëveshjes do të çojë në padrejtësi në lidhje me palët. Shkaqet se përse mund të ndodhë kjo mund të jenë të ndryshme.

¹¹⁰Disa faktorë, ndonëse sjellin ndryshim, nuk do të thotë se kanë sjellë modifikim të plotë të gjendjes nga ajo që palët kanë konsideruar në marrëveshje. Gjithsesi, është shumë e rëndësishme që të merren në analizë dhe në konsideratë ndryshimet e kushteve dhe rrethanave në momentin e zgjidhjes së martesës ose mbarimit të regjimit me atë kontratë. Është e pamundur të bësh një parashikim të mirë të së ardhmes në momentin e lidhjes së kontratës. Mund të ndodhë që kushtet të kenë pësuar një ndryshim aq drastik, sa që situata të jetë totalisht në kundërshtim me situatën në të cilën palët nënshkruan kontratën. Mundet që palët me kalimin e kohës të jenë pasuruar apo të kenë falimentuar, të jenë sëmurë apo të jenë bërë të paaftë. Nëse ky ndryshim i kushteve arrin të provohet para gjykatës, ajo do t'i shmanget zbatimit të saj, në të kundërt ajo do të zbatohet. Prandaj gjykata ka për detyrë të kontrollojë në mënyrë të pavarur marrëveshjet e bëra midis palëve dhe t'i vlerësojë ato nën dritën e rrethanave të rastit, duke vlerësuar interesat e familjes dhe të martesës si prioritare, kundrejt atyre pasurore të bashkëshortëve.

¹¹¹ Është shumë e rëndësishme që gjykata të vlerësojë edhe këta faktorë të tjerë, si: A ka fëmijë çifti në kohën e lidhjes së marrëveshjes paramartesore ose ndryshimit të regjimit pasuror? Sa janë marrë në konsideratë interesat e fëmijëve dhe nevojat për mbështetje të tyre? Zbatimi i kësaj marrëveshjeje, pra kontratës së regjimit pasuror martesor, duhet të sjellë drejtësi. Parimi i përparësisë së të drejtave e detyrimeve që burojnë nga martesë duhet të jetë orientimi kryesor në vlerën e këtij akti. Do të ishte absolutisht e pavlefshme një regjim me kontratë në të cilin cenohen elementët thelbësorë të martesës dhe familjes. Regjimi me kontratë 'është një kontratë'. Pra, kujdesi ndaj respektimit të parimeve të së drejtës kontraktore kërkon vëmendje më shumë, e cila duhet të jetë e fokusuar ndaj interesit të familjes, martesës e bashkëshortëve. Pa dyshim që një rol të veçantë pritet të luajë noteri. Nëse regjimi me kontratë nuk është zgjedhur para-martesë, atëherë çifti ka të drejtë që të kërkojë një regjim të tillë pas 2 vjetësh nga lidhja e martesës duke argumentuar se çfarë e motivon këtë ndryshim radikal, çfarë ka ndryshuar në ekonomi apo çfarë problemi ka krijuar regjimi i parë në funksion të interesit të familjes. Në çdo rast, kalimi nga një regjim pasuror në tjetrin, bëhet me pëlqimin e të dy bashkëshortëve sipas rregullave të KF. Gjithashtu, kalimi në një regjim pasuror me kontratë mund të ndodhë kur bëhet pjesëtimi i detyrueshëm i pasurisë në rastin e regjimit të bashkësisë ligjore. Në këtë mënyrë i hapet rrugë regjimit të pasurive të ndara. Kodi i familjes rendit ndër regjimet me kontratë atë të: bashkësisë me kontratë [e rregulluar në disa forma e mënyra 104] dhe atë të regjimit të pasurive të ndara.

5.4.3.2. Cështjet e barazisë dhe mosdiskriminimi në trashëgimi

Në vitin 1994, me ndryshimet politike që pasuan Shqipërinë, dhe me ardhjen në fuqi të Kodit të Ri Civil, u shfuqizua dispozitat e Kodit të mëparshëm civil, dhe Kodi i ri i kushtoi plot 102 nene institutit të trashëgimisë. Në pjesën e tretë të titulluar “Trashëgimia” e reja që prezanton Kodi Civil është rregullimi i këtij instituti më vete. Në dispozitat që rregullojnë këtë institutin parashikohet sistemi i fitimit të trashëgimisë, ku trashëgimtarit me çeljen e trashëgimisë i kalon ipso jure edhe posedimi mbi pasurinë trashëgimore, pa qenë nevoja për të venë dorë mbi te.¹¹²Sot institutin e trashëgimisë mund ta përkufizojmë si një person i cili me vdekjen humb jo vetëm zotësin juridike por edhe titullin mbi pasurin e tij, ku gjithashtu, vdekja në vetvete prodhon vetëm gjendje juridike të caktimit të pasurisë trashëgimore që i destinohet trashëgimtareve, dhe sipas nenit 316 të Kodit Civil me anë të trashëgimisë, pervec pasurisë, bëhet edhe transferimi universal i të drejtave të kësaj pasurie nga trashëgimlënësi tek një ose më shumë trashëgimtare. Një transferim i tillë në Institutin e Trashëgimisë bëhet nëpërmjet dy mënyrave: a.Së pari, trashëgimi testamentare që bëhet sipas vullnetit të testatorit. b.Se dyti, trashëgimi ligjore që bazohet në parashikimet që Kodi Civil i bën në dispozitat e tij ligjore. Trashëgimia përbën një ndër institutet më të rëndësishme të së drejtës dhe kjo për faktin jo vetëm se është një marrëdhënie juridike e cila has zbatimin më të shpeshtë dhe të vazhdueshëm në praktikë, por ajo çka është më e rëndësishme për këtë institut vjen si pasojë e objektit të këtij instituti, i cili ka të bëjë me kalimin apo transferimin e të drejtave dhe detyrimeve vetëm si pasojë e vdekjes së titullarit i cili ishte mbartës i këtyre të drejtave dhe detyrimeve pasurore. Pra, e gjithë tërësia e marrëdhënieve juridike si pronësia e të mirave materiale, të drejtat reale mbi sendet e të tjerëve, garancitë reale, kredite dhe detyrimet që iu transferohen trashëgimtareve si pasojë e vdekjes së titullarit që i mbarte këto të drejta do të quhet pronësi trashëgimore dhe personi që i

¹¹² Ligj Nr. 8116, datë 29.03.1996.

transferon këto të drejta do të quhet trashëgimlënësi.¹¹³ Rëndësia e institutit të trashëgimisë përcaktohet në rradhë të parë nga rëndësia që ka vet e drejta e pronësisë në tërësinë e saj në shoqërinë e sotme. Duke qenë një nga mënyrat më të rëndësishme dhe më e veçantë e fitimit të pronësisë ,tregon për rëndësinë e madhe që ajo merr në kushtet e sotme të ekonomisë së tregut dhe të qarkullimit të lirë të mallrave dhe kapitaleve. Edhe në kushtetuten tonë shprehimisht thuhet se: “Prona fitohet me dhurim,me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyre tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil “. ¹¹⁴ Në këtë mënyrë kushtetuta jonë e ka renditur trashëgiminë si një nga mënyrat klasike të fitimit të pronësisë, por kushtetuta si ligji themelor i çdo shteti parashikon vetëm një normë të përgjithshme me karakter deklarativ , pasi rregullimi i mëtejshëm i këtij instituti behet nga Kodi Civil. Përsa i përket karakteristikave të Institutit të së drejtës së trashëgimisë nga përmbajtja e nenit 316 të Kodit Civil ¹¹⁵ mbi trashëgiminë rezulton se trashëgimia si institut i së drejtës civile karakterizohet nga parimi i barazisë juridike midis burrit dhe gruas, midis femijeve meshkuj dhe femra si dhe midis femijeve të lindur nga martesë dhe femijëve të lindur jashtë saj. Kjo barazi shpreh karakterin human dhe demokratik të legjislacionit tonë civil, i cili rregullon marrëdhëniet juridike të trashëgimisë dhe e ka burimin te neni 18 i Kushtetutës së Shqipërisë. ¹¹⁶

Legjislacioni civil ka njohur të drejten e trashëgimlënësit për të disponuar pasurinë e tij me testament plotësisht apo pjesërisht dhe në rastin kur trashëgimlënësi ka disponuar pasurinë me testament, pasuria e tij pas vdekjes do të trashëgohet nga ata persona që trashëgimlënësi ka shprehur në vullnetin e tij. Në rastin kur zbatohet trashëgimia ligjore, ligji ka parashikuar barazinë e pjesëve midis trashëgimtarëve, që i përkasin të njëjtës rradhë trashëgimie. Në rastet

¹¹³ F.Galgano “E drejta Private” ,Botimi I Trete,2006, faqe 971.

¹¹⁴ Neni 41 I Kushtetutes Se Republikes se Shqiperise.

¹¹⁵ Neni 316 Trashegimia eshte kalimi me ligj ose me testament I pasurise (trashegimit) te personit te vdeku,nje ose me shume personave (trashegimtare),sipas rregullave te caktuara ne kete kod.

¹¹⁶ Neni 18 I Kushtetutes se Shqiperise :”Te gjithë jane te barabarte para ligjit si dhe askush nuk mund te diskriminohet per shkak te gjinins,prejardhjes,origjines shoqerore apo statusit te tij social”.

kur një trashëgimlënës, ka lenë si trashëgimtarë disa persona, të cilët i perkasin të njejtës rradhë trashëgimie, ata trashëgojnë në pjesë të barabarta, pavarësisht nga seksi dhe pavarësisht nga lidhja që kanë me trashëgimlënësin.¹¹⁷Mënyra kryesore e disponimit të pasurisë pas vdekjes së trashëgimlënësit është testamenti. Trashëgimia ligjore do të ketë vend kur:

- kur mungon testamenti;
- kur me testament është disponuar vetëm një pjesë e pasurisë trashëgimore;
- kur testamenti është tërësisht i pavlefshëm;
- kur testamenti është pjesërisht i pavlefshëm.

Rrethi i trashëgimtareve ligjore përcaktohet në Kodin tonë Civil dhe janë:

Në radhë të parë: *Ne trashëgiminë ligjore thirren fëmijët dhe bashkëshorti i aftë ose i paaftë për punë.* Në radhë të dytë: *Në trashëgime thirren prinderit e trashëgimlënësit dhe personat e paafte për punë.* Në radhë të tretë: *Në trashëgime thirren Personat e paftë për punë të trashëgimlënësit kur nuk ka trashëgimtarë të tjerë të radhës se dytë.*¹¹⁸

Kur mungojnë krejtësisht trashëgimtarët e të tri radhëve, pasuria trashëgimore u kalon të afërmeve të trashëgimlënësit më të afërt të tij, pa dallim ndërmjet vijës atësore dhe asaj amësore, por, gjithësi, jo më tej se shkalla e gjashtë dhe në qoftë se nuk ka të tillë, si trashëgimtar ligjor thërritet shteti. Nga sa më sipër mund të themi se Trashëgimia ka një rol dhe vend të veçantë në statusin pronësor të gruas, pasi në përcaktimin e radhës së trashëgimtarëve legjiscalioni aktual që bën rregullimin e institutit të trashëgimisë nuk bën dallime gjinore midis meshkujve dhe femrave që janë të aftë për të trashëguar, duke respektuar kështu edhe parimin e barazisë gjinore. Një grua bëhet pronare kryesisht, për shkak të bashkëpronësisë bashkëshortore ose trashëgimisë nga familja e origjinës, ose nga bashkëshorti pas vdekjes së tij. Që prona të fitohet me trashëgimi

¹¹⁷ Neni 361, paragrafi katër dhe pesë i tij.

¹¹⁸ Nazmi Bicoku. Veper e cituar. Faqe 74-76.

duhet të ketë vdekur personi që lë pasuri në trashëgim dhe gruaja të jetë në rrethin e trashëgimtarëve. Trashëgimia fitohet me ligj ose me testament. Rregullat përcaktohen në Kodin Civil. Trashëgimia me ligj zbatohet kur trashëgimlënësi nuk ka bërë testament. Nëse nje grua është në rrethin e trashëgimtarëve ajo përfiton të drejta mbi këtë pasuri si gjithë trashëgimtarët e tjerë. Si rregull trashëgimia çelet vetëm kur vdes trashëgimlënësi, por praktika tregon se grave ne Shqipëri u kërkohet që të nënshkruajnë një marrëveshje përmes të cilës ato shprehen për mënyrën se si do të përdoren të drejtat që rrjedhin nga një trashëgim ende i paçelur. Kjo marrëveshje është e pavlefshme. Grave u kërkohet më së shumti të heqin dorë nga trashëgimia. Kjo ndodh për shkak të kulturës zakonore, por mund të ndodh edhe për shkak të mashtrimit, frikës ose dhunës nga anëtarët meshkuj përfitues të trashëgimisë. Gratë nuk e kanë të qartë se çfarë do të thotë të heqësh dorë dhe si mund të ushtrojnë siç duhet këtë të drejtë.

5.4.4. Analizë e standardeve lidhur me mosdiskriminimin në çështjet e kujdesit shëndetësor

Problemet e shëndetit të grave janë evidente dhe çënojnë mirëqënien dhe potencialet e tyre për përmbushjen e të drejtës për shëndet. Kete analize e bejmelidhur me mbrojtjen e të drejtave të grave në sferën e shëndetit. Analiza është më shumë cilësore se sa sasiore dhe është përqendruar në çështjet e shëndetit riprodhues dhe seksual, në shëndetin e grave të dhunuara dhe trafikuar, te gratë me HIV/AIDS, te gratë në zonat rurale, etj. Shtetet kanë marrë përsipër detyrime të menjëhershme për të eliminuar diskriminimin kundër grave në fushën e kujdesit shëndetësor, për të garantuar që gratë të kenë akses të barabartë në shërbime shëndetësore. Këtu përfshihet detyrimi i shteteve për të siguruar shërbime shëndetësore për të cilat kanë nevojë vetëm gratë

*Shqipëria ka një kuadër të ri dheose të përmirësuar ligjor, ku përditësimi me CEDAW dhe standartet e dokumentave të tjerë të rëndësishëm është i dukshëm. Disa prej të cilëve janë: Ligji nr. 10221/4.2.2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”; Ratifikimi i Konventës së OKB-së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”, Ligji nr.108/2012; Ligji kuadër nr. 93/2014 “Përpërfshirjen dhe aksesueshmërinë e PAK”; Ratifikimi në vitin 2012 i Konventës së Këshillit të Europës “Për Parandalimin dhe Luftën Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje”⁸; ndryshimet në dispozita të veçanta në vitin 2012 dhe 2013 në Kodin Penal për veprat penale që lidhen me dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore; ndryshimet në Ligjin nr.9669/18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” në vitin 2010, përparim në drejtim të angazhimit për ngritjen e një qendre kombëtare për shërbime të përkujdesit social për viktimat e dhunës në familje, mbrojtja e konfidencialitetit të të dhënave dhe informacionit vetjak të viktimës dhe përmirësimit të urdhrave të mbrojtjes; Ratifikimi i Konventës të Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Për sigurinë dhe shëndetin në ndërtim”, 1988, miratuar me Ligjin nr. 5/30.01.2014, dhe “Për kuadrin promocional të sigurisë dhe të shëndetit në punë”, 2006, me miratimin e Ligjit nr. 4/30.01.2014. *Legjislacioni shqiptar në tërësi është i plotë dhe parashikon mbështetje të posaçme dhe shërbime shëndetësore të veçanta ndaj gruas, nënës dhe fëmijës. Problemet qëndrojnë në zbatimin e ligjit dhe jo thjesht në përmbajtjen e tij. Nevoja që Ligji nr.10107/30.3.2009, “Për Kujdesin Shëndetësor”, ndryshuar me ligjin nr. 51/14.2.2013, të parashikojë ofrimin e shërbimeve falas për fëmijët deri në 18 vjeç; Ligji “Për nxitjen dhe mbrojtjen e ushqyerjes me gji” të parashikojë edhe masa për mbështetjen e nënës për ushqyerjen e fëmijës me qumështin e gjirit; Ligji “Për ndërprerjen e shtatzënisë”, ndryshuar me ligjin nr. 57/14.2.2013, të parashikojë ofrimin e kujdesit shëndetësor falas, si kryerja e analizave para abortit, procedura e abortit apo vizitat pas tij, si dhe të ketë një dispozitë për detyrimin e**

institucioneve shëndetësore për të raportuar numrin e aborteve, ndonëse kjo ka rregullime në akte të tjera. Është e nevojshme të bëhen përmirësime në legjislacion në drejtime të tilla si: në lidhje me ekzaminimet depistuese dhe parandaluese lidhur me shtatzënitë e hershme, dhunën në familje dhe masat për parandalimin e saj, si dhe dhunën me bazë gjinore, shëndetin mendor, depistimin e grave për tumoret e traktit riprodhues, etj. Po kështu, është evidentuar nevoja për draftimin dhe

miratimin e një ligji që garanton njohjen e identitetit gjinor, si dhe të drejtën e femrave trans për të njohur identitetin gjinor. Nevoja për rishikime dhe përmirësime të kuadrit ligjor në lidhje me shëndetin duhet të jetë proces i vazhdueshëm dhe progresiv. Ligjet kanë nevojë për akte të tjera plotësuese si udhëzues, protokolle, urdhra, etj., me qëllim që të japin rezultatin e kërkuar. Kuadri ligjor duhet të shoqërohet me buxhetet përkatëse. Amendimet e herëpashershme të legjislacionit janë të nevojshme dhe duhen bërë në përputhje me ndryshimet dinamike që vijnë si rezultat i problemeve dhe nevojave të reja që lindin në fushën e shëndetit të grave. Ndërgjegjësimi dhe aksesimi i pamjaftueshëm i grave në shërbime, kthehen në pengesa kryesore për përfitimin e shërbimeve shëndetësore. Pavarësisht nga përmirësimi i treguesve shëndetësor dhe të ushqyerjes së nënës dhe fëmijës, ka pabarazi shëndetësore të lidhura me moshën, gjininë, mentalitetin, nivelin social-ekonomik, zonën gjeografike dhe vendbanimin. Ka një mungesë faktike të shërbimeve të integruara, që rezulton në boshllëqe kritike shëndetësore të cilat kufizojnë efektivitetin e programeve të SHSR dhe komprometojnë shëndetin e njerëzve, si dhe ushqejnë diskriminimin ndaj grupeve vulnerabël.

5.5. Standarte të disa legjislacioneve europiane në lidhje me barazinë ligjore

Pas vitit 2001 femrat ndodhen në kushte më të mira dhe kanë përmirësuar pozitën e tyre kundrejt meshkujve. Për shembull, në shumicën e vendeve të BE-së, gratë që diplomohen në Universitet janë më të shumta në numër se meshkujt. Megjithatë, në postet drejtuese akademike në universitetet evropiane dhe kryesisht në organet e niveleve të larta vendimore mbizotërojnë ende meshkujt. Sipas Raportit Evropian ST Indicators rezulton se numrin më të madh të të punësuarve femra në Universitete e përfshin Irlanda me 46%, më pas Portugalia me 45 %, Greqia 44%, Finlanda 42%, Spanja 34%, Suedia 33%, Franca 32%, Belgjika me 28%, Austria dhe Gjermania me 26%.

Është karakteristikë e rëndësishme e teknologjive të reja në kuadrin e Ekonomisë së Re, fakti se 80% e vendeve të punës në BE, vitet e fundit janë kryesisht vende që kërkojnë njohuri të specializuara në lidhje me teknologjitë e reja. Por femrat duket se u shmangen këtyre trendeve duke preferuar fushat teorike shkencore, fusha që përkohë me një papunësi të madhe në tërësi. Në universitete, tek teknologjitë e reja përfshihen vetëm 20% femra, pra meshkujt i kalojnë 2 apo 4 herë më tepër, ndërsa femrat përbëjnë 1/3 deri 1/4 e shkencave e personelit të laboratorëve shkencorë¹¹⁹. Shkaqet e shmangies lidhen me parametra sociale dhe lidhen me stereotipa dhe paragjykime që inkurajojnë femrat për t'u marrë me teknologjitë, duke mbyllur lakun e zgjedhjeve të tyre në karrierën e mëvonshme. Ndërkohë që në lidhje me përfshirjen në jetën politike, nëse i referohemi situatës aktuale na rezulton se pjesëmarrja e gruas në fushatën elektorale është domethënëse, por sigurisht mbetet akoma për të bërë. Bëhet fjalë për pjesëmarrjen e grave intelektuale, grave të suksesshme në karrierë në botën e politikës dhe vendimarrje, e cila në fakt tregon një emancipim të vetë politikës që sigurisht reflektohet më konkretisht tek shoqëria shqipëtare.

¹¹⁹BE-ja përveç Strategjisë *Europa 2020*, mbështet objektivat e Shteteve Anëtare, duke siguruar fonde për projekte nëpërmjet Fondit Social European (ESF), duke përfshirë edhe projektet që synojnë:

- Promovimin e aksesit dhe pjesëmarrjes së grave në të gjitha nivelet e tregut të punës dhe ndihmojnë në mbushjen e boshllëqeve të ngushta mes pagave dhe që mbështesin pavarësinë financiare të grave;
- Promovimin e grave sipërmarrëse dhe pjesëmarrjen e grave në shkencë dhe teknologji, në veçanti në pozicione vendimmarrëse;
- Eliminimin e stereotipeve gjinore në përzgjedhjen e karrierës dhe profesionit, si dhe promovimin e të mësuarit gjatë gjithë jetës;
- Bashkërendimin e punës dhe jetës familjare dhe ofrimin e mbështetjes dhe lehtësimeve për kujdesin për fëmijëve
- Mbështetjen për integrimin në punësimin e grave emigrante.

Në tërësi janë 11 shtete të Evropës ku në forma të ndryshme, kuota ose parimi i balancës gjinore është vendosur në ligj. Disa prej tyre kanë parashikuar kuota dhe në Kushtetutë, por shumica e kuotave janë parashikuar në ligjet zgjedhore dhe ato të barazisë gjinore. Kryesisht këto vende kanë parashikuar kuota si për organet qendrore edhe për ato vendore, por ka edhe vende që kanë parashikuar vetëm kuota vendore. Më poshtë po japim disa shembuj të legjislacioneve europiane për ilustrim dhe krahasim me legjislacionin tonë.

Pjesëmarrja e gruas në tregun e punës në BE është rritur nga 55% që ishte në vitin 1997 aktualisht ka shkuar në 63%. Edhe pse kjo paraqet një përparim të dukshëm, pjesëmarrja e grave në tregun e punës në BE është ende dukshëm më e ulët se ajo e burrave, të cilët aktualisht përbëjnë 75% të këtij tregu.

Ka dallime të konsiderueshme edhe ndërmjet Shteteve Anëtare kur është fjala për gratë e punësuar. Shkalla e punësimit të femrave është më e ulët se 60% në Greqi, Itali, Maltë, Kroaci, Spanjë, Hungari, Rumani, Sllovaki dhe Poloni, ndërkohë që është mbi 70% në Suedi, Danimarkë, Gjermani, Finlandë, Holandë, Austri dhe Estoni.

Natyra e vendeve të punës që gratë marrin përsipër është po aq e rëndësishme për adresimin e pabarazisë sa edhe niveli i përgjithshëm i punësimit. 32% e grave punojnë me kohë të pjesshme krahasuar me vetëm 8% të meshkujve. Kjo mund të çojë në mundësi të vogla për të bërë karrierë, pagë më e ulët dhe pensione të ulta në të ardhmen, nënshfrytëzim i kapitalit njerëzor dhe një rritje në këtë mënyrë më të ulët të ekonomisë dhe prosperitetit. Prandaj boshllëqet gjinore japin rritje si të kostove ekonomike ashtu edhe atyre sociale dhe duhet të trajtohen në mënyrë efektive sa herë që ato rezultojnë si nga barrierat shoqërore apo kufizimet shoqërore e institucionale.

Shtetet Anëtare me një punësim të femrave me kohë të pjesshme mbi mesataren e BE-së janë Holanda, Gjermania, Austria, Belgjika, Mbretëria e Bashkuar, Suedia, Luksemburgu, Danimarka dhe Irlanda.

Mungesa e ekuilibrit në statusin e punësimit të grave dhe burrave është reflektuar edhe në hendekun e pagave sipas gjinive dhe më pas në pensione më të ulëta të grave, duke krijuar kështu një rrezik më të lartë të varfërisë për gratë.

Për çdo orë pune gratë fitojnë mesatarisht 16.4% më pak se meshkujt. Kjo shifër është mbi 20% në Republikën Çeke, Austri, Estoni dhe Gjermani. "Hendeku gjinor i pensioneve" tregon se, mesatarisht në të gjithë BE-në, pensionet e grave janë 39% më të ulëta se pensionet e burrave.

Me miratimin e legjislacionit, vendosjen e objektivave, lëshimin e rekomandimeve dhe inkurajimin e transferimit të praktikave më të mira, BE-ja ka ndikuar në politikat kombëtare për lehtësimin ekuilibrit punë-jetë.

Vetëm disa nga Shtetet Anëtare (kryesisht vendet nordike dhe ato balltike) kanë pasur sukses në kombinimin e normave të larta të punësimit të femrave dhe një hendeku të ngushtë gjinor në orët e punës. Një përzjerje efektive politike duket se duhet të përfshijë kohë pune të barabartë mes gjinive të ndryshme, punë gjerësisht të disponueshme dhe fleksibël, stimuj për ndarjen e punës së papaguar brenda një çifti, dhe punësime të arritshme dhe të përballueshme me orë më të gjata kujdesi ndaj fëmijëve.

Si pjesë e strategjisë së saj ekonomike, *Europa 2020*, të gjitha shtetet anëtare të BE-së janë angazhuar për të rritur normën e punësimit të të rriturve në 75% deri në vitin 2020. Komisioni po ndjek këtë angazhim kombëtar duke i propozuar rekomandime çdo vit Shteteve Anëtare, të cilat përfshijnë çështjen e pjesëmarrjes së femrave në tregun e punës. Rekomandimet specifike ndaj Shteteve të vitit 2013, të miratuara nga Këshilli mbështesin sigurimin e cilësisë dhe kujdesin e lartë dhe të përballueshëm ndaj fëmijëve, si dhe stimuj të përshtatshëm tatimorë për gratë për të qëndruar në shtëpi, ose për tu kthyer në punë. Përveç kësaj, Rekomandimet adresuan nevojën për të siguruar shërbime kujdesi për të moshuarit për të lejuar gratë të punojnë më shumë, dhe duke trajtuar kështu boshllëqet në paga dhe pensione.

Siç e vuri në dukje dhe Raporti i Përbashkët i Punësimit i paraqitur në nëntor të vitit 2013, ka pasur progres me ndjekjen e këtyre rekomandimeve. Shtetet Anëtare kanë zbatuar masat për të rritur normat e punësimit të femrave dhe për të balancuar punën me jetën private, si psh. duke ofruar më shumë shërbime në dispozicion të fëmijëve të vegjël për arsimin dhe kujdesin dhe duke rishikuar rregulloret e prindërve, për të zgjeruar këtë të drejtë dhe për të inkurajuar më shumë baballarë që t'i përdorin ato.

Në bazë të Direktivës së punëtoveve shtatzëna të BE-së, të gjitha gratë në BE kanë të drejtën të kenë një leje lindjeje me të paktën 14 javë si dhe të drejtën e mbrojtës nga shkarkimi për shkak se janë shtatzënë. Në vitin 2008, Komisioni propozoi përmirësimin e situatës së mëtejshme me leje lindjeje më të gjatë dhe më të mirë¹²⁰. Sipas Programit të Punës të Komisionit për vitin 2015, nevojitet një periudhë gjashtë mujore për të arritur një përparim në këtë skemë. Nëse nuk arrihet

¹²⁰ Propozimi i Komisionit i cili do të rrisë të drejtën minimale në 18 javë të paguar në nivelin e pagës së paaftësisë për shkak të sëmundjes- është ende në diskutim në Këshillin e BE-së dhe Parlamentin Europian.

asnjëra prej këtyre parashikimeve, atëherë ky propozim do të zëvendësohet nga një iniciativë e re. Punëtorët e vetëpunësuar dhe partnerët e tyre mund të gëzojnë një mbrojtje sociale më të mirë- duke përfshirë të drejtën për leje lindje për herë të parë- në bazë të ligjit të ri europian për punëtorët e vetëpunësuar. Ligji dukshëm përmirëson mbrojtjen e punëtoreve femra të vetëpunësuar dhe asistimin e bashkëshortëve ose partnerëve të jetës. Për shembull, ata përfitojnë të ardhura të barrëlindjes dhe një leje lindjeje për të paktën 14 javë, sigurisht nëse zgjedhin ta kërkojnë atë. Në nivelin e Bashkimit Europian, është hera e parë që jepet leja prindërore për punëtorët e vetëpunësuar.

Dispozita mbi mbrojtjen sociale për bashkëshortët dhe partnerët e jetës (i njohur po ashtu edhe në ligjin kombëtar) është gjithashtu një përmirësim i konsiderueshëm prej Direktivës 1986. Ato kanë të drejtën e mbulimit të sigurimeve shoqërore (të tilla si pensionet) mbi baza të barabarta si punëtoresh formal të vetëpunësuar, nëse Shteti Anëtar ofron mbrojtje të tillë për punëtorët e vetëpunësuar. Kjo ndihmesë siguron një rrjet të fortë të sigurisë sociale dhe parandalon që gratë të zhyten në varfëri.

Direktiva e Bashkimit Europian për lejen prindërore përcakton kërkesat minimale për lejen prindërore, bazuar në marrëveshjen kuadër konkluduar nga partnerët social europian. Sipas Direktivës, punëtorët meshkuj dhe femra kanë të drejta individuale për lejen prindërore në bazë të lindjes apo adoptimit të një fëmije, duke gëzuar të drejtën që të kujdesen për fëmijën për së paku katër muaj (shih IP / 09/1854). Kjo bëhet me qëllim për të ndihmuar njerëzit të balancojnë jetën familjare dhe punën, duke promovuar mundësi të barabarta për burrat dhe gratë në tregun e punës. Për të inkurajuar baballarët që të marrin dhe ata lejen prindërore, nën parashikimet e direktivës së rishikuar, një nga katër muajt nuk është e transferueshme që do të thotë se në qoftë se babai nuk e kërkon atë, atëherë humbet një e drejtë e tillë.

Një faktor shumë i rëndësishëm në hendekun e pagës është barra e kujdesit që mbajnë gratë. Të dhënat tregojnë se në kohën kur meshkujt bëhen prindër, ata fillojnë të punojnë me orar të zgjatur. Ndërkohë, nuk ndodh e njëjta gjë me gratë. Kur ato bëhen nëna, ato ose reshtin së punuari me kohë të gjatë, ose punojnë me kohë të pjesshme, shpesh pa e dëshiruar një gjë të tillë.

Sigurimi i një dispozite të përshtatshme për kujdesin ndaj fëmijëve shërben si hap thelbësor për mundësi të barabarta në punësim midis femrave dhe meshkujve. Në vitin 2002, në Samitin e Barcelonës, u vendosën objektiva për ofrimin e kujdesin ndaj fëmijëve për: të paktën 90% të fëmijëve nga moshë 3 vjeç deri në moshën e arsimit të detyrueshëm dhe të paktën 33% të

fëmijëve nën moshën 3 vjeçare. Që nga viti 2007, përqindja e kujdesit ndaj fëmijëve bazuar marrëveshjeve formale të kujdesit për fëmijët është rritur pak (nga 26% në 28% për fëmijët deri në moshën tre vjeçare, dhe nga 81% në 83% për fëmijët nga mosha 3 vjeç deri në moshën e arsimit të detyrueshëm).

Ndërsa disa vende janë në rrugën e duhur për të arritur barazi në parlamentet kombëtare dhe në qeveri, gratë përbëjnë më pak se një e treta e ministrave dhe anëtarëve të parlamenteve në shumicën dërrmuese të vendeve anëtare. Në gjashtë shtete anëtare, femrat përbëjnë më pak se 20% të anëtarëve të parlamenteve si psh: Hungari (10%), Malta, Rumania, Qipro (14%), Irlanda (16%) dhe Lituania (18%).

Në nivel europian, gratë përbëjnë 37% të deputetëve në Parlamentin Europian. Kjo paraqet një përmirësim të qëndrueshëm nga 35% në 2009 dhe 31% në vitin 2004. Në Komision, 31% e Komisionerëve në Komisionin Junker janë femra, e cila është e njëjtë si niveli i Komisionit II Barroso I. Në Komisionin II Barroso nga 2004-2009, 29% e të Komisionerëve ishin femra.

Komisioni Europian ka rreth 450 anëtarë të stafit në të ashtuquajturin nivel të lartë të menaxhimit dhe rreth 1.200 në nivel të menaxhimit të mesëm. Numri i punonjësve femra në nivelin e lartë të menaxhimit është rritur nga 22% në 27,5% që nga 2010. Kurse në menaxhimin e mesëm numri i femrave është rritur nga 25% në 31,4% në të njëjtin cikël kohor. Qëllimi është për të arritur 40% deri në fund të mandatit të Komisionit të tanishëm në 2019 dhe shifrat të shkojnë përtej në afat më të gjatë, duke identifikuar staf të talentuar me femra me potencial, t inkurajojmë ato që të aplikojnë për poste drejtuese dhe t mbështesim gjatë rrugës.

Po ashtu BE-ja ka adresuar edhe problemet e dhunës kundër grave. Sipas Deklaratës 19 aneksuar Traktatit të Lisbonës, shtetet anëtare duhet të marrin të gjitha hapat e nevojshme për të trajtuar dhunën në familje dhe të ndihmojnë në mbrojtjen e viktimave. Gratë dhe vajzat që janë viktima të dhunës kanë nevojë për mbështetjen dhe mbrojtjen e duhur, e cila është e përforcuar nga ligjet në fuqi.

BE-ja ka punuar për të mbledhur të dhëna të sakta dhe të krahasueshme europiane mbi dhunën me bazë gjinore. Studimi i parë i gjerë i BE-në mbi përvojat e grave-viktimë të formave të ndryshme të dhunës, i ndërmarrë nga Agjencia e Bashkimit Europian për të Drejtat Themelore (FRA), tregon se dhuna ndodh kudo, në çdo shoqëri, qoftë në shtëpi, në punë, në shkollë, në rrugë apo online. Mesatarisht, çdo minutë të çdo ditë në Europë, 7 gra janë viktima të

përdhunimit apo sulmi tjetër seksual, 25 janë viktime të dhunës fizike dhe 74 janë viktime të ngacmimeve seksuale. Dhuna kibernetike është një shqetësim në rritje: 10% e grave kanë qenë viktime të ngacmimeve seksuale online, sic del po nga ky studim.

Viktimat e dhunës, kryesisht dhunës në familje, së shpejti mund të mbështeten në mbrojtje të gjerë nga institucionet e BE. BE-ja parashikon një paketë masash për të siguruar se të drejtat e viktimave nuk neglizhohen, dhe viktimat trajtohen drejtësisht. *Direktiva e të Drejtave të Viktimave*, e miratuar më 25 tetor 2012 siguron që viktimat trajtohen me respekt dhe marrin mbrojtjen e duhur, mbështetje dhe qasje në drejtësi. Direktiva forcon në mënyrë të konsiderueshme të drejtat e viktimave dhe anëtarëve të familjeve të tyre për informacioni, mbështetje e mbrojtje, si dhe të drejtat e tyre procedurale kur marrin pjesë në procedimet penale. Shumica e viktimave të trafikimit të regjistruara në BE janë gra dhe vajza (80%). BE-ja e ka njohur trafikimin e grave dhe vajzave si një formë e dhunës kundër grave dhe ka miratuar një kornizë gjithëpërfshirëse ligjore dhe politika për ta çrrënjësuar atë. Direktiva 2011/36 /EU e Anti-trafikimit është gjinore, e përqendruar në viktimat, dhe bazuar në të drejtat e njeriut. Përveç përafrimit të shteteve të BE-së me ligjet thelbësore penale, ajo përcakton dispozita të fuqishme për mbrojtjen e viktimave dhe parandalimin, si dhe mbështet parimin e mos-ndëshkimit dhe ndihmën e pakushtëzuar të viktimave. Strategjia e BE-së drejt Zhdukjes së Trafikimit të Qenieve Njerëzore shoqëron legjislacionin 2012-2016 me një sërë veprimesh, duke përfshirë dimensionet gjinore të trafikimit të qenieve njerëzore. Përveç kësaj, dy instrumente sigurojnë që viktimat të cilat përfitojnë nga një masë mbrojtëse në një vend të BE, janë të pajisura me të njëjtin nivel të mbrojtjes në vendet e tjera të BE ku ata lëvizin ose udhëtojnë. Në këtë mënyrë, mbrojtja do të udhëtojë me individin dhe nga kjo do të përfitojnë gratë në veçanti. Komisioni Europian financon fushata të shumta për rritjen e ndërgjegjësimit në vendet e BE dhe mbështet organizata, OJQ-të dhe rrjetet që punojnë për të parandaluar dhunën ndaj grave¹²¹.

Marrëveshja e Bashkimit Evropian e vitit 1995, në nenin 6 dhe 7 të saj i referohet në mënyrë të qartë Konventës së vitit 1950 edhe pse Bashkimi Evropian nuk është pjesë e Konventës si anëtar. Në vitin 2000 u hartua një Konventë për përgatitjen e Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së, e miratuar nga samiti i Nisës në po atë vit. Deri më tani, kjo Kartë është dokumenti më modern i të drejtave të njeriut në Evropë. Ajo përfshin të drejtat civile dhe politike, ashtu si dhe ato

¹²¹Programet kryesore të financimit janë quajtur *Daphne III* dhe *Progress*. Kshtu p.sh. qëllimi i programit të ardhshëm PROGRESS është të japë mbështetje financiare për vënien në jetë të objektivave të BE-së në fushën e punësimit dhe çështjeve sociale, duke kontribuar në këtë mënyrë në arritjen e objektivave të Strategjisë së Lisbonës.

ekonomike, sociale dhe kulturore, njësoj si Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut. Megjithatë, duke qenë se përfshin një numër detyrimesh të cilat bëjnë pjesë në marrëveshje të ndryshme ndërkombëtare ku vendet e BE-së janë anëtare, Karta mund të konsiderohet si një interpretim dhe qartësim i këtyre detyrimeve. Që prej 1995-s, BE përfshin në marrëveshjet e dyanshme klauzola të të drejtave të njeriut, si për shembull në Marrëveshjet e Stabilizim- Asociimit.

Bashkimi Evropian ka hartuar politika të të drejtave të njeriut, si për marrëdhëniet e brendshme, ashtu edhe për ato ndërkombëtare, pjesë e Politikave të Përbashkëta të Sigurimit me Jashtë. Raporti Vjetor i të Drejtave të Njeriut, i publikuar nga Këshilli i Bashkimit Evropian, pasqyron rëndësinë që kanë këto politika për Bashkimin Evropian. Këshilli bën deklarata publike por është gjithashtu aktiv prapa skene me anë të një diplomacie të drejtash njeriu të bazuar në raste. Bashkë me Komisionin Evropian, Këshilli merr përsipër dialogë të të drejtave të njeriut me disa shtete si Kina dhe Irani. Parlamenti Evropian ka luajtur një rol kryesor në ruajtjen e rëndësisë së të drejtave të njeriut në programin e BE-së. Ky Parlament gjithashtu nxjerr raporte vjetore të të drejtave të njeriut. Me iniciativën e Parlamentit është vënë në dispozicion mbështetje financiare për projekte të OJF-ve në fushën e të drejtave të njeriut dhe demokracisë.

Si donatori më i madh në botë, BE-ja ka një rol vendimtar për të luajtur në fuqizimin e grave dhe vajzave dhe në promovimin e barazisë gjinore. OZHM-të (Millenium Development Goals) kanë luajtur një rol të rëndësishëm në rritjen e vëmendjes për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave. Kontributi i BE-së ka ndihmuar edhe për të arritur një përparim konkret që nga 2004. Kjo megjithatë, nuk është e mjaftueshme sepse ekzistojnë ende shumë boshllëqe.

Barazia gjinore, të drejtat e njeriut dhe fuqizimi i grave dhe vajzave janë parakushte thelbësore për zhvillimin e qëndrueshëm të barabartë dhe gjithëpërfshirës, si dhe përbëjnë në vetvete vlera të rëndësishme dhe objektiva. Aktualisht, BE-ja është e përfshirë në diskutimet globale për një axhendë të re të zhvillimit dhe është e bindur se kjo *axhendë post-2015* e zhvillimit botëror ka nevojë për një qëllim më vete për të arritur barazinë gjinore dhe fuqizimin e të gjitha grave dhe vajzave.

Kapitulli VII- Konkluzione dhe rekomandime

7.1. Konkluzione

Në përfundim të këtij studimi, si konkluzion, mund të themi se ka qenë dhe është e vështirë për tu marrë me çështjet e pabarazisë gjinore ekzistuese dhe për të ecur përpara drejt një barazie më të madhe në lidhje me eksperiencat jetësore dhe shpërndarjen e oportuniteteve midis burrave dhe grave. Të drejtat e grave, realizimi i tyre dhe rritja e barazisë gjinore shtrohen sot me forcë nisur edhe nga koncepti modern i vlerësimit të të drejtave tyre si pjesë integrale e të drejtave të njeriut. Përtej dallimit mashkull- femër dhe burrë- grua qëndron një thelb i përbashkët njerëzor dhe human. Është pikërisht kjo “esencë” njerëzore që i bën dhe duhet t’i bëjë gratë mbartëse legjitime të të drejtave të barabarta me burrat në kontekstin e një shoqërie të lirë dhe demokratike. Shtetet me demokraci të zhvilluar kanë treguar se arritja e këtij synimi nuk është një utopi. Mjeti i domosdoshëm për realizimin e këtij qëllimi është krijimi i shoqërisë dhe mundësive të barabarta për të dyja gjinitë dhe nëpërmjet bashkëveprimit të të dyja gjinive, të burrave dhe grave, në të gjitha fushat dhe sferat e organizimit shoqëror. Në këtë drejtim si konkluzion mund të veçojmë aspektet ligjore dhe masat institucionale në Shqipëri:

Ratifikimi i një numri të madh konventash nuk e ezauron plotësisht problemin, sepse ende zbatueshmëria e Konventave nuk është e duhura, kjo edhe për efekt të njohurive të kufizuara lidhur me to, por edhe sepse vetëzbatueshmëria e tyre nuk është e mundur, për shkak se kërkohet dalja e një ligji të veçantë.

Mundësia dhe detyrimi i rregullimeve ligjore konform standarteve ndërkombëtare dhe europiane; Mungesa e sigurisë në të drejtat e shpallura dhe moszbatimi i ligjit mbeten me rëndësi prioritare. Ndërhyrjet ligjore duhet të mbajnë në konsideratë ndikimet e së drejtës zakonore me qëllim eliminimin e tyre.

Ndonëse kuadri ligjor vendas përgjithësisht është i kompletuar nën dritën edhe të akteve ndërkombëtare e rajonale, sërish problem kryesor mbetet moszbatimi në masën e duhur i tij, sidomos kur flasim për çështje të të drejtave dhe pozicionit të gruas në familje e shoqëri për garantimin e barazisë gjinore dhe integritet gjinor.

Analizat në përgjithësi për barazinë gjinore bazohen në katër fusha kryesore: pjesëmarrja dhe mundësitë ekonomike (fuqia punëtore femërore, barazia në paga, përqindja e grave në pozita

të larta), qasja në arsim (shkrim-leximi i grave dhe nëse ato kanë shkollim të lartë) Shëndeti dhe mbijetesja (jetëgjatësia për meshkujt dhe femrat, norma e vdekjeve) dhe pushteti politik (numri i femrave në pozitat e larta politike në 50 vitet e fundit). Ky studim është fokusuar në tre fusha: politikë (udhëheqje dhe vendim-bërje), ekonomi (punësim dhe gjenerim i të ardhurave), dhe marrëdhëniet në martesë dhe familje.

Arsyet e kësaj analize përforcohen nga fakti se ekziston një mungesë progresi në zvogëlimin e pabarazive gjinore, në vecanti si pasojë e një angazhimi të dobët politik dhe e ekzistencës së strukturave makroekonomike mospërfillëse ndaj gender-it. Barazia e vërtetë gjinore realizohet në kushtet e demokracisë dhe lirisë. Kjo vërtetohet edhe në shoqërinë tonë edhe për gratë shqiptare, të cilat, duke u bërë pjesë e kalimit nga diktatura në liri dhe demokraci, projektuan një perspektivë të re për arritjen e barazisë gjinore.

Historia e zhvillimit të së drejtës së të drejtave të njeriut tregon se çështjet e ashtuquajtura të grave janë bërë të dukshme për shkak të rritjes së aktivitetit të grave në arenën ndërkombëtare. Diskutimi i të drejtave të njeriut në lidhje me pozicionin dhe çështjet e grave buronte nga koncepti dhe rregullat e së drejtës ndërkombëtare tradicionale të formuluar nga burrat. Për shkak të roleve të ndërvarura sociale të grave, ato nuk ishin të pranishme në këtë proces. Akoma më shumë çështja lidhej edhe me dhunën ndaj tyre. Një numër i madh dokumentesh të tjera ligjore dhe të politikës së Kombeve të Bashkuara si dhe dokumente ndërkombëtare dhe rajonale argumentojnë që dhuna gjinore është formë dalluese e diskriminimit e cila përbën një dhunim të së drejtës ndërkombëtare të të drejtave njerëzore, në vetvete. Ndërsa aktet e dhunës janë kryer në të gjithë sektorët e shoqërisë, dhuna gjinore, si dhuna në familje, është drejtuar kryesisht tek gratë me qëllim që t'u heqë atyre një gamë të drejtash dhe të ruajë varësinë e tyre si grup. Trajtimi i dhunës kundër grave si formë diskriminimi është i pranishëm edhe në nivelin kombëtar. Në disa sisteme ligjore kombëtare, forma të caktuara të dhunës kundër grave i janë nënshtruar rishikimit gjyqësor në përputhje me legjislacionin përkatës jodiskriminues.

Dhuna në familje është një nga format më të përhapura të dhunës dhe të diskriminimit kundër grave. Pavarësisht nga treguesit e përhapjes së kësaj forme dhune, deri së fundi ajo nuk njihet si dhunim i të drejtave njerëzore të grave. Dështimi i shteteve për t'iu adresuar dhunës në familje si dhunim i të drejtave njerëzore të grave i është atribuar ndarjes së sferës publike dhe private dhe sistemit qëndror shtetëror të së drejtës ndërkombëtare. Të gjitha të drejtat njerëzore dhe liritë

e listuara njihen gjerësisht nga komuniteti ndërkombëtar. Karta e Kombeve të Bashkuara vendosi elemente të reja reale të një rëndësie të madhe për gratë. Kombeve të Bashkuara iu dha mandati të promovonin progresin dhe zhvillimin ekonomik e social dhe të krijonin organizma ndihmës. Miratimi i KEFDG nga ana tjetër u shoqërua me një numër të madh instrumentesh ndërkombëtare dhe rajonale të të drejtave të njeriut dhe dokumentesh të politikës, që detyruan qeveritë të ndërmarrin hapa në politikat kombëtare me synim mbrojtjen, përmbushjen dhe zbatimin e të drejtave të grave. Të gjitha format e dhunës kundër grave shkojnë përtej sjelljes shtypëse ose diskriminimit në përgjithësi dhe përbëjnë dëm, i cili rezulton nga forca ose detyrimi. Ato janë shoqëruar me pabarazi midis burrave dhe grave dhe strategji që përjetësojnë ose rrënjësojnë atë pabarazi. Kështu, dhuna kundër grave është një shfaqje e pozicioneve themelore të pabarabarta midis burrave dhe grave dhe përbën një formë të diskriminimit kundër grave.

Kjo çështje ka rëndësi edhe në Bashkimin Europian. Në BE koncepti i barazisë gjinore dhe diskriminimit është në evolucion të vazhdueshëm dhe interpretimet e tij rast pas rasti sjellin risi dhe ndryshime çdo ditë. Pas një lufte të gjatë lufta kundër diskriminimit është kthyer në një nga parimet kryesore të funksionimit të parimit të të drejtave të njeriut në BE. Parimi i mosdiskriminimit duhet të kthehet në një parim bazë që të përshkojë edhe legjisllacionin shqiptar.

I gjithë sistemi ligjor shqiptar është bazuar në parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit. Gjithashtu, mbrojtja dhe respektimi i dinjitetit, i të drejtave dhe lirive të njeriut përbën detyrim kushtetues. Jeta, martesë, familja gëzojnë mbrojtje të veçantë nga ana e shtetit. Kushtetuta nuk e përjashton mbrojtjen e familjes edhe në rastet kur nuk është e krijuar me martesë. Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti. Shqipëria është mjaft e pasur me strategji dhe dokumenta për integrimin gjinor por kjo nuk është e mjaftueshme. Ligji “Për barazinë gjinore në shoqëri” ka paraqitur vështirësi për zbatimin e tij në praktikë në lidhje me mekanizmat institucionalë dhe përgjegjësitë e tyre. Mundësitë për t’u ankuar në rastin e një diskriminimi gjinor dhe në aspekte të tjera, ndonëse parashikon si detyrë të qeverisë dhe të administratës publike nxjerrjen e statistikave gjinore në të gjithë administratën publike dhe në sektorin privat, ai nuk përcakton strukturat e caktuara shtetërore për kryerjen e kësaj detyre dhe afatet kohore të realizimit të saj. Ligji ka natyrë përshkruese dhe nuk përcakton detyra të qarta për respektimin e barazisë gjinore. Të gjitha këto probleme kanë bërë që të ndërmerren nisma për amendimin e tij.

Mund të themi në të vërtetë që niveli i përafrimit të legjislacionit në Shqipëri me standardet e BE-së, është në nivele të kënaqshme përse i përket procesit të hartimit dhe miratimit të legjislacionit kryesor, por jo të legjislacionit dytësor. Për më tepër ende në Shqipëri jemi larg ngritjes dhe mirëfunionimit të mekanizmave zbatues dhe mbikqyrës të legjislacionit kundër diskriminimit. Gjithashtu, siç është paraqitur disa herë si shqetësim, jo vetëm nga organizatat ndërkombëtare por edhe OJF-të vendase, sistemi gjyqësor, për shkak të nivelit të ulët dhe besimit të pakët në publik, nuk është në gjendje të ofrojë garanci në luftën kundër diskriminimit. Ka ardhur momenti që gjykatat shqiptare dhe veçanërisht Gjykata Kushtetuese të krijojnë jurisprudencën e tyre të pasur në luftën kundër diskriminimit dhe pabarazive sidomos gjinore.

Vetë Direktivat dhe aktet e tjera të së drejtës europiane kundër diskriminimit janë në ndryshim të vazhdueshëm, prandaj mendoj se është e nevojshme fillimi i zbatimit dhe i përfshirjes së këtyre akteve në legjislacionin e brendshëm. Megjithë karakterin e tyre të zbatueshmërisë së drejtpërdrejtë, për shkak të interpretimeve nga ana e Gjykatës Europiane të Drejtësisë, është e domosdoshme që Direktivat e BE-së, të përkthehen në legjislacionin e brendshëm shqiptar me ligje apo akte të tjera.

Për zbatimin e një politike të ndërgjegjshme nga pikpamja gjinore, kërkohet një mjedis institucional i ndërgjegjshëm ndaj plotësisht të nevojave të veçanta të djemve dhe vajzave. Pra sa i ndërgjegjshëm është ky mjedis për të zbatuar tashmë programe që adresojnë pabarazitë gjinore dhe promovojnë barazinë. Kur bëhet fjalë për raportin e familjes me shoqërinë globale duhet marrë parasysh kufiri kohor dhe hapësinor. Familja si institucion dhe ndërveprimi i saj me institucione të tjera përbëjnë bazat mbi të cilën ngrihet jeta sociale. Ato janë rregullatore jetike të marrëdhënieve që krijojnë qëniet njerëzore me njëra tjetrën me anë të cilëve sigurohet vazhdimësia e brezave (Giddens: 2007). Sipas sociologëve institucionet shoqërore i përgjigjen nevojave bazë dhe kanë attribute të përbashkëta si psh: përgjithësisht janë të paplanifikuara dhe zhvillohen gradualisht; janë konservative; ndryshojnë por gradualisht janë të ndërvarura; për këtë arsye ndryshimet në njërin prej këtyre institucioneve ka tendencë të sjellë ndryshime tek të tjerat, së fundmi statuset, rolet, vlerat dhe normat mund të sjellin ngjashmëri dhe tek institucionet e tjera.

Problemet gjinore tashmë janë vendosur në një perspektivë të re institucionale dhe ligjore. Shtetet dhe aktoret kryesore institucionale kanë mundësi që të kontribuojnë për një barazi më të madhe gjinore. Sot dimensionet e lirisë janë zgjeruar, shoqëria është më e vetëdijesuar për

të drejtat e grave dhe rolin që ato duhet të kenë në shoqëri. Në shoqërinë shqiptare me orientim maskilist, me doza të forta të mentalitetit tradicional që legjitimon pushtetin e burrave vazhdon të mbijetojë dhe të prodhojë stereotipet gjinore, dhunën, diskriminimin dhe pabarazitë në gjininë tjetër. Prania ende e fuqishme e stereotipeve gjinore dhe e dhunës në familje është dëshmia më e qartë se problemii pabarazisë gjinore është prezent, strukturor dhe kompleks. Një nga shkaqet e lëvizjes së ngadalshme në rrugën e emancipimit shoqëror është fakti se shumë aktivitete, konfekonceptohen si çështje ekskluzive të grave. Promovimi i të drejtave të grave dhe nismat për përmirësimin e statutit të tyre në shoqëri shpesh bëhet nga këndvështrime feminist. Fakti që të drejtat e grave janë legalizuar si pjesë integrale e të drejtave të njeriut, është një hap progresiv në rrugën e zhvillimit demokratik të vendit. Por retorikat patetike për respektin e të drejtave të grave nuk mund të fshehin realitetin gri, disavantazhet, pengesat dhe problemet sociale me të cilat ballafaqohen femrat në përpjekjet e tyre për pjesmarrje dhe status të barabartë në shoqëri. Procesi i kalimit nga ekonomia e centralizuar në ekonominë e tregut është shoqëruar me dy prirje të cilat shkojnë në kahe të kundërt me prirjet analoge në vendet industriale të zhvilluara. Edhe pse vitet e fundit ka një rritje të ndjeshme të numrit të grave të punësuar, statistikat e papunësisë të krahasuar ndërmjet të dy gjinive tregojnë se femrat janë më të prekura nga ky fenomen, i cili ndikon ndjeshëm në “feminimin” e varfërisë dhe desocializimin e grave. Prirja tjetër është rritja e numrit të grave të punësuar në ekonominë shtëpiake (bujqësi) dhe njësitë e vogla të biznesit, shumica e të cilave janë pronë e burrit. Tërheqja e grave nga sfera e punës dhe kthimi në modelin e familjes tradicionale dëmton pavarësinë ekonomike, e cila është faktor esencial për afirmimin e personalitetit dhe pjesmarrjen e tyre të barabartë në jetën e vendit. Një tregues tjetër i (pa) barazisë gjinore është shprëndarja e mundësive për ndryshimin e statusit social. Në kushtet e shoqërisë pluraliste dhe demokratike shanset dhe mundësitë për ndryshimin e sistemit të stutuseve janë të hapura për të dyja gjinitë, por ato nuk janë të shpërndara në mënyrë simetrike. Jo pak gra në përpjekje për t’u përshtatur me kushtet dhe kërkesat e ekonomisë së tregut kanë arritur suksese, duke u afirmuar si drejtuese të afta në jetën politike, shoqërore, kulturore dhe në botën e biznesit. Por realiteti tregon se janë pikërisht burrat që kanë arritur të ndryshojnë dhe ngrihen shpejt në hierarkinë statusore, duke zotëruar vende pune që janë më të paguara, duke siguruar pozicione vendimarrëse në jetën politike, në sferën e administratës publike dhe të biznesit. Ky realitet dëshmon për barrierat sociale dhe kostot më të larta të përpjekjeve që duhet të bëjnë femrat për të afirmuar personalitetin në një shoqëri të strukturuar historikisht për

dominimin e meshkujve. Statuti dhe roli dytësor i gruas në shoqëri është produkt i organizimit strukturor dhe funksionimit të shoqërisë, është shprehje e një kulture të tërë të sofistikuar në rrjedhën e historisë, e cila e ka legjitimuar pozitën superiore, dominuese dhe pushtetin e burrit në familje në sferat social – ekonomike dhe politike. Historikisht, mbi bazën e ndarjes tradicionale të roleve gjinore është ngritur struktura e organizimit të jetës në familje dhe më tej ky model është transplantuar dhe fuqizuar në jetën sociale, ekonomike dhe politike.

Progresi dhe arritja e barazisë reale gjinore në të tri fushat bazë, në familje, në fushën social – ekonomike, si dhe në jetën politike dhe publike, nuk mund të vijë spontanisht dhe as vetëm nëpërmjet shpresave për iluminimin e shoqërisë. Sigurisht që në promovimin e të drejtave të grave dhe parandalimin e formave më ekstremetë shkeljes së këtyre të drejtave, sikurse dhuna gjinore, duhet më shumë angazhim për sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e shoqërisë. Transformimi kulturor i shoqërisë është një proces i gjatë dhe kompleks dhe si i tillë kërkon jo vetëm apel, por edhe përmirësim të instrumenteve ligjore, ngritjen e strukturave mbështetëse dhe krijimin e barazisë së mundësive për punë, karrierë, vendimmarrje dhe përfaqësim, si dhe ndërgjegjësimin e një shoqërie ku barazia gjinore të jetë pranuar si një realitet i ri, ku burrat dhe gratë të kenë të njëjtat detyrime dhe të njëjtat privilegje, të njëjtat mundësi reale për afirmim të personalitetit dhe pjesmarrjes në të gjitha sferat e jetës shoqërore. Përfshirja gjerësisht e shoqërisë civile, pjesmarrja e komunitetit dhe marrja e përgjegjësisë nga pushteti vendor, fuqizimi i familjes dhe nxitja e një kulture të re të respektimit të të drejtave të grave, janë çelësi për të çuar përpara arritjen e barazisë gjinore në të gjitha fushat e jetës. Vetëm në këtë kontekst gjithëpërfshirës do të mund të parandalohen dhe eliminohen krimet në familje dhe format e dhunës gjinore. Ndryshe aspiratat dhe strategjitë për arritjen e barazisë gjinore sipas standarteve dhe koncepteve bashkëkohore do të mbeteshin thjesht një utopi.

7.2. Rekomandime

Rekomandimet në vijim synojnë që të japin një kontribut konkret në përmirësimin e nivelit të kuptimit dhe respektimit më cilësor të të drejtave të gruas në praktikë, të realizimit të parimit kushtetues të barazisë (reale) dhe rritjen e rolit të gruas në shoqëri përmes masave dhe politikave efikase. Duke konsideruar me modesti një kontribut të punës kërkimore, mendoj që këto rekomandime përcjellin dhe pasqyrojnë më së miri dhe qëllimin dhe objektivin kryesor të temës.

- Sa kohë që rezultatet tregojnë pabarazi gjinore, duhen ndërmarrë nxitje dhe nisma të metejshme për reforma ligjore e politikash. Një harmonizim i brendshëm i kuadrit ligjor mbetet ende me rëndësi.
- Strategjitë duhet të jenë të ndërthurura e të parashikojnë masa konkrete për respektimin e barazisë reale dhe eliminimin e diskriminimit, në kushtet e vendit tone dhe jo në përgjithësi vetem referuar standarteve europiane Kërkohe një koordinim i strukturave shtetërore që veprojnë në fushën kundër diskriminimit edhe me mbështetjen e fuqishme të organizmave jo qeveritare.
- Mund të krijojmë organizma të veçantë për nxitjen e barazisë në trajtim dhe luftën kundër diskriminimit. Duke qënë se vendet e Ballkanit Perëndimor në këtë fushë kanë pak a shumë të njëjta probleme mund të zhvillohet më shumë ideja e krijimit të organizmave dhe programeve ndërkufitare për mbrojtjen e të drejtave në këtë fushë.
- Angazhimi dhe pjesëmarrja në rritje e gruas në jetën publike e politikëbërje dhe vendimarrje, përmes aksioneve positive e politikave konkrete dhe gjithëpërfshirëse duhet të vazhdojë të mbetet prioritet kryesor që të adresohet.
- Të njihen dhe zbatohen instrumentet ndërkombëtarë dhe të referohen në vendimet gjyqësore, duke bërë kujdes për respektimin e standardeve të: Konventës KEFDG dhe rekomandimeve të Komitetit KEFDG si dhe vërejtjeve për Shqipërinë; Konventës së Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftënkundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”.
- Të azhurnohen në mënyrë dinamike aktorët e sistemit të drejtësisë me jurisprudencën e GJEDNJ lidhur me çështje që implikojnë nenin14 [mbrojtja nga diskriminimi], 8 [jeta private dhe familjare] dhe 12 [e drejta për martesë] të KEDNj apo edhe protokollet shtesë të KEDNJ.
- Të azhurnohen në mënyrë dinamike aktorët e sistemit të drejtësisë me rastet e KEFDG;
- Gjykatat duhet të angazhohen seriozisht në zbatimin praktik të këtij legjislacioni duke filluar që nga interpretimi i koncepteve kryesore të diskriminimit dhe trajtimit të barabartë deri tek përkufizimi i kritereve që shërbejnë si bazë për diskriminimin. E rëndësishme është të përkufizohen dhe përcaktohen masat restauruese dhe dëmshpërblimet për viktimat në fushën e diskriminimit. Kjo sigurisht mund të bëhet mbi bazën e kërkesave individuale përpara gjykatave por edhe mbi kërkesat që organizata të

ndryshme që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut mund të paraqesin përpara Gjykatës tonë Kushtetuese. Në këtë fazë të evolucionit të konceptit të luftës kundër diskriminimit duhet ndryshuar dhe koncepti tradicional i barrës së provës. Kjo për arsye se megjithëse Direktivat e BE kanë karakterin e zbatimit të drejtpërdrejtë në sistemin e brendshëm ligjor, për mendimin tim duhet patjetër që sistemi i brendshëm juridik të sqarojë deri në hollësi zbatimin praktik të këtyre Direktivave. Në këtë kuadër një rol të rëndësishëm mund të luajë edhe Komisioneri për Mbrojtjen ndaj Diskriminimit dhe Avokati i Popullit.

- Duhet të forcohet mekanizimi i kontrollit të zbatimit të dispozitave kundër diskriminimit dhe respektimit të të drejtave të gruas si në nivel qendror, por sidomos në nivel rajonal.
- Aktorët e sistemit të drejtësisë të luajnë një rol aktiv edhe gjatë seancave/proceseve gjyqësore në eliminimin e ndikimit të instituteve të së drejtës zakonore dhe paragjyqimeve gjinore;
- Hartimi i ligjeve dhe akteve nënligjore specifike kundër diskriminimit dhe trajtimit jo të barbartë në të gjitha fushat që mbulohen nga Direktivat e BE-se duhet bërë duke respektuar standardet minimale të parashikuara në këto Direktiva.
- Puna me gratë për të njohur të drejtat e tyre duhet të jetë e vazhdueshme jo vetëm përmes aktiviteteve të OJF-ve por edhe këshillimit prej institucioneve publike.
- Paralelisht, nuk duhet neglizhuar ndërgjegjësimi i meshkujve me parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit sidomos në çështjet familjare. Tregu i punës vazhdon të mbizotërohet nga meshkujt, me më pak gra të angazhuara në punësim dhe shumica prej tyre në punë janë në profesionet më pak të paguara.
- Përdorimi i medias dhe mjeteve të tjera të informacionit; përgatitja e emisioneve televizive dhe fushatave apo aktiviteteve ndërgjegjësuere duhet të jetë me agresive
- Shkolla e Magjistraturës, Dhoma Kombëtare e Avokatisë, universitetet etj. duhet të kujdesen në vazhdimësi për azhurnimin e aktorëve kryesorë të sistemit të drejtësisë me standardet e barazisë gjinore dhe kujdesin në zbatimin e tyre në proceset gjyqësore dhe jashtëgjyqësore. Kështu, nëse çështjet mund të zgjidhen me ndërmjetësim, është shumë e rëndësishme që një marrëveshje e arritur të mos çënojë këto parime bazë.
- Mungesa e sigurisë në të drejtat e shpallura dhe moszbatimi i ligjit mbeten me rëndësi prioritare.

- Mendoj se është i domosdoshëm një trajnim i vazhdueshëm dhe gjithpërfshirës i gjyqtarëve, avokatëve, prokurorëve dhe juristëve të administratës publike në këtë fushë pasi sipas raporteve të organizmave ndërkombëtare në Shqipëri niveli i gjyqësorit në luftën kundër diskriminimit, është i ulët. Kjo mund të vijë për shumë arsye, por edhe për faktin se nuk ka asnjë rast të dhënë statistikor për ankim kundër diskriminimit në gjykata tona.
- Edukimi me të drejtat dhe përgjegjësitë brenda strukturës familjare po ashtu mbetet një çështje me rëndësi.
- Dhënia e ndihmës konkrete për gratë në nevojë dhe këshillimi mbetet ende një problem për adresim sidomos kur flasim për çështje të tilla si diskriminimi, dhuna (në familje), viktimizimi etj.
- Në zonat rurale duhet të merren masa konkrete zbatuese për zhvillimin e politikave dhe strategjive konkrete për fuqizimin ekonomik, arsimor dhe social të shtresave të marxhinalizuara në këto zona duke iu dhënë akses më të shumë në burime prodhuese, të kapitalit, etj.
- Është e domosdoshme që të dhënat të jenë koherente, të përditësuara dhe të aksesueshme. Ato vlejnë për analizën e situatës, për të parë ekontrolluar ndryshimin që ka sjellë çdo aksionligjor e politikapozitive si dhe masat e përshtatshme e efektive për reduktimin e pabarazisë dhe faktorët që ndikojnë.
- INSTAT- i, Ministrinë dhe institucionet e tjera, gjykatat e të tjera agjenci që merren me çështjet e të dhënave duhet të bashkëpunojnë në këtë drejtim dhe të krijojnë statistika jo të izoluara por gjithëpërfshirëse dhe të integruara me aspektet gjinore.
- Hulumtimet e kryera në funksion të këtij studimi vunë në dukje edhe aspekte të tjera që kërkojnë më shumë kërkim, analizë dhe shtjellim. Studime mbi impaktin gjinor të pasojave personale e pasurore që vijnë nga zgjidhja e martesës apo dhuna në familje dhe pabarazitë sociale vazhdojnë te kënaqësi.
- Rritja e vetëdijes mbi të drejtat e anëtarëve të familjes mbetet një sfidë e profesionistëve sa herë hartojnë, miratojnë, zbatojnë e japin vendime sidhe mbrojnë këto të drejta.
- Është e rëndësishme që trajnimet të ndërtohen duke qasur standardet me problemet konkrete që hasin gratë dhe familja e shoqëria në Shqipëri, me qëllim që t'u jepet zgjidhje problemeve të dala në terren.

- Eliminimi i zakoneve patriarkale dhe diskriminuese është një problem gjithëpërfshirës global. Në këtë drejtim, evidentimi i modeleve pozitive që japin rezultat e që mund të adoptohen në një vend si Shqipëria mund të jetë një veprim i duhur, që t'i shërbejë adaptimit të modeleve gjithëpërfshirëse të gruas në jetën e vendit.

BIBLIOGRAFIA

1. Burime parësore

Direktiva 2000/43/KE e Këshillit Europian, Direktiva për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave, pavarësisht nga prejardhja e tyre raciale ose etnike.

Direktiva 2000/78/KE e Këshillit Europian, Direktiva Kuadër për Trajtimin e Barbartë në Punësim dhe Profesion.

Direktiva 75/117/KEE Mbi parimin e pagës së barabartë;

Direktiva 97/80/KE mbi Barrën e Provës në rastin e diskriminimit mbi bazën e seksit;

Direktiva e Këshillit 76/207/e KEE-së e 9 shkurtit 1976 për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në lidhje me qasjen në punësim, trajnimin profesional dhe ngritjen në detyrë, dhe kushtet e punës.

Direktiva mbi parimin e trajtimit të barabartë midis burrave dhe grave në aksesin dhe furnizimin me mallra dhe shërbime, *Direktiva 2004/113 / KE*.

Karta Europiane e të Drejtave të Njeriut, BE.

Kodi i familjes i Republikës së Shqipërisë

Kodi i Procedurës i Republikës së Shqipërisë

Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë

Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë

Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore, ratifikuar me ligjin Nr.8137, datë 31.7.1996 (plotësuar me protokollet shtesë).

Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas (KEFDG).

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Ligj Nr. 10221, datë. 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga të gjitha format e diskriminimit në RSH”.

Ligj Nr. 104/2012 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”.

Ligj nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”

Ligji nr. 10221, datë 4.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”

Ligji nr. 10237, date 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin ne pune”

Ligji nr. 10347, dt 4.11.2010 “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”

Ligji nr.10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”.

Ligji Nr. 108/2013, datë 28.03.2013 “Për të Huajt”,

Ligji nr.126/2013, datë 25.4.2013, “Për një shtesë dhe ndryshim në ligjin nr.10 383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”.

Ligji Nr. 144/2013 “ Për disa ndryshime në Kodin Penal të RSH”

Ligji nr.184/2013, datë 28.12.2013, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.10 383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar”.

Ligji Nr. 7703, datë.11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ligji nr. 7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në R.Sh”

Ligji nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit të punës”, i ndryshuar

Ligji nr.7995 datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit” i ndryshuar me Ligjin Nr. 8444, date 21.0.1.1999, me ligjin Nr. 8862 date 7.03.2002, me ligjin 9570 date 3.7.2006, dhe me Ligjin Nr. 10137, datë 11.05.2009.

Ligji nr. 7995 datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit” i ndryshuar me Ligjin Nr. 8444, date 21.0.1.1999, me ligjin Nr. 8862 date

Ligji nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbrit”, i ndryshuar

Ligji nr. 8331, date 16.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar.

Ligji nr. 8454, datë 4.02.1999, “Për Avokatin e Popullit” i plotësuar me ligjin nr. 8600 datë 10.04.2000

Ligji Nr. 8872, datë 29.03.2020 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar me Ligjin Nr. 10011, datë 30.10.2008 dhe Ligjin Nr. 10434, datë 23.06.2011.

Ligji Nr. 8872, datë 29.03.2020 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar me Ligjin Nr. 10011,

Ligji nr.9136, datë 11.09.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore"; i ndryshuar.

Ligji Nr. 9669, datë.18.12.2006“Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”

Ligji Nr. 9690 , datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”

Ligji Nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”

Ligji nr.8328, date 16.04.1998“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar

Ligji nr.8876 datë 4.04.2002 “Mbi shëndetin riprodhues”.

Ligji nr.9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”.

Protokolli shtesë i KEFDG (1978), Ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë 1993, me Ligjin nr.7767, datë 09.11.1993.

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2004 – 2015, të miratuar me V.K.M nr. 538, datë 12.08.2004 dhe Strategjia Kombëtare për Arsimin e Lartë (2008-2013) punëkërkesve të papunë, femra”

Traktati i Bashkimit European.

1. Burime dytësore

2. Burime dytësore

Anastasi, A. (2009), “E drejta kushtetuese e krahasuar; raste nga praktika kushtetuese dhe leksione per studentet e drejtesise”, Tirane: Dajti 2000.

Anastasi, Mandro-Balili, Shkurti, Bozo, Barazia gjinore dhe mosdiskriminimi, Tirane, 2012

Anastasi,A.(2010), Të drejtat e gruas në legjislacionin shqiptar.

Balmori, H., Urekalimi. Zhvillim- Gender, 2009

Barazia gjinore dhe vendimmarrja, (2005) Përmbledhje artikujsh, Tirane.

Barazia gjinore ne shoqeri. Pakete trajnimi mbi Ligjin Per barazine gjinore ne shoqeri, (2010) Ministria e Punes, Ceshtjeve Sociale dhe Shanseve te barabarta, Tirane.

Barazia gjinore ne vendimmarrjen lokale (2006) Tirane.

Bashkimi European, Përmbledhje Traktatesh Botim i Qendrës Europiane, 2000.

Bell, M. (2004), *The Concept of Equality*, Qendra për Legjislacionin dhe Integrimin European, Universiteti i Leicester: Trier.

Blanpain, R. (2003), *European Labour Law*, Kluwer Law International.

Ceshtjet e barazise gjinore ne standartet ligjore dhe jurisprudencen kombëtare dhe ndërkombëtare (2011) Tirane.

Collins, H. (2003), *Discrimination, Equality and Social Inclusion*, *Modern Law Review*, January.

Critical review of literature relating to the EU Directive to Combat Discrimination, botimi i Komisionit Europiane, Drejtoria e Përgjithshme e punësimit dhe Çështjeve Sociale, Korrik 2004.

De Beauvoir, S. (2002) *Seksi i Dytë*. Tiranë: Cabej

Developing anti-discrimination law in Europe, botim i Komisionit Europian, Shtator 2005.

Developing anti-discrimination law in Europe; the 27 EU Member States Compared, 2010; http://ec.europa.eu/justice/discrimination/files/comparative_analysis2010_en.pdf

EC (2003). Thematic Evaluation of the Integration of Gender in EC Development Co-operation with Third Countries. Brussels.

Emmert, F. (2000), *European Union Law (Cases)*, Kluwer Law International.

Equality and Non-discrimination, Raporti Vjetor 2005 i Komisionit Europian;

European Anti-Discrimination Law Review, Buletin ligjor i Rrjetit Europian të Ekspertëve Ligjorë në fushën e mosdiskriminimit, Tetor 2005.

European Commission: Directorate-General for Employment, Social Affairs and Equal Opportunities. Unit G1. *Equality between women and men in the European Union*. August 2005.

Feldmann, H. (2005), How Social is European social policy? www.emeraldinsight.com/0306-8293.htm;

Gencheva, M. (2004), *Gender Discrimination and the Burden of Proof in EU Legislation*, Botim i East-West Management Institute, USAID, Sofie.

Ghellab, Y. (2004), *Non-discrimination in Employment and Occupation*, Final Report 2004, Botim i Organizatës Ndërkombëtare të Punës.

Giddens, A. (2007) *Sociologjia*. Tiranë: Cabej

Gjermani, E. (2012) *Antologji*. Tiranë

Gomien, D. (2005), *Udhëzues i Shkurtër i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut*, Botim i Këshillit të Europës.

Gomien, D., & Harris, D. (1996), *Ligji dhe Praktika e Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe Kartës Sociale Europiane*, Botim i Këshillit të Europës.

Gruda, A., Barazia gjinore ne procesin e integrimin europian. Shifra dhe fakte, 2008.

Hendriks, A (2003). Reasonable Accommodation, A New Concept, Trier: Prill 2003

INSTAT (2014), *Perspektiva gjinore në Shqipëri, analizë gjinore- Census 2011*, Tiranë.

INSTAT.(2005), Femrat dhe meshkujt në Shqipëri.

Integrimi gjinor ne politika dhe strategji, Tirane, 2010

Integrimi gjinor ne praktike, Tirane, 2007

Jacoba K., Barazia gjinore dhe qeverisja vendore, Tirane, 2012.

Këshilli Europian (1996) Raporti final i Grupit të Specialistëve mbi Barazinë dhe Demokracinë

Këshilli Europian (1997) Gratë në politikë në Këshillin Europian të Shteteve anëtare

Komisioni Europian (1996) Përfshirja e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat në të gjitha politikat dhe aktivitetet e komunitetit

Komisioni Europian: Strategjia për barazi midis grave dhe burrave (2010-2015).

Krijimi i mundësive ekonomike për gratë dhe vajzat në Shqipëri. Një strategji për parandalimin e trafikimit, Tirane, 2006.

Leijenaar, Monique (1997) Integrimi, Hapi tjetër në Politikën e Mundësive të Barabarta diskutimi për takimin evropian të drejtorëve për Politikën e Mundësive të Barabarta, Amsterdam (Hollandë) 7.2.1997

Leskaj, Meminaj, Avdulaj, Gruaja në politike dhe vendimmarrje, Botim i Qendres Psiko-Sociale Vatra, Tirane, 2007.

Mc.Crudden, Cristopher (1996) Integrimi Drejtimi i duhur

Miluka Juna, Hendeku gjinor i pagave në Shqipëri. Burime dhe Rekomandime, Tirane, 2011.

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPCSSH) dhe UNWOMEN, (2012). *Raporti Kombëtar mbi Barazinë Gjinore dhe Situatën e Grave*, Tiranë.

Nanette Funk & Magda Mueller (1993) Post Komunizmi dhe Politikat Gjinore. Routledge. Londër.

NGO Report on the situation of women and girls in the Republic of Albania, Tirana, 2006.

Novicki, M. (2000), *Gurët Udhërrëfyes*, Botim i Qendrës Shqiptare për të Drejtat e Njeriut, Tiranë.

Novicki, M. (2000), Rreth konventës Europiane, Komentari i Shkurtër mbi Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, Botimet Morava.

Omari, L. & Anastasi, A. (2008) E drejta kushtetuese, "Pegi", Tiranë

Përfaqësimi dhe cilësia e demokracisë në Shqipëri, një perspektive gjinore, Aleanca Gjinore për zhvillim, Tirane, 2006.

Përmbledhje aktesh kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e barazisë gjinore, Tirane, 2007

Përmbledhje aktesh ndërkombëtare, Botim i Komitetit Shqiptar të Helsinkit, 1994.

Përmbledhje esesh, Aleanca gjinore për zhvillim, 2006.

Përmbledhje vendimesh të Gjykatës Europiane e të drejtave të njeriut, Gjykatës së Bashkimit Europian, dhe institucioneve të barazisë së rrjetit equine mbi çështje të mbrojtjes nga diskriminimi, Tirane, 2014

Picari Blerta, Barazia gjinore. Kusht për integrimin europian, Tirane, 2008

Pikat fokale të barazisë gjinore në Shqipëri, Tirane, 2008

Pitt, G. (2004), Employment Law [Fifth Edition], Sweet & Maxwell.

Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, Ministria e Integritimit, Tiranë.

Platforma udhëzuese e BE-së për barazinë ndërmjet grave e burrave (2006-2010), Botim i Qendrës së Aleancës Gjinore për Zhvillim. Tiranë, Mars 2008.

Politikat për promovimin e organizatave aktive në fushën e barazisë ndërmjet burrave e grave (2004-2006). <http://europa.eu/scadplus/leg/en/cha/c10936.htm>.

Programi i Kombeve të Bashkuara në Shqipëri. www.undp.org.al.

Putting equality into practice, Programi i Veprimit të Komunitetit për Luftën kundër Diskriminimit, Botim i Komisionit European, Mars 2006.

QNL.(2006), Institucionet shqiptare për mbrojtjen e gruas në familje.

Raport i Komisionit kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) 2001.

Raport i Komisionit kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) 2003.

Raport i Komisionit kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) 2005.

Raport monitorimi (2013), “Njohja dhe zbatimi i standarteve të barazisë gjinore në procesin gjyqësor”, QNL, Tiranë.

Raporti i barazisë ndërmjet burrave e grave (2004), <http://europa.eu/scadplus/leg/en/cha/c10934.htm>.

Raporti mbi studimin e përjasjes së legjislacionit shqiptar me Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, Këshilli i Europës, Ministria e Drejtësisë dhe Qendra Europiane, Qershor 2003.

Remedies and Sanction in EC Non-discrimination Law, Botim i Komisionit European, 2000

Sciarra, S. (2001), *Labour Law in the Courts* [National judges and the European Court of Justice], Hart Publishing, UK.

Semini M., *Përmbledhje e disa prej vendimeve të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë për çështjet e barazisë gjinore*, Tirane, 2013

Shkurti L., *Kontributi i grave në vendimmarrje*, Prishtine, 2009.

Špidla, V. (2007). “Introduction by Commissioner Vladmír Špidla.” *Vienna Yearbook of Population Research* 2007 1-3.

Studim mbi situatën në Shqipëri të grave lider në nivel vendor. Një analizë baze. (2011) Tirane.

Te jesh grua pas viteve 1990, (2007) Tirane.

The Evolution of Labour Law (Part 1 & 2), Raport i Përgjithshëm, Botim i Komisionit Europian, Qershor 2005.

The Prohibition of Discrimination under Human Rights Law, Botimi i Komisionit Europian Shkurt 2005.

Udhëzues: Çështjet e barazisë gjinore në standardet ligjore dhe jurisprudencën kombëtare e ndërkombëtare, UNIFEM dhe Shkolla e Magjistraturë, Pegi: Tiranë.

UNDP (2014) Dhuna me bazë gjinore.

UNDP Albania (2003). Sondazh mbi Statusin e Gruas në Politikë në Shqipëri. Tiranë.

UNFPA (2006). Focusing on Gender: An Assessment of Gender Integration in UNFPA Materials. New York.

UNWOMEN (2013), *Përmbledhje e disa prej vendimeve të GJED për çështjet e barazisë gjinore*, Tiranë: Albpaper.

Vendim i Këshillit 2001/51/EC më 20 Dhjetor 2000 për themelimin e Programit lidhur me strategjinë strukturore mbi barazinë gjinore (2001-2005).

Vendim nr.1, datë 8.1.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor.

Vendim nr.124, datë 5.3.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e statutit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”.

Vendim nr.1672/2006/EC i Parlamentit Europian dhe Këshillit më 25 Tetor 2006, *për themelimin e një Programi të Komunitetit për Punësim dhe Solidaritet Social - PROGRESS* [Gazeta zyrtare L 315 e datës 15.11.2006].

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.396, datë 22. 08. 1994 "Për Arsimin 8-Vjeçar në Gjuhën Amtare të Personave të Minoriteteve"

VKM nr.1087 datë 28 .10.2009 “Për miratimin e Planit Kombëtar të veprimit për Dekadën e Përfshirjes së Romëve 2005-2015”.

VKM nr.366, datë 15.04.2009 Për kompensimin e pagesës për pajisjen me letërnjoftim të shtresave në nevojë.

VKM nr.437, datë 8.04.2008 “Për anëtarësimin e Këshillit të Ministrave të RSH-së në Deklaratën “Dekada e Përfshirjes së Romëve”.

Waldijk, K. (2004), Combating sexual orientation discrimination in employment, Raport i Grupit të Ekspertëve Europianë për Luftën kundër Diskriminimit mbi Bazën e Orientimit Seksual, Prill 2004.

Weiwei, L. (2004).*Equality and Non-Discrimination Under International Human Rights Law*, botim i Qendrës Norvegjeze për të Drejtat e Njeriut, Mars 2004.

Zaçe, V.(1999), Marrëdhëniet martesore sipas legjislacionit shqiptar.

3. Burime nga interneti

www.mfa.gov.al;

www.qpz.gov.al.

www.unioniamarodrom.com

www.errc.org

<http://eur-lex.europa.eu>.

